

E DREJTA – LAW

Përmbajtja – content

Prof. Dr. Enver Hasani

Rasti i Asociacionit serb në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës

The Case of a Serb Association before the Constitutional Court of Kosovo

Prof. Dr. Arsim Bajrami & MA. sc. Florent Muçaj & Përparim Gruda

Konstitucionalizimi dhe kontrolli kushtetues i partive politike rasti i Kosovës

Constitutionality and the control of political parties - Kosovo's case

Prof. Ass. Dr. Haxhi Gashi,

Regjistrimi i pronësisë dhe të drejtave tjera sendore në Kosovë: vështrim kritik në perspektivë komparative

The registration of property and other real rights in Kosovo: A critical review from a comparative perspective

Prof. Ass. Dr. Remzije Istrefi

Kuptimi i nocionit të drejtësisë tranzicionale dhe i pajtimit nga perspektiva ndërkombëtare e ndërtimit të paqes

Notion of the Transitional Justice and Reconciliation from a Standpoint of International Peace Building

Prof. Ass. Dr. Rustem Qehaja

Rregullimi ligjor i hipotekës në Kosovë

Legal regulation of mortgage in Kosovo

Dr. Enkelejda Turkeshi

Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale: vështrim krahasues mbi legjislacionin penal mjedisor në Shqipëri dhe Kosovë

The protection of environment through criminal law: a comparative analysis of the environmental criminal laws of Albania and Kosovo

MA. sc. Emine Abdyl

Trafikimi me njerëz në Kosovë dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit

Human Trafficking and the Protection of the Victims of Trafficking

E DREJTA - LAW

Nr.1-4/2015

E DREJTA LAW

Nr.1-4/2015



Revistë për Çështje Juridike dhe Shoqërore
Journal for Juridical and Social Issues

Prishtinë, 2016



E DREJTA – LAW

**Revistë për çështje Juridike dhe Shoqërore
Journal for Juridical and Social Issues
Viti XLI - Nr. 1-4 - 2015**

**Botues – Publisher
Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës
University of Prishtina School of law**



E Drejta – Law

Revistë për Çështje Juridike dhe Shoqërore

Journal for Juridical and Social Issues

Viti XLI - Nr. 1-4 - 2015

Botohet çdo tre muaj – published every three months

Redaksia – Editorial Staff

Anëtarë

Dr. sc. Abdulla Aliu, prof. i rreg., Dr. sc. Haki Demolli, prof. i rreg., Dr. sc. Bedri Peci, prof. asoc., Dr. sc. Visar Morina, prof. asoc., Dr. sc. Qerim Qerimi, prof. ass., MA. sc., Dren Doli, MA. sc. Vigan Qorrolli, MA. sc. Qerkin Berisha

Kryeredaktor – Editor-in-chief

Dr. sc. Qerim Qerimi

Redaktor përgjegjës – Editor

MA. sc. Qerkin Berisha

Shtypi:

Shtypshkronja NORD

Prishtinë

Përmbajtja – Content

Artikuj – Articles

(Summaries in English)

Prof. Dr. Enver Hasani

Rasti i Asociacionit serb në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës7
The Case of a Serb Association before the Constitutional Court of Kosovo

Prof. Dr. Arsim Bajrami & MA. sc. Florent Muçaj & Përparim Gruda

Konstitucionalizimi dhe kontrolli kushtetues i partive politike rasti i Kosovës
.....35
Constitutionality and the control of political parties - Kosovo's case

Prof. Ass. Dr. Haxhi Gashi

Regjistrimi i pronësisë dhe të drejtave tjera sendore në Kosovë: vështrim kritik në perspektivë komparative73
The registration of property and other real rights in Kosovo: A critical review from a comparative perspective

Prof. Ass. Dr. Remzije Istrefi

Kuptimi i nocionit të drejtësisë tranzicionale dhe i pajtimit nga perspektiva ndërkombëtare e ndërtimit të paqes89
Notion of the Transitional Justice and Reconciliation from a Standpoint of International Peace Building

Prof. Ass. Dr. Rrustem Qehaja

Rregullimi ligjor i hipotekës në Kosovë111
Legal regulation of mortgage in Kosovo

Dr. Enkelejda Turkeshi

Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale: vështrim krahasues mbi legjislacionin penal mjedisor në Shqipëri dhe Kosovë127
The protection of environment through criminal law: a comparative analysis of the environmental criminal laws of Albania and Kosovo

MA. sc. Emine Abdyli

Trafikimi me njerëz në Kosovë dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit147
Human Trafficking and the Protection of the Victims of Trafficking



Artikuj
Articles

Prof. dr. Enver Hasani

Rasti i asociacionit serb në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës

Hyrje

Kur prof. B. Banaszak më dërgoi, më 16 mars 2016, një kërkesë për shkruar një punim për nder të profesorit të dashur Arnold Rainer në një afat deri në mes të muajit prill 2016, nuk kisha si të mendoja për diçka tjetër pos për një temë nga Ballkani, për rajonin, njerëzit dhe projektet hulumtuese të të cilit aq shumë i ka mbështetur prof. Arnold Rainer gjatë tërë karrierës së tij profesionale dhe akademike. Mendova se kjo temë do të ishte një shenjë simbolike e respektit të thellë që kam për prof. Arnold Rainer, i cili asnjëherë nuk e la Kosovën anash në debatet e në diskutimet akademike të juristëve evropianë, siç do të kishin dashur disa. Në fakt, ishte profesori Rainer ai që, në shtatorin e vitit 2009, kishte ftuar autorin e këtyre rreshtave që, në cilësinë e kryetarit të parë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, e sapoformuar pak muaj më herët, të marrë pjesë në Kongresin XI mbi të Drejtën Komparative Kushtetuese dhe Forumin Kushtetues Evropian, që u mbajt në Regensburg të Gjermanisë në dhjetor të vitit 2009.

Marrëdhëniet Kosovë-Serbi, në kuptimin politik, përbëjnë njëën e qetësisë në Ballkanin Perëndimor. Këto marrëdhënie janë pjesë e peizazhit të përgjithshëm ballkanik të marrëdhënieve serbo-shqiptare, marrëdhënie të cilat nuk kanë pasur një harmoni e qetësi për të shumtën e kohës. Këtu e kemi fjalën për kohën e fillimit të shekullit XIX e deri më sot, pra për kohën nga fillimi i formimit të shteteve nacionale në Ballkan, kur ballkanasit luftuan për emancipim e për çlirim nga Perandoria Osmane. Ky punim, sigurisht, nuk ka për qëllim që të merret më çështjet e nacionalizmit në Ballkan, e as me marrëdhëniet e popujve të Ballkanit nga këndvështrimi historik. Qëllim dhe synim i këtij punimi është të sqarojë aspektet juridiko-kushtetuese të disa marrëveshjeve të lidhura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në vazhden e stabilizimit të marrëdhënieve në mes të këtyre dy vendeve të trazuara të Ballkanit.

Aspektet juridiko-kushtetuese të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të cilat kanë dominuar skenën politike, publike e akademike gjatë këtyre tre vjetëve të fundit që kur filloi dialogu me Serbinë në Bruksel, në vitin 2013, me ndihmën dhe me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, nuk kanë qenë edhe aq dominante. Aspektet politike kanë qenë dhe mbeten primare në marrëdhënien Kosovë-Serbi. Aspektet juridiko-kushtetuese kanë qenë kryesisht të lidhura për natyrën juridike-kushtetuese dhe me vendin e disa marrëveshjeve të lidhura ndërmjet dy vendeve. Nuk ka rëndësi që dialogu me Serbinë nuk doli të jetë krejt teknik, siç thuhej dhe siç ishte më 2005, kur autori i këtyre rreshtave kishte udhëhequr një dialog Kosovë-Serbi me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian e të SHBA-së, kur asnjë marrëveshje nuk u arrit në Vjenë përveç marrëveshjes që të vazhdohet me dialog edhe në të ardhmen. Këto aspekte krejt socio-politike, që vetëm më vonë do të reflektohen në dimensionin e tyre juridik-kushtetues, do të trajtohen në seksionin e parë të këtij punimi. Kjo sepse vetëm kështu mund të hapet rruga për të kuptuar seksionin e dytë në vijim, ku flitet për vendin dhe për fuqinë juridiko-kushtetuese të traktateve ndërkombëtare në sistemin e brendshëm kosovar.

Në diskursin kosovar, pas kontrollit kushtetues të *Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë*, të 19 prillit 2013, ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës më 27 qershor 2013 me Ligjin nr. 04/L-199 (në tekstin e mëtejshëm: *Marrëveshja e Parë*), u pa qartë se ka një mosnjohje të skajshme të koncepteve bazike nga e drejta kushtetuese që lidhen me ratifikimin, me llojet dhe me funksionin e tij, me vendin dhe me fuqinë juridiko-kushtetuese të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në sistemin e brendshëm juridik-kushtetues kosovar, si dhe me statusin e marrëveshjeve ndërkombëtare të paratifikuara në kuadër të këtij sistemi, përfshirë këtu edhe mundësitë eventuale të kontrollit të tyre kushtetues. Kjo mosnjohje, në veçanti, shihet në mesin e komunitetit juridik, por edhe më gjerë në publikun e gjerë kosovar. Kjo rrethanë u bë krejt e qartë pas nënshkrimit, më 25 gusht 2015 në Bruksel, të *Marrëveshjes mbi Parimet e Përgjithshme Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe* (në tekstin e mëtejshëm: *Marrëveshja e Dytë*). Kjo marrëveshje nuk iu nënshtrua asnjë ratifikimi, por që, lidhur me të, Gjykata Kushtetuese u prononcua në një mënyrë krejtësisht të çuditshme me Aktgjykimin KO130/15, të 23 dhjetorit 2015, i cili do të elaborohet në këtë shkrim gjerësisht në vijim.¹

¹ Aktgjykim në rastin nr. KO130/15. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar

Këto dy çështje, pra çështja e vendit dhe e rolit të marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin juridik-kushtetues kosovar, si dhe kushtet e mënyrat për aplikim të kontrollit kushtetues ndaj tyre, do të jenë objekt i një trajtimi të veçantë në seksionet tre dhe katër të këtij punimi, duke bërë të qartë se ka një dallim substancial ndërmjet paragrafit 1, të nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës së Kosovës dhe paragrafit 2 të po këtij neni, diçka që ekziston pak a shumë thuajse në të gjitha kushtetutat e vendeve evropiane, si të ish-vendeve komuniste ashtu edhe të demokracive tradicionale të Kontinentit të vjetër. U mor vesh, formulimet e dispozitave dallojnë, por mesazhi ngel i njëjtë: ekzistojnë disa lloje të marrëveshjeve ndërkombëtare që i nënshtrohen ratifikimit të brendshëm nga ana e organit përfaqësues, por edhe disa të tjera që mund të ratifikohen edhe nga Shefi i Shtetit, nga Qeveria ose nga organi tjetër kushtetues i autorizuar për një gjë të tillë. Ratifikimi i këtyre të fundit quhet ratifikim ndërkombëtar, për dallim nga ratifikimi i brendshëm ose kushtetues që ka të bëjë me rastet kur akti i ratifikimit ndërmerret nga parlamenti. Dy llojet e ratifikimit do të diskutohen e do të trajtohen në këtë punim.

1. Rrethanat e krijimit të rastit

Marrëdhëniet Kosovë-Serbi, siç e thamë më sipër, nuk janë objekt trajtimi i këtij punimi, në veçanti jo në aspektin e historisë së tyre dhe të problemeve që janë krijuar përgjatë shekujve.² Sa për lexuesin jo mjaft të informuar, megjithatë, besojmë që ka nevojë të thuhet disa fjalë shumë shpejt e shkurt lidhur me atë se si ka ardhur gjendja deri këtu, kur Gjykata Kushtetuese e Kosovës duhet të merret me aspektet kushtetuese të marrëdhënieve Kosovë-Serbi.

Kosova, në periudhën prej mbarimit të Luftës së Parë e deri në mbarim të Luftës së Ftohtë, ka qenë pjesë e asaj që njihet si ish-Jugosllavi. Ndërmjet dy luftërave botërore, Jugosllavia ka qenë me rregullim shtetëror monarkik, për

“Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore” me frymën e Kushtetutës, me nenin 3.1 [Barazia para Ligjit], me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Prishtinë, 23 dhjetor 2015.

² Për këtë çështje, shih më shumë te libri i jashtëzakonshëm i Noel Malcolm-it, *Kosovo. A Short History* (New York University Press: New York, 1999). Në fakt, analiza jo vetëm historike, por edhe juridike-ndërkombëtare e statusit të Kosovës brenda ish-Jugosllavisë ngërthen një mprehtësi të veçantë të autorit që meriton edhe vëmendje të veçantë. Kjo bëhet në kapitullin e fundit që flet për Kosovën pas vdekjes së Titos, deri më 28 prill 1999, kur është dorëzuar për botim dorëshkrimi i librit.

t'u kthyer në një republikë komuniste pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Si e tillë, pra si republikë komuniste, ish-Jugosllavia ka ekzistuar deri në mbarim të Luftës së Ftohtë kur edhe qe shpërbërë. Nga rrënojat e saj u krijuan fillimisht pesë shtete sovrane dhe të pavarura, e më vonë, më 17 shkurt 2008, nga mbetjet e asaj që u krijuan më 1992 si Republika Federale e Jugosllavisë (Serbi-Mali i Zi) u krijua edhe shteti i Malit të Zi dhe shteti i Kosovës, si dy shtete sovrane e të pavarura. Trashëgimia i ish-Jugosllavisë dhe mbyllja e procesit të shpërbërjes në planin ndërkombëtar kishin ndodhur *de facto* më 1992, kurse *de jure* vetëm më 2001, kur u lidh Marrëveshja mbi Trashëgiminë ndërmjet pesë shteteve të dala nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë.³ Me pavarësimin e Malit të Zi, më 3 qershor 2006, trashëgimia ndërmjet këtij shteti dhe Serbisë ka ndodhur më automatizëm sipas një marrëveshjeje të lidhur nga to në Beograd, më 2002, duke ia ndërruar emrin nga “Republika Federale e Jugosllavisë” në “Unioni Serbi-Mali Zi”. Sipas kësaj marrëveshjeje, largimi eventual i njërit prej anëtarëve nga Unioni nënkuptonte që secili duhet t'i zbatojë në mënyrë paqësore dhe me marrëveshje dispozitat e Marrëveshjes së Vjenës të vitit 2001 për trashëgiminë e ish-Jugosllavisë.

Kosova, pas 10 qershorit 1999, u fut nën administrim ndërkombëtar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (KS). Kjo rezolutë e mandatonte KS-në që në Kosovë të instalonte një administratë ndërkombëtare me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve vendore për vetëqeverisje lokale, deri në zgjidhjen e statusit politik të Kosovës. Në aspektin formal, sipas kësaj rezolute, Kosova akoma trajtohej si pjesë formale e Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbi-Mali i Zi), përkatësisht e Unionit Serbi-Mali Zi, ku sovraniteti i këtij shteti mbi Kosovën quhej si i suspenduar. Më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë pas një sërë negociatash të ndërmjetësuar nga ish-presidenti finlandez Martti Ahtisaari, i cili hartoi një projekt ndërkombëtar mbi bazën e të cilit Kosova shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008.⁴ Ky projekt, i njohur si

³ Marrëveshja është lidhur në Vjenë, më 29 qershor 2001, ndërmjet Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbi-Mali i Zi), Sllovenisë dhe Maqedonisë. Për trajtim akademik të kësaj marrëveshjeje, Cf. më shumë: Enver Hasani, *The Evolution of Succession Process in Former Yugoslavia*, botuar në *Tomas Jefferson Law Review*, Vol. 29, No. 1, 2006 (SHBA); ribotuar me leje te autorit edhe në *Miskolc Journal of International Law*, Vol. 4, No. 2, 2007 (Hungari). Për versionin e përditësuar të këtij punimi në gjuhën shqipe, Cf. Enver Hasani, *Specifikat e trashëgimit të ish-Jugosllavisë dhe pozita e Kosovës në të*, botuar në *E DREJTA/LAW*, nr. 1/2012 (revistë për çështje juridike dhe shoqërore), Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Prishtinë (Kosovë).

⁴ Në prill të vitit 2007, Emisari Special i OKB-së, Martti Ahtisaari, ka parashtuar në KS të OKB-së *Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës* (Plani Ahtisaari). Plani Ahtisari ka një tekst kryesor me 15 nene të cilat përcaktojnë parimet e përgjithshme, si

Plani Ahtisaari, nuk u pranua nga pala serbe e as nga KS i OKB-së, i cili edhe kishte mandatuar misionin e presidentit Martti Ahtisaari me qëllim të zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës. Më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) deklaroi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk mund të kontestohet sepse nuk binte ndesh me asnjë pjesë të së drejtës pozitive ndërkombëtare.⁵

Sado që Plani Ahtisari kishte parashikuar një mekanizëm shumë të detajuar e unik për kushtet kosovare për mbrojtjen e komuniteteve joshumicë, çështja e mbrojtjes dhe e promovimit të komuniteteve joshumicë në Kosovë, me kuptim këtu në rend të parë komunitetin serb, ngeli një problem akut. As ajo që u cilësua si decentralizim, i nisur para vitit 2008 por që më pastaj u vazhdua, nuk ka dhënë një përgjigje të kënaqshme në këtë aspekt, ashtu që sërish u hap një dialog teknik që filloi gjatë vitit 2011 e që akoma zgjat deri në kohën e shkrimit të këtij punimi. Në kuadër të këtij dialogu teknik kanë lindur disa marrëveshje, prej të cilave, për qëllimet e këtij punimi, më të rëndësishme janë dy: Marrëveshja e Parë dhe Marrëveshja e Dytë.

Marrëveshja e Parë ka gjithsej 15 paragrafë, prej të cilëve paragrafët 1 deri në 6 flasin gjerësisht dhe në mënyrë konkrete për themelimin e një asociacioni të komunave me shumicë serbe. Ky asociacion, sipas tekstit të Marrëveshjes së Parë, themelohet nëpërmjet Statutit dhe modelohet mbi bazën e strukturës e formës së asociacionit ekzistues të komunave të Kosovës.

Marrëveshja e Dytë ka gjithsej 22 paragrafë dhe në tërësi shtjellon dispozitat e Marrëveshjes së Parë, por duke e cilësuar tani si një asociacion që mbron e që promovon interesat e serbëve lokalë, që ka një status juridiko-

dhe 12 ankese që elaborojnë këto parime. Plani Ahtisaari ka të bëjë në rend të parë me mbrojtjen e të drejtave, të identitetit dhe të kulturës së komuniteteve joshqiptare të Kosovës, duke përfshirë këtu themelimin e një kuadri për pjesëmarrjen e tyre në jetën publike. Emisari Special Martti Ahtisaari propozoi që Kosova të bëhej e pavarur me kusht që të ketë një periudhë të mbikëqyrjes së kësaj pavarësie të Kosovës. Titulli i plotë i Planit Ahtisaari është *Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës*, 2 shkurt 2007.

⁵ Ky mendim këshillëdhënës është kërkuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me insistimin e Qeverisë së Serbisë. GJND-ja, me këtë mendim këshillëdhënës, ka bërë të qartë në mënyrë elokvente se deklarimi i pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 ka ndodhur si rezultat i ushtrimit të *pouvoirs constituant* përmes përfaqësuesve të vet krejtësisht jashtë rendit juridik të krijuar nga UNMIK-u. Sipas GJND-së, kjo nënkuptonte se rendi i ri juridiko-kushtetues, i krijuar në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë, është një rend tërësisht i ri dhe i ndryshëm nga rendi pararendës. Për më tepër, ky rend as që mëtonte të ishte vijimësi e rendit paraprak që ka ekzistuar në Kosovë në çdo kohë deri më 17 shkurt 2008 kur u shpall pavarësia e Kosovës. Më shumë për këtë shih paragrafët 52-56; 74-84; 96-109; dhe 114-121, të mendimit këshillëdhënës të GJND-së të 22 korrikut 2010 lidhur me atë nëse deklarata e njëanshme e shpalljes së pavarësisë së Kosovës ishte në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

administrativ *on par* me personat juridikë nga e drejta publike në Kosovë me të gjitha pasojat që bart një status i tillë juridiko-kushtetues, që Qeverisë i jep tagrin e dekretimit të Statutit të Asociacionit, kurse Gjykatës Kushtetuese një “juridiksion shtesë” sa i përket kontrollit të kushtetutshmërisë së këtij statuti pasi të jetë draftuar nga komisioni menaxhues dhe pas vërtetimit me dekret qeveritar. Në shikim të parë, duket qartë se Marrëveshja e Dytë dukshëm del nga kuadri i përcaktuar i Marrëveshjes së Parë sepse krijon statuse, të drejta dhe detyrime të nivelit lokal, që mund të cenojnë rëndë parimet themelore të sistemit kushtetues kosovar. Për këtë kemi folur gjerësisht akoma para prononcimit të Gjykatës Kushtetuese me verdiktin e vet KO130/95, të 23 dhjetorit 2015.⁶

Opozita kosovare, që nga momenti i bërjes publike në gusht të vitit 2015 të tekstit të Marrëveshjes së Dytë, ka filluar kundërshtimin e saj, përfshirë këtu edhe metodat jopolitike e violente. Fjalët çelës të opozitës kanë qenë nga fillimi se fare nuk duhet të ndodhë themelimi i Asociacionit të Komunave Serbe, ndërkohë që Qeveria deri në fund ka qenë e bindur se kjo duhet të ndodhë dhe se, në këtë drejtim, nuk ka pasur asnjë tejkallim të kompetencave të saj me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Dytë, më 25 gusht 2015. Situata jashtëzakonisht e tensionuar politike bëri që znj. Atifete Jahjaga, presidente e Kosovës, çështjen ta dërgojë në Gjykatën Kushtetuese, në vijim të vënies në jetë të kompetencave të saj kushtetuese si përfaqësues i unitetit juridik-kushtetues të popullit të Kosovës.⁷ Kërkesa u dërgua më 31 tetor 2015 dhe me të kërkohej që Gjykata të përgjigjej në pyetjen si vijon:

“Duke marrë parasysh se Parimet e Asociacionit rregullojnë krijimin dhe funksionimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, a janë në përputhshmëri këto parime dhe elemente me frymën e Kushtetutës, neni 3, paragrafi 1 (natyra shumetnike), me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës?”.

Nga kërkesa qartë shihet se Presidentja nuk ka konsideruar që Kosova ka ndonjë detyrim ndërkombëtar për Kosovën nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Dytë nga ana e Kryeministrit të Kosovës. Për më tepër, fare nuk merret se

⁶ Shkrimi i parë publik që konstaton disa cenime të rënda kushtetuese të tekstit të Marrëveshjes së Dytë i ka bërë autori i këtyre rreshtave në një shkrim të gjatë të titulluar: *Marrëveshja ia njej pushtetin kushtetutbërës Asociacionit*, botuar në të përditshmen kosovare *ZËRI DITOR*, më 4 nëntor 2015 (fq. 10-11). Në këtë punim pak a shumë trajtohen gjërat e njëjta me ato të botuara në gazetën e sipërcituar *ZËRI DITOR*.

⁷ Neni 83 [Statusi i Presidentit] i Kushtetutës: “Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës”.

Marrëveshja e Dytë ka formën apo përmbajtjen e një detyrimi valid ndërkombëtar të shtetit të Kosovës. Kjo sjellje kështu ka kushtëzuar edhe sjelljen dhe përgjigjen e Gjykatës dhe buron si pasojë e situatës jashtëzakonisht të nderë që aktualisht mbretëron në Kosovë që nga vjeshta e vitit 2014. Megjithatë, kjo vetëm u tha sa për të treguar arsyet e një kërkesë të tillë të bërë në panik, si dhe të një verdikti të Gjykatës të dhënë po ashtu në panik. Kjo në asnjë mënyrë nuk amnistion padijen profesionale respektive të aktorëve si më sipër, të cilët në çdo situatë e nën çdo presion duhet ta mbrojnë Kushtetutën e Kosovës, dispozitat e saj që janë esenciale për të ruajtur reputacionin e Kosovës ndërkombëtarisht, të atyre dispozitave që flasin për statusin juridiko-kushtetues të detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës të marra nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare. Parimi i proporcionalitetit me rastin e gjykimit dhe zgjidhjes së çështjeve që kanë implikime ndërkombëtare vjen i pari në këtë aspekt⁸. Kjo nënkupton se nuk ka logjikë dhe nuk shkon që Gjykata Kushtetuese të luajë rolin e një gjykate ndërkombëtare dhe të amnistojë gabimet e padijen e politikës kosovare, të bëra në planin ndërkombëtar nëpërmjet shtjellimeve juridiko-kushtetuese që nuk kanë mbështetje në asnjë teori ose praktikë kushtetuese komparative. Ta shohim më nga afër këtë problematikë.

2. Vendi i marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin e brendshëm

Në Evropë, për momentin, ekzistojnë tri lloje të sistemeve juridiko-kushtetuese që përcaktojnë vendin dhe rolin e traktateve ndërkombëtare në sistemin e brendshëm⁹. Në disa shtete, kushtetutat nacionale u japin një status special, në veçanti kur flitet për traktatet nga fusha e të drejtave të

⁸ Siç e ka thënë Hans Kelsen shumë kohë më heret, më 1929, nuk ekzistojnë pengesa juridike që të parashikohet kontrolli kushtetues represiv i marrëveshjeve ndërkombëtare. As në të drejtën kushtetuese nuk ka një pengesë të tillë. Por, sipas tij, ka pengesa të natyrës politike që shteti duhet mirë t'i peshoj kur vendos për një hap të tillë, gjithnjë me supozim që në tekstin kushtetues ekziston një dispozitë e tillë shprehimore që lejon kontrollin kushtetues represiv të marrëveshjeve ndërkombëtare. Cf. më shumë për Hans Kelsen, si dhe për zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe shtjellimet tjera të tij në mes të dy luftërave botërore, në disertacionin e pabotuar të doktoratës të Olivera Vucic, *Austrijsko ustavno sudstvo – çuvar federacije i ustava* (mbojtur mw 1995 nw Fakultetin Juridik nw Universitetin e Beogradit), fq. 200-204.

⁹ Mbi statusin e marrëveshjeve ndërkombëtare në të drejtën e brendshme në përgjithësi në aspektin komparativ, Cf. më shumë Anne Peters, "Supremacy Lost: International Law Meets Domestic Constitutional Law". *Vienna Journal on International Constitutional Law*. Vol 3 Issue 3 (September 2009) fq. 170-198.

njeriut;¹⁰ në disa të tjera, traktatet kanë statusin ndërmjet kushtetutës dhe ligjit;¹¹ dhe, së fundi, në disa vende evropiane, traktatet e të gjitha llojeve, me kushtetutë nacionale, gëzojnë statusin e ligjit të zakonshëm.¹² Këtu bën përjashtim Holanda, e cila i jep një primat absolut të drejtës ndërkombëtare, pa marrë parasysh burimin e saj (traktat, zakon ndërkombëtar apo burim tjetër i të drejtës ndërkombëtare).

Kosova bën pjesë në kategorinë e shumicës së shteteve evropiane që traktatit ndërkombëtar ia njohin fuqinë mbi ligjin e zakonshëm dhe nën dispozitat kushtetuese, me përjashtim të traktateve mbi të drejta e njeriut të cilat kanë fuqinë e normës kushtetuese si çdo normë tjetër kushtetuese.¹³ Kjo zgjidhje e

¹⁰ Kjo është kështu me shumicën e shteteve të ish-lindjes komuniste ku traktatet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut kanë status të privilegjuar në sistemin e tyre juridiko-kushtetues, duke qëndruar mbi ligjet e zakonshme, në disa raste edhe baras me vetë kushtetutat nacionale (p.sh., Shqipëria dhe Maqedonia). Ky trend i ndërkombëtarizimit ka filluar pas mbarimit të Luftës së Ftohtë. Cf. më shumë në materialet si vijon: Eric Stein, "International Law in Internal Law: Towards Internationalisation of Central – Eastern European Constitutions". *American Journal of International Law* Vol. 88 No. 3 (July 1994) fq. 427-450; European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), "The Relationship Between International and Domestic Law". *Science and Technique of Democracy* No. 5 . CDL – STD (1995) 005 (Strasbourg , 15 September 1993), në veçanti seksioni: *The Implementation of International Human Rights Agreements*.

¹¹ Ky është standardi i pranuar nga shumica e vendeve evropiane, pa llogaritur këtu traktatet mbi të drejtat e njeriut. Kjo do të thotë se, në shumicën e vendeve evropiane, traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga parlamenti bëhen pjesë e sistemit të brendshëm pas publikimit të tyre në një gazetë zyrtare dhe mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke pasur kështu fuqinë mbi ligjin e zakonshëm që rri sipas fuqisë juridike menjëherë pas dispozitave kushtetuese. Cf. Thomas Burgenthal, "Modern Constitutions and Human Rights Treaties". *Columbia Journal of Transnational Law* Vol. 36 (Special Double Issue) 1997, fq. 211-223; European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), "The Relationship Between International and Domestic Law", në veçanti seksioni: *The Elaboration of Model Clauses on the Relationship Between International and Domestic Law*.

¹² Në Britaninë e Madhe dhe në vendet e tjera të modeluara sipas saj, nuk bëhet ndonjë dallim ndërmjet traktateve ndërkombëtare të përgjithshme dhe atyre mbi të drejtat e njeriut, sepse dy llojet e traktateve në fjalë kanë statusin e ligjit të zakonshëm britanik. Cf. më shumë te Anthony Aust, *Modern Treaty Law in Practice* (Cambridge University Press: Cambridge, 2000) pp. 151-154.

¹³ Kjo shihet shumë qartë nga vetë formulimi i nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. Ky nen përcakton, *inter alia*, se të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të cilat përmenden në këtë nen, garantohen me Kushtetutë dhe zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës. Në rast konflikti, thuhet më tej në këtë nen, ndërmjet dispozitave të ligjeve dhe të akteve të tjera të institucioneve publike kosovare dhe këtyre dokumenteve ndërkombëtare, atëherë përparësi kanë këto të fundit.

fundit ekziston edhe në rastin e Bosnjës e Hercegovinës, ani se atje detyrimi kushtetues është pjesë përbërëse e Marrëveshjes së Dejtonit (1995), si marrëveshje ndërkombëtare e regjistruar në Sekretariatit e OKB-së.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar më 9 prill 2009, ka përcaktuar qartë një standard të marrëdhënies në mes të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ligjeve kosovare, duke ua njohur të parave statusin më të ulët se Kushtetuta e më të lartë se ligji i zakonshëm. Ky standard i vënë kësajsoj nënkupton që çdo normë, e cila bie ndesh më një normë ndërkombëtare kontraktuale, shfuqizohet në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj të fundit.¹⁴ Tani këtu shtrohet pyetja nëse një status të tillë juridiko-kushtetues e kanë vetëm marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Kosovës (ratifikimi i brendshëm),¹⁵ në kuptim të nenit 18. 1 të

Dokumentet ndërkombëtare, të cilat përmenden në nenin 22 të Kushtetutës si më sipër, janë si vijon: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; dhe (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Sikundër shihet, nga kjo listë përjashtohen marrëveshjet apo dokumentet ndërkombëtare që garantojnë të drejtat socio-ekonomike. Kjo për faktin se në një vend si Kosova, një listim i tillë do të shkaktohte pritje joreale dhe keqkuptime, të cilat do të mund të shërbenin si bazë për revolucione e përmbysje të tjera sociale në çdo kohë.

Në fund të kësaj, vlen të theksohet se, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, e tërë praktika gjyqësore dhe çdo praktikë tjetër e organeve publike në Kosovë duhet të mbështetet në interpretimet e GJEDNJ-së. Këtë, shprehimisht, e vë në dukje dispozita e nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, e cila thotë: “Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

¹⁴ Neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] i Kushtetutës: “1. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe kur zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji; 2. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës”.

¹⁵ Fjala “ratifikim” ka rrënjë latine dhe ka kuptimin e pëlqimit, të vërtetimit. Si e tillë, ajo përbëhet nga dy pjesë: e para, *ratus*, që domethënë i vlefshëm dhe, e dyta, *facere*, që domethënë për të bërë.

Ekzistojnë dy lloje të ratifikimit: ratifikimi i brendshëm dhe ratifikimi ndërkombëtar. Ratifikimi ndërkombëtar është një dokument formal-juridik më të cilin shteti jep pëlqimin në planin ndërkombëtar për t’u konsideruar i lidhur për një marrëveshje ndërkombëtare. Ratifikimi i brendshëm bëhet në shumicën e rasteve nga organi përfaqësues.

Kushtetutës,¹⁶ apo çdo marrëveshje tjetër ndërkombëtare, pa marrë parasysh llojin e ratifikimit, siç përcaktohet në nenin 18.2 të Kushtetutës, i cili formulim nuk dallon në esencë për nga mesazhi që bart nga kushtetutat e vendeve të tjera evropiane?¹⁷ Kjo për arsye se ka marrëveshje ndërkombëtare që lidhen në mënyrë të vlefshme sipas dispozitave të Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve, të vitit 1969 (në tekstin e mëtejshëm: KVDT), përkatësisht sipas standardeve të së drejtës zakonore ndërkombëtare, por të cilat nuk i nënshtrohen ratifikimit të brendshëm. I tillë është rasti me Marrëveshjen e Dytë, e cila në pikëpamje të së drejtës ndërkombëtare zakonore ka statusin e marrëveshjes së lidhur në vazhdim të zbatimit të qëllimeve dhe të objektit të Marrëveshjes së Parë. Nga aspekti i të drejtës së brendshme, Marrëveshja e Dytë ka karakter të legjislacionit implementues që administron mënyrën e zbatimit dhe detajet e tjera që lidhen me vënien në jetë të Marrëveshjes së Parë. Lidhja e Marrëveshjes së Dytë në Bruksel, më 25 gusht 2015, sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare është e barabartë me ratifikimin ndërkombëtar.

Në kohët e vjetra, ratifikimin e brendshëm e ka bërë mbreti dhe ka pasur efekt retroaktiv ngaqë me aktin e tillë mbreti ka vërtetuar *post festum* veprimet e përfaqësuesit të tij. Më vonë, kjo prerogativë iu njoh parlamentit dhe që atëherë ka shërbyer si një mjet kontrolli ndaj veprimeve të ekzekutivit. Kjo ka qenë pjesë e luftës për parlamentarizëm.

Ndërkohë që ratifikimi i brendshëm është kategori që rregullohet më kushtetutë, ratifikimi ndërkombëtar normohet me nenin 14 [Consent to be Bound by A Treaty Expressed by Ratification, Acceptance or Approval] lidhur me nenin 2 [Use of Terms] të KVDT. Shih, për më tepër, te Frank Hoffmeister, *Consent to be bound by a treaty expressed by ratification, acceptance or approval*; te Dörr, Oliver, Schmalenbach, Kirsten (Eds.), *Vienna Convention on the Law of Treaties. A Commentary* (SPRINGER: Verlag Berlin Heidelberg, 2012) pp. 182-183; te Boris Krivokapić, *Enciklopedijski rečnik medjunarodnog prava i medjunarodnih odnosa* (JP Službeni Glasnik: Beograd, 2010) str. 903-904; te Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, Sixth Edition (Oxford University Press: Oxford, 2003) pp. 582-583; te Vladimir Ibler, *Rječnik Medjunarodnog Javnog Parava* (Informator: Zagreb, 1972) str. 55, 253 & 313.

¹⁶ Neni 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës:

“1. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:

- (1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
- (2) të drejtat dhe liritë themelore;
- (3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare; dhe
- (4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës”.

¹⁷ Neni 18. 2 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës:

“2. Marrëveshjet ndërkombëtare, me përjashtim të atyre në pikën 1, ratifikohen pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

3. Presidenti i Republikës së Kosovës ose Kryeministri njoftojnë Kuvendin sa herë që të nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare”.

Sqarimi i natyrës juridiko-ndërkombëtare dhe juridiko-kushtetuese të Marrëveshjes së Dytë ka rëndësi për dy arsye: e para, sepse ekziston një parim zakonor ndërkombëtar i cili quhet parimi *bona fide*, i cili nënkupton se *pacta sunt servanda* duhet të zbatohet me mirëbesim, pa marrë parasysh kufizimet e brendshme juridiko-kushtetuese të shteteve; dhe, e dyta, në rastet kur një marrëveshje ndërkombëtare ka kaluar ratifikimin e brendshëm nga parlamenti, kontrolli kushtetues i normave të saj paraqet një problem serioz sepse kushtetutat zakonisht përcaktojnë disa kufizime mjaft të qarta të kufijve të kontrollit kushtetues të cilat kufizime duhet ti respektojnë gjykatat nacionale kushtetuese¹⁸.

Dilema, përkitazi me fuqinë e traktateve ndërkombëtare të lidhura në mënyrë të duhur nga ana e autoriteteve kushtetuese vendore, kanë pasur edhe vendet e tjera ish-komuniste të Evropës. Kjo për arsye se lidhja e një traktati mund të ndodhë që koincidon me aktin e ratifikimit ndërkombëtar. Kjo këtu nuk ka ndonjë rëndësi sepse, fundja, çdo detyrim i marrë ndërkombëtar duhet të zbatohet me mirëbesim, *bona fide*, nëse shteti i caktuar mendon të jetë një anëtar serioz i bashkësisë ndërkombëtare. Kosova nuk bën përjashtim në këtë drejtim, gjë e cila u pa gjatë dialogut me Serbinë pas lidhjes së disa marrëveshjeve ndërkombëtare, nga të cilat vetëm njëra iu nënshtroi ratifikimit nga Kuvendi i Kosovës, tanimë e cilësuar si Marrëveshja e Parë. Dilema kryesore që lindi ndër kosovarët ka pasur të bëjë me përcaktimin e statusit juridiko-kushtetues të marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare të cilat patën vetëm ratifikim ndërkombëtar të kryer nga njëri prej organeve kushtetuese kosovare që nuk ka nevojë për të pasur plotfuqi për ta futur shtetin në detyrim ndërkombëtar (Shefi shtetit, Kryeministri apo ministri i Jashtëm).¹⁹ Këto marrëveshje nuk kanë pasur ratifikim të brendshëm nga Kuvendi i Kosovës dhe janë lidhur në vijim të implementimit të Marrëveshjes së Parë, të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës.²⁰ Me ratifikim

¹⁸ Mbi kufijtë e kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare, shih punimin e Maja Nastić, "Constitutional Review of International Agreements: Comparative Law Perspective", botuar në FACTA UNIVERSITATIS. Series: *Law and Politics* (Nis, Serbia) Vol. 13, No 1, 2015, fq. 59 – 72. ; Për vendet e demokracive perëndimore tradicionale dhe ish lindjen komuniste e më gjërë, shih studimin e detajuar Dinah Shelton (ed.), *International Law and Domestic Legal Systems. Incorporation, Transformation, and Persuasion* (Oxford University Press: Oxford, 2011).

¹⁹ Sipas Kushtetutës së Kosovës, por edhe sipas kushtetutave të tjera dhe standardit zakonor ndërkombëtar, ratifikimi në fjalë mund të kryhet nga ana e shefit të Shtetit, shefit të Qeverisë dhe shefit të dikasterit të jashtëm (ministrit të Jashtëm). Këto tri organe nuk kanë nevojë për plotfuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare. Cf. Neni 7.2 ("a") [Plotfuqitë] i KVDT.

²⁰ Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për Marrëveshjen e Dytë. Ka edhe marrëveshje në lëmenjtë e tjerë, të cilat janë lidhur në vazhdim të implementimit të Marrëveshjes së Parë. E tillë është, ta zëmë, "*Marrëveshja për Telekomunikacionin në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë*", aprovuar me Vendimin e Qeverisë nr. 03/148. Vetëm Marrëveshja e

ndërkombëtar, siç u theksua më herët, nënkuptohet ai veprim që rregullohet me dispozitat e KVDT-së dhe me të drejtën ndërkombëtare zakonore.

3. Kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga parlamenti

Nisur nga kjo qasje lidhur me vendin dhe me rolin e marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin juridik u krijuan edhe juridiksionet përkatëse nacionale për kontrollin e tyre kushtetues. Në shumicën e vendeve ish-komuniste, marrëveshjet ndërkombëtare që kishin të bënin me çështjet e ndjeshme të sovranitetit shtetëror, të financave shtetërore, të të drejtave të njeriut, të territorit etj., kërkohet t'i nënshtroheshin ratifikimit parlamentar dhe pëlqimit të ekzekutivit, veprime që kryheshin me draftimin e një ligji të veçantë.²¹ Ligji, me të cilin ratifikohet një marrëveshje ndërkombëtare, sipas

Dytë ka qenë deri më sot objekt vendimmarrjeje në Gjykatën Kushtetuese, me Aktgjykimin KO130/15, të 23 dhjetorit 2015.

Marrëveshja për Telekomunikacionin nuk ka nevojë për ratifikim parlamentar meqë shërben si një akt juridik implementues i Marrëveshjes së Parë, e cila nga ana tjetër është ratifikuar me ligj të veçantë, me Ligjin nr. 04/L-199 të cekur më sipër. Si e tillë, Marrëveshja për Telekomunikacionin ka karakter implementues administrativ, siç kanë edhe Planit i Veprimit dhe të gjitha aktet e tjera të Qeverisë së Kosovës, të nxjerra në vijim të implementimit të detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës të marra në bazë të Marrëveshjes së parë, të Kushtetutës dhe të ligjeve të Kosovës.

²¹ Në fakt, edhe demokracitë e vjetra evropiane, si: Franca, Italia, Gjermania etj., kanë dispozita shprehimore kushtetuese që përcaktojnë saktë se marrëveshjet e caktuara të rëndësisë së veçantë shtetërore që prekin çështjet e sovranitetit territorial dhe shtetëror, financat, buxhetin apo ndonjë interes tjetër vital, ratifikohen me ligj nga ana e parlamentit nacional. Professor C. Economides, "The Relationship Between International and Domestic Law", *Science and Technique of Democracy*, No. 6, CDL – STD 006 (Vennice Commission: Strasbourg, 1993).

Në vendet e sistemit anglosakson, në Britani të Madhe ta zëmë, nxjerra e ligjit, i cili quhet *enabling act* (ligji autorizues), kërkohet jo për të futur në sistemin e brendshëm një normë të një marrëveshjeje ndërkombëtare por për të transformuar tërësisht një normë të tillë ndërkombëtare duke e kthyer atë në një normë të brendshme juridiko-kushtetuese. Ky ligj nxirret zakonisht kur një marrëveshje ndërkombëtare, pra një normë e përmbajtur në një marrëveshje ndërkombëtare, afekton të drejtat dhe përgjegjësitë private, rezulton në ngarkesën e fondeve publike, ose kërkon ndryshimin e një ligji vendor ose të drejtës së përgjithshme (*common law*) me qëllim që ajo marrëveshje të mund të zbatohet nga ana e gjykatave të vendit. Cf. Franck C. Newman and David Wiessbrodt, *International Human Rights: Law, Policy, and Process*, Anderson Publishing Company: Cincinnati, Ohio, 1996, p. 23; Thomas Buergenthal, *Modern Constitutions and Human Rights Treaties*, 36 Colum. J. Transnat'l L. 211 (1997) pp. 213-216; Anthony Aust, *Modern Treaty Law and Practice*, Kapitulli 10 (*Treaties and Domestic Law*), pp. 143-161; Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, Oxford University Press: Oxford, 2003, pp. 44-45; David Weissbrodt and

zgjdhjeve kushtetuese të shumicës dërrmuese të vendeve ish-komuniste të Evropës por edhe më gjerë, nuk ka fare asnjë fuqi normative. Kjo do të thotë se ai ligj vetëm sa e fut në sistemin e brendshëm juridik-kushtetues një marrëveshje të lidhur ndërkombëtare, e cila, nëse ka norma të vetekzekutueshme²², mund të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo do të thotë se, në një rast të tillë, marrëveshja ndërkombëtare mund krijojë të drejta e detyrime për palët të cilat mund të realizohen pranë gjykatave e organeve të tjera nacionale në mënyrë të njëjtë si çdo ligj apo normë tjetër e brendshme. Kështu është rasti edhe me Kosovën dhe me nenin 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës të cituar më lart. E njëjta vlen edhe për paragrafin e dytë në vijim të nenit të njëjtë, i cili flet për llojet e tjera të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat nuk kërkojnë ratifikim të organit përfaqësues, por vetëm lidhjen e tyre me veprimin adekuat të organeve kushtetuese të cilat, sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare, nuk kanë nevojë të kenë plotfuqi: Shefi i Shtetit, Kryeministri, dhe, së fundi, ministri i Jashtëm. Për marrëveshjet e lidhura në këtë mënyrë vetëm njoftohet organi përfaqësues, Kuvendi i Kosovës, për hir të zbatimit të parimit të transparencës së punës së organeve kushtetuese që janë të ngarkuara më punët e politikës së jashtme. Sa i përket forcës juridiko-kushtetuese, asnjë dallim nuk ka ndërmjet kategorisë së parë dhe të dytë, gjithnjë me kusht që janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Fuqia e tyre në praktikë varet nga natyra e normave që përmbajnë. Në rastet kur marrëveshjet e tilla kanë norma të vetekzekutueshme, zbatimi i tyre i drejtpërdrejtë nuk vihet në pikëpyetje. Në rastet kur ato nuk kanë një natyrë të tillë të vetekzekutueshme, atëherë kërkohet lidhja e një marrëveshje tjetër shtesë, apo nxjerrja e një legjislacioni tjetër vendor shtesë, të cilët kanë për qëllim implementimin e marrëveshjes së ratifikuar ndërkombëtare në kuptim të paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës.²³ Zaten, vetë emërtimi i këtij neni të

Connie de la Vega, *International Human Rights. An Introduction*, University of Pennsylvania Press: Philadelphia, 2007, pp. 4-6.

²²Shih më shumë për këtë në punimin e shkëlqyer të David Sloss “Non-Self-Executing Treaties: Exposing a Constitutional Fallacy”. *U.C. Davis Law Review* . Vol. 36 No. 1 (November 2002) fq. 2-84.

²³ Legjislacioni implementues mund të ketë formën e vendimit të Qeverisë, siç ishte rasti me Vendimin e Qeverisë për Marrëveshjen për Telekomunikacionin, e përmendur më lart. Ai legjislacion mund ta ketë formën e ligjit të kualifikuar, siç ishte rasti me Ligjin nr. 05/L-053 për Dhomat Speciale dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 3 gusht 2015. Në fund fare, ky legjislacion implementues mund të ketë natyrën e marrëveshjes shtesë në vazhdim të implementimit të një detyrimi primar origjinal ndërkombëtar, i cili nuk është marrëveshje ndërkombëtare por që ka lindur si pasojë e një vendimi të një organi ndërkombëtar, siç është rasti me Vendimin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës që miraton Raportin dok. 12462, të 7 janarit 2011, lidhur me

Kushtetutës së Kosovës e bën të qartë, pa asnjë ekuivok, se bëhet fjalë për dy llojet e ratifikimit që u përfolën më lart.

Marrëveshjet nga nenit 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues nga ana e Gjykatës Kushtetuese, si pasojë e faktit se standardi i kontrollit kushtetues të marrëveshjeve të tilla është shumë i rreptë dhe nuk lejon gjykatat kushtetuese të ndërhyjnë në komunikimin ndërkombëtar të shteteve, të cilat, nëse do ta kishin një të drejtë të tillë, atëherë do ta luanin rolin e një gjykate ndërkombëtare kushtetuese. Këtë pozitë e ka mbrojtur edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës në aktgjykimin e saj lidhur me kontrollin kushtetues të Marrëveshjes së Parë.²⁴ Me këtë aktgjykim, Gjykata ka bërë të qartë se, në vendet ku lejohet kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare, një gjë e tillë mund të bëhet vetëm para se ato të jenë ratifikuar nga ana e organit përfaqësues (ratifikimi i brendshëm). Pas ratifikimit, një gjë e tillë nuk mund të ndodhë sepse, siç ka konstatuar me të drejtë Gjykata Kushtetuese, një gjë e tillë do të pengonte seriozisht komunikimin ndërkombëtar ndërmjet shteteve. Në Evropë ekzistojnë shtete, të përmendura edhe në këtë aktgjykim të Gjykatës, të cilat njohin të drejtën e kontrollit preventiv të marrëveshjeve ndërkombëtare, si: Shqipëria, Bullgaria, Kroacia etj.²⁵ Në praktikën e vet gjyqësore, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë me *Vendimin nr. 15/2009*, të 15 prillit 2010, ka shpallur si antikushtetuese një marrëveshje të paratifikuar, të lidhur ndërmjet këtij vendi dhe Greqisë, e cila synonte caktimin e kufijve të tyre në det.²⁶

Janë të rralla shtetet që lejojnë kontrollin kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare pas ratifikimit të tyre të brendshëm nga parlamenti. Polonia e

pretendimet për krimet e kryera ndërkufitare dhe ndërkombëtare gjatë konfliktit në Kosovë dhe pas tij. Si legjislacion implementues që ka natyrën juridike të marrëveshjes ndërkombëtare që ka lindur si pasojë e implementimit të një detyrimi primar (original) ndërkombëtar mund të theksohet Marrëveshja e Përkohshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Holandës mbi Organizimin e Institucionit të Gjykatës Speciale të Kosovës i Zhvendosur në Holandë, e lidhur në Prishtinë, më 26 janar 2016. Kjo marrëveshje është ratifikuar me Dekretin DMN- 003-2016 e Presidentes së Republikës së Kosovës për Ratifikim të Marrëveshjes Ndërkombëtare, i cili mban datën 3 shkurt 2016.

²⁴ *Aktgjykim në Rastin nr. KO95/13. Parashtrues: Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-199 për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje (Nr. ref.: AGJ469/13, 9 shtator 2013).*

²⁵ Cf. Paragrafët 48-69 të Aktgjykimit.

²⁶ Cf. më shumë për trajtimin elokuent të këtij rasti nga vetë raportuesi i çështjes, prof. Xhezair Zaganjori, *Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare*, (MORAVA, Tiranë, 2011) fq. 39-52.

Serbia janë ndër to.²⁷ Në vendet që kanë një zgjidhje të tillë kushtetuese, partnerët negociues të një marrëveshje ndërkombëtare duhet të njoftohen me kohë nga negociuesit e tillë për kufizimet e tyre kushtetuese. Kjo për faktin se barrierat kushtetuese nuk mund të jenë arsye valide për anulim të marrëveshjes së lidhur ndërkombëtare, përveç nëse nga rrethanat e rastit del se palët e kanë pasur të qartë një barrierë të tillë.²⁸ Shtetet, si Gjermania, për t'i ikur kësaj situatë të pakëndshme, me Aktgjykimin e 29 qershorit 2009 lidhur me Traktatin e Lisbonës, ka ofruar zgjidhje subtile që në mënyrë të tërthortë kanë pranuar mundësinë praktike të kontrollit kushtetues të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, por vetëm nëse organi përfaqësues ka vepruar *ultra vires*, qoftë me rastin e ratifikimit të brendshëm ose gjatë implementimit të marrëveshjes ndërkombëtare akoma të paratifikuar. Quhet se ekziston veprimi *ultra vires* i organit kushtetues, sipas verdiktit të Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, në rastet kur një marrëveshje e lidhur ndërkombëtare prek në dispozitat kryesore kushtetuese të neneve 1 dhe 20 lidhur me nenin 79 të Ligjit Bazik të Gjermanisë. Këto nene përbëjnë identitetin kushtetues gjerman.²⁹

Nëse marrëveshja ndërkombëtare futet në sistemin e brendshëm juridik nëpërmjet një ligji për ratifikim të brendshëm, por dispozitat e saj nuk kanë natyrë vetëkzekutuese, atëherë kjo do të thotë se ajo marrëveshje e ratifikuar nuk mund të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë sepse nuk krijon të drejta e detyrime për palët private dhe për palët e tjera. Një situatë e tillë kërkon nxjerrjen e një norme shtesë implementuese të marrëveshjes së ratifikuar me ligj. Kjo normë implementuese zakonisht ka karakter juridiko-kushtetues të

²⁷ Neni 167. 2 [Statusi Gjykatës Kushtetuese] i Kushtetutës së Serbisë të vitit 2006 thotë shprehimisht se Gjykata Kushtetuese mund të vendosë lidhur me përputhshmërinë e marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare me Kushtetutën, kurse neni 118.1 [Tribunali Kushtetues] i Kushtetutës së Polonisë të vitit 1997 stipulon të drejtën e Tribunalit që të gjykojë përputhshmërinë e ligjeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën.

²⁸ Në fakt, në nenin 46 [Dispozitat e të Drejtës së Brendshme Lidhur me Kompetencën për Lidhjen e Traktateve] të KVDT-së, shprehimisht theksohet se zgjidhjet e brendshme kushtetuese e ligjore nuk mund të shërbejnë si bazë juridike për moszbatim të detyrimeve të marra nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura në mënyrë të duhur.

²⁹ Në rastin gjerman bëhet fjalë për kontrollin kushtetues të cilin e bën Gjykata Federale e Gjermanisë kundrejt akteve *ultra vires* të organeve kushtetuese me qëllim të mbrojtjes së identitetit kushtetues të Gjermanisë karshi Bashkimit Evropian. Cf. Daniel Thym, *From Ultra Vires Control to Constitutional – Identity – Review: The Lisbon Judgement and German Constitutional Court*. Në Jose Maria Beneyto/Ingolf Pernice (eds.), *Europe's Constitutional Challenges in the Light of the recent Case Law of National Constitutional Courts: Lisbon and Beyond* (Nomos, Baden-Baden, 2011), pp. 45-62; Mattias Wendel, *Lisbon Before the Courts: Comparative Perspectives*. Në Jose Maria Beneyto/Ingolf Pernice (eds.), *Europe's Constitutional Challenges in the Light of the recent Case Law of National Constitutional Courts*. pp. 65-106.

një norme të brendshme (ligj, dekret, urdhër qeverie etj.). Në rastet kur kjo normë implementuese nuk ka natyrë juridike të brendshme, atëherë norma e dytë ndërkombëtare që implementon një detyrim ndërkombëtar origjinal ka natyrë juridike të normës suksesive në kuptim të nenit 30 [Zbatimi i Marrëveshjeve Sukcesive Lidhur me të Njëjtën Çështje] të KVDT-së, nen i cili në tërësi reflekton dhe sanksionon të drejtën ndërkombëtare zakonore. Si e tillë, kjo normë implementuese e natyrës suksesive, në asnjë rast nuk mund të sabotojë objektin dhe qëllimin e detyrimit të parë të përmbajtur në marrëveshjen e parë të ratifikuar nga organi përfaqësues me pëlqim të organit ekzekutiv. Në këso rastesh, norma e dytë ndërkombëtare shërben si normë implementuese e normës së parë, e normës bazë, e cila përmbahet në marrëveshjen e lidhur ndërkombëtare që i është nënshtruar ratifikimit të brendshëm të organit përfaqësues, gjithnjë me pëlqimin e organit ekzekutiv. Në një raport të Komisionit të Venecias, duke iu referuar Maqedonisë, marrëveshjet ndërkombëtare që nuk ratifikohen nga parlamenti nuk do mend se janë pjesë përbërëse e rendit të brendshëm juridik dhe gjejnë zbatim të njëjtë si dhe ato të ratifikuara, në vartësi të natyrës së normave që prodhojnë (të vetekzekutueshme ose jo). Me një fjalë, këto marrëveshje shpjegohen përmes teorisë moniste mbi marrëdhënien në mes të drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare, njejët si kur flitet për marrëveshjet e ratifikuara nga parlamenti.³⁰ Kjo për faktin se marrëveshjet e lidhura, të cilat përmbajnë norma të tilla, zakonisht administrojnë normat e marrëveshjes së ratifikuar me qëllim të saktësimit dhe të implementimit të tyre. Normat e përmbajtura në marrëveshjet administrative lindin si pasojë e ekzistimit të dy rrethanave: e para, dispozitat e normës së marrëveshjes së ratifikuar zakonisht nuk janë mjaftë precize dhe nuk i përcaktojnë qartë dhe si duhet të drejtat dhe detyrimet e palëve; dhe, e dyta, si pasojë e kësaj pasaktësie dhe paqartësie lind edhe nevoja për hapa shtesë për vënien në jetë të normave të ratifikuara nga parlamenti (gjithnjë me prezumimin se ekziston edhe pëlqimi i ekzekutivit).

Të një natyre të tillë janë edhe marrëveshjet e lidhura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në vijim të implementimit të Marrëveshjes së Parë. Marrëveshja e Dytë është më e rëndësishmja, ndër to për shkak të vetë përmbajtjes së saj si dhe për faktin se tanimë ekziston një prononcim i Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë përmbajtje. Ky prononcim, i cili më shumë ka shkaktuar huti se që ka sqaruar, e aq më pak të ketë zgjidhur, vendin dhe pozitën e marrëveshjeve ndërkombëtare të paratifikuara nga Kuvendi (me pëlqimin e

³⁰ Cf. Mr. Igor Spirovski, *The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws With International Treaties: New Trends in Constitutional Justice*, CDL-JU(2009)036 (Venice Commission, Strasbourg, 17 November 2009).

Ekzekutivit) në sistemin juridik-kushtetues kosovar. Ky rast ka qenë një rast ideal për Gjykatën që të sqarojë përfundimisht natyrën e dispozitave të paragrafit 2, të nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, dispozita që, siç thamë më herët, aspak nuk dallojnë për nga mesazhi që bartin dispozitat e ngjashme të kushtetutave të vendeve të Evropës, si të atyre të vendeve ish-komuniste ashtu dhe të demokracive tradicionale evropiane. Në të gjitha rastet e tjera, marrëveshjet që nuk i nënshtrohen ratifikimit të brendshëm, cilësohen si marrëveshje administrative sepse administrojnë për qëllime të implementimit një normë tjetër ndërkombëtare që gjendet në një marrëveshje ndërkombëtare e cila është lidhur dhe është ratifikuar nga organi përfaqësues me pëlqim të ekzekutivit. Marrëveshja ndërkombëtare, kur ka formën e shkruar, mund të gjendet në një instrument ratifikimi ose në disa sosh.

4. Kontrolli kushtetues i marrëveshjeve të paratifikuara dërkombëtare

Siç mund të vërehet nga diskutimi i mësipërm, nuk ka në Kushtetutën e Kosovës qoftë dhe një dispozitë që flet për mundësinë e lejimit të kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare, pa marrë parasysh nëse janë ratifikuar ose jo nga Kuvendi, nga Shefi i Shtetit të Kosovës, apo nga vetë Qeveria. Në fakt, mundësinë e ratifikimit të llojeve të caktuara të marrëveshjeve ndërkombëtare nga ana e Shefit të Shtetit e lejon shprehimisht paragrafi 2 i nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. I njëjti nen, por edhe tërë Kushtetuta, ngelen të heshtur sa i përket ratifikimit të llojeve të caktuara të marrëveshjeve ndërkombëtare nga ana e Qeverisë. Kjo nënkupton se çdo ratifikim që kryhet nga Qeveria duhet të bëhet me autorizim të Shefit të Shtetit, me kusht që fjala nuk është për marrëveshjet nga neni 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës. Nga aspekti ndërkombëtar, ndërkaq, vlen të theksohet e të sqarohet se, edhe pa këtë autorizim të Shefit të Shtetit, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara ndërkombëtarisht nga Qeveria janë tërësisht valide dhe paqartësitë kushtetuese nga neni 18.2 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës nuk mund të shpërbejnë si bazë për mohimin e detyrimeve të marra ndërkombëtare. Atëherë, si ndodhi që Marrëveshja e Dytë u bë objekt kontrolli kushtetues në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës? Përgjigja në këtë pyetje gjendet në historikun e zgjerimit të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, që ka ndodhur me rastin e njohur si “Rasti Qeska”, Aktgjykimi KO80/10, i 7 tetorit 2010, kur Gjykata krejtësisht në mënyrë të gabuar interpretoi dispozitat e neneve 84.9

[Kompetencat e Presidentit]³¹ dhe 93.10 [Kompetencat e Qeverisë]³² të Kushtetutës, sikur gjoja ato lejojnë “ngritje të çështjeve kushtetuese” pa asnjë kufizim nga ana e Presidentit dhe Qeverisë.³³ Ky ka qenë dhe ngel gabim, sepse dispozitat e sipërcekura të këtyre dy neneve kushtetuese flasin për “ngritjen e çështjeve kushtetuese” nga ana e këtyre dy organeve kushtetuese vetëm në kuadër të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese të përcaktuar qartë me nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Kosovës. Se një gjë e tillë ka qenë qëllim i hartuesve të Kushtetutës, qartë dëshmohet nga redaktimi i dispozitës tërësisht të ngjashme të nenit 135.4 [Raportimi i Avokatit të Popullit] të Kushtetutës.³⁴

³¹ Presidenti i Republikës së Kosovës: ... “(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese”.

³² Qeveria ka këto kompetenca: ... “(10) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese”.

³³ Përveç rastit të parë, “Rastit Qeska”, raste të tjera që deri më sot janë vendosur nga Gjykata mbi të njëjtin arsyetim dhe logjikë janë si vijon: Aktgjykimi i 7 tetorit 2010 në rastin nr. KO80/10 (Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Tij, dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të kompetencave në rastin e kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska); Aktgjykimi i 22 dhjetorit 2010 në rastin nr. KO97/10 (Kërkesa e parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, dr. Jakup Krasniqi, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe njëkohësisht të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës); Aktgjykimi i 20 shtatorit 2011 në rastin nr. KO98/11 (Parashtrues: Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës); Aktgjykimi i 20 shtatorit 2012 në rastin nr. KO57/12 (Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit nr. 04/1-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës); Aktvendimi i 11 shkurtit 2014 në rastin nr. KO18/14. (Parashtrues: Vesna Mikić dhe 20 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kërkesë për “[...] interpretim të dispozitave të Kushtetutës së Kosovës lidhur me vendet e rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë”); Aktgjykimi i 1 korrikut 2014 në rastin nr. KO103/14 (Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës. Përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës); Aktgjykimi i 23 dhjetorit 2015 në rastin nr. KO130/15 (Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës. Lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar “Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë -Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore” me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës).

³⁴ Avokati Popullit: “(4)... ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute”.

pozicionet si në këtë punim, autori i këtyre rreshtave i ka mbrojtur që në dhjetor të vitit 2013 në librin koautorial ku komentohet për herë të parë Kushtetuta e Republikës së Kosovës, dorëshkrimi i të cilit në fakt u pat dorëzuar për botim gjashtë muaj më herët. Cf.

Mënyra ekstensive e interpretimit të dispozitave mbi kompetencat e Presidentit dhe të Qeverisë, të cilin e ka bërë Gjykata, në esencë ka rezultuar në atë që kompetencat e këtyre dy organeve kushtetuese të jenë përcaktuese të vetë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Ky ngatërrim konceptual i juridiksionit me kompetencën,³⁵ më shumë se kaq, bëri që cila palë e autorizuar të jetë përcaktues i lejueshmërisë së ngritjes së çdo çështjeje kushtetuese në rastet kur ajo ngrihet *in concreto* nga Presidenti apo nga Qeveria e Kosovës. Këto dy organe kushtetuese kanë të drejtë që të jenë palë e autorizuar vetëm në çështjet e parashikuara nga neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës, si palë të privileguara që nuk kanë nevojë të provojnë ekzistimin e një interesi juridik për ngritjen e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese. Ajo çfarë ka ndodhur është se këto dy organe kushtetuese mund të kërkojnë nxjerrjen e vendimeve interpretative dhe këshilluese për punën që bëjnë pa asnjë kufizim material nga neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës. Kjo nënkupton se është puna e tyre që bëjnë, jo ndonjë akt juridik më i ulët se Kushtetuta, që analizohet nëse bie ose nuk bie në kundërshtim më Kushtetutën. Puna e bërë si pikë referimi mund të jetë edhe si punë në kuptimin hipotetik, pra punë që mund të bëhet nëse Gjykata nuk e cilëson më parë vet si punë jokushtetuese, pa ndihmën e askujt dhe krejt në mnëyrë arbitrare. Autorizimi për të nxjerrë

Enver Hasani-Ivan Čukalović, *Kushtetuta e Kosovës. Komentar* (GIZ, në emër të Ministrisë Gjermane Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, Prishtinë, 2013), fq. 400-401, lidhur me fq. 665. Këtë e theksoj këtu për të dëshmuar se me kohë e kam pasur shumë të qartë se ky lloj aktivizmi gjyqësor, me kalimin e kohës mund të bëhej barrë e padrueshme për gjyqësinë kushtetuese kosovare. Çdo ditë e më shumë do të shihet se kisha të drejtë ngaqë gjyqësia kushtetuese kosovare nuk ka as kapacitet profesional dhe intelektual, e as vullnet dhe sinqeritet kolegjial, për t'u ballafaquar me një juridiksion të tillë metafizik për çështje të papërcaktuara që nuk kanë asnjë funksion pos akomodimin dhe shpëtimin e lëkurës së politikanëve obskurantist të shtetit të Kosovës, shtet që akoma është në ndërtim e sipër.

³⁵ Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se gjetiu, në praktikën komparative të gjyqësisë kushtetuese, nuk ka pasur zgjerim të juridiksionit fillestar (origjinal) të gjykatave kushtetuese jashtë përcaktimeve të teksteve të kushtetutave nacionale. Përkundrazi, një gjë e tillë, e njohur si aktivizëm gjyqësor, ka ekzistuar dhe eksiton në të gjitha kontinentet e botës ku ka gjyqësi kushtetuese dhe ky zgjerim juridiksioni në disa raste ka marrë përmasa enorme shqetësuese ku gjykatat kanë luajtur rolin e gjykatave të faktit dhe arbitrit në çështjet nga më të thjeshta deri te ato që kanë pasur një natyrë të theksuar të pastër politike. Shih më shumë për këtë në studimin e jashtëzakonshëm ku jepet pasqyra komparative të kësaj çështje, Allan R. Brewer-Carias, *Constitutional Courts as Positive Legislators, A Comparative Law Study* (Cambridge University Press, Cambridge, 2011). Në kapitullin 5 [“Gjykatat kushtetuese si ligjvënës në çështjet e kontrollit kushtetues”] autori flet gjerësisht për praktikën komparative të gjyqësisë kushtetuese nga e cila praktikë shumë qartë shihet se gjykatat kanë krijuar juridiksion material plotësues për kontroll kushtetues në rastet që fare nuk kanë qenë të përcaktuara me juridiksionin e tyre origjinal. E njëjta gjë vlen edhe për zgjerimin e juridiksionit të tyre për sa i përket aspekteve procedurale të kontrollit kushtetues.

vendime interpretative dhe këshillëdhënëse jashtë autorizimit shprehimor të tekstit material të Kushtetutës, është i njohur në praktikën e disa vendeve në Evropë, si: Bullgaria, Italia etj. Mirëpo, me kalimin e kohës, gradualisht, shtetet e tilla i kanë përcaktuar rregullat shtesë me qëllim të konstitucionalizimit të këtij aktiviteti ekstensiv të gjykatave të tyre kushtetuese.

Duke përfituar nga kjo gjendje kushtetuese e krijuar nga vetë Gjykata Kushtetuese, Marrëveshja e Dytë përfundoi në Gjykatën Kushtetuese si “çështje kushtetuese”, e ngritur nga presidentja e Republikës, znj. Atifete Jahjaga. Presidentja Atifete Jahjaga ka folur në kërkesën e saj në mënyrë krejt hipotetike për Marrëveshjen e Dytë, duke e cilësuar atë si diçka që akoma nuk është pjesë e sistemit juridik kosovar, meqë asnjëherë nuk është publikuar në Gazetë Zyrtare e as që ka filluar zbatimin e saj. Kjo, megjithatë, nuk e ka penguar Gjykatën Kushtetuese që të merret me dispozitat krejt konkrete të Marrëveshjes së Dytë, duke e konsideruar të njëjtën si një dokument ekzistues operativ brenda sistemit juridik-kushtetues kosovar. I tërë teksti i këtij aktgjykimit flet me terma këshillues, hipotetikë për të ardhmen, duke i dhënë udhëzime konfuzive Qeverisë për mënyrën e implementimit të Marrëveshjes së Dytë, si dhe për formën që duhet të ketë akti juridik që duhet të implementojë jo Marrëveshjen e Dytë, e cila efektivisht ishte objekt i kontrollit kushtetues, por Marrëveshjen e Parë që asnjëherë nuk ka mundur të jetë objekt i kontrollit kushtetues për arsye të pengesave kushtetuese për një gjë të tillë (mungesa e juridiksionit *ratione materiae*), siç është konstatuar nga vetë Gjykata me aktgjykimin për Marrëveshjen e Parë.³⁶ Me këtë veprim, Gjykata ka përdorur Marrëveshjen e Parë si një trampolinë për të folur për Marrëveshjen e Parë, duke i cilësuar detyrimet që dalin nga ajo, pra formimi i Asociacionit të komunave serbe, si detyrime ndërkombëtare që duhet vënë në jetë.³⁷ Se formimi i Asociacionit përbën një detyrim ndërkombëtar të Kosovës nuk mund të vihet në pyetje, sepse vetë akti i ratifikimit parlamentar të Marrëveshjes së Parë ka konfirmuar një gjë të tillë. Pikërisht, argumenti i moslejueshmërisë së kontrollit represiv të marrëveshjeve ndërkombëtare në praktikën komparative kushtetuese, bazohet në aktin e ratifikimit të brendshëm parlamentar që zakonisht kërkon një shumicë të kualifikuar, krahas pëlqimit të Ekzekutivit. Vetë akti i ratifikimit parlamentar shërben si zëvendësim i kontrollit kushtetues dhe si argument kundër çdo kontrolli kushtetues represiv, pra pas votimit me shumicë të kualifikuar nga ana e Parlamentit të një marrëveshjeje

³⁶ Cf. Pikën III të pjesës operative të Aktgjykimit KO95/13, të 9 shtatorit 2013.

³⁷ Cf. Pikën II të pjesës operative të Aktgjykimit KO130/15, të 23 dhjetorit 2015.

ndërkombëtare, gjithnjë duke supozuar se ekziston në mënyrë simultane edhe pëlqimi i Ekzekutivit.

Konstatimi në pjesën operative II, nga ana e Gjykatës, se duhet të formohet Asociacioni i komunave serbe, i cili del si konkluzion i pjesës arsyetuese të aktgjykimit në të cilin asnjë precedent komparativ nuk citohet në favor të këtij konkluzioni,³⁸ nuk thotë asgjë tjetër veçse deklaroi një detyrim ekzistues ndërkombëtar të Kosovës, i marrë nëpërmjet ratifikimit parlamentar të një marrëveshjeje ndërkombëtare konform nenit 18.1

³⁸ Në fakt, i vetmi referim në burim komparativ gjendet në paragrafin 146 të Aktgjykimit KO130/15, i cili fare nuk ka të bëjë me arsyetimin e pjesës që mëton ta arsyetojë, aq më pak me pjesën e tij operative. Kjo nuk do të thotë se referimet komparative janë *a priori* të shëndetshme, sepse jo rrallë ato mund të përdoren për të konfirmuar një rrugë të drejtë që e kanë marrë vendet e tjera. Por, anasjelltas, përdorimi i doktrinës dhe i precedentit të huaj mund të përdoret për të vazhduar me ndjekjen e një rruge të gabuar dhe për të mohuar detyrimet kushtetuese të vendit të caktuar, me përdorimin e mekanizmave të brendshëm kushtetues. Rasti i një aktgjykimi, të cilin e nxori Gjykata Kushtetuese e Federatës Ruse më 14 korrik 2015 është një shembull tipik i kësaj. Me këtë aktgjykim, Gjykata e ka bërë të qartë se, në Rusi, ani se ka një pranim formal të monizmit sa i përket vendit e rolit të marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin juridiko-kushtetues rus, megjithatë në praktikë kjo nuk është kështu. Duke përdorur praktikën gjermane, austriake e italiane, Gjykata ka mohuar detyrimet ndërkombëtare të Rusisë për sa i përket zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Cf. *Judgment No. 21 – P/2015 of 14 July 2015 of the Constitutional Court of the Russian Federation Circulated as a document of the Venice Commission CDL-REF (2016) 019. Strasbourg, 23 February 2016 (Opinion No. 832/2015)*.

Kjo qasje ruse ka zhgënjyer jo vetëm anëtarët e plenares së 106 të Komisionit të Venecias, përfshirë autorin e këtyre rreshtave si përfaqësues i Kosovës aty, e mbajtur më 11-12 mars 2016 në Venedik, por edhe autorin rus që kishin shkruar më heret me aq zell e krenari për largimin rus nga izolimi ndërkombëtar dhe përqaftimin e teorisë moniste në Kushtetutën e vitit 1993 në këtë vend, fill pas mbarimit të Luftës së Ftohtë. Cf. Gennady M. Danilenko, "The New Russian Constitution and International Law". *American Journal of International Law* Vol. 88 No. 3 (July 1994) fq. 451-470.

Rusia edhe mund ta ketë një luks të tillë dhe të mohojë detyrimet e marra ndërkombëtare. Por, vendet e vogla si Kosova duhet të jenë më balancuese kur gjykojnë detyrimet ndërkombëtare që kanë marrë kundruall respektimit të dispozitave të kushtetutave të tyre. Asnjëherë nuk duhet të vihet në pyetje respektimi i kushtetutës nacionale, nga të gjithë. Ajo që duhet të vihet në pyetje është fakti se me rastin e gjykimit duhet të kryhet një balancim ndërmjet detyrimeve ndërkombëtare të marra dhe kushtetutës së vendit. Shih më shumë, për rolin pozitiv dhe negativ të doktrinës dhe të precedentit komparativ në të drejtën kushtetuese, librin elokuent të Vicki C. Jackson, *Constitutional Engagement in a Transnational Era* (Oxford University Press: Oxford, 2010). Në kapitullin 1 ["Rezistimi i Transnacionales"], autorja flet gjerësisht për modalitetet e rezistimit të përdorimit të burimeve të jashtme, doktrinare e nga praktika gjyqësore, si dhe për arsyet e ndryshme të këtij rezistimi. Nganjëherë, ky rezistim është fisnik dhe i dobishëm, siç është rasti me shtetet e reja në krijim e sipër, por në disa mund të jetë vetizolues dhe vetëshkatërrues për shoqërinë që ndjek një rrugë të tillë.

[Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, duke e marrë kështu rolin e një organi të vlerësimit ndërkombëtar të “kushtetutshmërisë ndërkombëtare”, të detyrimeve të marra ndërkombëtarisht nga ana e shtetit të Kosovës. Përveç kësaj, një kontroll represiv kushtetues nuk do të ishte në interes të shtetit sepse do ta dëmtonte seriozisht kapacitetin kontraktues të tij në planin ndërkombëtar, sic e ka thënë Hans Kelsen qysh në vitin e largët 1929³⁹. Ka qenë pikërisht ky rol që nuk duhet ta ketë asnjëherë asnjë gjykatë kushtetuese. Ngjashëm me Hans Kelsen ka thënë edhe vetë Gjykata Kushtetuese e Kosovës, duke u bazuar në praktikën komparative kushtetuese, në Aktgjykimin KO95/13, të 9 shtatorit 2013.⁴⁰ Mënyra e qasjes në Aktgjykimin KO130/15, pa asnjë dyshim që paraqet marrje të një roli këshillëdhënës dhe interpretativ nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë rast, njësoj si në Aktgjykimin KO95/13, Gjykata është dashur ta luaj rolin e arbitrit të qartë në zgjidhjen e çdo çështjeje kontestuese kushtetuese që parashtrohet për zgjidhje nga palët e autorizuarra dhe sipas procedurave të përcaktuara me nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuarra] të Kushtetutës.

Kjo nuk do të thotë se nuk mund të ketë kontroll kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura sipas nenit 18.2 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. Përkundrazi. Mendojmë se një gjë e tillë duhet të ndodhë pikërisht për faktin se mungon ratifikimi parlamentar i këtyre llojeve të marrëveshjeve, ashtu që ka rrezik real çdo herë që Presidenti dhe Qeveria të veprojnë *ultra vires*, me ose pa dashje, në vijim të zbatimit të kompetencave të tyre kushtetuese. Ngjashëm më këtë arsyetim ka vepruar edhe Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë në rastin e diskutuar më herët, *Lisbon Treaty*⁴¹, kur ka theksuar se mund të jetë kompetente për të bërë kontrollin kushtetues të detyrimeve të marra ndërkombëtare në rastet kur organet kushtetuese jopërfaqësuese (ekzekutivi) tejkalojnë kompetencat e tyre dhe veprojnë *ultra vires* duke prekur dispozitat kushtetuese gjermane që cilësohen si përbërëse të identitetit kushtetues gjerman. Këtë është dashur ta bëjë edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës, duke i cilësuar si jokushtetuese dispozitat konkrete të Marrëveshjes së Dytë dhe, për pasojë, duke i nxjerrë të njëjtat dispozita jashtë rendit juridik-kushtetues kosovar. Në të njëjtën kohë, Gjykata është dashur t’u tregojë organeve kushtetuese që janë në ngarkesë më punët e jashtme se çdo herë kur hyjnë në detyrime ndërkombëtare duhet t’i kenë parasysh kufizimet kushtetuese dhe që në të njëjtën kohë kufizimet e

³⁹ Cituar sipas Olivera Vucic, *Austrijsko ustavno sudstvo – çuvar federacije i ustava*, fq. 201, fusnota 269.

⁴⁰ Cf. Paragrafët 95-101 e Aktgjykimit KO130/15.

⁴¹ Shih gjithashtu: Leonard F.M. Besselink, “National and constitutional identity before and after Lisbon”. *Utrecht Law Review*. Volume 6, Issue 3 (November) 2010 fq. 36-49.

tilla duhet t'ua bëjnë me dije edhe partnerëve ndërkombëtarë me rastin e negociemeve dhe me rastin e marrjes së çdo detyrimi ndërkombëtar.⁴²

Kjo është dashur të thuhet nga Gjykata, pra t'u tregohet organeve kushtetuese se cilat janë kufizimet kushtetuese me rastin e negociimit dhe të lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare të të gjitha llojeve, jo vetëm të atyre nga paragrafi 2 i nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. Nuk ka relevancë dhe nuk ndihmon organet kushtetuese të Kosovës nëse atyre u tregohet *post festum* se kanë cenuar dispozitat e caktuara të Kushtetutës së Kosovës me rastin e veprimit të tyre si aktorë të marrëdhënieve ndërkombëtare. Ajo që ndihmon shumë është qartësimi i secilit kufizim kushtetues, sa më shumë që të jetë e mundur, në mënyrë që kur të ndodhë përsëritja e situatave të ngjashme vendimet nga e kaluara të shërbejnë si një udhërrëfyes për mospërsëritjen e gabimeve të njëjta. Këtë mision e kanë gjykatat kushtetuese, si dhe gjykatat supreme në rastet kur ushtrojnë edhe juridiksion kushtetues. Ndryshe do të duhej çdo ditë të shkruhej nga një kushtetutë, me sa më shumë detaje, në mënyrë që të parashihen e të sanksionohen gjërat e përditshme. Kjo do të thotë rritje enorme e vëllimit fizik të tekstit kushtetues, deri në përmasat e vëllimit në të cilin është shkruar *Epi i Gilgameshit* me mijëra vjet para erës sonë. Në një rast të tillë, teksti kushtetues ditor, përveç që do të ishte i gjatë dhe i pakuptimtë, ai as nuk do të kishte përmbajtje kushtetuese por vetëm epike, njësoj si *Epi i Gilgameshit*.

Përfundim

Kontrolli kushtetues i Marrëveshjes së Dytë ngre një sërë çështjet të rëndësishme të së drejtës kushtetuese kosovare, siç janë: vendi dhe roli i marrëveshjeve ndërkombëtare të paratifikuara nga Parlamenti në sistemin kushtetues kosovar, statusi i detyrimeve të marra ndërkombëtare nga ana e autoriteteve publike të Kosovës, të cilat akoma nuk janë shpallur në Gazetën Zyrtare, caqet e kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare në përgjithësi, pra edhe atyre të ratifikuara, sepse juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese sot për sot është pa kufi në rast se Presidenti apo Qeveria e Kosovës vendosin të ngrenë një çështje kushtetuese, e kështu me radhë.

Gjykata Kushtetuese ka pasur një rast ideal për të sqaruar dhe për të precizuar juridiksionin e saj kur bëhet fjalë për ngritjen e “çështjeve kushtetuese” nga Presidenti dhe nga Qeveria, por edhe për të vënë bazat e një

⁴² Këtë e ka bërë në mënyrë të shkëlqyeshme Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në vendimin e komentuar në faqen që diskutohet me fusnotën 25 të këtij punimi.

kontrolli kushtetues të balancuar, kur bëhet fjalë për detyrimet e marra ndërkombëtare në mënyrë valide nga ana e organeve kushtetuese kosovare. Lëshimi i këtij rasti vështirë se mund të rikuperohet në të ardhmen kur Statuti i Asociacionit të komunave të vijë për kontroll kushtetues në Gjykatën Kushtetuese, sërish mbi bazën e ngritjes si çështje kushtetuese nga ana e Qeverisë, pra jo siç është paramenduar me Marrëveshjen e Dytë.⁴³

Mosmarrja me këto çështje nga ana e Gjykatës Kushtetuese shpjegohet me panikun nën të cilin është marrë vendimi i saj, i krijuar nga situata aktuale jashtëzakonisht e rëndë dhe e tensionuar, ku konflikti social ka rrezik të marrë dimension politik total në të gjitha aspektet e mundshme të tij. Kjo, megjithatë, nuk amnistion askënd që të lëshojë pe ndaj vijave të kuqe të profesionit, të cilat asnjëherë nuk duhet të kalohen kur kemi të bëjmë me mbrojtjen e tekstit kushtetues dhe të vlerave të tij. Kjo sepse gjendja aktuale në Kosovë sigurisht se do të kalohet pas një palë zgjedhjesh dhe rolet mund të ndryshojnë, ashtu që ata që sot janë kundër interpretimit të Gjykatës në rastin e Marrëveshjes së Parë dhe që përkrahin në mënyrë naive Marrëveshjen e Dytë, për qëllime krejt politike, në të ardhmen do t'i ndërrojnë rolet me këta që sot kanë mendim të kundërt. Por, teksti i Kushtetutës dhe vlerat që ngërthen ai, janë të përjetshme dhe sublime dhe si të tilla edhe duhet mbrojtur e promovuar sipas standardeve krejtësisht profesionale, pa marrë parasysh çmimin që paguhet nga ndonjëri prej nesh. Fundja, konstitucionalizmi modern, siç e njohim sot dhe të cilit i takojmë si shoqëri, nuk ka kaluar pa dhunë, pa vuajtje, pa konflikt dhe pa akte primitive, të cilat, të gjitha së bashku, kanë synuar të pengojnë arritjen e njeriut në një stad me cilësor të lirisë njerëzore.

⁴³ Në paragrafin 21 [“Dispozitat e përgjithshme dhe përfundimtare”] të Marrëveshjes së Dytë, thuhet: “Statuti i Asociacionit/Bashkësisë do të hartohet nga Ekipi Menaxhues dhe do të paraqitet në Dialogun e Nivelit të Lartë brenda 4 muajsh nga dita e arritjes së marrëveshjes së këtyre parimeve elementeve, me lehtësim sipas nevojës, duke përfshirë atë të Ministrisë së Qeverisjes Lokale. Statuti do të vërtetohet me dekret pas marrëveshjes në Dialog. Cilido amendament që do të prezantohet nga Asociacioni/Bashkësia do të vërtetohet me dekret dhe do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese”.

Prof. Dr. Enver Hasani**The Case of a Serb Association before the Constitutional Court of Kosovo****Summary**

Judgement KO 130/15 regarding the constitutional review of the Second Agreement concluded between Kosovo and Serbia in Brussels on 25 August 2015 raises several issues for the constitutional law of Kosovo, such as about the place and role of international agreements of all types within the domestic system of Kosovo. In particular, this affects unpublished international agreements, scope of review of the international agreements in general, and a very extensive and unlimited nature of the material jurisdiction of the Constitutional Court at present. This jurisdiction has been extended over the years since the creation of the Constitutional Court in February 2009, and is based solely on the right of the President and Government of Kosovo to raise and file with the Constitutional Court they deem interesting. It is the quality of being a party, e.g., the President and the Government of Kosovo, that determines the jurisdiction of the Court, not the material text of the Constitution. In Article 113 [Jurisdiction and Authorized Parties] of the Constitution of Kosovo, no mention is made about the competence of the President and the Government to raise constitutional issues outside the scope of the material provisions of Article 113 above.

The power to “refer constitutional issues” as an expression exists only in Article 135. 4 [Ombudsperson Reporting] of the Constitution. This Article, however, is different. It is very instructive indeed, both for the Constitutional Court, and other actors of constitutional life of Kosovo. Article 135.4 of the Constitution clearly states that “the Ombudsperson may refer matters to the Constitutional Court in accordance with the provisions of this Constitution”. There is no provision in the Constitution that allows the President and the Government of Kosovo to refer constitutional issues independently of Article 113 paragraphs 2 & 3 [Jurisdiction and Authorized Parties] of the Constitution.

It is the material jurisdiction of Article 113 of the Constitution in general that determines the type of the parties, not the vice versa. When Article 112.1 [Constitutional Court: General Principles] of the Constitution says that “the Constitutional Court is the final authority for the interpretation of the Constitution and the compliance of laws with the Constitution”, it clearly intends at a principled level to frame in a comprehensive manner the overall material jurisdiction of the Court provided for in the text of Article 113 [Jurisdiction and Authorized Parties] of the Constitution.

Constitutional Court has had a golden opportunity to clarify and fix its own jurisdiction which has gone astray these recent years and has ever since been exercised in an uncontrolled manner when it comes to some vague issues triggered by two central constitutional organs: the President and Government of Kosovo. This was not done by the Judgement of the Court in case KO 130/15 dealing with the constitutionality of the Second Agreement concluded between Kosovo and Serbia in Brussels on 25 August 2015. This case was a good opportunity to show to the constitutional organs and the wider public what means for a state organ to enter into international obligations on behalf of the State, what is the scope of such international obligations and, finally, to show the manner through which these obligations turn into domestic law obligatory for all public authorities and private persons alike as they then create rights and duties persons should be enforce before domestic courts and other public authorities.

These omissions are pretty difficult to fix in the near future when the Statute of the Association of the Serb Majority Municipalities of Kosovo appears before the Court for a constitutional review. This is so since again the issue of the constitutionality of the Statute will appear as part of a constitutional question raised by the Government, not as planned by the drafters of the Paragraph 21 of the Second Agreement. It was believed by the drafters of the Statute that this paragraph can serve as a basis to enable the Court to review the text of the Statute as such.

The very reason for this omission lays in the fact that this decision of the Court was rendered in a panic due to the volatile situation prevailing in Kosovo at present. This is not the reason to justify the decision and its very poor reasoning in constitutional terms. There are some red lines that one should never cross when in a position to judge professionally. Protection of the Constitution and its values should serve as the guiding motive, not political balances of the day as they change daily. This is so since for sure those who today criticize the decision will next time be in favor of the

second decision that has to be taken by the Court regarding the constitutionality of the Statue of the Association of the Serb Majority Association. It is the text of the Constitution and the values it enshrines that should prevail always and serve as our reference, not the configuration of political forces on daily basis. At the end of the day, the Western constitutionalism to which Kosovo aspires has not achieved current stage of development without sufferings and a bloodshed of the people striving for more freedom during throughout past times. Had the West given up their fight for it, Kosovo and the rest of former Communist Europe would not have reached this much of human liberty and freedom. It is this human freedom we should all strive for to the end and fight for its protection and promotion when threatened. It is human freedom and dignity that stands behind the values of the Constitution, not the current balance of political forces in Kosovo and very fragile and volatile situation existing at press.

Prof. Dr. Arsim BAJRAMI*, MA. Sc. **Florent MUÇAJ***,
Përparim GRUDA*

Konstitucionalizimi dhe kontrolli kushtetues i partive politike - rasti i Kosovës

1. Hyrje dhe vështrime të përgjithshme mbi partitë politike

Ky punim ka për qëllim të trajtoj karakteristikat e kontrollit kushtetues të partive politike si dhe kriteret që janë përdorur përgjatë ushtrimit të kontrollit të partive, por edhe konstitucionalizimit të tyre. Fillimisht, duhet bërë dallimin në mes të konstitucionalizimit të partive politike me kontrollin kushtetues të tyre, pasi që në fakt janë dy procese të ndara teorikisht dhe praktikisht.

Punimi përbëhet nga tri seksione të cilat kanë për qëllim të pasqyrojnë mekanizmin kushtetues të kontrollit dhe konstitucionalizimit të partive politike. Në seksionin e parë trajtohet koncepti i përgjithshëm i konstitucionalizimit të partive politike dhe rëndësia e tij, ku vihen në pah elementet e konstitucionalizimit dhe mënyrës së shfaqjes së tij në praktikë. Në seksionin e dytë trajtohen standardet evropiane të krijuara sa i përket konstitucionalizimit dhe kontrollit të partive politike ndërsa seksioni i fundit rezervohet për një trajtim të detajuar të rastit të konstitucionalizimit dhe kontrollit të partive politike në sistemin kushtetues Kosovar.

Përmes këtyre tri dimensionëve, lexuesi do të ketë mundësi të krijojë një qartësi të kësaj tematike kushtetuese, për të kuptuar shkaqet, kriteret dhe

* Arsim Bajrami është Profesor i të Drejtës Kushtetuese në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, ka qenë anëtar i komisionit për hartimin e Kushtetutës të Republikës së Kosovës (2008) dhe kryetar i komisionit për amendamentimin (ndryshimin) e kushtetutës së Republikës së Kosovës 2011-2012, si dhe është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Artëve të Kosovës dhe asaj Evropiane. Kontakti: arsim_bajrami@hotmail.com.

* Florent Muçaj është asistent i lëndëve kushtetuese në katedrën Kushtetuese-Administrative, pranë Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe ka qenë pjesë e komisionit për amendamentimin (ndryshimin) e kushtetutës së Republikës së Kosovës 2011-2012. Kontakti: florentmuçaj@gmail.com.

* Përparim Gruda është ligjërues i së Drejtës Kushtetuese dhe Administrative në Kolegjin Evropian “Juridica” në Prishtinë. Kontakti: perparim.gruda@gmail.com.

mënyrën e transmetimit të çështjes në fjalë, e cila del të jetë një temë me mjaft interes në fushën e studimeve kushtetuese. Meqenëse e tërë çështja bosht lidhet me partitë politike, nuk ka asnjë logjikë që ky trajtim të nisë pa bërë një përpjekje për përkufizimin e partive politike, si entitete të veçanta, qoftë si pjesë e trajtimit teorik e filozofik apo trajtimit praktik, kushtetues dhe ligjor.

Ideja si më sipër për dhënien e një përkufizimi mbi partitë politike, në shumë raste duket sikur më shumë hap probleme të reja se që jep ndonjë zgjidhje. Për shumë studiues kjo përpjekje do të thotë të merresh me një çështje ku je i detyruar të zgjedhësh një kamp të pozicioneve, për shkak të përkufizimeve të shumta. Mbase këtë më së miri e shpjegon fakti që *Jean Blondel* kurkishte folur për partitë politike zgjodhi nëntitullin: “...a genuine case for discontent...”, duke adresuar në fakt elementin e vështirësisë për një përkufizim të partive politike¹.

Sipas një përkufizimi tashmë klasik të Max Weber-it, sipas të cilit “*Partia përbën marrdhënie të tipit shoqërizues, një përkatësi e bazuar mbi një rekrutim, qëllimi i të cilës është që të siguroj pushtetin për drejtuesit e saj në mes të një grupi të institucionalizuar për të realizuar një ideal ose për të përfituar përparësi materiale për militantët*”². Një definicion i njohur i partive politike ka ardhur nga studiuesi i shkencave politike Antony Downs, i cili shkruan se “*Një parti politike është një ekip i njerëzve që kërkon të kontrolloj aparaturat qeverisëse duke fituar pushtet gjatë një palë zgjedhesh të rregullta*”³. Politologu i njohur G. Sartori jep një formulim më sintetik: “*një parti është një grup politik i identifikuar me një etiketë zyrtare që paraqitet në zgjedhje dhe është i aftë të vendos nëpërmjet zgjedhjeve kandidatët në poste publike*”⁴.

Në vijim sa më sipër, duke marrë parasysh definicionet e partive politike në përgjithësi definicioni më i plotë duket të jetë përcaktimi sipas të cilit Partitë politike paraqesin bashkimin e lirë të qytetarëve me qëndrime të njëjta, të cilët për zgjidhjen e problemeve politike bëjnë propozime programore dhe paraqesin kandidatë për mandate në parlament dhe për poste qeveritare, me qëllim që pas zgjedhjeve të suksesshme të zbatojnë në praktikë programin e

¹ Daniel-Louis Seiler, “*Partitë Politike*”, (Përktheu Blerta Hyska), UET Press, Tiranë, 2010, fq. 12.

² Po aty, fq.23.

³ Anthony Downs, “*An Economic Theory of Democracy*”, The Journal of Political Economy, Volume 65, Issue 2, April, 1957.

⁴ Gianfranco Pasquino, “*The Political Science of Giovanni Sartori*”, European Political Science (2005), 4, doi:10.1057/palgrave.eps.2210003, fq.33–41.

tyre⁵. Pra, siç mund të shihet partitë politike trajtohen si grupe të caktuara që kanë për qëllim marrjen e pushtetit dhe qeverisjen në organet shtetërore, gjë e cila mundësohet përmes zgjedhjeve të lira. Në këtë kontekst, partitë trajtohen si subjekte që kanë qëllime politike. Gjithashtu, trajtimet në vazhdim, por edhe definicionet paraparke japin të kuptojnë që partitë politike mund të trajtohen edhe në sfondin e të drejtave të njeriut, duke nënkuptuar bashkimin e lirë të qytetarëve dhe njëzëve⁶. Sidoqoftë, fjala kyq e partisë politike është pushteti, fitimi, ruajtja dhe kultivimi i tij si një qëllim primar dhe i pashmangshëm i çdo partie politike⁷.

Nga pikëpamja etimologjike fjala “*parti*” për disa studiues vjen nga frengjishtja e vjetër. Ajo rrjedhë nga fjala “*partir*” që donte të thoshte ndaj në pjesë, veçoj, ndaj, kuptim që sot gjendet në fjalët “*repartir*” dhe “*se departir*”. Të tjerë autorë origjinën e kësaj fjale e gjejnë tek latinishtja, fjala “*parse*” që donte të thoshte “*pjesë*”⁸. Si dukuri sociale, ndërkaq, partitë politike lidhen me lindjen e qeverise përfaqësuese dhe zgjerimin progresiv të të drejtës së votës gjatë shekullit XIX⁹.

Në kontekst të përkufizimeve autorët kanë trajtuar edhe kushtet që duhet plotësojë një organizatë për t’u cilësuar si parti politike në një sistem që cilësohet demokraci liberale kushtetuese. Së këndejmi një organizatë për t’u përkufizuar si parti politike ndër të tjera duhet të plotësojë kushtet në vijim:

1. Të ketë struktura të tilla që të lejojnë pjesëmarrjen e anëtarësisë;
2. Të jetë në gjendje të formulojë një program të politikave publike;
3. Të ushtrojë veprimtari në më shumë se një palë zgjedhje¹⁰.

Nga ajo që u tha më lartë, që lidhet edhe me përkufizimin e partisë politike si nocion bosht i trajtimit në këtë punim, si dhe nga kushtet që theksojnë shumica e autorëve në rastin e trajtimit të partive politike, qartazi

⁵ Ky është një definicion që krijohet duke marrë parasysh të gjitha elementet që përmban qëllimi i ekzistimit të partive politike.

⁶ Liritë dhe të drejtat e njeriut të parapara me akte ndërkombëtare dhe Kushtetutë, për aq sa i përshtaten partive politike. Këtu mund të përmendim në veçanti lirinë e asociimit, tubimit dhe atë të shprehjes.

⁷ W.Philips Shively, “*Power and Choice. An Introduction to Political Science*” (McGraw Hill: University of Minnesota, 2003) Eighth Edition, fq.244.

⁸ Daniel-Louis Seiler, “*Partitë Politike*”, (Përktheu Blerta Hyska), UET Press,(*cituar fusnota 1 supra*), fq. 12, Tiranë, 2010.

⁹ Në aspektin teorik për herë të parë me çështjen e partive politike është marrë Edmond Buke, në fund të shekullit XVIII. Shih më shumë në: Andrew Haeywood, “*Politika*” (Brezi ’81: Prishtinë, 2008) fq. 230-231.

¹⁰ Është fjala edhe për autorët e cituar më lartë, të cilët i kanë dhënë edhe përkufizimet e partive politike, mirëpo këto kërkesa hasen në përgjithësi tek pjesa më e madhe e autorëve që janë marrë me partitë politike.

shihet se elementi që i dallon ato është pjesmarrja në zgjedhje dhe në qeverisje, si i tillë elementi politik është kyq dhe i largon partitë politike herë pas here nga menyra e trajtimit të tyre në kuadër të sfondit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Partitë politike në sistemet jodemokartike të të gjitha llojeve nuk kanë cilësitë e sipërcekura dhe funksionojnë sipas logjikës së njëmendësisë në fitimin, ruajtjen dhe kultivimin e pushtetit ku qytetari nuk ka asnjë ndikim përveç se të shërbej si objekt mbi të cilin vepron.

2. Konstitucionalizimi i partive politike-konteksti dhe standardet

Dukuria partiake është shumë e vjetër, por partitë, në kuptimin që në njohim sot, janë shfaqur në fillim të shekullit XIX. Grupet e ndryshme politike kanë marrë forma të ndryshme gjatë rrjedhës së historisë, në fillim ato janë shfaqur si organizime tërsisht joformale për promovimin e interesave thjeshtë personale dhe të grupeve të ngushta të interesit¹¹. Në këtë kuptim, një grup i njerëzve mblidheshin rreth një udhëheqësi për të realizuar interesa të ngushta personale ose klanore, padyshim, kjo situatë nuk mund t'i bënte ato faktorë të zhvillimit të shoqërive dhe të demokracisë, meqë flitej për grupe klanore. Kështu, u bë e nevojshme që aktiviteti që ato ushtronin t'i nënshtruhej një kornize të paracaktuar normative e cila përgjithësisht emërtohet si statut. Ky akt është bazamenti juridik mbi të cilin duhet të ngrihet partia dhe në të cilin në mënyrë precize përcaktohen parimet themelore që organizojnë veprimtarinë e partisë, orientimin saj ideologjik, objektiva që do të ndjek, mënyrën e udhëheqjes dhe procedurën e anëtarësimit të anëtareve, etj.

Rëndësia e partive politike për demokraci është e njohur gjerësisht. Gjithashtu, kjo çështje është një dimension kushtetues shumë i rëndësishëm për demokracitë moderne. Parime të tilla si pjesëmarrja, përfaqësimi, pluralizmi dhe parimi i konkurrencës kanë ardhur duke u zgjeruar në shumë kushtetuta demokratike. Në thelb kushtetutat orientojnë partitë politike në drejtim të vlerave kyçe demokratike dhe parimeve të tjera që lidhen kryesisht me rolin elektoral dhe parlamentar, mbi të gjitha përmes partive realizohet vlera kushtetuese e pluralizmit politik.

Megjithatë, në vijim sa më sipër, rregullimi i qartë kushtetues i partive politike ka ndodhur vetëm pas Luftës së Dytë Botërore. Në këtë pikëpamje, Islanda, Austria, Italia dhe Gjermania i përkasin valës së parë të

¹¹ Jean-Marie Denquin, *“Hyrye në Shkenca Politike”*, (Përktheu Belina Budina), UET Press, Tiranë, 2009, fq 83.

konstitucionalizmit të partive që përkon me demokratizimin dhe restaurimin e demokracisë në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore. Vala e dytë përfshiu Francën (themelimi i Republikës V në vitin 1958), Maltën dhe Qipron, kurse vala e tretë përfshiu jugun e Evropës, Greqinë, Portugalinë dhe Spanjën, në mesin e viteve 1970. Një një valë e katërt cilësohet rënia e komunizmit dhe mbarimi i Luftës së Ftohët, kur u përfshinë të gjitha vendet post-komuniste në fund të viteve 1980 dhe fillim të viteve 1990 (Hungaria–1989, Bullgaria, Kroacia, Serbia–1990 Lituania, Rumania, Sllovenia–1991, Shqipëria–1992 dhe Ukraina 1996, si dhe vendet tjera)¹². Së fundmi, si valë e pestë mund të konsiderohet periudha e viteve 2000-2010 ku përfshihen Finlanda, Zvicra,–1999, Luksemburgu–2008 dhe Kosova-2008. Siç mund të shihet valët e konstitucionalizmit të partive politike zakonisht korrespondojnë me proceset e bërjes së kushtetutave, sepse në shumicën e rasteve shkrimi i kushtetutave të reja, apo ndryshimi i disa pjesëve kryesore të kushtetutave ekzistuese (Finlanda dhe Zvicra) vjen si rezultat i lidhur ndryshimet dhe përmbyset të mëdha sociale, siç janë revolucionet, luftërat, dështimet e sistemit, adaptimet e tij, ose krijimi i një shteti apo regjimi politik krejtësisht të ri¹³.

Historikisht kushtetutat e vendeve perendimore janë përmbajtur nga të përmendurit e partive politike ose përshkrimi të rolit të tyre në sistemin politik, periudha pas Luftës së Dytë Botërore ka dëshmuar për një proces të vazhdueshëm të konstitucionalizimit të partive politike¹⁴. Praktika e konstitucionalizimit të partive politike dhe vendi që ju atribua partive politike në kushtetutat përkatëse u pa si një kusht për të rivendosur demokracinë si dhe një masë parandaluese për të krijuar mekanizma që ndalojnë ardhjen në pushtet të ideologjive të rrezikshme. Në fakt, periudha në mes të dy luftërave botërore ishte dominuar nga partitë totalitare dhe parlamentarizmin fragjil që kryesisht bazohet në sisteme zgjedhore të shumicës dhe në monarki gjysëm kushtetuese. Më ardhjen në pushtet të Hitlerit dhe forcimin e diktaturës së tij, sikur erdhi deri të efekti domino sepse shumica e vendeve të Evropës u modeluan gradualisht mbi parimet e njejta të sundimit diktatorial. Vlen të theksohet se kushtetuta e parë në Evropë që përmendi partitë politike, ishte ajo e Islandës e vitit 1944, e cila akoma është në fuqi në atë vend, ku në nenin 31 të saj u përcaktua : “[...]

¹² James P. McGregor (1996). “Constitutional Factors in Politics in Post-Communist Central and Western Europe, *Communist and Post-Communist Studies*” 29/2: 147- 66.

¹³ Elster, “*Forces and Mechanisms in the Constitution-Making Process*”, 370-71, *Duke Law Journal* Vol.45:364.

¹⁴ Ingrid van Biezen (2012) “*Constitutionalizing Party Democracy: The Constitutive Codification of Political Parties in Post-War Europe*”, *British Journal of Political Science*, 42(1), fq. 187-212.

*Ndarja e ulseve në Parlamentin e Irlandes (Althingi) bëhet në bazë të rezultatit të zgjedhjeve, duke siguruar hapësirën e mundshme që secila parti politike që ka fituar votat e nevojshme të marrë ulëse në Parlamentin e Irlandës (Althingi) në proporcion me numrin e anëtareve të parlamentit*¹⁵. Rasti i dytë kur përmenden partitë politike në kushtetutë, është ai i Kushtetutës së Austrisë të vitit 1945. Në këtë rast konteksti i përmendjes së partisë politike ishte negativ në sensin që thuhej se kushdo që mban post në një parti politike nuk mund të jetë anëtar i Gjykatës Kushtetuese¹⁶.

Gjermania përfaqëson modelin më të mirë të rregullimit kushtetues të partive politike apo konstitucionalizimit të tyre. Neni 21 i Ligjit Themelor përcakton:

1. Partitë bashkëpunojnë për formimin e vullnetit politik të popullit. Krijimi i tyre është i lirë. Organizimi i tyre i brendshëm duhet t'u përgjigjet parimeve themelore të demokracisë. Ato duhet të japin llogari publikisht për burimet e mjeteve të tyre financiare;
2. Partitë, të cilat me qëllimet e tyre ose me sjelljen e anëtarëve të tyre synojnë të dëmtojnë ose të eliminojnë rendin themeltar demokratik e liberal ose të rrezikojnë ekzistencën e Republikës Federale Gjermane, janë antikushtetuese. Për çështjen antikushtetuese vendos Gjykata Kushtetuese Federale;
3. Hollësitë rregullohen nga ligjet federale¹⁷.

Nga ky formulim vërehet qartë se Ligji Themelor Gjerman nuk toleron parti politike me qëllime apo aktivitet armiqësor ndaj rendit kushtetues dhe demokratik të saj, duke mbyllur kështu rrugën për çfarëdo rikthimi të mundshëm të ndonjë partie naziste dhe komuniste¹⁸. Në thelb të këtij formulimi kushtetues gjendet, pa asnjë dyshim, e kaluara tragjike e popullit gjerman në mes të dy lufëtarave botërore pas ardhjes së Adolf Hitlerit në pushtet më 1933. Jo vetëm këto dispozita kushtetuese që merren me rolin dhe pozitën e partive politike në sistemin kushtetues gjerman, por edhe dispozitat tjera kryesore të Ligjit Themelor që përbëjnë identitetin kushtetues

¹⁵ Ingrid van Biezen (2012), burimi i cituar në fusnotën 14 *supra*, fq.33.

¹⁶ Kushtetuta e Austrisë, neni 147.4. E arritshme në: https://www.constituteproject.org/constitution/Austria_2013.pdf?lang=en, qasur më 20 Mars 2016.

¹⁷ Ligji Themelor i Republikës Federale Gjermane i arritshëm në: https://www.constituteproject.org/constitution/German_Federal_Republic_2012.pdf?lang=en, qasur më 17 Mars 2016.

¹⁸ Më shumë për trajtimin që i bën Ligji Themelor Gjerman partive politike shih: Carl J. Schneider, "Political Parties in the German Basic Law", 1949. i arritshëm në: <http://www.jstor.org/discover/10.2307/443534?sid=21105766742413&uid=2&uid=3738928&uid=4>. Qasur më 17 Mars 2016.

gjerman kanë si sfond të tyre këtë hisotri tragjike gjermane dhe frikën nga restaurimi i logjikës totalitare¹⁹.

Konstitucionalizmi i partive politike në Gjermani nuk është ekskluzivisht një fenomen i pasluftës, pasi partitë politike atje janë përmendur në disa dispozita kushtetuese edhe para luftës së dytë botërore: Kushtetuta e Vajmarit e 1919 ua bënte një kërkesë partive politike për neutralitet politik të zyrtarëve publik, duke përcaktuar se “*nëpunësit civilë janë shërbëtorë të publikut si një e tërë, jo të një partie*”²⁰. Jo vetëm në këtë aspekt, por edhe në aspektin e të drejtave të njeriut, Kushtetuta e Vajmarit parqet tekstin më sublim fillestar evropian të konstitucionalizimit të partive politike dhe të garantimit kushtetues të pozitës së individit të lirë në sistemin qeverisës gjerman. Në teori, Karl Shmit, këto dy risi dhe cilësi pozitive të Kushtetutës së Vajmarit, i ka quajtur si “*kushtetuta e dytë*” dhe si dispozita që coptonin vullnetin e popullit gjerman për të qenë i lirë²¹. Siç dihet, eksperimenti me Vajmarin dështoi si pasojë e rrethanave të brendshme dhe ndërkombëtare që shkonin kundër vënies në jetë të demokracive liberale kushtetuese siç i njohim sot. Restaurimi i shpirtit të kushtetutës së Vajmarit erdhi në shprehje vetëm pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore dhe, si për ironi, sërish me ndihmën dhe ndërhyrjen e jashtme.

Në kushtetutën e SHBA-ve të vitit 1787 nuk përmenden fare partitë politike. Në fakt kjo Kushtetutë u shkrua në kohën kur partitë politike nuk ekzistonin fare, sikur në kuptimin e sotëm, sigurisht kjo vlerësohet të jetë edhe arsyeja pse fillimisht në Kushtetutë nuk u parashikua asnjë rregullim për partitë politike. Ata që shkruan Kushtetutën, “*etërit e themelues*”, kishin neveri për partitë politike²². Megjithatë, nevoja për të parashikuar ndalime për krijimin e forcave politike, në SHBA nuk ka lindur ndonjëherë, marrë parsysh jetën e qetë politike dhe stabilitetin kushtetues, kjo edhe për faktin se Amerika nuk ka vuajtur pasojat e veprimt të një partie të vetme, për të kontrolluar në vazhdimësi gjithë jetën institucionale, shoqërore dhe shtetërore të Federatës²³.

¹⁹ Paul Franz, “*Unconstitutional and Outlawed Political Parties: A German-American Comparison*”, Boston College International and Comparative Law Review, Volume 5, Issue 1, fq.52-56.

²⁰ Kushtetuta e Vajmarit, neni 130. E arritshme në: http://www.zum.de/psm/weimar/weimar_vve.php. Qasur me 21 Shkurt 2016.

²¹ Slobodan Samardzic (ed.), “*Norma i Olduka. Karl Smit i Njegovi Kriticari*” (“*FilipVisnjic*”: Beograd, 2001), fq.145-202 dhe 323-336.

²² Andrew Haeywood, *Politika*, fq. 230.

²³ Richard J.Hardy, “*The Paradoxes of Political Parties in American Constitutional Development*”, Bloomington, Indiana, 2011, i arritshëm

Aktualisht, shumica e kushtetutave dhe ligjeve themelore të vendeve të botës bëjnë rregullime të caktuara, për sa i përket partive politike, në kuptim të konstitucionalizimit të tyre. Ky rregullim kushtetues përqendrohet në tri aspekte kyqe: e para, ndalimi i partive që kërcënojnë dhe dëmtojnë demokracinë; e dyta, vendosjen e pluralizmit politik; e treta, garantimin transparençës në financimin e partive politike. Nga kjo qartë shihet se konstitucionalizimi është i lidhur ngushtë me kontrollin e partive politike, ani se këto në thelb paraqesin procese të ndara. Konstitucionalizimi në fakt nënkupton krijimin e rregullave kushtetuese që pasqyrojnë funksionin e partive politike në një sistem kushtetues, si dhe krijimin e rregullave që kufizojnë eventualisht aktivitetin e partive politike. Në anën tjetër, kontrolli nënkupton një proces i cili pason pas konstitucionalizimit dhe ka për qëllim vlerësimin e aktivitetit, të programeve dhe të statutit të një partie politike. Ky lloj mekanizimi kontrollues në shumicën e rasteve del të jetë gjykata kushtetuese e vendit përkatës²⁴. Për këto arsye, në vijim të këtij punimi në do të merremi si me kontrollin e partive politike ashtu edhe me ndalimin e aktivitetit të tyre nga ana e mekanizmave të caktuar kushtetues.

Nuk ekzistojnë kritere unike që përcaktojnë momentin kur një partie politike i ndalohet veprimtaria dhe funksionimi i mëtejshëm. Kjo situatë e paqartësisë buron nga një varg arsyesh. Në rend të parë, një ndër arsyet është për shkak të mungesës së një akti në nivel ndërkombëtar që do të rregullonte këtë çështje, gjë që është e kuptueshme nëse kihet parasysh se partitë politike operojnë në planin nacional dhe asnjëherë nuk mund të ketë një konsensus ndërkombëtar për këtë çështje. Veç kësaj, ka edhe arsye të tjera, siç janë: ekzistimi i traditave të ndryshme juridiko-kushtetuese; kultura demokratike; historia e partive politike si dhe shtrirja e rrymave ekstremiste në vende të caktuara. Pavarësisht këtyre divergjencave, ekzistojnë disa kritere parimore që janë prezente në sistemet e ndryshme kushtetuese si dhe që pranohen në botën demokratike si shkaqe për të ndaluar partitë politike. Të njëjtat përfshijnë kriteret si më poshtë:

1. kërcënojnë integritetin territorial të shtetit;
2. kërcënojnë ekzistencën dhe sovranitetin e shtetit;
3. nxisin dallimet etnike;
4. mbështetën në ideologji totalitare, ta zëmë naziste ose fashiste;
5. përdorin dhunën si mjet për të arritur qëllimet e tyre;
6. kanë lidhje me organizata kriminale;

në:<http://www.civiced.org/pdfs/GermanAmericanConf2011/Hardy.pdf>. Qasur së fundmi me 20 Mars 2016.

²⁴ Konstitucionalizimi dhe kontrolli i partive politike dallojnë në aspekt përmbajtësor, sepse janë dy procese të ndara, që janë reflektuar edhe në titullin e këtij punimi.

7. vepronë në fshehtësi.

Këto shkaqe natyrisht nuk parashikohen në të gjitha kushtetutat e vendeve evropiane, por vetëm në disa prej tyre. Aty ku parashikohen, zakonisht më pas me ligjet specifike i shtjellojnë kriteret konkrete të parcaktuara me kushtetutë. Në kuptim praktik, pyetja themelore që mund të bëhet në këtë rast është: a mjafton që të ekzistoj vetëm njëra nga shkaqet e përmendura më lartë për të ndaluar veprimin e një parti politike, apo duhet që në mënyrë kumulative të ekzistojnë të gjitha kushtet si më sipër? Në përgjigjen e kësaj pyetje një kontribut të çmueshëm ka dhënë dhe po jep Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), si dhe praktika e gjykatave Kushtetuese të vendeve të ndryshme, të cilat sqarojnë nëse është përmbushur një apo disa prej kushteve si më sipër.

Nga praktika e GJEDNJ dhe jurisprudenca nacionale është vërejtur se për të marrë një vendim për të ndaluar veprimin e një parti politike duhet që veprimtaria e saj të ketë qenë vazhdimisht në kundërshtim me rendin kushtetues dhe rendin demokratik, pra, që partia në dukje të parë (*prima facie*) duhet të paraqes një rrezik real, të qartë dhe jo imagjinar. Në vendimmarrjen e tyre gjykatat nacionale duhet që të provojnë plotësisht qëllimin e partive politike për të luftuar rendin demokratik dhe kushtetues në mënyrë të vazhdueshme. Kjo don të thotë se konkretisht duhet të provohet se vetë partia, jo disa anëtarë të saj, ka përdorur mjete jokushtetuese për të arritur qëllimet e tyre programore. Partitë kanë për obligim që të distancohen nga veprimet jo-kushtetuese të antarëve të tyre, duke dënuar publikisht ato veprime, në të kundërtën supozohet se partia e tillë miraton veprimet antikushtetuese për arritjen e qëllimeve programore²⁵. Vetkuptohet se një shtet me demokraci kushtetuese duhet të sigurohet para marrjes se një vendimi për të ndaluar veprimin e një parti se ndalimi është zgjidhja dhe rruga e vetme që ka ngelë në dispozicion. Barra e të provuarit të kësaj rrethane bie mbi shtetin, jo partinë politike aktiviteti i të cilës ndalohe.

I gjithë shqyrtimi i ndalimit të veprimit të një partie politike në çdo rast duhet bërë brenda standardeve dhe rregullave të një procesi të rregullt ligjor, duke respektuar me përpikmëri standardet e konstitucionalizimit që ka krijuar një shtet përkatës. Së këndejmi, një vendim që ndalon veprimin e një partie politike duhet të merret nga një gjykatë e paanshme dhe e përcaktuar me ligj. Në disa vende, si Spanja dhe Danimarka, kjo kompetence është lënë në duart

²⁵ Erald Shushari, “Kontrolli Kushtetues i partive politike”, Botuar në: Revista “Avokatia” nr. 8, Tiranë, 2014.

e Gjykatës së Lartë²⁶, kurse në disa tjera edhe gjykatave të zakonshme. Në shumicën e rasteve, siç u tha më sipër, kjo detyrë i është ngarkuar gjykatave kushtetuese.

Është jetike që gjykata që vendos këtë çështje të jetë e pavarur dhe e paanshme. Ky është edhe parim i punës së gjyqësorit sepse, në të kundërtën, ajo mund të shndërrohet dhe perceptohet nga publiku si një instrument i pushtetit për të eliminuar kundërshtaret politik dhe këtë nuk duhet ta lejojë asnjë gjykatë. Në kuptim të këtij parimi apo kushti, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës me Rezolutën 1308 (2002), paragrafi 11, ka përcaktuar se: "*një parti politike duhet të ndalohet ose të shpërndahet vetëm si një mjet i fundit*" dhe atë në përputhje me procedurat të cilat ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme për gjykim të drejtë"²⁷.

Nga ajo që u shtjellua më lartë vërehet që ka një dallim në mes të konstitucionalizimit dhe kontrollit. Në fakt duhet të pranojmë që në instancën e fundit edhe kontrolli është pjesë e konstitucionalizimit të partive brenda një sistemi kushtetues. Po ashtu shihet që konstitucionalizimi transmetohet në kontekst dhe standarde të caktuara, të shtjelluar më lartë.

3. Standardet evropiane për konstitucionalizimin dhe kontrollin e partive politike

Përmendja e parë e partive politike në kontekst të Parlamentit Evropian është bërë në nenin 138 të Traktatit të Mاستrihtit²⁸, i cili ndër të tjera thotë se: "*Partitë politike në nivel evropian janë të rëndësishme si faktor për integrimin brenda Bashkimit. Ato kontribuojnë në formimin e vetëdijes evropiane duke shprehur vullnetin politik të qytetarëve të Unionit*". Si pasojë e këtij normimi lindi nevoja për të krijuar një kornizë më precize normative për partitë politike. Kjo u bë me Traktatin e Nicës²⁹, i cili ia shtoi nenit 138 të Traktatit të Mاستrihtit se: "*Këshilli, duke vepruar në përputhje me procedurën e referuar në nenin 251, përcaktojnë edhe rregullat për*

²⁶ Po aty.

²⁷ Parliamentary Assembly Council of Europe, Resolution 1308 (2002) *Restrictions on political parties in the Council of Europe member states*. <http://assembly.coe.int/Main.asp?link=/Documents/AdoptedText/ta02/ERES1308.htm>, qasur së fundmi më 22 Shkurt 2016.

²⁸ "Maastricht Treaty": <http://eurlex.europa.eu/en/treaties/dat/11992M/htm/11992M.html>, qasur së fundmi më 10 Mars 2016.

²⁹ "Nice Treaty": http://eurlex.europa.eu/en/treaties/dat/12001C/pdf/12001C_EN.pdf, qasur së fundmi më 10 Mars 2016.

rregullimin e partive politike në nivelin evropian dhe në veçanti rregullat në lidhje me financimin e tyre".

Më vonë janë miratuar normativat implementuese të këtij neni të Traktatit të Nicës, Rregullorja nr.2004/2003, e cila përcakton elementet e një partie dhe format e financimit, Rregullorja nr.2005/2224 si dhe Rregullorja nr.1524/2007³⁰. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës³¹ ka pasur disa ndryshime në mënyrën e trajtimit të partive politike brenda Bashkimit Evropian. Kjo sepse Traktati i Lisbonës i dha forcë Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta), një version fillestar i të cilës ishte miratuar qysh në vitin 2000 kurse versioni i modifikuar i Kartës pati qenë pjesë e draft-Kushtetutës së Evropës. Gjatë procesit të hartimit të Kartës, çështja nëse duhej të përfshinte partitë politike ka qenë objekt debati në ndërkohë që në versionin përfundimtar të Kartës, në nenin 12, u njoh liria e tubimit dhe e organizimit. Kështu, në paragrafin e dytë të saj Karta thotë se: *“partitë politike në nivel të Bashkimit kontribuojnë për të shprehur vullnetin politik të qytetarëve të Bashkimit”*. Shpjegimi i përmbajtjes së këtij paragrafi që jepet nga Parlamenti është se Paragrafi 2 i këtij neni korrespondon me nenin 191 të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian³². Edhe pse Karta është modifikuar, ky paragraf ka mbetur i pandryshuar³³.

Më pas Traktati i Lisbonës ka miratuar disa rishikime në tekstin e tij, gjë që rezultoi në nenin 10 dhe nenin 224 në versionet e konsoliduara të traktatit. Neni 10 përcakton se *“partitë politike në nivel evropian kontribuojnë në formimin e ndërgjegjësimit politik dhe shprehjen vullnetit e qytetarëve të Bashkimit”*, kurse neni 224 përcakton kompetencën për Parlamentin e Evropës dhe Këshillin që, duke vepruar në përputhje me procedurat e zakonshme legjislative, me anë të rregulloreve të rregullojnë aspekte të detajuara të funksionimit të partive politike. Kjo mbi bazën e referimit në nenin 10 të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe në veçanti rregullat në lidhje me financimin e tyre. Ndryshimi kryesor me nenin 191 të Traktatit

³⁰ Fransje Molenaar, *“The Development of European Standards on Political Parties and their Regulation, The Legal Regulation of Political Parties Working”* Paper 4 February 2010. <http://www.partylaw.leidenuniv.nl/uploads/wp0410.pdf>, qasur së fundmi më 20 Mars 2016.

³¹“Lisbon Treaty” : <http://eurlex.europa.eu/JOHtml.do?uri=OJ:C:2007:306:SOM:EN:HTML>, qasur së fundmi më 13 Mars 2016.

³² European Parliament (2000d). *“Draft Charter of Fundamental Rights of the European Union”*. http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/04473_en.pdf, qasur së fundmi më 15 Mars 2016.

³³ Olgun Akbulut, *“Criteria Developed by the European Court of Human Rights on the Dissolution of Political Parties”*, Fordham International Law Journal, Volume 34, Issue 1, 2010. <http://ir.lawnet.fordham.edu/ilj/vol34/iss1/2/>, qasur së fundmi më 20 Mars 2016.

Themelues të Komunitetit Evropian konsiston në atë se Traktati i Lisbonës e lë jashtë pjesën e cila thotë që "*partitë politike në nivel evropian janë të rëndësishme si faktor për integrim në Bashkim*". Arsyeja pse është berë kjo, as sot e kësaj dite nuk është bërë e qartë. Siç mund të shihet Bashkimi Evropian ka krijuar disa rregulla më shumë në kuptim të konstitucionalizimit sesa në kuptim të kontrollit e ndalimit të aktiviteteve të partive politike. Kjo për faktin se këto rregulla janë përcaktuar me traktate, të cilat, në rastin e Bashkimit Evropian, e luajnë rolin e akteve kushtetuese.

4. Kriteret e zhvilluara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut për ndalimin e partive politike

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), ka theksuar se partitë politike janë një formë e organizimit që është thelbësore për funksionimin e duhur të demokracisë³⁴ dhe si një aktor me një "rol thelbësor në sigurimin e pluralizmit dhe funksionimin e duhur të demokracisë³⁵." Partitë Politike mbeten *sine qua non* i demokracive perëndimore. Shumë e diskutueshme është çështja e ndalimit të tyre në raste të caktuara kur ato shkelin parimet e demokracisë, pikërisht nisur nga fakti se ato paraqesin një kusht thelbësor të domosdoshëm për funksionim të demokracisë së mirëfillët. Pak a shumë ky fakt u konstatua edhe më lartë. Çështja e ndalimit të tyre ka marrë rëndësi në të drejtën evropiane për të drejtat e njeriut që nga vitet 1990. Para kësaj kohë ndalimi dhe shpërbërja e një partie politike njihej si një dukuri e Luftës së Ftohtë, pra nuk njihej aq shumë në praktikën evropiane³⁶. Struktura rigjide e sistemit ndërkombëtar në këtë kohë diktonte edhe proceset kushtetuese e politike brenda vendeve respektive të dy blloqeve antagonistë të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ish-Bashkimi Sovjetik respektivisht. Rasti i Partisë Komuniste të ish Gjermanisë Perëndimore paraqet shembull tipik që reflekton këtë situatë të kohës së Luftës së Ftohtë. Partia Komuniste e Gjermanisë pati qenë një parti e madhe politike në Gjermani në periudhën në mes të viteve 1918 dhe 1933, si dhe një parti të vogël në Gjermaninë Perëndimore në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore, derisa ajo u ndalua në vitin 1956. Kur partia Komuniste Gjermane në vitin 1957, dorëzoi një kërkesë Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, Komisioni pa asnjë hamendje e hodhi poshtë kërkesën në bazë të

³⁴ Case of the Refah Partisi (The Welfare Party) and Others v. Turkey. (40/1993/435/514) (European Court of Human Rights, February 13, 2003), paragrafët 87-89.

³⁵ Po aty.

³⁶ Olgun Akbulut, "Criteria Developed by the European Court of Human Rights on the Dissolution of Political Parties", Fordham International Law Journal, Volume 34, Issue 1, 2010, (Cituar në fusnotën 33, *supra*).

nenit 17 (abuzimi i drejtës për kërkesë individuale) të KEDNJ³⁷. Kjo qasje evropiane reflektonte në tërësi klimën e Luftës së Ftohtë dhe frikën nga rreziku komunist që ekzistonte në vendet e demokracive kushtetuese perëndimore në dy anët e Atlantikut.

Përveç sa më sipër, aktualisht në shtetet evropiane ekzistenca dhe veprimtaria e partive politike mbrohen nga nenet 10, i cili garanton lirinë e shprehjes dhe 11, i cili garanton lirinë e tubimit dhe organizimit (asociimit), të KEDNJ³⁸.

Ndalimi i partive politike nga gjykatat kushtetuese është bërë objekt shqyrtimi nga GJEDNJ, mbi bazën e elaborimit të dy neneve si më sipër, pra të neneve 10 dhe 11 të KEDNJ. Rastet kanë ardhur nga vende të ndryshme. Më së shumti ka pasur raste nga Turqia sepse Gjykata Kushtetuese atje ka ndaluar 28 parti deri më tani, gjë që sërish e vërteton tezën tonë të sipërcekur se klima e Luftës së Ftohtë ka ndikuar në shumë ndalime të tilla, meqë Turqia dhe ruajtja e pozicionit të saj gjeostrategjik si anëtare e NATO-së dhe si një digë e mbrojtjes nga rreziku komunist kanë qenë të një rëndësie prioritare. Njëjtë vlen edhe për Turqinë pas mbarimit të Luftës së Ftohtë dhe rrezikut që vjen nga radikalizmi islamik. Prandaj, Gjykata Kushtetuese ka shërbyer si një mekanizëm i jashtëzakonshëm për të garantuar parimet kushtetuese që njihen si “*kemalizëm*”, pra forma republikane e Turqisë, ndajrja e fesë nga shteti, si dhe orientimi perëndimor i shoqërisë turke. GJEDNJ, ka trajtuar 21 raste në lidhje me shkeljen e të drejtave të mbrojtura nga neni 11 i KEDNJ dhe që kanë pasur lidhje me partitë politike³⁹. Gjatë vendosjes së këtyre rasteve, ajo ka krijuar standarde të caktuara juridike edhe përsa i përket partive politike duke i trajtuar ato në frymën e Konventës.

Vendimet e GJEDNJ përsa i përket këtyre rasteve kanë pasur efekt të madh në sistemet ligjore kombëtare. Siç u konstatua, vendi që është përfshirë më së shumti nga këto raste është Turqia, ajo ka ndryshuar kushtetutën dhe ligjin saj për partitë politike për t'i sjellë në linjë me standardet e përcaktuar nga KEDNJ në rastet që i përkisnin, duke futur kështu parimin e proporcionalitetit si bazë të gjykimit në të tilla rastet që i përkisnin pikërisht

³⁷ Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, Decisione by the Commissione a admissibility of the application Nr. 250/57. file:///C:/Documents%20and%20Settings/Besi%20Net%201/Desktop/DECISION%20BY%20THE%20COMMISSION%20ON%20THE%20ADMISSIBILITY.pdf. Qasur së fundmi më 29 Shkurt 2016.

³⁸ E drejta për t'u organizuar në parti, sindikata, shoqata etj.

³⁹ Fransje Molenaar, “*The Development of European Standards on Political Parties and their Regulation, The Legal Regulation of Political Parties Working*” Paper 4 February 2010. (Cituar në fusnotën 30, *supra*).

asaj. Njësoj kanë vepruar edhe shumë vende tjera që kanë pasur ndonjë rast para GJEDNJ.

Për herë të parë, në historinë e saj GJEDNJ është dashur të vendos për shpërbërjen e një partie politike në rastin *United Communist Party v. Turkey*⁴⁰. Partia e Bashkuar Komuniste në Turqi ishte formuar si një parti politike më 4 qershor 1990. Vetëm dhjetë ditë më vonë, kur ajo ishte duke u përgatitur për të marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme, Kryeprokurori i Republikës së Turqisë shtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për të nxjerr një urdhër për shpërbërjen e Partisë së Bashkuar Komuniste Turke. Kryeprokurori pati akuzuar Partinë se po “*kryente aktivitete që mund të minojnë integritetin territorial të Shtetit [turk] dhe unitetin e kombit turk*”. Edhe qëndrimi i saj ndaj minoritetit kurd u konsiderua i papranueshëm ashtu që një vit më vonë, Gjykata Kushtetuese urdhëroi shpërbërjen e saj partie për shkak të pikëpamjeve të shprehura në program të saj⁴¹.

Pas shpërbërjes së saj, Partia e Bashkuar Komuniste Turke paditi Turqinë në Strasburg⁴², duke i kërkuar GJEDNJ për t’u deklaruar nëse shpërbërja kishte qenë cënim, ndër të tjera, i neneve 10 (liria e shprehjes) dhe 11 (liria e asociimit) të KEDNJ. Qeveria turke argumentoi rastin duke pohuar se KEDNJ nuk përmend partitë politike, kurse vetë neni 11 mbi lirinë e asociimit nuk zbatohet për partitë politike. Sipas Qeverisë, rasti përbënte një abuzim me të drejtën e aplikimit individual dhe se kërkesa duhej shpallur e papranueshme në zbatim të nenit 17 të KEDNJ. Gjykata, hodhi poshtë kundërshtimet e Qeverisë dhe vendosi se neni 11 i KEDNJ zbatohet edhe për këtë rast, sepse neni 11 thotë: “*Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij*”⁴³.

GJEDNJ në praktikën e saj ka përpunuar edhe raste kur është justifikuar ndalimi dhe shpërndarja e një partie politike. Ndër të tjera, GJEDNJ ka përcaktuar se kjo mund të ndodhë vetëm kur shkaqet dhe kriteret e ndalimit të partive politike të jenë të përcaktuara qartë dhe në mënyrë ezauresive nga legjislacioni i brendshëm, legjislacion që, në çdo rast, duhet të jetë i qartë për rastet kur parashikon ndalimin dhe shpërndarjen e partive politike, sepse

⁴⁰ European Court of Human Rights, “*Comunist Party and Others vs Turkey*”, (133/1996/752/951), Judgment, Strasbourg, 30 January 1998.

⁴¹ Po aty.

⁴² Qyteti ku është Selia e GJEDNJ.

⁴³ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni, 11, e qasshme: [http://www.echr.coe.int/Documents/ Convention_SQL.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SQL.pdf), qasur së fundmi më 8 Mars 2016

çfarëdo paqartësi konsiderohet e papranueshme. Në këtë drejtim kërkohet që shkaqet e përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm, përpos qartësisë të kenë edhe legjitimitet, pasi GJEDNJ njeh rëndësinë e madhe që kanë partitë për një shoqëri dhe për ndalimin saj kërkon një arsye të fortë. Në frymën e kësaj, një parti mund të ndalohet edhe kur bie ndesh me parimet e një demokracie funksionale, pra jo vetëm kur bie ndesh me strukturën dhe organizimin e një shteti⁴⁴. Kështu, në rastin *Socialist Party and Others v. Turkey*, GJEDNJ u shpreh se: “fakti që një program i tillë politik është konsideruar i papajtueshëm me parimet dhe strukturën e shtetit turk, nuk e bën atë të bie në kundërshtim me rregullat e demokracisë, sepse ky është vetë thelbi i demokracisë, të lejoj edhe propozimin e programeve politike të cilat vënë në diskutim mënyrën sesi është organizuar aktualisht shteti, gjithnjë me kusht që ato të mos dëmtojnë vetë demokracinë”⁴⁵. Në këtë rast GJEDNJ ka vendosur një standard tjetër, sa i takon ndalimit të partisë politike, duke vënë në spikamë përputhshmërinë eventuale të programit partiak me rendin kushtetues. I një rëndësie të tillë për rendin kushtetues është parimi i laicitetit. Në lidhje me thyerjen e parimit të laicitetit në Turqi, GJEDNJ u mor në rastin *The Refah Partisi and Others v. Turkey*⁴⁶. Partia e Mirëqenies (Turqisht: Refah Partisi), ishte themeluar më 19 korrik 1983. Më 21 maj 1997, Kryeprokurori i Republikës së Turqisë dorëzoi një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për të shpërbër Partinë e Mirëqenies me arsyetimin se Partia ishte bërë qendër e aktiviteteve kundër parimit republikan të sekularizmit. Gjykata Kushtetuese, urdhëroi shpërbërjen e kësaj partie më 16 Janar 1998, në kohën kur partia ishte në pushtet që prej tetëmbëdhjetë muajsh në një qeveri koalicioni me një parti të qendrës së djathtë. Njëherësh, ky rast ka qenë më i rëndësishmi në krahasim me rastet e mëparshme të shpërbërjes, sepse kishte përfshirë një parti në pushtet⁴⁷. Gjithashtu, ky rast ka qenë objekt trajtimi nga GJEDNJ dhe Turqia si provë kishte përdorur fjalime të përfaqësuesve të partisë⁴⁸.

⁴⁴ Erald Shushari, “Kontrolli Kushtetues i partive politike”, Revista “Avokatia” nr. 8, Tiranë, 2014. (Cituar në fusnotën 25, *supra*).

⁴⁵ European Court of Human Rights, *Socialist Party and others v. Turkey*, (20/1997/804/1007), Judgment, Strasbourg, 25 May 1998. Po ashtu më shumë për praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Turqisë në ndalimin e partive politike shih, Bülent Algan, “*Dissolution of Political Parties by the Constitutional Court in Turkey: an Everlasting Conflict Between the Court and the Parliament?*”, AUHFD, 60 (4) 2011, fq.809-836.

⁴⁶ European Court of Human Rights, *Welfare Party and Others v. Turkey*(Applications nos. [41340/98](#), [41342/98](#), [41343/98](#) and [41344/98](#)) Judgment, Strasbourg, 13 February 2003.

⁴⁷ Olgun Akbulut, “*Criteria Developed by the European Court of Human Rights on the Dissolution of Political Parties*”, Fordham International Law Journal, Volume 34, Issue 1, 2010.(Cituar në fusnotën 33, *supra*).

⁴⁸ Po aty.

Megjithatë, është mjaft interesant të shihet se si GJEDNJ u distancua nga çështja nëse Partia e Mirëqenies përbënte një kërcënim real për laicitetin, demokraci, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut, duke konstatuar në fund se nuk ka pasur shkelje të nenit 11 të Konventës⁴⁹. Kjo don të thotë se GJEDNJ, në fakt, nuk u mor fare me çështjen e arsyeve të cilat i kishin përdorur mekanizmat e brendshëm kushtetues të Turqisë si argument për ndalimin e aktivitetit të kësaj partie. Për më tepër, si të tillë rastin e ka cilësuar si rast që nuk përbën shkelje të KEDNJ.

GJEDNJ në praktikën e saj të viteve të fundit është marrë edhe me çështjen e partive politike që mbështesin terrorizimin. Në rastin *Herri Batasuna v. Spain*, gjykata është marrë me një kërkesë të një partie politike që u shpërbë pasi u gjet fajtores për mbështetje të terrorizmit⁵⁰. Herri Batasuna, një koalicion elektoral dhe Batasuna parti politike, u themelua më 1 mars, 1979, përkatësisht 3 maj 2001, në Spanjë si krah politik i organizatës *Euskadi Ta Askatasuna* (“ETA”). Spanja, kishte miratuar një ligj për partitë politike, qëllimi i të cilit ishte për të përcaktuar kufizimet mbi partitë politike kur ato shkelin të drejtat e qytetarëve, duke nxitur racizëm ose dhunë. Prokurori i Përgjithshëm i Spanjës, kishte paraqitur një rast në Gjykatën Supreme Spanjolle më 2 shtator 2002, për shpërbërjen e partisë, ku gjykata vendosi shpërbërjen e kësaj partie. Ankuesi pretendoi se shpërbërja e tyre kishte shkaktuar shkelje të të drejtës së tyre për lirinë e asociimit. Duke përshkruar Ligjin Institucional nr. 6/2002 mbi partitë politike si një ligj ad hoc, ankuesit argumentuan se ai nuk ishte as i arritshëm as i parashikueshëm dhe u ankuan se ai ishte aplikuar në mënyrë retrospektive. Duke deklaruar se qëllimi i shpërbërjes së tyre kishte qenë për të eliminuar debatin politik në Baski, ata u ankuan se masa nuk kishte pasur asnjë qëllim legjitim. Po ashtu, ata argumentuan se kjo nuk mund të konsiderohet e nevojshme në një shoqëri demokratike duke konsideruar se kjo ishte një shkelje e parimit të proporcionalitetit⁵¹. GJEDNJ vendosi se nuk kishte shkelje të nenit 11⁵².

⁴⁹ European Court of Human Rights, *Welfare Party and Others v. Turkey* (Applications nos. 41340/98, 41342/98, 41343/98 and 41344/98) Judgment, Strasbourg, 13 February 2003.

⁵⁰ European Court of Human Rights, *Herri Batasuna and Batasuna v. Spain* (Applications nos. 25803/04 and 25817/04) Judgment, Strasbourg, 30 Jun 2009.

⁵¹ European Court of Human Rights, *Herri Batasuna and Batasuna v. Spain* (Applications nos. 25803/04 and 25817/04) Judgment, Strasbourg, 30 Jun 2009.

⁵² Po aty. Më shumë për këtë rast shih po ashtu Eduardo Virgala Foruria, “*The banning of political parties in Spain (the Batasuna case)*” Paper to the World Congress of Constitutional Law 2014- Workshop 13: Constitutional dimensions of political parties and elections. <https://www.jus.uio.no/english/research/news-and-events/events/conferences/2014/ēccl-cmde/wccl/papers/ws13/ē13-foruria.pdf>, qasur së fundmi me 28 Shkurt 2016.

5. Roli i Komisionit Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias) në konstitucionalizimin dhe kontrollin e partive politike

Në vazhden e krijimit të standardeve evropiane, edhe Këshilli i Evropës nëpërmjet Komisionit Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias) ka luajtur një rol të rëndësishëm në përcaktimin e standardeve dhe parimeve demokratike të funksionimit të partive politike, por edhe në përcaktimin e legjislacionit kombëtar që rregullon partitë politike. Në këtë kontekst, Komisioni i Venecias është ftuar shpesh herë për të ofruar opinione mbi pajtueshmërinë e ligjeve kombëtare që rregullojnë partitë me standardet ndërkombëtare⁵³. Janë dy udhëzime kryesore që ka dhënë Komisioni i Venecias në lidhje me rregullimin e ndalimit dhe shpërbërjes së partive politike:

1. "Udhëzimet mbi ndalimin dhe shpërbërjen e partive politike dhe masat e ngjashme"⁵⁴;

2. "Udhëzimet dhe raporti shpjegues mbi legjislacionin e partive politike: Disa çështje specifike".

Të dy dokumentet përcaktojnë se e drejta për t'u organizuar në parti politike është e mbrojtur si pjesë e lirisë së asociimit sipas nenit 11 të KENDJ dhe i bëhet referencë praktikës gjyqësore të GJEDNJ.

Ndërsa në lidhje me financimin partive politike si dimension, Komisioni i Venecias, së bashku me OSBE/OHDIR në vitin 2001 ka hartuar raportin me titull "*Udhëzime dhe Raporti mbi financimin e partive politike*"⁵⁵. Dokumenti është i bazuar në një raport krahasues të legjislacionit kombëtar për financimin e partive politike dhe në këtë mënyrë i kushtohet vëmendje praktikës shtetërore në këtë fushë. Në hyrje të Udhëzimeve, Komisioni thekson shqetësimin e tij të shkaktuar nga skandalet e fundit financiare që përfshijnë partitë politike në Evropë. Kjo lloj sjellje është e papajtueshme me

⁵³ Fransje Molenaar, "*The Development of European Standards on Political Parties and their Regulation, The Legal Regulation of Political Parties Working*" Paper 4 February 2010. (Cituar në fusnotën 30, *supra*).

⁵⁴ Venice Commission (1999). "*Guidelines on Prohibition and Dissolution of Political Parties and Analogous Measures*". Guidelines adopted by the Venice Molenaar: The Development of European Standards 52 Commission at its 41st plenary session. Venice, 10-11 December 1999. <http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-INF%282000%29001-e>, qasur së fundmi me 3 Mars 2016.

⁵⁵ Venice Commission (2001). "*Guidelines and Report on the Financing of Political Parties*." Guidelines adopted by the Venice Commission at its 46st plenary session. Venice, 09-10 March 2001. <http://www.osce.org/odihr/37843?doenload=true>, qasur së fundmi me 5 Mars 2016.

"rolin thelbësor të partive politike brenda demokracisë"⁵⁶. Më tutje, në këtë raport trajtohen çështje të tilla si financimi publik, financimi privat, fushatat elektorale, kontrolli i fondeve të partive dhe sanksionet. Raporti kërkon që financimi i partive politike në çdo rast të jetë transparent dhe të gjitha shpenzimet e fushatave duhet të kenë një kufizim të përcaktuar më parë si dhe shteti të parashikoj sanksionim për partitë që shkelin kriteret e përcaktuara për financim. U mor vesh, se financimi nuk është pjesë e ndarë nga konstitucionalizimi dhe kontrolli i partive politike, por kjo që u konstatua më lartë, u bë me qëllim të pasqyrimin të kontributit që ka dhënë Komisioni i Venecias përsa i përket partive politike. Sidoqoftë, vlenë të theksohet se çështja e kontrollit financiar dhe financimi i partive politike nuk ka qenë shkak i ndalimit të vperimtarisë së tyre (konstitucionalizimit) apo i vet shërbërjes.

Po ashtu, në vitin 2010 është miratuar një raport me titull "*udhëzues mbi rregullimin partive politike*"⁵⁷. Ky raport përcakton 10 parime mbi të cilat duhet të mbështetet legjislacioni që rregullon partitë politike si dhe vlerësimi që bëjnë organet kompetente kur vlersojnë këtë legjislacion. Këto parime janë:

1. E drejta individuale për lirinë e asociimit;
2. Detyrimi i shtetit për të mbrojtur të drejtën individuale të asociimit;
3. Ligjshmëria;
4. Proporcionaliteti;
5. Mosdiskriminimi;
6. Trajtimi i barabartë;
7. Pluralizmi politik;
8. Administrimi i mirë i Legjislacionit Lidhur me Partitë Politike;
9. E drejta për mjet efektiv në rastet e shkeljes të të drejtave;
10. Llogaridhënia⁵⁸.

6. Shqyrtimi i kushtetutshmërisë së partive politike nga gjykatat kushtetuese

Një nga funksionet më themelore të shumicës së gjykatave kushtetuese të shteteve demokratike, është kontrollimi i kushtetutshmërisë së partive

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ "*Guidelines on political party regulation*", by OSCE/ODIHR and Venice Commission, 25 October 2010 (Study no. 595/2010), p. 6. Shih., [http://www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-AD\(2010\)024-e.pdf](http://www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-AD(2010)024-e.pdf), qasur së fundmi me 6 Mars 2016.

⁵⁸ "*Guidelines on political party regulation*", by OSCE/ODIHR and Venice Commission, 25 October 2010 (Study no. 595/2010), p. 6. Shih., [http://www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-AD\(2010\)024-e.pdf](http://www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-AD(2010)024-e.pdf), qasur së fundmi me 14 Mars 2016.

politike dhe organizatave të tjera. U kuptua tashmë që partitë politike janë akter shumë të rëndësishëm në jetën shtetërore dhe institucionale, andaj veprimtaria e tyre nuk mund të mbetet e pakontrolluar, deri në një instancë të fundit⁵⁹. Në thelb të demokracisë qëndron pjesëmarrja aktive dhe e lirë e të gjithë shtetasve në jetën shtetërore të vendit të tyre, ku pluralizmi, është një ndër vlerat më themelore. Koncepti, për një shoqëri demokratike nuk mund të lejoj krijimin e partive që propagandojnë dhe përpiqen të realizojnë qëllimin e tyre me anë të përdorimit të dhunës, forcës, armëve ose çfarëdo mjeti tjetër jodemokratik e luftënxitës. Veprimtaria e partive politike me karakter të fshehtë, është e paligjshme, pra partitë politike, veprimtarinë e tyre duhet ta ushtrojnë në përputhje me parimet kushtetuese të shtetit ligjor, demokratik dhe me sovranitetin e popullit.

Siç u tha partitë politike, janë mjet kryesor i lidhjes ndërmjet qytetarit të thjeshtë dhe shtetit, ku roli i tyre konsiderohet i domosdoshëm dhe i pazëvendësueshëm në bërjen e jetës politike. Ky rol që partitë kanë në shoqëri, nuk mund të lihet i pakontrolluar, sepse përvoja nga e kaluara ka treguar se partitë mund të shkelin mbi parimet dhe vlerat kushtetuese e demokratike. Pikërisht, për këtë arsye kushtetuta dhe ligjet themelore të shumë vendeve të botës, krahas evidentimit të rolit, peshës dhe rëndësisë që kanë partitë politike për zhvillimin e pluralizmit dhe të demokracisë në përgjithësi, parashikojnë edhe ndalimin e atyre partive që e mbështesin veprimtarinë e tyre në ideologji, në parime dhe rregulla që e dëmtojnë dhe kërcënojnë seriozisht demokracinë. Në këtë drejtim, roli i shtetit është shumë i madh që të reagoj ndaj akterëve të cilët rrezikojnë demokracinë.

Kudo nëpër vendet demokratike, Gjykatat Kushtetuese, kanë rolin kryesor në kontrollin e kushtetutshmërisë së veprimtarive të partive politike e të organizatave tjera me karakter politik, të cilat ushtrojnë misionin e tyre në kundërshtim me konceptet, parimet dhe vlerat kushtetuese e demokratike, kjo lidhet edhe me faktin që ky mekanizëm shihet si më i sigurti për garantimin e kushtetutshmërisë.

Në përgjithësi, ky funksion që kanë gjykatat kushtetuese në botë është ndër më kryesoret. Modeli i përdorur në Ligjin Themelor Gjerman, që konsiderohet si një ndër sistemet më të avancuara në këtë aspekt, është huazuar nga shumë vende postkomuniste të cilat për shumë kohë kanë vuajtur pasojat e veprimit të një partie të vetme e cila ka kontrolluar të gjithë jetën institucionale, shoqërore dhe shtetërore duke dalë edhe mbi kushtetutën

⁵⁹ Sokol Sadushi, “*Kontrolli Kushtetues*”, Tiranë, 2004, fq. 126.

dhe ligjet, mbase, kjo ka qenë njëra ndër arsyt kryesore që këto vende kontrollin kushtetues të partive politike e kanë vënë ndër funksionet më kryesore të gjykatave të tyre kushtetuese. Dëshmi e kësaj, është Kushtetuta e Shqipërisë, Kushtetuta e Kroacisë, Kushtetuta e Lituanisë, Kushtetuta të Polonisë, Kushtetuta e Sllovenisë etj.

Kur gjykatat kushtetuese hidhen në shikimin kushtetutshmërisë së partive dhe organizatave tjera politike, zakonisht ndalen në dy çështje kyçe: *së pari*: nëse partia ose organizata politike është krijuar në përputhje me dispozitat kushtetuese; *së dyti*: nëse veprimtaria e tyre përputhet me kushtetutën.

Në parim konsiderohet antikushtetuese krijimi dhe veprimtaria e partive dhe organizatave tjera politike në ato raste kur programi i tyre dhe veprimtaria që ato ushtrojnë mbështetet në metoda totalitariste që nxisin e përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore⁶⁰. Njëkohësisht, përveç këtyre edhe partitë që veprojnë në ilegalitet konsiderohen po ashtu si jokushtetuese.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, i ka dhënë të drejtën Gjykatës Kushtetuese që të shikoj nëse krijimi dhe veprimtaria e partive politike dhe organizatave tjera është në përputhje me kushtetutën dhe vlerat demokratike të mishëruara në të. Kështu, neni 131, pika “d”, i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon se: "Gjykata Kushtetuese vendos për kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si edhe të veprimtarisë së tyre, sipas nenit 9 të kësaj Kushtetute". Nga mënyra sesi është formuluar kjo normë duket qartë se kur Gjykata Kushtetuese shqyrton një çështje me këtë objekt duhet të ndalet në dy pika: nëse partia ose organizata politike është krijuar në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe nëse veprimtaria e tyre përputhet me kushtetutën. Edhe pse Kushtetuta e Shqipërisë e ka vënë kontrollin kushtetues të partive politike ndër funksionet më të rëndësishme të Gjykatës Kushtetuese, në praktikë vlerësimi i kushtetutshmërisë së partive politike dhe organizatave të tjera politike ka qenë i rrallë. Në vitet e para të vendosjes së pluralizmit në Shqipëri, u patën vënë re disa prirje për të krijuar parti politike dhe organizata të tjera politike tej koncepteve që parashikonte ligji dhe dispozitat kushtetuese⁶¹. Me vendimin nr.7, datë 16.9.1992, Gjykata

⁶⁰ Shih disa nga kriteret trajtuara më sipër në punim: 1.kërcënojnë integritetin territorial të shtetit; 2.kërcënojnë ekzistencën dhe sovranitetin e shtetit; 3.nxisin dallimet etnike; 4.mbështetën në ideologji totalitare, ta zëmë naziste ose fashiste; 5.përdorin dhunën si mjet për të arritur qëllimet e tyre; 6.kanë lidhje me organizata kriminale; 7.veprojnë në fshehtësi.

⁶¹ Erald Shushari, “Kontrolli kushtetues i partive politike” Revista “Avokatia” nr. 8, Tiranë, 2014. (Cituar në fusnotën 25, *supra*).

Kushtetuese, shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga Kryesia e Partisë Komuniste të Shqipërisë, e cila kërkonte “shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr.7591, datë 16.7.1992 “Për ndryshimin e përmbajtjes së gërmës “b” të nenit 6 të ligjit “Për partitë politike”, si edhe anulimin e urdhrit nr 43/2, datë 17.7.1992 të Ministrisë të Drejtësisë për nxjerrjen jashtë ligjit të Partisë Komuniste.” Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën e paraqitur, duke arsyetuar që “moslejimi me ligj i krijimit dhe i veprimtarisë së partive politike, kur qëllimet dhe veprimtaria e tyre kanë karakter antikombëtar, enveristo-komunist, marksist-leninist etj, nuk vjen në kundërshtim me parimin e pluralizmit partiak. Sipas Dispozitave Kryesore Kushtetuese, Republika e Shqipërisë është shtet juridik dhe demokratik. Nga kjo del se qëllimet dhe veprimtaria e partive politike duhet të zhvillohen vetëm mbi parime demokratike. Nuk mund të lejohet veprimtaria e partive politike, që kanë në themel parime antidemokratike, si rrëzimin me dhunë të rendit kushtetues, hapjen dhe kufizimin e lirive demokratike të shtetasve, diktaturën e proletariatit, luftën e klasave etj”⁶².

Në vendimin nr.2, datë 21.7.1992, Gjykata Kushtetuese ka shpallur të paligjshme veprimtarinë e organizatës së pamiruar “Bashkimi i kuadrove ushtarkë në rezervë”, si edhe ndalimin e veprimtarisë së mëtejshme të saj. Ajo arsyeton në këtë vendim se: “në mbështetje edhe të nenit 16 të ligjit nr. 7502, datë 25.7.1992 “Për partitë politike”, asnjë parti apo organizatë politike ose shoqërore nuk ka të drejtë të zhvillojë veprimtari në përmbajtje të së cilës trajtohet ose bëhet fjalë tërësisht apo pjesërisht për objektivat ose qëllimet e krijimit të kësaj organizate, të marrë vendime dhe të mbajë qëndrim për të, para miratimit të saj nga organi kompetent shtetëror e as të shprehën në emër të saj zyrtarisht”⁶³.

Nga kjo që u tha më sipër shihet qartë se partitë politike nepër vendet e ndryshme në Ballkan dhe gjetiu, ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kuadër të një strukture më të kompletuar kushtetuese, përse i përket dimensioneve që lidhen me to. Sistemet kushtetuese kanë arritur të krijojnë standarde të caktuara të konstitucionalizimit, përfshirë këtu edhe kontrollin dhe ndalimin e atyre partive që ushtrojnë aktivitetin në kundërshtim me rendin kushtetues. U mor vesh se qasja e konstitucionalizimit të partive dhe mekanizmat përmes të cilës ato kontrollohen ndryshon nga shteti në shtet, mirëpo duket se trendi ka lëvizur në atë mënyrë që sistemet e ndryshme kanë ndikuar shumë në standardet evropiane të konstitucionalizimit të partive politike, të cilat janë trajtuar më lartë. Njëjtë si në vendet tjera, të cilat kanë krijuar mekanizma

⁶² Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Vendimi Nr. 7, datë 16.9.1992.

⁶³ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Vendimi Nr. 2, datë 21.7.1992.

përsa i përket konstitucionalizimit dhe kontrollit të partive politike, edhe në Kosovë sistemi i ri kushtetues ka absorbuar vlerat dhe standardet evropiane lidhur me rolin dhe pozitën kushtetuese të partive politike. Në rastin e Kosovës, megjithatë, çështja e kontrollit kushtetues të jetës dhe punës së partive politike ka një dimension krejt tjetër dhe nuk përbën ndonjë problem të veçant në shoqëri tonë. Në seksionin më poshtë trajtohet konstitucionalizimi i partive politike në rastin e Kosovës, meqë çështja e kontrollit kushtetues të partive politike asnjëherë nuk është shtruar seriozisht për diskutim gjatë hartimit të Kushtetutës së Kosovës 2008 që sot është në fuqi⁶⁴.

7. Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008 dhe partitë politike përkritazi me konstitucionalizimin dhe kontrollin e tyre

Në parim, problemin e trajtimit të konstitucionalizimit dhe kontrollit kushtetues të partive politike, edhe në rastin e Kosovës duhet shikuar në kontekst të prizmit të përgjithshëm të trajtimit të interpretimeve të bëra nga GJEDNJ si dhe praktikave të tjera të vendeve demokratike. Në qasjen e konstitucionalizimit të partive politike, përfshirë edhe kontrollin e tyre nga Gjykata Kushtetuese, në rastin e Kosovës duhet pasur parasysh edhe karakteristikat e rendit Kushtetues të Kosovës si dhe rrethanat tjera që kanë qar deri në dizenjimin e këtij sistemi kushtetues në Kosovë.

Para se të shtjellojmë me thëllësisht çështjen, fillimisht duhet theksuar se Gjykata Kushtetuese e Kosovës, nuk posedon një juridiksion orgjinal përmes së cilit do të mund të kontrollonte apo edhe ndalonte aktivitetet e partive politike, programet dhe statutet e tyre⁶⁵. Duke marrë parasysh këtë fakt, rrjedhimisht analiza zhvendoset në një kënd tjetër, i cili mund të prodhojë dy pyetje të lidhura me njëra tjetrën: E para pyetje lidhet me faktin se përse në Kushtetutën e Kosovës (2008) nuk është paraparë një mekanizëm i tillë i kontrollit dhe e dyta ka të bëjë me atë se si realizohet një funksion i tillë në sistemin Kushtetues të Kosovës, përmes të cilit mund të arrihej një kontroll i aktivitetit të partive politike?

U mor vesh se kontrolli kushtetues i aktiviteteve, statuteve dhe programeve të partive politike është ushtruar në mënyrë më rigoroze në vendet ku ka

⁶⁴ Prof.Dr.Arsim Bajrami (autori i parë), Intervistë, 12.03.2016.

⁶⁵ Neni 113 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që përcakton juridiksionin e saj dhe kompetencat e veçanta nuk përcakton edhe një kompetencë të tillë, përmes të cilës do të mundësoj një kontroll kushtetues i aktiviteteve, statuteve dhe programeve të partive politike. Një gjë e tillë nuk përcaktohet as në ndonjë nen tjetër të Kushtetutës.

ekzistuar frika reale për përhapjen apo rikthimin e regjimeve të mëhershme jodemokratike. Qartazi, kjo lidhet me historinë e shteteve përkatëse, ku në rastin e Gjermanisë, ta zëmë, ky fakt historik konsiston në rikthimin e mundshëm në pushtet të partive me orientim nazist. Njëjtë vlen edhe për Turqinë, e cila që nga themelimi i saj si Republikë ka pasur dhe ka ankthin e prishjes së parametrave të asaj që atje njihet si “*kemalizëm*”, ku laiciteti dhe ndarja e islamit nga shteti përbën elementin kyq, rikthimin e partive me orientim pro islamik ka qenë dhe ngelet prioritet i shoqërisë turke, ani se partitë aktuale në pamje kanë një fytyrë të tillë, por në thelb nuk kanë arritur akoma ti ndryshojnë parimet e “*kemalizmit*” mbi të cilat ndërtohet Republika e Turqisë⁶⁶. Në fakt, ndrojtja e hakmarrjes historike dhe rikthimit të ideologjive dhe regjimeve të kaluara përmes partive politike vertetohet qartë nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Turqisë dhe rastet e partive politike të saj që janë trajtuar nga GJEDNJ. Ka autor që vlerësojnë se, në rastin e Turqisë, në fakt, duket se objektivi kushtetues për masa preventive dhe kontroll të partive politike me orientim islamist është tradhëtuar në një farë masë⁶⁷, qoftë përmes veprimit me standarde të dyfishta nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Turqisë ose mosveprimit për ndalimin e këtyre partive.

Të përkujtojmë çështjen e parë që e shtruar më lartë në formë të pyetjes, faktin se përse sistemi kushtetues në Kosovë i bazuar në Kushtetutën e vitit 2008 nuk ka instaluar një kontroll të tillë të parandalimit të partive politike? Kjo pyetje mund të gjej përgjigje vetëm nëse nisemi nga dimensionimi i mësipërm historik dhe frika që mund të ketë ekzistuar tek popujt dhe sistemet e tjera kushtetuese. Në këtë kuptim Kosova ka një histori tjetër, histori kjo e shkëputjes nga sistemi kushtetues komunist dhe luftës së fundit për çlirim nga sistemi diktatorial i regjimit të Slllobodan Millosheviqit. Konteksti kushtetues kosovar ka një ndërtim krejt të ndryshëm, si pasojë e faktit se Kosova ka pasur një trajektore tjetër të zhvillimit social, politik, ekonomik, kulturor, gjë e cila e bën Kosovën mjaft më ndryshe nga vendet e tjera ish-komuniste të Evropës⁶⁸. Kjo rrethanë, tregon qartazi realitetin dhe historinë kushtetuese të Kosovës, e cila ka kaluar nëpër periudha të shkëputjes kirurgjike dhe kjo ka pasur ndikim të madh edhe në çështjen për të cilën po flasim.

⁶⁶ Prof.Dr.Enver Hasani, Intervistë, 15.02.2015.

⁶⁷ Po aty.

⁶⁸ Prof.Dr.Enver Hsani, “*Veçoritë themelore të sistemit kushtetues në Kosovë*”, Revista E Drejta-Law, nr.1-4, 2014, fq 7.

Fillimisht, Kosova ka pasur një sistem kushtues komunist, në kohën për sa ishte në kuadër të ish-Jugosllavisë, më pas ky realitet u bart në sistemin kushtues të Serbisë⁶⁹, duke kaluar në një sistem kushtues në tranzicion pas instalimit të administratës ndërkombëtare në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara⁷⁰. Ky tranzicion, në rastin e Kosovës, është tërësisht sepccifik krahauar me vendet tjera të Evropës ish komuniste. Kjo për faktin se Kosova nga qershori 1999 deri më shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008 ka qenë nën kontrollin administrativ të Kombeve të Bashkuara dhe konsitucionalizimi i partive është bërë në këtë kuadër, përkatësiht në bazë të asaj që quhej “*Korniza Kushtetuese mbi Vetqeverisjen e Përkohëshme të Kosovës*”, e cila ka pasur statusin e dokumentit juridik të Kombëve të Bashkuara⁷¹.

Modeli ekzistent i krijuar pas shpalljes së Deklaratës së Pavarësisë më 17 shkurt 2008, dhe hyrjes në fuqi të Kushtutës ka qenë dhe mbetet një model kushtues pro-perendimor, i cili nuk përkon fare me realitetin historik dhe kjo shpesh herë ka prodhuar edhe keqkuptime dhe keqinterpretime në qarqet akademike dhe politike⁷². Modeli aktual kushtues dhe përmbajtja e tij në kuptim të kontrollit të partive politike do të trajtohet më poshtë, meqë rast do të pasqyrohet edhe mënyra se si mund të realizohet në Kushtutën e Kosovës një kontroll i tillë aktiviteteve, programeve dhe statuteve të partive politike.

Konteksti i historisë kushtetuese të Kosovës ka ndikuar qartësisht në mospërcaktimin dhe mungesën e një kompetence kushtetuese që do të mundësonte ushtrimin e kontrollit kushtues të aktivitetit, programeve dhe statuteve të partive politike në Kosovë. Mënyra e krijimit të sistemit kushtues kosovar, i cili zbatohet aktualisht, nuk ka fare koherencë apo kontinuitet me të kaluarën Kushtetuese të Kosovës. Kjo rrethanë i ka

⁶⁹ Me rastin e okupimit të dhunshëm në vitin 1989.

⁷⁰ Prof.Dr.Arsim Bajrami (autori i parë), në tekstet e tij universitare “*Sistemi Kushtetues i Republikës Kosovës*” Prishtinë 2011 dhe “*E Drejta e Kosovës në Tranzicion*”, Prishtinë 2002, sqaron pozitën Kushtetuese të Kosovës në kuadër të ish-Jugosllavisë, duke trajtuar rëniet dhe ngritjet e saj, periudhën kur në Kosovë ka qenë valid sistemi dhe rregullat Kushtetuese të Serbisë si dhe Tranzicionin Kushtetues që ka kaluar Kosova nga viti 1999-2008. Ky pasqyrim, tregon qartë se Kosova ka pasur shkëputje “kirurgjike” të njëpasnjëshme, andaj këto shkëputje kanë ndikuar në tjetërsimin e karakteristikave dhe unifikimin e historisë kushtetuese që ka reflektuar edhe në aspektin për të cilin po flasim në këtë punim.

⁷¹ *Korniza Kushtetuese për Vetqeverisje të Përkohëshme në Kosovë, 2001*, e cila i njëjtte partitë politike si entitet në përmbajtjen e saj. Shih psh: nenet: 9.1.3 (a); 9.1.3 (b), (i); 9.1.7 (b), (ç), (dh); 9.1.11; 9.1.20; 9.1.22; 9.2.1 (b)-Kapitulli për Kryetarin e Kosovës; 9.3.8-Kapitulli për Qeverinë. Pra në këtë dokument kushtetues, partitë politike përmendëshin në kontekstin e pjesëmarrjes dhe ushtrimit të pushtetit apo të qeverisjes.

⁷² Shih burimi në fusnotën 68 *supra*.

mjaftuar hartuesve të kushtetutës aktuale që ta cilësojnë si të panevojshëm krijimin e një mekanizmi kushtetues që do të ushtronte kontroll kushtetues ndaj aktivitetit, programeve dhe statuteve të partive politike. Edhe në rastin e Kosovës, ky mekanizëm natyrshëm do të ishte Gjykata Kushtetuese.

Një faktor tjetër që duket se ka ndikuar në këtë rrethanë është edhe prezenca ndërkombëtare në hartimin e Kushtetutës së Kosovës, prezencë kjo që u transmetua përmes OJQ-ve ndërkombëtare dhe zyreve diplomatike në Prishtinë⁷³. Madje Profesor Weller, në faqet përkatëse të librit të tij, *“Shtetësia e Kontestuar”* pranon që ka pasur aq shumë ndërhyrje sa që faktori ndërkombëtar kishin qenë shumë të pakënaqur⁷⁴ me disa nëngrupe që ishin krijuar në grupin bazik për hartimin e Kushtetutës së Kosovës. Padyshim, ky fakt i asistencës ndërkombëtare në procesin e bërjes së kushtetutës nuk mohohet as nga hartuesit kosovar⁷⁵. Kjo rrethanë e historisë së re kushtetuese që ndikoj në hartimin e Kushtetutës në fuqi të Kosovës dhe që njëherësh krijoi realitetin e ri kushtetues kosovar, duket të jetë e mjaftueshme, për të reflektuar edhe në modelin dhe dizajnimin e mekanizmit që kryen kontrollin Kushtetues në Kosovë. Në kontekstin e trajtimit të çështjes bosht, duhet të theksohet se faktori vendor dhe ndërkombëtarë që kanë hartuar Kushtetutën e Kosovës, sidomos pjesën e kontrollit kushtetues, kanë qenë të vetëdijshëm se Kosovës, me ralizimin social dhe politik të krijuar deri në atë moment nuk i duhej një kontroll aq rigoroz i veprimtarisë, programeve dhe statuteve të partive politike⁷⁶.

⁷³ Marc Weller, *“Shtetësia e Kontestuar”*, botimet KOHA, Prishtinë 2011, fq 391-408.

⁷⁴ Në katë rast të pakënaqur nënkupton pakënaqësinë me cilësinë profesionale të drafteve që kishin dorëzuar nëngrupet e caktuara, ku bëhet përjashtim i një grupi të ngushtë prej vendorëve apo individëve të caktuar të cilët bashkë me faktorin ndërkombëtar e kishin marrë mbi supë hartimin e draftit final të Kushtetutës aktuale (2008). Këtu, në faqën 403 Proesor Weller i referohet emrave konkret dhe duke falenderuar *ad hominem* për punën e tyre në komisionin për hartimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Profesorët Universitarë A.Bajrami (autori i parë) dhe H.Kuçi.

⁷⁵ Prof.Dr.Enver Hsani, *“Veçoritë themelore të Sistemit Kushtetues në Kosovë”*, Revista E Drejta-Law, nr.1-4, 2014, fq 33. (Cituar në fusnotën 68 *supra*).

⁷⁶ Që nga vitet e 90'ta Kosova kishte filluar krijimin e partive dhe lëvizjeve të para politike, duke nisur me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe të tjerat. Më pas në vitin 1999 e deri në vitin 2008, momentin kur po hartohej Kushtetuta e Kosovës, u krijuan dhe u shuan po ashtu edhe disa parti të tjera politike të cilat kryesisht kishin orientim pro-perendimor dhe pse pa një profilizim të qartë, por ky është një problem krejt tjetër. Në fakt vitet e tranzicionit kushtetues kishin ndërtuar frymën e pluralizmit politik një vlerë kjo e rëndësishme kushtetuese, me shumicën e partive të krijuara pas luftës (pas vitit 1999).

Siç u theksua më sipër⁷⁷, vitet e tranzicionit kushtetues në Kosovë dëshmuar se u krijuan forca politike të tilla shumica e të cilave, kishin orientim pro-perendimor dhe në programet e statutet e tyre kishin të instaluar mekanizma demokratik të realizimit të synimeve dhe veprimeve të tyre. Për më tepër, aktiviteti dhe programet e tyre përkonin me realitetin kushtetues. Edhe sot, në kohën kur po shkruhen këto rreshta, në Kosovë është po i njëjti realitet politik në kuptimin aktivitetit të partive politike, me disa dallime të vogla. Ky realitet social dhe politik, në kontekst të partive politike duket që nuk janë cilësuar si rrezik real që në Kosovë mund të paraqitet ndonjë parti e cila në një formë apo tjetër do të rrezikonte rendin kushtetues dhe në këtë mënyrë aktiviteti i saj do të kishte nevojë të ndalohej. Kjo rrethanë ka zvogluar gjasat që në Kushtetutën e Kosovës të ketë nevojë për një mekanizëm të tillë që do t'i kontrollonte partitë politike⁷⁸.

Sa i përket pyetjes dhe arsyes se pse sistemi kushtetues kosovar nuk e ka një mekanizëm të tillë, përveç shkaqeve historike dhe realitetit social e politik të analizuar si më sipër, një përgjigje me të saktë do të mund të jepnin *travaux preparatoires* (materialet përgaditore) të draftuata gjatë hartimit të Kushtetutës së Kosovës. Këto dokumente do të mund të ndihmonin dhe pasqyronin autenticitetin e normave aktuale, por edhe të idesë mbi bazën mbi të cilën është ngritur sistemi aktual kushtetues kosovar. Fatkeqësisht, *travaux preparatoires* e hartimit të Kushtetutës së Kosovës nuk janë gjetur në asnjë rast, bile edhe atëherë kur ato qenë kërkuar nga Gjykata Kushtetuese për nevoja të interpretimit të Kushtetutës. Kjo situatë shpesh krijoi edhe keqkuptime e hutë në opinionin publik kosovar⁷⁹. Mungesa e këtyre dokumenteve dhe përcaktimi i statusit të përdorimit të tyre paraqet një mungesë të madhe në funksion të sqarimit të problemeve Kushtetuese, përfshirë edhe çështjen në diskutim. Nga perceptcionet e përgjithshme, çështja e konstitucionalizimit dhe kontrollit kushtetues të partive politike, nuk duket

⁷⁷ Përmes parimëve të mishëruara në Kornizën për Vetëqeverisje të Përkohëshme në Kosovë, 2001, e cila mundësoi pluralizmin politik si vlerë kushtetuese, duke i njohur partitë politike si entitet, kur bëhet fjalë për formimin e Kuvendit të Kosovës, Zgjedhjen e Kryetarit apo Qeverisë së Kosovës. Shih për më tepër fusnotën 71 *supra*, në lidhje me nenet konkrete të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohëshme në Kosovës, 2001, në të cilën përmenden partitë politike.

⁷⁸ E zëmë, e theksuam edhe në rreshtat e punimit se historia politike dhe ideologjike e secilit vend ka ndikuar në konsitucionalizimin dhe kontrollin e partive politike. Shembull, Gjermania shfaqte frikën e rikthimit të Nazizmit, Turqia të orientimit Islamik apo Shqipëria të Komunizmit, sikur edhe shtetet tjera që kanë qenë pjesë e sistemit komunist dhe e kanë adaptuar këtë zgjidhje kushtetuese.

⁷⁹ Shih dhe njëherë, Prof.Dr.Enver Hsani, “*Veçoritë themelore të Sistemit Kushtetues në Kosovë*”, Revista E Drejta-Law, nr.1-4, 2014, fq.33, (Cituar në fusnotën 68 *supra*) ku pasqyrohen problemet dhe debatet që kishin shkaktuar mosgjetja e *travaux preparatoires*, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës 2008. Në fakt nuk dihet asyeja e vërtetë e mungesës së tyre.

të ketë qenë edhe aq seriozisht e diskutueshme gjatë hartimit të Kushtetutës së Kosovës, edhe pse për këtë ka pasur disa debate të vogla, që nuk ndikuan në tekstin final të Kushtetutës, përse i përket çështjes së kontrollit të partive politike⁸⁰. Për më tepër, e vërteta është se kontrolli kushtetues i partive politike në Kosovë nuk është parë si një rrezik real për sistemin kushtetues të Kosovës sepse të gjitha partitë politike, përjashtim të asaj të krijuar nga Presidenti Ibarhim Rugova, pra LDK-së (“Lidhja Demokratike e Kosovës”) u formuan në kontekstin e krijimit të shtetit të ri të Kosovës dhe u identifikuan si “parti të luftës”. Vet fakti se ato patën një identifikim të tillë, të cilat zotoheshin hapur se do ta ndërtonin një Kosovë të re dhe jo violente të bazuar në standarde perëndimore, mjaftonte për të konkluduar heshturazi se në Kosovë nuk ka rrezik për esktrimizëm partiak të çfarëdo provenience. Ky trend, në fakt, u pa edhe gjatë draftimit⁸¹ dhe pranimit nga ana e Kosovës të tekstit të Marrëveshjes së Rambujesë (1999)⁸².

Pjesa tjetër e këtij shkrimi përqëndrohet në pyetjen tjetër bosht, atë se si realizohet një kontroll eventual i partive politike, përbrenda mekanizmave ekzistent në Kushtetuën e Kosovës, në rast se lind një nevojë e tillë e kontrollit kushtetues?

8. Mekanizmat kushtetues përmes të cilëve mund të realizohet kontrolli i partive politike në sistemin kushtetues të Kosovës

Duket sikur realiteti social dhe politik kosovar i krijuar në periudhën e tranzicionit kushtetues të ketë qenë mjaft i qartë ashtu që ka krijuar një perceptcion të sakët lidhur me mungesën e rrezikut se mund të ketë parti politike e cila seriozisht do të ushtronte aktivitetin e saj në kundërshtim me

⁸⁰ Nga kontaktet e autorëve me hartuesit kosovar të grupit të ngushtë Kushtetutës del se ka ekzistuar një debat për këtë çështje, meqë rast Komisioni për Hartimin e Kushtetutës së Kosovës 2008 kishte porositur edhe analiza hulumtuese në lidhje me çështjen e kontrollit të partive politike, analiza këto që i kishin perpiluar partnerët ndërkombëtarë që i ofronin ndihmë Komisionit për Hartimin e Kushtetutës së Kosovës, mirëpo pa ndikim që të hynin në tekstin final të Kushtetutës së Republikës së Kosovës 2008. *Shih* edhe Intervista e cituar në fusnotën 64 *supra* me Prof.Dr.Arsim Bajrami (autori i parë), 12.03.2016.

⁸¹ Shih tekstin zyrtar të Marrëveshjes së Rambujesë “*Marrëveshja e Përkoheshme për Paqe dhe Vetëqeverisje të Përkohëshme në Kosovë*”, 1999. Kjo marrëveshje për më tepër legjitimon frymën e pluralizmit politik në Kosovë (*Psh-Kapitulli III-Zhvillimi dhe Mbikëqyrja e Zgjedhjeve*), kjo tregon se klasa e atëhershme politike në Kosovë po përgaditej që të aplikojë përherë të parë në realitetin social dhe politik kosovar, pluralizmin, si vlerë kushtetuese dhe demokratike.

⁸² Për më tepër në lidhje me këtë shih edhe: Marc Weller, “*Shtësia e Kontestuar*”, Botimet KOHA, Prishtinë, Qershor 2011, fq.208-248.

rendin kushtetues dhe rregullat kushtetuese të kijuara me Kushtetutën e vitit 2008. Kjo rrethanë qartë e dukshme ka pasur ndikim përcaktues edhe tek hartuesit e Kushtetues së Kosovës pasi që në të nuk parashihet një mekanizëm konkret i cili mund të ushtronte kontroll direkt mbi programet, statutet dhe veprimtarinë e partive politike.

Në vijim si më sipër, kjo megjithatë nuk nënkupton se ne nuk duhet të diskutojmë në vazhdim të këtyre rreshtave vetë frymën e Kushtetutës së Kosovës dhe mënyrën se si mund të realizohet një kontroll i tillë, duke marrë parasysh që rendi kushtetues kosovar është ndërtuar mbi vlerat pro perendimore, duke i dhënë një hapsirë të konsiderueshme lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare⁸³. Në fakt, ky pozicion, që mund të konsiderohet veçori pozitive e sistemit kushtetues kosovar determinon edhe mënyrën e realizimit të kontrollit eventual të një partie politike në sistemin kushtetues të Kosovës. Kjo situatë imponon pyetjen krejt konkrete: nëse Kushtetuta e Kosovës nuk ka krijuar një formë të juridiksionit orgjinal që do të mundësonte kontrollin e partive politike dhe aktiviteteve të tyre, atëherë si realizohet ky funksion?. Kjo pyetje imponohet nga shkakun se jeta çdoherë është para normës dhe mund të befasojë me paraqitjen e rasteve të tilla që shtrajnë nevojën e kontrollit kushtetues të një partie politike! Aryeja kyçe që nuk që në Kushtetutën e Kosovës nuk ka një mekanizëm të tillë ka të bëjë me faktin se hartuesit (draftuesit) e Kushtetutës së Kosovës kanë krijuar mekanizma tjerë plotësues të tërthortë përmes të cilëve mund të pengohet ardhja në pushtet e partive që kanë qasje ekstreme⁸⁴. Me një fjalë, një mundësi e tillë e kontrollit të partive politike mund realizohet përmes disa mjeteve e metodave tjera të cilat do t'i analizojmë në vijim. Kjo në të njëjtën kohë nënkupton se, siç e cekëm më sipër, në rastin e Kosovës nuk është parë e arsyeshme që të krijohet një juridiksion i tillë orgjinal marrë parasysh kontekstin socio-politik dhe historikun e Kosovës pas shpërbërjes së komunizmit e deri në pavarësimin e saj më 17 shkurt 2008^{85,86,87}.

⁸³ Shih më shumë edhe në: Paul de Hert / Fisnik Korenica, "The New Kosovo Constitution and Its Relationship with the European Convention on Human Rights: Constitutionalisation "Without" Ratification in Post-Conflict Societies", Heidelberg Journal of International Law, 76 (2016), 1-24, fq.10-12 dhe 15-22.

⁸⁴ Shih intervista e cituar në fusnotën 66 *supra*.

⁸⁵ Në lidhje me kontekstin social politik kosovar po ashtu shih edhe: Arsim Bajrami, "Historia e Kostitucionalizmit Shqipëtar, 1912-2012", Prishtinë 2014, fq.192-242.

⁸⁶ Për kontekstin socio politik kosovar dhe historikun e zhvillimit apo krijimit të tij, shih autorin: Gazmend Zajmi, "Vepra 1", Akademia e Shkencave edhe Artëve të Kosovës, Prishtinë 1997, fq.45-50,75-85,165-180 apo i njëjti autor "Vepra 3", Akademia e Shkencave dhe Artëve të Kosovës, Prishtinë 2003, fq.153-157.

⁸⁷ Realitetin socio politik kosovar e kanë pasqyruar edhe autorët e huaj si: Noel Malcolm "Kosova një Histori e Shkurtër", Mecmilan, London, 1993, fq.327-347 dhe 348-372 apo shih edhe Marc Weller "Shtësia e Kontestuar", botimet KOHA, Qershor 2011, fq.299-405.

Kushtetuta e Kosovës 2008, partitë politike i trajton si entitete apo subjekte të veçanta. Kjo tregon që ka një dallim në mes të partisë politike dhe asaj që quhet standard evropian i trajtimit të partive politike, sepse siç shihet më lartë ky standard është orientuar në kuadër të lirisë së asociimit dhe lirisë së shprehjes⁸⁸. Ky standard duhet të jetë edhe njëri prej mjeteve kryesore alternative përmes të cilit mund të ushtrohet një kontroll i partive politike në sistemin kushtetues kosovar. Kjo për më tepër është një cilësi dalluese e konstitucionalizimit të partive politike në Kosovë.

Pluralizmi politik, në vijim sa më sipër, përbën një vlerë të veçantë të Kushtetutës së Kosovës. Kjo cilësi e dytë bën që sipas Kushtetutës së Kosovës partitë politike të trajtohen si një subjekt i veçantë të cilët mundësojnë bërjen e jetës politike dhe realizimin e pluralizmit politik si një prej vlerave themelore në sistemin kushtetues kosovar⁸⁹. Në fakt, nisur nga domethënia e fjalës pluralizëm, kjo nënkupton se ai në të njëjtën kohë paraqitet si një imanencë e sistemit të ndarjes së pushtetit në mes të një numri të partive politike⁹⁰. Nuk ka dilemë që parimi i pluralizmit nënkupton të kundërtën e monizmit në rastet kur ky i fundit realizohet përmes partive politike⁹¹.

Partitë politike, si subjekt në rendin kushtetues të Kosovës, përmes të cilave realizohet vlera e pluralizmit sipas nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës së Kosovës, përmenden pikërisht në kontekstin e pjesëmarrjes në qeverisje dhe realizimit të saj përmes institucioneve kushtetuese, siç janë Kuvendi apo Qeveria e Kosovës.

Në nenin 64.1 [Struktura e Kuvendit] të Kushtetutës së Kosovës përmenden partitë politike në kontekstin e ndarjes së vendeve në Kuvendin e Kosovës, sipas numrit të votave të fituara në zgjedhje sipas sistemit proporcional me lista të hapura⁹². Duket qartë se dimensionin e partive politike në Kushtetutën e Kosovës ka të bëjë me realizimin e pushtetit të cilin e fitojnë përmes

⁸⁸ Respektivisht neni 10 dhe 11 i KEDNJ.

⁸⁹ Neni 7 [Vlerat]. 1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

⁹⁰ <http://www.oxforddictionaries.com/definition/english/pluralism>, qasur me 24 Janar 2015.

⁹¹ Burimi i cituar në funksnotën 90 *supra*, qasur me 24 Janar 2015.

⁹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 64 [Struktura e Kuvendit] 1. Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.

zgjedhjeve të lira, që zhvillohen në përputhje me ligjet në fuqi në Kosovë, sipas sistemit proporcional me lista të hapura, i cili përbën një sistem kushtetues zgjedhor⁹³. Në raport me këtë, ligji përkatës për zgjedhjet në Republikën e Kosovës parasheh edhe procedurën e garimit dhe pjesëmarrjes së partive, koalicioneve dhe nismave qytetare në zgjedhje⁹⁴. Kjo çështje kishte qenë objekt shqyrtimi edhe në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, ku Gjykata Kushtetuese në kuptimin e efektit juridik dhe të rezultatit zgjedhor sipas nenit 64.1 [Struktura e Kuvendit] barazon termin koalicion apo parti politike⁹⁵.⁹⁶ Kjo tregon qartë rolin e partive politike në rendin kushtetues të Kosovës dhe njëherësh argumenton faktin teorik që pushteti dhe pjesëmarrja në institucione mund të realizohet përmes tyre, në funksion të realizimit të pluralizmit politik si një vlerë kushtetuese.

U mor vesh që rendi kushtetues i Kosovës i përmend partitë vetëm në këtë dimension kontekstual të realizimit të pluralizmit, çfarë është edhe qëllimi i partive politike⁹⁷, pra që rendi kushtetues i Kosovës në kuptim të

⁹³ Në nenin 61.1 përpos partive politike si subjekte kushtetuese përmenden edhe koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur të cilët mund të jenë pjesë e zgjedhjeve dhe garës për të qenë pjesë e institucioneve kushtetuese, në këtë rast: Kuvendit dhe Qeverisë.

⁹⁴ Shih: Ligji Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithëshme në Republikën e Kosovës, nenet në të cilat përmenden partitë politike, koalicionet apo nismat qytetare dhe kontestin e përmendjes së tyre: 1,3,4. (Kreu III) nenet: 11, 12, 13, 14, 15,16,17,18,19,20,47,53,56,61,63,64,65,66,67,68,74,87,111,122,123.

⁹⁵ “AKTGJYKIM ne Rastin Nr. K0103/14, Parashtrues Presidentja e Republikës se Kosovës Perkitazi me vleresimin e perputhshmerisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutes së Republikës së Kosovës” –Përdorimi i termave "parti politike ose koalicion", kur përmenden në lidhje me nenin 84 (14) dhe me nenin 95, paragrafët 1 dhe 4, të Kushtetutës, nënkupton partinë politike ose koalicionin që është regjistruar sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithëshme, merr pjesë si subjekt zgjedhor, është i përfshirë në fletëvotim të zgjedhjeve, e kalon pragun dhe rrjedhimisht fiton vende në Kuvend.

⁹⁶ Përveç këtij rasti, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, i trajton partitë politike edhe në rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12, Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorezuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës me 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012, pikat: 134-139. Me këtë rast partitë politike trajtohen si entitete të veçanta kushtetuese, por njëherit edhe si subjekte që gëzojnë liri dhe të drejta të njeriut. Këtë interpretim, Gjykata Kushtetuese e Kosovës e kishte bërë në shqyrtimin e amendamenteve të propozuara për zgjedhjen e drejtëpërdrejtë nga populli të Presidentit të Republikës së Kosovës, ku në nenin e ri të propozuar 86.3, ishte përcaktuar që kandidatin për president mund ta propozojnë vetëm partitë që kanë ulëse në Parlamentin e Kosovës. Kjo sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese i vendos në pozita të pabarabarta partitë politike parlamentare dhe ato që nuk kishin fituar vende në parlament dhe prek drejtëpërdrejtë në liritë dhe të drejtat e njeriut. Pra, ky interpretim qartëson pozicionin e partive politike në pozitën e personave juridik të cilëve mund t'u shkelen të drejtat e njeriut.

⁹⁷ E zëmë shembulli i nenit 95 të Kushtetutës, **Neni 95 [Zgjedhja e Qeverisë]** 1. Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë. 5.Nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të

konstitucionalizimit nuk ka të instaluar ndonjë kufizim në lidhje me aktivitetin e partive politike.

Siç e theksuam më lartë, në funksion të konstitucionalizimit disa shtete kanë vendosur norma kufizuese për aktivitetin e partive politike, duke pamundësuar që ky aktivitet të ushtrohet në rastet kur nuk është në përputhje me rendin kushtetues. Një ndër faktorët kyç i cili ka ndikuar që në raport me partitë politike në Kosovë mos të krijohet ndonjë kufizim i tillë ka qenë, ndër të tjera, jokoherenca që ka pasur sistemi kushtetues i Kosovës në të kaluarën, por edhe mbikëqyrja e këtij sistemi në vazhdimësi nga ana e faktorit ndërkombëtar. Në funksion të sqarimit më të detajuar të çështjes, është me interes të theksohet se edhe Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (2001), i ka trajtuar partitë politike dhe koalicionet pothuajse në të njëjtën mënyrë, siç i trajton sot rendi kushtetues i Kosovës⁹⁸. Ky realitet kushtetues i sajuar gjatë realitetit të ri politik pas 10 qershorit 1999 ka qenë ndër faktorëve shtesë që kanë ndikuar në dizenjimin e rendit kushtetues të Kosovës pas shpalljes së pavarësisë. Skena politike kosovare dhe sistemi i zgjedhjeve pas shpallejs së pavarësisë më 2008 nuk pësoi ndryshime serioze edhe pse pati disa tentativa⁹⁹.

Meqenëse nuk janë përcaktuar kufizime kushtetuese për aktivitetin e partive politike, kufizimet e vetme, nëse mund të quhen të tilla, janë ato të cilave iu nënshtrihen partitë politike dhe që kanë të bëjnë me zgjidhjet ligjore që janë adresuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës¹⁰⁰. Pra, *suma summarum*, në kuptimin e konceptit të konstitucionalizimit të partive politike, Kosova nuk i përket sistemit që vendos masa direkte apo

formuar Qeverinë. Pra, siç mund të shihet edhe në këtë dispozitë kushtetuese sikur edhe në atë paraprake partia politike dhe koalicioni përmendet në kontekstin e themelimit të institucioneve që dalin nga zgjedhjet e lira.

⁹⁸ Për më tepër, shih *Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme* e vitit 2001, e cila po ashtu nuk parashihte kufizime të natyrës së ndalimit të aktiviteteve të partive politike. Partitë politike dhe koalicionit edhe në aktin i cili përbënte rendin Kushtetues të Kosovës në tranzicion trajtoheshin po në të njëjtin kontekst siç i trajton sot rendi kushtetues aplikativ, pra si subjekte të veçanta të cilat ushtrojnë pushtetin përmes pjesëmarrjes në organet përfaqësuese të pushtetit shtetëror dhe organeve kushtetuese.

⁹⁹ Shih, Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 7 prill 2011, Nr. 04-R-2, e cila parashihte krijimin e një komisioni dhe apikimin e një reforme zgjedhore përmes ndryshimeve ligjore, që do të ndryshonte edhe realitetin e partive politike në Republikën e Kosovës, por kjo reformë nuk u përfundua asnjëher.

¹⁰⁰ Këto kufizime në lidhje me partitë politike nuk mund të quhen kushtetuese por janë tërësisht të natyrës administrative: si të tilla mund të jenë procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në zgjedhje, kufizimet gjatë fushatës etj.

mekanizma origjinal të kontrollit të aktivitetit të partive politike por vetëm masa e mekanizma të tërthorët ligjor.

Cili pra është mekanizmi tjetër përmes të cilit në sistemin kushtetues të Kosovës ushtrohet ky kontroll? E thamë edhe më lartë se mekanizmat mund të jenë edhe të natyrës tjetër, pra të ashtuquajtur mekanizma indirekt, përmes të cilëve mund të realizohet një qëllim i tillë¹⁰¹.

9. Ndikimi i kriterëve të vendosura nga GJEDNJ në lidhje me kontrollin e partive politike dhe aplikimi si mekanizma alternativ të kontrollit në sistemin kushtetues të Kosovës

Nga ajo që u tha deri më tani, u pa qartë se ndikimi i vlerave pro perendimore që është reflektuar përmes mbikqyrjes ndërkombëtare, qoftë edhe në hartimin e kushtetutës aktuale të Kosovës, drejtëpërdrejtë ka ndikuar në përcaktimin e dimensionit të realizimit të kontrollit të partive politike. Duhet pranuar se një ndër vlerat dhe cilësitë themelore të rendit kushtetues kosovar janë të drejtat e njeriut, përfshirë edhe ato të komuniteteve dhe naëtarëve të tyre, vendi dhe roli i tyre në rendin tonë juridik e kushtetues ka një rëndësi të veçantë. Kjo nga shkaku se të gjitha dimensionet e të drejtave të njeriut janë prodhim i pastër i rendit kushtetues të Kosovës dhe ky prodhim dhe dizajn reflekton në shumë aspekte cilësitë e konstitucionalizmit modern dhe jo strukturën materiale të shoqërisë kosovare¹⁰².

Megjithatë, në këtë pjesë do të mundohemi të shtjellojmë se cilat mund të jenë mekanizmat alternativ përmes të cilëve mund të bëhet kontrolli i partive politike në rendin kushtetues kosovar, gjithnjë duke pasur parasysh veçoritë që ka sistemi kushtetues i Kosovës.

Praktika e GJEDNJ ka krijuar standarde të atilla, ku ekzistimin ose jo të një partie politike e ka interpretuar në funksion të dy lirive dhe të drejtave themelore, të lirisë së shprehjes dhe lirisë së asociimit. Dy këto të drejta janë të parapara edhe në Kushtutën e Kosovës, njejtë siç janë paraparë në nenet përkatëse të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹⁰³. Brenda kësaj

¹⁰¹ Në intervistën e cituar më lartë të dhënë autorëve, (cituar në fusnotën 66 *supra*), ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës pranon se ky kontroll në rastin e Kosovës mund të arrihet përmes mekanizmave shtesë, ndër këta mekanizma shtesë sipas tij mund të jenë: Shumica e dyfishtë, ligjet me interes vital si dhe pamundësia për ndryshimin e Kushtetutës pa pëlqimin e komuniteteve pakicë.

¹⁰² Prof.Dr.Enver Hasani, “Veçoritë themelore të Sistemit Kushtetues në Kosovë”, Revista E Drejta-Law, nr.1-4, 2014, fq 23. (Fusnota 68 *supra*).

¹⁰³ Për më tepër shih: Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe KEDNJ: Kushtetuta e Republikës së Kosovës: **Neni 40 [Liria e Shprehjes]** 1.Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes

logjike duhet të kërkohen edhe këta mekanizma alternative që mundësojnë kontrollin në fjalë. Kjo edhe për faktin se KEDNJ ka një status kushtetues në Kosovës sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Kosovës, ku thuhet: *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*. Përmes kësaj dispozite, Konventa është në tërësi e inkorporuar në sistemin kushtetues kosovar dhe shërben si pikë referimi për çdo interpretim të të drejtave të njeriut¹⁰⁴¹⁰⁵.

përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. 2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. **Neni 43 [Liria e Tubimit]** 1. Liria e tubimit paqësor është e garantuar. Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to. Këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse është e domosdoshme për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare, ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. **Neni 44 [Liria e Asociimit]** 1. Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate. 2. Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve. 3. Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente. **KEDNJ: NENI 10 Liria e shprehjes** 1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me liçencë. 2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor. **NENI 11 Liria e tubimit dhe e organizimit** 1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij. 2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.

¹⁰⁴ Paul de Hert / Fisnik Korenica, burimi i cituar në fusnotën 83 *supra*, fq. 20-22.

¹⁰⁵ Aplikimi i praktikës gjyqësore të GJEDNJ dhe inkorporimi i saj në rendin kushtetues kosovar, si një vlerë e rëndësishme pro perendimore është aplikuar në të gjitha rastet sidomos në Gjykatën Kushtetuese, kur është vendosur *in meritum*, në rastet e shkeljes së lirive dhe të drejtave të

Nisur nga kjo rrethanë, praktika gjyqësore e GJEDNJ në rendin kushtetues kosovar është sipër praktikës gjyqësore vendore sepse kjo e fundit duhet ta ndjek të parën. Kjo don të thot se edhe kontrolli i partive apo organizatave që eventualisht mund të çënojnë rendin kushtetues të Kosovës, së pari duhet të shiqohet në prizmin e lirive dhe të drejtave të njeriut, kryesisht lirisë së asociimit, tubimit dhe asaj të shprehjes. Shikuar nga ky prizëm, edhe parandalimi eventual i aktivitetëve të parive politike që çënojnë rendin kushtetues kosovar duhet të gjykohet mbi bazën e mekanizmave kryesorë alternativ që ka instaluar rendi kushtetues i Kosovës për të arritur këtë objektiv kushtetues, gjithnjë duke pasur parasysh standardet evropiane mbi lirinë e asociimit, të shprehjes, të tubimit dhe organizimit.

Liria e asociimit nga neni 44 i Kushtetues së Kosovës shërben si pikë nisje në vlerësimin e aktivitetit kushtetues të partive politike dhe organizatave tjera. Kjo e drejtë e njeriut ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar organizata, pa pasur nevojë që të siguroj leje, apo të drejtën për të qenë pjesë e një organizate. Në frymën e këtij neni dhe praktikës së GJEDNJ, fjala organizatë mund të nënkuptojë edhe një parti politike apo lëvizje e cila mund të marrë pjesë në zgjedhje. Siç e thamë, pragrafi 3 i nenit 44, në një ekzaminim më të thellë instalon kufizimet që mund t'i kenë organizatat e tilla, ku këto kufizime kanë të bëjnë me atë nëse ato çënojnë rendin kushtetues, shkelin të drejtat e njeriut, nxisin urrejtje racore, kombëtare etnike apo fetare. Nëse janë të tilla, organizatat në fjalë mund të ndalohen me vendim të gjykatës kompetente¹⁰⁶. Kjo don të thot se nëse e trajtojmë partinë politike në frymën e praktikës së GJEDNJ dhe lirinë e asociimit ashtu siç parashihet edhe në Kushtetutën e Kosovës, atëherë qartë del se edhe partia politike, në instancën e fundit, paraqet një bashkim apo një organizatë të caktuar e cila ka një qëllim të caktuar politik. Edhe GJEDNJ nga prizmi i lirive dhe të drejtave të njeriut e ka trajtuar çështjen e ndalimit ose të veprimit të partive politike si një subjekt¹⁰⁷. Nisur nga ky fakt, praktika e GJEDNJ i trajton partitë politike si organizata brenda lirisë së asociimit. Siç u pa edhe në nenin 44.3 të Kushtetutës së Kosovës, gjykata kompetente, në këtë rast nuk mund të jetë Gjykata Kushtetuese sepse Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme qartë kontrollon ligjshmërinë e veprimit të partive politike që

njeriut. Pra, në aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, gjatë trajtimit dhe arsyetimit të rasteve konkrete, praktika e GJEDNJ është mishëruar masë të madhe në rendin kushtetues kosovar.

¹⁰⁶ Neni 44.3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “3. Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim çënimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente”.

¹⁰⁷ Madje siç mund të shihet më sipër në rastet e trajtuara, GJEDNJ i ka anuluar aktgjykimet e Gjykatave Kushtetuese duke u bazuar në lirinë e asociimit dhe atë të tubimit (Rastet e Turqisë).

nga formimi e deri te shpërbërja e tyre¹⁰⁸. Në shikim të parë mund të duket që nëse plotësohen kushtet e parapara në nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Kosovës, mund të vijë deri tek shuarja e një organizatë e cila në këtë kontekst mund të jetë edhe parti politike dhe atë për shkak se aktiviteti i saj ka pasur për qëllim cënimin e rendit kushtetues. Kjo me premisën se përmes aktivitetit të saj, organizata e caktuar ka shkelur liritë dhe të drejtat e njeriut apo për shkak që përmes aktivitetit të saj organizatë e tillë ka nxitur urrjetje racore, kombëtare, etnike apo fetare. Në fakt kjo nuk është kështu sepse juridiksioni në fjalë ka të bëjë vetëm me cënimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese të kryera nga një autoritet publik, gjë që nuk është rasti me organizatat politike, siç janë partitë politike. Pra, duhet të ketë një vendim të një autoriteti publik për të qenë rasti i lejueshm sipas nenit 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës me të cilin janë cënuar të drejtat dhe liritë kushtetuese të individit apo të ndonjë personi tjetër juridik. Sado që aktiviteti i një organizate politike mund të përfshijë aktivitete antikushtetuese, asnjëherë nuk mund të jetë objekt vendimi i Gjykatës Kushtetuese me të cilin ndalohet aktiviteti i mëtejshëm i saj. Në Kosovë kjo është çështje ligjore, jo kushtetuese. Si çështje kushtetuese është vetëm në mënyrë indirekte dhe atë përmes ushtrimit të ankesës kushtetuese me të cilën pohohet cënimi i lirive dhe të drejtave themelore të garantuara më Kushtetutën e Kosovës, kapitulli II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe kapitulli III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjestarëve të Tyre].

Për fund mund të thuhet se në rendin kushtetues kosovar partitë politike trajtohen si subjekte të veçanta në dy dimensione, në dimensionin e parë si subjekte që marrin pjesë në pushtetin shtetëror përmes zgjedhjeve dhe në dimensionin e dytë si organizata apo persona juridik që gëzojnë të drejtat tyre, për aq sa është e mundur, ashtu siç janë të parapara në Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës së Kosovës. Edhe pse Sistemi Kushtetues i Kosovës, nuk ka krijuar mekanizma direkt të kontrollit të veprimtarisë së partive politike, brenda vlerave të tij ka instaluar mekanizëm me të cilin mund të ndalojë aktivitetin e një organizate, që mund të jetë edhe parti politike, nëse ajo i plotëson njërin nga kushtet e parapara në nenin 44.3 [Liria e Asociimit] të Kushtetutës së Kosovës. Ky kontroll i partive politike mund të ushtrohet brenda qarkut të lirive dhe të drejtave të njeriut duke mundësuar shuarjen e aktivitetit të ndonjë organizate që mund të jetë edhe OJQ, iniciativë apo parti politike përmes vendimit të një gjykate kompetente, e cila gjithnjë është gjykatë e rregullt.

¹⁰⁸ Shih fusnotën 94 *supra* dhe nenet Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhje e përgjithëshme në Republikën e Kosovës: 1,3,4. (Kreu III) nenet: 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 47, 53, 56, 61, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 74, 87, 111, 122, 123.

Jasht kësaj logjike, mund të ketë edhe mekanizma të tjerë kushtetues të cilët nuk mund t'i quajmë mekanizma kontrollues të aktivitetit të partive politike e që në një formë ose formën tjetër mund të pengojnë ardhjen në pushtet të partive që mund të kenë qasje ekstreme ndaj rendit kushtetues. Si mekanizma të tillë mund të veçohen procedura e ndryshimit të kushtetutës dhe pëlqimi i pakicave për këto ndryshime, shumica e dyfisht apo edhe ligjet me interes vital. Këto elemente që lidhen me theks të veçantë me pozitën e komunitete pakicë në rendin kushtetues kosovar mund të ketë efekt indirekt në realizimin e kontrollit kushtetues të partive politike, si një masë preventive për të realizuar këtë funksion.

Jashtë normave dhe rendit kushtetues, brenda realitetit faktik kosovar, në vitin 2013 ishte hapur debat duke shkaktuar konfuzion nëse Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ) i Kosovës do të lejonte regjistrimin e partisë politike me emrin lista unike "Serbia". Pikërisht, emërtimi në këtë mënyrë nxiti edhe debate publike e politike, sepse emërtimi si i tillë dukej që mund të nxiste urrejtje etnike, rrethanë kjo që është e përcaktuar në nenin 44.3 [Liria e Asociimit] të Kushtetutës¹⁰⁹. Në rastin konkret, emërtimi ishte i tillë sa që lejonte ndalimin e regjistrimit¹¹⁰. Megjithatë, pas presioneve të KQZ, autoritetet në Serbi kësaj liste unike ia ndërruan emërtimin në mënyrë që ai u bë i pranueshëm për realitetin kushtetues dhe ligjor kosovar¹¹¹.

Një rast tjetër që kishte nxitur bile edhe debat kushtetues ishte ai i çertifikimi si parti politike i Lëvizjes Islamike Bashkohu (LISBA) e cila me 19 shkurt 2013 kishte aplikuar për regjistrim në KQZ¹¹². Në muajin mars të po atij viti KQZ kishte miratuar kërkesën e LISBA për regjistrim si parti politike¹¹³, edhe pse ky fakt mund të nxiste urrejtjen fetare¹¹⁴. Në këtë rast, në emër të mbrojtjes së shtetit laik, si njëra ndër vlerat e rendit kushtetues kosovar, Avokati i Popullit, por edhe disa OJQ e qytetarë, paralajmëronin hapjen e

¹⁰⁹ Gjatë këtij debati, autori Florent Muçaj kishte dhënë një prononcim për televizionin publik të Kosovës (RTK), me që rast si argument kushtetues kishte përmendur nenin 44.3 të Kushtetutës së Kosovës. Kronika është transmetuar në RTK me datë 08 Shtator 2013-edicioni i lajmëve qëndrore.

¹¹⁰ Neni 5, pika c, e rregullores së KQZ-së për regjistrimin e një subjekti politik, thotë se kërkesa për regjistrim duhet të refuzohet vetëm nëse subjekti politik ka emër, akronim ose simbol që mund të nxisë urrejtje ndëretnike ose fetare.

¹¹¹ <http://lajmi.net/konfirmohet-heqja-e-emrit-srbija/>, qasur së fundmi me 19 Mars 2016.

¹¹² Kominikatë për media e KQZ, http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/20.02.2013_gdrjigtjck.pdf, qasur së fundmi me 25 Shkurt 2016.

¹¹³ Po aty.

¹¹⁴ Shih fusnotën e 110 *supra* dhe ndalesat në rregulloren e KQZ për regjistrim.

rastit në Gjykatën Kushtetuese, për të mbrojtur këtë parim kushtetues¹¹⁵. Por siç u konstatua më lartë dhe siç mund të shihet edhe në këtë rast, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, nuk ka pasur e as nuk ka kompetencë orgjinale që të shqyrtojë aktivitetin e partive politike dhe përputhjen e aktivitetit të tyre me Kushtetutën. Një gjë të tillë, rendi kushtetues kosovar e mundëson përmes mekanizmave alternativ të tërthorët të cilët i shtjelluam më lartë. Këta mekanizma janë të mjaftueshëm dhe pamundësojnë që një parti politike të ushtroj aktivitetin e saj në kundërshtim me kushtetutën dhe sistemin ligjor kosovar. Përveç mënyrës së realizimit të këtij funksioni, gjithashtu u shtjellua dhe u konstatua që realiteti politik kosovar, mbikëqyrja ndërkombëtare dhe realiteti i ri politik që ka thithur vlerat pro perendimore kushtetuese, të cilat janë shkaktarët kryesore se përse në rendin kushtetues kosovar nuk ka ndonjë mekanizëm direkt përmes të cilit ushtrohet kufizimi i aktiviteteve të partive politike.

¹¹⁵ <http://www.telegrafi.com/lajme/per-levizjen-bashkohu-paralajmerohet-padi-ne-kushtetuese-2-29817.html>, qasur së fundmi më 28 Shkurt 2016.

Arsim BAJRAMI, Florent MUÇAJ, Përparim GRUDA

Constitutionality and the control of political parties - Kosovo's case

Summary

The control of political parties is a very important topic that is treated by constitutional and political sciences. There are many different systems worldwide and different criteria in terms of constitutional control of political parties. In many countries, non-constitutional activity of political parties is prohibited, and this standard is in accordance with the constitution, law, and control to political parties in certain countries through appropriate mechanisms. Therefore, regarding to the constitutional rules and control of political parties, some countries appear to be more liberal and separated from the classical aspect of restrictions and control of political parties.

This paper treats three segments associated with the control and restrictions of political parties: firstly, constitutional rules and the manner of restrictions and control of political parties, which means constitutionality; secondly, control and restrictions of political parties in the context of the rules applied by the European Union and European Court of Human Rights ECHR; thirdly, the case of the Republic of Kosovo and standards applicable in the Republic of Kosovo about the control of political parties.

As can be seen, standards of constitutional control and constitutional rules vary depending on the history and different social circumstances that have determined the development of pluralism in certain countries. In the context of this, for various reasons, Republic of Kosovo has a liberal approach toward this case, if not saying that in the Republic of Kosovo there is no effective legal control of the activity, program, and statute of any political party.

The Republic of Kosovo exercises this control based on indirect mechanisms, among which include the EHCR standards related to freedom of association and assembly.

As we previously mentioned, this paper focuses on the importance of the need to have an effective mechanism that controls or restricts any eventual non-constitutional activity of political parties in a legal and political order.

Prof. Dr. iur. Haxhi Gashi, prof.ass*

Regjistrimi i pronësisë dhe te drejtave tjera sendore në Kosovë: Vështrim kritik në perspektive krahasimore

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është trajtimi i mënyrës së fitimit të drejtave sendore (reale) në sistemin ligjor në Kosovë si dhe sistemi i regjistrimit në vështrim ligjor dhe praktik duke vendosur disa pika krahasimi me sistemet ligjore në Evropë. Ka shumë diskutime dhe paqartësi në mënyrën e fitimit të pronësisë dhe të drejtave tjera sendore sipas ligjit në Kosovë, edhe pse sistemi kërkon regjistrimin e të drejtave në paluajtshmëri. Kështu që, në këtë punim do të diskutohet si regjistrohet e drejta sendore dhe roli i regjistrave si karakter deklarativ (vetëm për qëllim të informimit të palëve) apo i karakterit konstituiv-themelues (mënyrë e krijimit të drejtës). Në këtë kontekst është shumë me rëndësi për një analizë dhe determinim i momentit të fitimit të drejtës sendore (reale) dhe dallimi nga marrëdhëniet kontraktuale, posedimi me mirëbesim, ose format tjera të transferit (bartjes) së pronësisë dhe të drejtave tjera sendore dhe dallimi nga transaksionet joformale si dhe konsekuencat ligjore për palët në rast të dështimit të regjistrimit të drejtës në regjistër.

1. Hyrje

Të drejtat sendore, të njohura si *iura in rem* në drejtat mbi sendet e paluajtshme fitohen vetëm me regjistrimin e të drejtës në regjistrat publike të themeluara për këtë qëllim. Në sistemin juridik në Kosovë si të drejta mbi sendin konsiderohen e drejta e pronësisë, e drejta e servitutit, e drejta e hipotekës, e drejta e pengut, e drejta e ndërtimit dhe barrët sendore. Jo rrallë

* Prof.Dr.Iur. Haxhi Gashi, prof.ass, është profesor i të drejtës civile dhe Dekan i Fakultetit Juridik në Universitetin e Prishtinës. Autori ka përfunduar studimet themelore dhe Master (Mr.sc) në Fakultetin Juridik të UP, ndërsa doktoraturën (PhD) në Universitetin e Bremenit në Gjermani në vitin 2011. Autori është anëtarë i Komisionit Shtetëror për Hartimin e Kodit Civil të Kosovës. Një Pjesë e këtij punimi në versionin anglisht është dërguar dhe pranuar për botim në revistën shkencore në Gjermani, *Hanse Law Review, Vol.11, Nr.1, 2016.*

në praktikë lindin konteste lidhur me mënyrën e fitimit të drejtës mbi sendin e caktuar e që për pasojë është sfidë edhe e organeve gjyqësore për mënyrën e zgjidhjes së kontesteve të tilla. Vështirësitë shfaqen lidhur me bazat e ndryshme ligjore të cilave ju referohen palët lidhur me fitimin ose humbjen e një të drejte sendore, por edhe për faktin e mënyrave të regjistrimit ose mos-regjistrimit të pronës ose ndonjë drejte tjetër sendore. Gjithashtu, si mungesë e regjistrimit të pronës krijohet mundësia e qarkullimit joformal që shfaqe edhe pasoja të sigurinë e transaksioneve dhe fitimit të drejtave.

Sistemet juridik në botë kur është fjala për mënyrë të fitimit të drejtës mbi sendin e caktuar, kanë dallime në këtë drejtim varësisht se si e kanë rregulluar mënyrën e fitimit. Kosova ka krijuar një sistem të ri të regjistrimit të drejtave sendore, por që ka ngjashmëri dhe dallime me disa sisteme juridike në Evropë, kryesisht ka ngjashmëri me sistemin Austriak dhe Gjerman, por me disa specifika dallon me sistemin Francez. Andaj, edhe fokusi në punim do të ketë vështrimi krahasues me këto juridiksione për aq sa është e nevojshëm të sqarohet sistemi i regjistrimit të drejtave sendore në sendet e paluajtshme.

Qëllimi i punimi është që të trajtoj mënyrën e fitimit të drejtave sendore në Kosovë dhe sistemin e regjistrimit me një vështrim ligjor dhe praktik duke vendosur disa pika krahasimi me sistem të ndryshme juridike në Evropë. Ka mjaft diskutime lidhur me mënyrat e fitimit të pronësisë dhe të drejtave tjera sendore sipas legjislacionit në Kosovë edhe pse sistemi aktual kërkon regjistrimin e të drejtës në paluajtshmëri. Për më shumë diskutimet përqendrohen në mënyrën e regjistrimit dhe rolin e regjistrave, si karakter deklarativ (vetëm për të njoftuar palët) apo karakter konstituiv (themelues) të drejtës. Për këtë është shumë më rëndësi një analizë kritike ligjore në këtë drejtim për të përcaktuar momentin e fitimit të drejtës së sendore duke e dalluar nga marrëdhënia kontraktuese, ose nga posedimi me mirëbesim ose format tjera të posedimit të një të drejte sendore. Po ashtu është me interes vështrimi dhe dallimi i transaksioneve (bartjeve) jo formale dhe pasojat juridike që lindin për palët në rast të mos regjistrimit të drejtës në regjistër.

Pyetjet kryesore që do të shtjellohen: Çka janë të drejtat sendore dhe cilat janë ato sipas të drejtës pozitive në Kosovë? Si krijohen të drejta sendore në paluajtshmëri - fitimi dhe humbja? Regjistrimi i të drejtave sendore sistemi i regjistrimit - efekti në qarkullimin e të drejtave? A kanë regjistrat e të drejtave sendore saktësi absolute apo lejohet vërtetimi i të kundërtës? Si qarkullohen/barten të drejtat sendore? Cilat janë specifikat secilës të drejtë sendore veç e veç në relacion me mënyrën e fitimit-krijimit? Nëse

qarkullohen të drejtat sendore në mënyrë jo formale, cila kontestet dhe të drejtat lindin mes palëve?

Fjalët kyçe: *Pronësia, të drejtat sendore, titulli juridik, regjistrimi.*

2. Koncepti i të drejtave sendore

Të drejtat sendore janë të drejtat që ka një subjekt (person fizik ose juridik ose shteti) lidhur mbi një send të caktuar, pra e drejta në send (*iura in rem*). Secili send duhet ta ketë pronarin e vetë, dhe në kohën moderne pak ose fare nuk ka sende të askujt, me përjashtim të sendeve të braktitura. Ato (sendet) ose u takojnë personave privat, ose shtetit si pronë shtetërore ose publike. Fokusi në këtë punim është në të drejtat sendore në pronën private. Pjesa për të drejtat sendore në pronën publike rregullohet me ligje të veçanta dhe mund të jetë objekt trajtimi një punim tjetër.

Koncepti i të drejtave sendore ose ndryshe *iura in rem*, derivon (rrjedhë) nga sistemet e lashta juridike,¹ ku formësimin ligjor e gjejmë më të theksuar në të drejtën romake.² Në Evropë konceptin e të drejtave sendore e njohin të gjitha juridiksionet, ndërsa për regjistrimet e të drejtave sendore në paluajtshmeri ka specifika në secilin sistem juridik.³ Koncepti i të drejtave sendore në Kosovë dhe mënyra e regjistrimit janë të influencuara nga sistemi Austriak dhe Gjerman të cilat përveç titullit juridik kërkojnë edhe regjistrimin e të drejtave sendore në regjistrat e tokave.⁴ Ngjashëm me ligjet pozitive në Kosovë, të drejtat sendore themelohen (krijohen) me regjistrim duke pasur Titullin Juridik (*iustus titullus*) që është puna juridike (për fitimin derivativ) titujt tjerë (për fitimin origjinerë) dhe mënyrën e fitimit që është regjistrimi (*modus aquirendi*). Sipas Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (LPDTS), nenit 36, par 1, "*për bartjen e pronësisë në një paluajtshmeri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si baze juridike dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në regjistrin e të drejtave në paluajtshmeri*".⁵ Për të drejtat sendore në paluajtshmeri dhe mënyrën e fitimit,

¹ Për më shumë informata për sistemet e lashta juridike Shih Statovci, Ejup, The Ownership, origin and development: comparative study, Pristine 1983, Republished in 2009.

² Për njohuri për të drejtën romake dhe të drejtat mbi sendet, shih: Andrew Borkowski & Paul Du Plessis, E drejta Romake, UET Press, Tiranë, 2004, fq 201-269.

³ Shih, Hurndall, Anthony, Property in Europe, Law and Practice, Tottel Publishing Ltd, 2007.

⁴ Shih, Hurndall, Anthony, Property in Europe, Law and Practice, Tottel Publishing Ltd, 2007, Sistemi Austriak, faqe 3-33, Sistemi Gjerman, fq. 213-248.

⁵ Ligji i pronësisë dhe të drejtat tjera sendore është miratuar në Kuvend me dt.25.06.2009 është shpallë nga Presidenti me date 15.07. 2009 dhe ka hyrë në fuqi 15 dite nga dita e

ndryshimit dhe shuarjes flet neni 115, 1. “Për fitimin, ndryshimin e përmbajtjes, bartjen, shuarjen e pronësisë, të drejtës së parablerjes, dhe të drejtave sendore të kufizuara në një paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme si bazë juridike ndërmjet titullarit dhe të një pale tjetër si dhe regjistrimi i ndryshimit juridik në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë”. Por edhe në rast të fitimit të pronësisë në mënyrë origjinere duhet të ketë një titull juridik të vlefshëm (akti juridik) dhe regjistrimi i të drejtës në regjistër (modus acquirendi). Prandaj trajtimi i fitimit të drejtave sendore dhe mënyra e regjistrimit janë të me interes për lexuesin dhe ata që merren me praktikë për të pasur qartësi lidhur me dispozitat ligjore dhe krijuar siguri juridike në transaksionet me pronësinë dhe të drejtat tjera sendore.

2.1 Çka janë të drejtat sendore?

Te drejta civile (private) ndahen në te drejta personale, te drejta pasurore dhe te drejta sendore. Te drejtat sendore janë kategoria e të drejtës që ka të bëjë me të drejtën mbi sendin e caktuar (*iura in rem*). Legjislacionet e ndryshme numërojnë te drejtat sendore me numërim takstativ-*numerues clausus*.⁶ Në të drejtën e Kosovës si te drejta sendore nuk janë numëruar takstativisht por nga përmbajtja e ligjit konsiderohen, Pronësia, Servitutet, Hipoteka, Pengu, E drejta e ndërtimit dhe barrët sendore.⁷ Por duhet theksuar se edhe e drejta e parablerjes është përfshirë si e drejtë sendore dhe e cila krijohet me regjistrim.⁸ Në disa legjislacione si shembull Slloveni edhe borxhi mbi tokën si e drejtë sendore.⁹

shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 57/2009 date 4 Gusht 2009, respektivisht ka hyrë në fuqi me date 20 Gusht 2009 (këtu e tutje LPDTS), faqe.

⁶ Ligji i Sllovenisë për Pronën (Stvarnopravni Zakonik), Gazeta Zyrtare, nr. 87/17 Gusht 2002, Neni. 2, parasheh “ të drejtat sendore janë: pronësia, pengu, borxhi i tokës, servitutet, e drejta e ngarkesës (barrët), e drejta e ndërtimit”, Ligji i Kroacinë për të drejtat sendore, Gazeta Zyrtare, nr. 91/96, 68/98, 13 7/99, 22/00, 73/00, dhe 114/01, Neni 1, parasheh, “çdo person fizik dhe juridik mund të jetë titullar i një të **drejte pronësie** dhe të drejtave tjera sendore: **servituteve, ngarkesat sendore, e drejta e ndërtimit dhe pengu (hipoteka dhe pengu)**...”.

⁷ Shih, Ligji për pronësinë dhe te drejtat tjera sendore.

⁸ Shih LPDTS, neni 115, paragrafi 1, në mënyrë eksplicite e drejta e parablerjes është paraparë si e drejtë sendore dhe që kërkohet të regjistrohet sikur të drejtat tjera sendore.

⁹ Ligji i Sllovenisë, neni 2.

2.2 Si krijohen te drejtat sendore ne paluajtshmeri - Fitimi dhe humbja e te drejtave sendore ne paluajtshmëri

Sipas sistemit juridike në Kosovë një e drejte sendore në paluajtshmëri (pronësia, servituti, hipoteka, barrët sendore dhe e drejta e ndërtimit dhe e drejta e parablerjes) fitohen me një titull të vlefshëm juridik (iustus titullus) dhe me regjistrimin e te drejtës (modus aquirendi) në regjistrin për regjistrimin e te drejtave ne paluajtshmëri (regjistri i tokave). Titulli juridik mund të jete titull derivativ- pra titull i nxjerr nga paraardhësi p.sh, kur pronësia fitohet nga shitësi. Ne këtë rast kontrata është titull juridik, ndërsa titulli është derivativ sepse e drejta fitohet nga një person (titullar) i cili me parë e kishte te drejtën e tillë. Por për tu fituar e drejta kërkohet si kusht regjistrimi në regjistër. Regjistrimi është i domosdoshëm dhe ka karakter konstituiv (themelues) sepse vetëm me regjistrim fitohet e drejta.¹⁰ Regjistrimi është kusht edhe për fitimin e të drejtave tjera sendore. Një e drejte sendore mund të fitohet edhe me një akt tjetër juridik, titull origjiner, p.sh parashkrimi fitues me mirëbesim, vendimi i organit shtetëror (shpronësimi), vendimi i agjensionit të privatizimit etj.¹¹ Edhe te rasti i titullit juridik origjiner kërkohet edhe regjistrimi i të drejtës në regjistër si kusht për fitimin të drejtës (*modus aquirendi*). Si shembull nëse fitohet pronësia në paluajtshmeri me parashkrim fitues siç parashihet ne LPDTS në afatin për 20 vite, kur poseduesi është me mirëbesim dhe gjate kësaj kohe nuk ka pasur kundërshtim nga askush,¹² e drejta nuk fitohet ne mënyrë automatike. Për këtë duhet të ekzistoj një vendim i gjykatës që e vërteton parashkrimin fitues dhe në bazë të vendimit të gjykatës të regjistrohet e drejta e pronësisë në regjistër. Nëse nuk është regjistruar e drejta ende nuk është fituar. Personi që është i shënuar në regjistër figuron si pronarë. Sipas LPDTS, për tu fituar e drejta duhet të këtë ndryshim në regjistër.

Si rregullohet kjo çështje me legjislacione tjera? Edhe disa legjislacione si ai Gjerman, Austriak, kanë të njëjtat rregulla ose kushte ligjore për fitimin e te drejtave sendore në paluajtshmeri. Nëse e drejta nuk regjistrohet ajo ende nuk është fituar. Nëse bëhen transaksione bartje të drejtave pa regjistrim, efektet juridike do të jenë mjaft negative sepse në këtë rast ka vetëm bartje faktike të sendit, por jo edhe bartje juridike. Megjithatë, në legjislacionin e Francës për bartjen e të drejtës së pronësisë nuk është kusht regjistrimi,

¹⁰ Shih LPDTS.

¹¹ Shih ligjin nr. 04/L-009 plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrin për regjistrimin e e te drejtave ne paluajtshmeri, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.7/10 Gusht 2011.

¹² Shih LPDTS, neni 40, par.1.

mjafton vetëm kontrata për të prodhuar efekte juridike mes palëve (*compromis de vente*), ndërsa kontrata tjetër pasuese (*contract de vente*) që është akti noterial ose shkresa (*Deed*) që e bën perfekt transaksionin, është e domosdoshëm të regjistrohet dhe të jetë efektive në raport me palën e tretë.¹³

3. Si funksionon sistemi i regjistrimit të drejtave sendore në Kosovë?

3.1 Vështrim i shkurtër historik

Sistemi i regjistrave të drejtave sendore në Kosovë ka një histori të veçantë të funksionimit e që ka edhe efekte dhe pasoja të ndryshme në fitimin dhe humbjen e të drejtave në paluajtshmeri. Sistemi fillestar rrjedh nga Regjimi Otoman i vitit 1858, ku si dokument për pronësinë ishte *Tapia*.¹⁴ Sistemi i Tapive vazhdon edhe në Jugosllavinë e vjetër me nxjerrjen e Ligjit për Tapitë në vitin 1931. Më pas, sistemi rrjedhë nga sistemi i ish-Jugosllavisë që ishte ndikuar nga E drejta Austriake. Në ish-Jugosllavi ishte paraparë të themelohen regjistrat e tokave bazuar në Ligjin për Librat e tokave të vitit 1930, ku u arrit të krijohen në disa vende si Slloveni, Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Pjesën Veriore të Serbisë etj.¹⁵ Por në Kosovë në vend të regjistrit të tokave është themeluar vetëm Regjistri kadastral, që përmbante shënime kadastrale si emërtimi i pronës, lokacioni, ngarkesat në pronë etj, që në fakt përmban të njëjtat shënime sikur regjistri i tokave.¹⁶ Megjithatë nuk është lëshuar ndonjë *Tapia* si dokument të dokumentimit të pronësisë, por *Fleta Poseduese*. Transaksionet-bartjet e të drejtave janë realizuar me këtë dokument-*Fleta Poseduese*. Një situatë e tillë ka vazhduar deri me nxjerrjen e Ligjit për themelimin regjistrit për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmeri (Regjistri i Tokave), i themeluar me Ligjin e vitit 2002,¹⁷ me ndryshimet e mëvonshme në vitin 2003¹⁸ dhe 2011,¹⁹ si dhe Ligji për

¹³ Maitre Philippe Dubois, *Property in Europe, Law and Practice*, Sistemi Francez, në: Hurndall, Anthony, *Property in Europe, Law and Practice*, Tottel Publishing Ltd, 2007, fq. 185.

¹⁴ Shih Statovci Ejup, *Marrëdhëniet pronësore juridike në pronën e paluajtshme në Kosovë*, Prishtinë 1976, Ri-publikuar në vitin 2009, fq. 273.

¹⁵ Shih Statovci, Ejup, *Marrëdhëniet pronësore juridike në pronën e paluajtshme në Kosovë*, Prishtinë 1976, Ri-publikuar në vitin 2009, fq. 272-273.

¹⁶ Aliu, Abdulla, *E drejta sendore (pronësia)*, Prishtinë 2014, fq. 448-449; Ligji për kadastrin, *Gazeta Zyrtare e RSFJ*, nr. 12/06/1980.

¹⁷ Shih Ligji nr.2002/5 për themelimin e regjistrit të drejtave në pronën e paluajtshme, shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut, 2003/27, 18.08.2003.

¹⁸ Shih Ligji 2003/13 për ndryshimin e ligjit nr.2002/5.

¹⁹ Ligji nr.04/L-009 për ndryshimin e ligjit 2002/5, për themelimin e regjistrit të drejtave në pronën e paluajtshme, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*, nr.7/10 Gusht 2011.

Kadastrin i viti 2003 i amenduar në vitin 2011.²⁰ Të drejtat sendore janë rregulluar me ligjin e ri Ligjin për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore (LPDTS).²¹ Sipas LPDTS, prezumohet se është pronarë titullari i Tapisë që është lëshuar para 23 Mars 1989.²² Nëse Tapia është lëshuar pas 23 Marsit 1989, vlefshmëria e Tapisë duhet të provohet me vendim të gjykatës.²³ Qëllimi i ligjit është të sqaroj situatën me dokumente të ndryshme të pronësisë përfshirë edhe Tapinë para hyrjes në fuqi të këtij LPDTS. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për themelimin e regjistrimit për regjistrimin e të drejtave në pronën e paluajtshme në vitin 2002 me ndryshimet e mëvonshme, nuk lëshohet Tapi, por lëshohet Certifikata për të drejta pronësor. Sistemi Kadastral vazhdon sipas Ligjit për Kadastrin i viti 2003 me ndryshimet në vitin 2011, sistem i ngjashëm me atë Austriak që bazohet në regjistrimin e tokave, ndërtesave, banesave, të drejtave tjera sendore, pra aspektin teknik të drejtave sendore.

3.2 Krijimi i regjistrimit të ri- regjistri për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmeri

Me ligjin për themelimin e regjistrimit për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmeri,²⁴ është shënuar një kthesë shumë e rëndësishme në regjistrimin e pronësisë dhe të drejtave tjera sendore e cila krijon një siguri të transaksioneve - bartjes dhe ngarkimit të drejtave. Regjistri ka karakter të njëjtë sikur në legjislacione të tjera që kanë Librat e tokave p.sh. në Gjermani, Austri etj. Në regjistrin regjistrohen si të drejta sendore, Pronësia, Hipoteka, Servitutet, Barrët sendore, dhe E drejta e ndërtimit. Ligji ka pësuar ndryshime duke specifikuar dhe sqaruar drejtat sendore që regjistrohen. Me

²⁰ Ligji nr. 04/L-13 për Kadastrin, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.13/1 Shtator 2011.

²¹ Ligji i pronësisë dhe të drejtat tjera sendore është miratuar në Kuvend me dt.25.06.2009 është shpallur nga Presidenti me date 15.07. 2009 dhe ka hyre në fuqi 15 dite nga dita e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 57/2009 date 4 Gusht 2009, respektivisht ka hyre në fuqi me date 20 Gusht 2009 (këtu e tutje LPDTS).

²² LPDTS, neni 286, par. 3, parasheh: “ Presumohet se janë pronarë të paluajtshmerisë personat, të cilët në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji posedojnë një tapi, e cila ata ose pasardhësit e tyre juridike i emërton si pronar të një paluajtshmerie dhe kjo tapi është lëshuar para 23 marsit 1989. Ndërsa paragrafi 2, parasheh: ” Presumimi sipas paragrafit 1 mund të rrezohet vetëm përmes një vendimi të plotfuqishëm të një gjykate”.

²³ LPDTS, neni 286, par. 3, parasheh:” Personat, të cilët posedojnë një tapi, e cila ata ose paraardhësit e tyre juridike i emërton si pronar të një paluajtshmerie dhe kjo tapi është lëshuar pas 23 marsit 1989 duhet ta vërtetojnë vlefshmërinë e tapive në gjykatën kompetente të Kosovës sipas procedurës së paraparë”.

²⁴ Shih Ligji nr.2002/5 për themelimin e regjistrimit të drejtave në pronën e paluajtshme, shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut, 2003/27, 18.08.2003

ligjin e vitit 2002 përcaktoheshin të drejta që mund të regjistroheshin në këtë regjistër si vijon: *pronësia, hipotekat, servitutet, të drejtat e shfrytëzimit të pronave shoqërore dhe pronave shtetërore*.²⁵ Me ndryshime të mëvonshme Ligji nr.04/L-009 për ndryshimin e ligjit 2002/5, shtohen edhe të drejtat tjera sendore që mund të regjistrohen në këtë regjistër si: *e drejta e shfrytëzimit të pronave komunale dhe e drejta e shfrytëzimit në pronë publike, barrët dhe ngarkesat pronësore*.²⁶ Megjithatë me ligjin për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore (LPDTS), i cili rregullon të drejtat sendore në pronën private si të drejta sendore konsiderohen: Pronësia, E drejta e parablerjes, Pengu, Hipoteka, Servitutet, Barrët sendore dhe E drejta e ndërtimit.²⁷ Te gjitha këto të drejta parashihet të regjistrohen në regjistrin për të drejtat në paluajtshmeri që ka lokacion në Kadastër Komunal në vendndodhjen e paluajtshmërisë, ndërsa pengu në sendet e luajtshme regjistrohet në regjistër të veçantë në Zyrën e Pengjeve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.²⁸

3.3 Karakteri (funksioni) i regjistrimit

Të drejtat sendore në paluajtshmeri mund të themelohen (krijohen) vetëm me regjistrim. Kjo është përcaktuar me vete Ligjin për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore (LPDTS). Me nenin 115 të LPDTS, parashihen dy kushte për fitimin e të drejtave sendore, titulli juridik (një punë juridike) dhe regjistrimi i të drejtës.²⁹ Karakteri i regjistrimit është i natyrës *konstituive* (themeluese), sepse përderisa një e drejte ende nuk është regjistruar ajo nuk është fituar, së paku kështu e ka përcaktuar ligji. Një person mund të ketë titullin e vlefshëm juridik si kontratën, testamentin, vendimin e organit shtetëror etj, por nëse e drejta ende nuk është regjistruar titullari është vetëm posedues me mirëbesim dhe me titull të ligjshëm, por ende nuk e ka fituar të drejtën. Titullar i të drejtës është personi që është ende i regjistruar në regjistër. Një karakter i tillë i regjistrimit ekziston edhe në sistemin austriak ku vetëm me regjistrim e drejta fitohet ku pa regjistrim ka vetëm të drejtë kontraktuese por nuk fitohet e drejta sendore e natyrës absolute ashtu që edhe bartja (kalimi) i titullit është

²⁵ Shih Ligji nr.2002/5, neni 2, paragrafi 2.

²⁶ Shih Ligji nr.04/L-009 për ndryshimin e ligjit 2002/5, për themelimin e regjistrimit të drejtave në pronë dhe paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.7/10 Gusht 2011, neni 3.

²⁷ Ligji i pronësisë dhe të drejtat tjera sendore (LPDTS), Gazetën Zyrtare, nr. 57/2009.

²⁸ Shih Rregullorja 2001/5 për pengun në sendet e luajtshme, Rregullorja nr.2001/ për regjistrimin e pengut në sendet e luajtshme, Ligji nr.04/L-136 për regjistrimin e pengut në sendet e luajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.33/22 Nëntor 2012.

²⁹ Shih LPDTS, neni 115, paragrafi 1.

i lidhur me regjistrim.³⁰ Po ashtu një rregull i tillë ekziston edhe në sistemin gjerman, sipas të cilit të drejtat sendore fitohen vetëm me regjistrim dhe kalimi i titullit (bartja e të drejtës) te personi tjetër po ashtu bëhet me regjistrim.³¹ Gjithashtu përparësia e një të drejte sendore është përcaktuar me përparësinë e regjistrimit, që rrjedhimisht tregon edhe krijimin e të drejtës në raport me një të drejtë tjetër që krijohet-regjistrohet më vonë. E drejta që regjistrohet e para në një send ka përparësi në raport me të drejtat që regjistrohen më vonë.³² Edhe shuarja-përfundimi i një të drejte sendore është e lidhur me faktin e ndryshimit në regjistër. Shtrohet pyetja nëse e drejta sendore është blerë nga personi që nuk e ka te regjistruar të drejtën? Në këtë rast kemi transaksion (bartje) joformal, sepse personi i cili nuk e ka titullin e regjistruar nuk mund ta bartë të drejtën. Po ashtu blerësi nuk mund ta regjistrojë të drejtën dhe rrjedhimisht mbetet vetëm posedues. Por si qëndron raporti mes palëve kontraktues? në këtë drejtim gjejmë edhe sistem juridik p.sh sistemi Francez ku e drejta e pronësisë si e drejtë sendore fitohet vetëm me kontratë mesë palëve, ndërsa regjistrimi ka efekte vetëm në raport me palën e tretë.

3.4 Regjistrat krijojnë supozimin e sigurisë se të dhënave dhe nuk kanë karakter të saktësisë absolute

Regjistri për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmeri nuk e ka parimin e saktësisë absolute. Me Ligjin e Kosovës për regjistrin e të drejtave në paluajtshmeri përcaktohet se të dhënat në regjistër kanë një karakter të supozimit juridik ashtu që shënimet supozohet se janë të sigurta derisa nuk vërtetohet e kundërta.³³ Me këtë ligj lejohet korrigjimi i regjistrimit me kërkesë të një personi që pretendon se ka të drejta mbi pronën e regjistruar, duke shënuar një vërejtje në regjistër, pastaj kërkesa zgjidhet nga organi kompetent - gjykata. Pas vendimit të gjykatës korrigjohet regjistrimi.³⁴ Ky sistem ka rrjedhur për shkak të mungesës së regjistrave siç u theksua më lartë, por vetëm sistemit të regjistrimit kadastral. Andaj, ekziston supozimi se

³⁰ Shih Ivo Deskovic, Property in Europe, Law and Practice, Sistemi Austriak, në: Hurndall, Anthony, Property in Europe, Law and Practice, Tottel Publishing Ltd, 2007, faqe 9 -10.

³¹ Shih Gerhard Weigen, Stefan Lingemann, Wolfgang Spörr, Edgar Jousen, Dirk Wasmann, Eckhart Schwyer and Christopher Kuner, Property in Europe, Law and Practice, Sistemi Gjerman, në: Hurndall, Anthony, Property in Europe, Law and Practice, Tottel Publishing Ltd, 2007, faqe, 219-220.

³² Shih LPDTS, neni 118.

³³ Shih Ligji 2002/5, për themelimin e regjistrit të të drejtave në pronën e paluajtshme, neni 5.

³⁴ Për më shumë shih Ligji 2002/5, për themelimin e regjistrit të të drejtave në pronën e paluajtshme, neni 5, paragrafi, 5.4.

mund te ketë gabime në regjistrim, prandaj edhe është lejuar kundërshtimi/korrigjimi i regjistrimit dhe vërtetimi i të kundërtës se asaj që është regjistruar në regjistër. Edhe sipas Kodit Civil Gjerman, regjistrimi i të drejtës e ka supozimin ligjore se personi i regjistruar e ka edhe te drejtën. Nëse e drejta fshihet nga regjistri, konsiderohet se nuk ekziston me tutje.³⁵ Te dhënat ne regjistër supozohen se janë te sakta, për veç nëse ka ndonjë kundërshtim dhe ky kundërshtim behet i ditur nga regjistri për fituesin e te drejtës. Ky njoftim për fituesin e te drejtës duhet te behet ne kohen kur aplikon për regjistrimin e te drejtës.³⁶ Pra fituesi i të drejtës (blerësi me mirëbesim) nëse e blen të drejtën duke u bazuar në shënimet e regjistrit është i mbrojtur me prezumimin e saktësisë së të dhënave në regjistër dhe bëhet pronarë (bëhet transferi i të drejtës), përveç nëse ai e ka njoftimin se regjistrimi është me defekt (gabime).³⁷ Nëse e drejta nuk përputhet me atë që është në regjistër, mund te kërkohet korrigjimi, nga Regjistri por me aprovimin e personit që afektohet (preket) nga korrigjimi (personi që është ende i regjistruar ne regjistër si titullar).³⁸ Nëse ky person (personi i regjistruar si titullar) refuzon korrigjimin atëherë personi që kërkon korrigjimin e ka të drejtën e kërkesës kundër palës jo-koperuese.³⁹

³⁵ Krahaso, Kodi Civil Gjerman, neni 891.”1) If a right has been entered in the Land Register for a person, it is presumed that the person is entitled to this right. 2) If a right entered in the Land Register is deleted, it is presumed that the right does not exist.

³⁶ Shih Kodi Civil Gjerman, neni 892.

³⁷ Shih Gerhard Weigen, Stefan Lingemann, Wolfgang Spoerr, Edgar Jousen, Dirk Wasmann, Eckhart Schwyer and Christopher Kuner, Property in Europe, Law and Practice, Sistemi Gjerman, në: Hurndall, Anthony, Property in Europe, Law and Practice, Tottel Publishing Ltd, 2007, faqe, 219.

³⁸ Shih Kodi Civil Gjerman, neni 894.

³⁹ Shih Gerhard Weigen, Stefan Lingemann, Wolfgang Spoerr, Edgar Jousen, Dirk Wasmann, Eckhart Schwyer and Christopher Kuner, Property in Europe, Law and Practice, Sistemi Gjerman, në: Hurndall, Anthony, Property in Europe, Law and Practice, Tottel Publishing Ltd, 2007, faqe, 210.

4. Pronësia në pronën e paluajtshme⁴⁰

4.1 Fitimi i pronësisë në pronën e paluajtshme

E drejta e pronësisë në pronën e paluajtshme fitohet me: 1) titull juridik (*iustus titullus*) që mund të jetë titulli derivativ (puna juridike-kauza) dhe titull origjiner (parashkrimi, vendimi i organit shtetëror, bashkimi i sendeve, etj) dhe 2) mënyra e fitimit (*modus aquirendi*) e që në këtë rast është regjistrimi i të drejtës në regjistër për të drejtat në paluajtshmëri.

4.2 Regjistrimi

Pronësia në pronën e paluajtshme mund të fitohet vetëm duke e regjistruar të drejtën e pronësisë në regjistrin për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmëri. Natyra e regjistrimit është e karakterit konstitutiv sepse siç u tha me lartë e drejta fitohet vetëm pasi të jetë regjistruar. Nuk mund të ketë fitim të drejtës së pronësisë në paluajtshmëri pa u regjistruar e drejta, sepse siç u tha, në regjistër duhet të ketë ndryshim të regjistrimit kur bartet ose krijohet ndonjë e drejtë. Sipas LPDTS, neni 36, par.1 *“Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave nëpaluajtshmëri”*. Në të kundërtën nëse e drejta nuk është e regjistruar, ajo ende mbetet e personit që është i regjistruar në regjistër.

4.3 Efektet juridike të regjistrimit në vështrim krahasues

Cilat janë efektet juridike të mungesës së regjistrimit? Supozojmë se një person e ka blerë sendin e paluajtshëm (tokë, ndërtesë, banesë) dhe e ka titullin juridik, kontratën e shitblerjes e cila duhet të jete formale e vërtetuar nga Noteri, por të drejtën nuk e ka regjistruar. Mund të jetë edhe rasti kur e ka vetëm kontratën e shkruar por të pa noterizuar. Ky person (shitësi) nuk mund ta bartë të drejtën e pronësisë sepse ende certifikatën e pronësisë nuk e ka në emër të tij, andaj edhe një transaksion i bartjes së pronësisë (shitjes)

⁴⁰ Sipas ligjeve në Kosovë, nocioni “Paluajtshmëri” nënkupton token dhe gjithçka që është e ngulitur me tokën (ndërtesat, instalimet ngulitura në tokë etj). Pronari i tokës konsiderohet edhe pronarë i ndërtesës me përjashtim nëse, ka krijuar të drejtë të veçantë në ndërtesë p.sh të drejtën e ndërtimit. Lidhur me konceptin e pronësisë sipas LPDTS, shih Haxhi Gashi, Fitimi dhe humbja e pronësisë sipas LPDTS: ndikimi i Kodit Civil gjerman (BGB) në ligjin e Kosovës, *Hanse Law Review*, Vol.9, No.1, faqe 41-60, fq. 55.

nuk mund te behet. Mund të bëhet vetëm bartja të posedimit, por kalimi i titullit të të drejtës së pronësisë bëhet vetëm përmes regjistrimit. Blerësi që e ka blere sendin e paluajtshëm nga jo pronari (personi që nuk e ka pronën mbi veti-regjistrimin) nuk mund ta regjistroj te drejtën. Me regjistrim lëshohet *Certifikata e Pronësisë* që vërteton të drejtën. Kjo logjik e themelimit të drejtave sendore ekziston edhe në disa sisteme juridike. Në sistemin austriak, fitimi i pronësisë mund të bëhet me titull juridik (kontrata) por duhet të bëhet regjistrimi i të drejtës në regjistër që mbahet nga gjykata e shkallës së ultë lokale (*Bezirksgerichte*), dhe derisa nuk është bërë regjistrimi palët kanë vetëm marrëdhënie kontraktuese. Edhe pse kalimi i posedimit mund të bëhet më herët, mirëpo pa regjistrim të drejtës blerësi asnjëherë nuk bëhet pronarë dhe nuk e ka të drejtën absolute.⁴¹

Një koncept i tillë i regjistrave ekziston edhe në të drejtën gjermane, ku pronësia fitohet vetëm me regjistrimin e të drejtës në regjistër.⁴² Po ashtu edhe bartja e të drejtës mund të bëhet vetëm me regjistrim. Personi i pa regjistruar nuk mund të bëjë bartjen e të drejtës në tokë (pronën e paluajtshme). Titulli (e drejta) mund të themelohet vetëm me regjistrimi në regjistrin e tokës (*Grundbuch*), ndërsa regjistrat mbahen nga një divizion nga gjykatat lokale (*Amtsgericht*).⁴³ Siç dihet në sistemin gjerman dallon kontrata nga marrëdhëniet e detyrimeve dhe kontrata për bartjen e titullit juridik i njohur si - *parimi i abstaksionit*. Parakushtet për fitimin e të drejtës mbi tokë (paluajtshmëri) kërkohet: a) kontrata e shitjes, b) marrëveshja për bartjen e të drejtës-titullit (*Auflassungsvormerkung*) dhe c) dhe regjistrimi i bartjes së titullit në regjistër.⁴⁴

Tërheqja e paraleleve dhe krahasimi i sistemit të regjistrave në Kosovë me disa juridiksione ka për qëllim që të kuptohet rëndësia e regjistrimit dhe fakti se regjistrat kanë karakter konstituiv të fitimit të drejtës sikur në juridiksionet e lartpërmendura Austriak, Gjerman. Nëse palët nuk i kanë regjistruar të

⁴¹ Shih Ivo Deskovic, Property in Europe, Law and Practice, Sistemi Austriak, në: Hurndall, Anthony, Property in Europe, Law and Practice, Tottel Publishing Ltd, 2007, faqe 10.

⁴² Krahaso nenin 873, par. 1 dhe 2 te Kodit Civil Gjerman (BGB).

⁴³ Shih Gerhard Weigen, Stefan Lingemann, Wolfgang Spoerr, Edgar Jousen, Dirk Wasmann, Eckhart Schweyer and Christopher Kuner, Property in Europe, Law and Practice, Sistemi Gjerman, në: Hurndall, Anthony, Property in Europe, Law and Practice, Tottel Publishing Ltd, 2007, faqe, 219.

⁴⁴ Shih Gerhard Weigen, Stefan Lingemann, Wolfgang Spoerr, Edgar Jousen, Dirk Wasmann, Eckhart Schweyer and Christopher Kuner, Property in Europe, Law and Practice, Sistemi Gjerman, në: Hurndall, Anthony, Property in Europe, Law and Practice, Tottel Publishing Ltd, 2007, faqe, 219.

drejtat, mund të humbin rastet në gjykatë nëse për këtë ka kundërshtim nga palët tjera që e kanë të drejtën e regjistruar dhe nuk kanë autorizuar bartjen e të drejtës së tyre. Në praktik ndodhë shumë që të ketë transaksione joformale ku bëhen shitblerje pa bërë ndryshime në regjistër, dhe ekziston mundësia që sendi të shitet disa herë, pa u bartur e drejta e pronësisë me regjistrim. Në këtë rast e drejta mbetet mbi personin që e ka të regjistruar të drejtën, ndërsa pala që nuk është pronarë i regjistruar ose nuk e ka autorizimin e shitjes nga pronari e ka shitur sendin dhe ka bartur vetëm posedimin por nuk mund të regjistroj të drejtën palës-blerësit. Në këtë rast shitësi do të jetë përgjegjës për kompensimin e dëmit për shkak të shitjes së sendit me mungesa juridike (shitja e sendit pa pasur të drejtë pronësie ose pa autorizimin e pronarit). Po ashtu blerësi nuk e fiton të drejtën nëse e ka blere sendin nga personi që nuk e ka të drejtën të regjistruar. Ekziston vetëm një rast kur blerësi i sendit të paluajtshëm është me mirëbesim (e ka blerë sendin por nuk e di se sendi nuk i takon shitësit), nëse kalon afati i parashkrimit prej 20 viteve dhe nuk ka kundërshtim mund ta fitoj pronësinë, por duke e vërtetuar parashkrimin me vendim të gjykatës dhe regjistrimin e të drejtës. Ndryshe në asnjë rast tjetër nuk mund të fitohet pronësia nga jopronari, respektivisht personi që nuk e ka të drejtën e regjistruar në regjistër. Po ashtu nuk mund të fitohet pronësia nga poseduesi me keqbesim, mashtrim, dhune, uzurpim pavarësisht kohës së mbajtjes në posedim të sendit të paluajtshëm.

Përfundim

Regjistrimi i të drejtave sendore në Kosovë është parakusht për fitimin e një të drejte sendore. Sistemi i ri i regjistrimit i të drejtave sendore i themeluar në vitin 2002 i njohur si Regjistri për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmeri (njëjtë sikur Librat e Tokave në juridiksione tjera), kërkon regjistrimin e të drejtës sendore. Sipas Ligjit të Kosovës janë të njohura këtë të drejta sendore: pronësia, e drejta e parablerjes, servitutet, pengu, hipoteka, e drejta e ndërtimit dhe barrët (ngarkesat) sendore.

Për të fituar një të drejtë sendore kërkohet të plotësohen dy kushte: titulli juridik (*iustus titulus*), si: kontrata, testamenti, vendimi i organit shtetëror, parashkrimi, bashkimi i sendeve etj, që mund të jetë titull derivativ ose origjiner, dhe forma e fitimit që është regjistrimi (*modus aquirendi*). LPDTS, në mënyrë specifike kërkon regjistrimin e të drejtës në regjistrin e themeluar për këtë qëllim. Krahasuar me juridiksione tjera, e drejta në Kosovë, ka ngjashmëri me sistemin Austriak dhe Gjerman të regjistrimit (Librat e Tokave) për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmeri.

Sistemi i regjistrimit të drejtave sendore në Kosovë ka supozimin se të dhënat në regjistër janë të sigurta derisa nuk argumentohet e kundërta. Ky sistem e lejon korrigjimin me vendim të gjykatës ose agjencionit tjetër të paraparë për këtë qëllim (si shembull Agjencioni i Pronave). Bazuar në vendimin e gjykatës /agjencionit do të bëhet korrigjimi i të shënimeve në regjistër. Regjistrimi ka efekt në mes të palëve dhe në raport edhe me palët e treta. Pa regjistrim, e drejta sendore nuk është themeluar (krijuar). Çfarëdo transferi (bartje) e të drejtës sendore (reale) mund të bëhet vetëm me regjistrim; ndryshe ekziston vetëm bartja e posedimit dhe jo e drejta.

Prof. Dr. iur. Haxhi Gashi, prof.ass *

The registry of property and other real rights in Kosovo: A critical review from a comparative perspective -

Summary

This paper treats the way of acquiring real rights under Kosovo legal system. It provides also comparative analysis with regard to the registration of real rights with different legal system in Europe. There are a lot of discussions about ways of acquiring ownership and other real rights under the law in Kosovo, although the current system requires the registration of rights to immovable property. Therefore, this paper discusses more on how to register real rights and the role of records as declarative (only to inform the parties) or constitutive (founder) character. In this context the paper provides analysis to determine the moment of acquiring real rights as distinct from the contractual relationship, the possession in good faith or other forms of transfer of ownership and other real right. In this regard under this paper are distinguished informal transactions and legal consequences arising for the parties in case of failure to register the right to register.

The registration for the real rights in Kosovo is a precondition for acquisition of any real rights. The new registration system of the real rights established in 2002 as known registry for registration of rights in immovable property (like Land books in other jurisdictions), requires a registration of the real rights over immovable. Under Kosovo law as real rights are recognized: ownership, right of pre-emption, servitudes, pledge, mortgage, right of building and charges.

* Prof.Dr.Iur.Haxhi Gashi, prof. ass., is a professor of the civil (property) law and Dean of Faculty of Law of the University of Pristina. The author has completed his Master (LLM) at Faculty of Law of the University of Pristina in 2005 and PhD at the University of Bremen in Germany in 2011. He has been involved in drafting civil law legislation in Kosovo since 2003. Currently he is a member of the State Committee Experts for drafting Civil Code in Kosovo.

In order to acquire any real right a two conditions are required: legal title (*iustus titulus*), contract, will, decision of state body, prescription, merged property etc that can be (derivative or original title) and the acquisition form that is registration (*modus aquirendi*). The LPORR specifically requires registration of the real rights in the registry established for the purpose of the rights in immovable. Compare to other jurisdictions the Kosovo jurisdictions has similarities to the Austrian and German system of the registration (Land Books) of the real rights in immovable.

The registration system of the real rights in Kosovo has a presumption of the true data until it is not contrary argued. It allows correction by decision of the court or other agencies foreseen by law (for example agency of property). Based on the decision of the court/agency will be correction in the registry. Registry has legal effect between parties and also against third parties. Without registration a real right is not acquired. Any transfer of the real rights title could be only by registration; contrary it could be only transfer of possession without having a legal title.

Prof. Ass. Remzije Istrefi*

Kuptimi i nocionit të drejtësisë transicionale dhe i pajtimit nga perspektiva ndërkombëtare e ndërtimit të paqes

Abstrakt

Dekadave të fundit, aktorët ndërkombëtarë luajtën një rol me ndikim dhe përshpejtues për lehtësimin e drejtësisë dhe pajtimin e shoqërive të ndara, përmes përpjekjeve në situatat e paskonfliktit për ndërtimin e paqes. Aktorët ndërkombëtarë jo vetëm ofrojnë një rol ndërmjetësues në mes të armiqve të dikurshëm, por edhe janë bërë pjesëmarrës efektiv në projektimin dhe ndërmarrjen e aktiviteteve që janë pjesë e mekanizmit të drejtësisë transicionale, në disa raste duke synuar pajtimin mes tyre. Duke vepruar kështu, këta aktorë marrin rolin e një "agjencie morale", të cilës shumë shpesh i mungon besimi politik dhe mirëbesimi nga ana e shoqërisë ku veprojnë.

Ky punim mëton të shqyrtojë kritikën lidhur me rolin e aktorëve ndërkombëtarë në proceset e drejtësisë transicionale që kanë të bëjnë me aktivitetet e ndërtimit të paqes në një shoqëri të dal nga konflikti, si dhe të vlerësojë kontributin e tyre në formësimin e konceptit të pajtimit.

Punimi analizon efektin e kritikave të tilla, dhe diskuton nëse kritikën ekzistuese shkencore i ndryshojnë rrënjësisht konceptet dominuese të drejtësisë transicionale apo potencialisht kërkojnë ndërlidhjen e korpusit ekzistues të njohurive dhe kornizës përkatëse konceptuale.

* Prof. Ass. Remzije Istrefi është ligjëruese në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës në lëndët Mbrojta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, dhe Organizatat Ndërkombëtare, dhe është këshilltare e jashtme në Projektin: "Mbështetje për Drejtësinë Transicionale në Kosovë (STJK Project), Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), për të mbështetur Grupin Punues Ndër-ministral për Ballafaqimin me të Kaluarën dhe Pajtimin (GPBmKP) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Qeveria e Republikës së Kosovës, për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtimin. Mendimet e shprehura janë qëndrime personale të autores dhe nuk reflektojnë mendime institucionale.

Fjalët kyçe: drejtësia transicionale, pajtimi, bashkësia ndërkombëtare, ndërtimi i paqes, të drejtat e njeriut.

Hyrje

Drejtësia transicionale është konceptuar në përgjithësi si një fushë që hulumton përpjekjet për të siguruar paqen dhe drejtësinë.¹ Edhe pse fushë e re studimi, i është ekspozuar vazhdimisht kritikave teorike dhe praktike.² Një numër çështjesh të diskutueshme janë ngritur lidhur me ideologjinë e fushës, funksionimin dhe legjitimitetin e mekanizmave ligjorë, kapacitetin e përgjithshëm të hartuesve të saj, arritja e qëllimeve në praktikë dhe të tjera.

Pajtimi si qëllim final i drejtësisë transicionale është bërë po ashtu koncept i kontestuar, me një rrjet të gjerë qasjesh konfuze e konkurruese. Vlera e pajtimit është diskutuar në kontekste të ndryshme politike, etike dhe ligjore. Më pas, ai u kthye në përpjekje për t'i arritur më mirë kushtet që kanë të bëjnë me të kaluarën në shoqëritë në transicion dhe të për t'i përmirësuar marrëdhëniet mes palëve dikur në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Në dekadat e fundit, aktorët ndërkombëtarë luajtën një rol me ndikim dhe përshpejtues në lehtësimin e drejtësisë dhe pajtimin e shoqërive të ndara përmes përpjekjeve të paskonfliktit për ndërtimin e paqes. Aktorët ndërkombëtarë jo vetëm ofrojnë një rol ndërmjetësues mes armiqve të dikurshëm, por edhe janë bërë pjesëmarrës efektiv në projektimin dhe ndërmarrjen e aktiviteteve që janë pjesë e mekanizmit të drejtësisë transicionale në disa raste duke synuar pajtimin mes tyre. Duke vepruar kështu, këta aktorë marrin rolin e një "agjencie morale", të cilës shumë shpesh i mungon besimi politik dhe përmbushja e mirëbesimit.

Në territoret e prekura nga luftërat civile dhe trazirat e dhunshme, aspekte kritike të agjendës së një vendi pas konflikti rrallë pranojnë lehtë "zgjdhje"

¹ Termi 'drejtësi transicionale' është përdorur më 1995 nga Neil Kritz, i cili ka publikuar një studim në tri vëllime të titulluar "Transitional Justice: How Emerging Democracies Reckon with Former Regimes". Ky studim praqet një studim koherente të mekanizmave që ende konsiderohen qendror në studimet e drejtësisë transicionale sot, të tilla sic janë komisionet e hetimit, gjyqet, verifikimet dhe restitucionet apo reparacionet. Shih Neil J. Kritz, *Transitional Justice: How Emerging Democracies Reckon with Former Regimes* (Washington, DC: United States Institute of Peace Press, 1995).

² Për natyrën bashkëkohore të 'fushës' së drejtësisë transicionale shih përgjithësisht: Christine Bell Transitional Justice, "Interdisciplinarity and the State of the 'Field' or 'Non-Field'". *The International Journal of Transitional Justice*, Vol. 3, 2009, 5–27.

të gjeneralizueshme.³ Gjithnjë e më shumë, përvoja e pranuar është se burimet më të mirat dhe kështu 'modalitetet' më të mira – edhe pse me shumë dilema dhe në dukje të vështira - të menaxhimit të pasojave të konflikteve të dhunshme bien brenda vetë shteteve. Megjithatë, shumica e shoqërive që dalin nga konfliktet e dhunshme janë krejtësisht të 'lodhura' dhe ekonomikisht të varfra. Ato nuk kanë burimet teknike dhe materiale për të ngritur projekte shëruese, komisionet për të vërtetën, pajtimin, programe të riparacioneve, dhe shumë shpesh ka një mungesë të vullnetit politik për të iniciuar dhe zbatuar proceset e drejtësisë transicionale dhe të pajtimit.

Njëkohësisht, me rritjen e numrit të konflikteve rajonale, gjithnjë e më shumë luftëra civile u zhvilluan në vitet 1990, komuniteti ndërkombëtar u angazhua në mënyrë progresive më shumë me ndërtimin e paqes, duke mos përjashtuar operacionet paqeruajtëse si për nga cilësia ashtu edhe për nga sasia.⁴ Aktorët ndërkombëtarë u angazhuan në rajonet apo vendet jo vetëm për të mbajtur paqe - në disa raste, pas një ndërhyrjeje ndërkombëtare ushtarake - por edhe për të ndërtuar paqen në fazën e pas konfliktit.⁵ Këto ndërhyrje kanë qenë të kombinuara me operacionet 'paqeruajtëse' që kërkojnë për t'i dhënë fund konflikteve të dhunshme të lidhura në një formë apo tjetër me qeveritë jo përfaqësuese dhe/ose represive, dhe për të sjellë një transicion me mjete më paqësore që kanë të bëjnë me eliminimin e interesave konfliktuale në një periudhë të transformimit të konfliktit.⁶

³ "Traditional Justice and Reconciliation after Violent Conflict: Learning from African Experiences, International Institute for Democracy and Electoral Assistance 2008", gjendet në:

http://www.idea.int/publications/traditional_justice/upload/Traditional_Justice_and_Reconciliation_after_Violent_Conflict.pdf.

⁴ Shih Edward Newman, Roland Paris, and Oliver P. Richmond, "Introduction", në Edward Newman, Roland Paris, and Oliver P. Richmond, eds, *New Perspectives on Liberal Peacebuilding* 3, 9 (UN 2009).

⁵ Me fundin e Luftës së Ftohtë, bota përjetoj një zgjerim të shpejtë në paqeruajtjen ndërkombëtare dhe ndërtimin e paqes dhe operacionet e paqes të OKB-së shpejt u rritën në sofistikim dhe kompleksitet. Shih: Simon Chesterman, You, *The People: The United Nations, Transitional Administration, and State Building* (Oxford University Press: 2004) 238. Për gjeneratën tjetër të misioneve paqeruajtëse shih Roland Paris, *Peacekeeping and the Constraints of Global Culture*, 9 *Eur J Ind Rel* 441,448-50 (2003).

⁶ Shembujt më kompleks të operacioneve multi-dimensionale të paqes përfshijnë Kamboxhën, Angolën, Burundin, Republikën Qendrore Afrikane, Liberinë, Mozambikun, Ruandën, Sierra Leonën, Çadin, Sudanin, Bregun e Fildishtë, Republikën Demokratike të Kongos, Somalinë, Kosovën, El Salvadorin, Guatemalën, Haitin, Timorin Lindor, Bosnjë dhe Hercegovinë, Sllavoninë Lindore, dhe Kroacinë.

Koncepti i "ndërtimit të paqes pas konfliktit" është lidhur me operacionet multi-dimensionale të paqes të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) që shpesh i atribuohen raportit *Agjenda për Paqe* të vitit 1992 të ish Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Boutros Boutros-Ghali, i cili e ka definuar atë si "aksion për të identifikuar dhe mbështetur strukturat të cilat do të tentojnë të forcojnë dhe konsolidojnë paqen për të shmangur rikthimin në konflikt".⁷ Që nga ajo kohë, koncepti është institucionalizuar nëpër një numër organizatash jashtë sistemit të OKB-së e që përdoren për të formësuar dhe organizuar një sërë aktivitetesh pas konfliktit.⁸ OKB, organizatat rajonale, si dhe ndihma e shtetet individuale në projektet e ndërtimit të paqes pas konfliktit ka marrë forma të ndryshme, disa më të përgjithshme, disa të tjera shumë të veçanta. Për shembull, Unioni Afrikan (AU) është angazhuar në mbështetjen e disa proceseve të paqes në Afrikë, Bashkimi Evropian (BE) është aktiv në mbështetjen e procesit të paqes në Ballkanin Perëndimor ose në territoret e ish-Jugosllavisë, dhe Organizata e Shteteve Amerikane (OAS) po mbështet disa procese të paqes në hemisferën perëndimore (si, për shembull, në Haiti). Në Kosovë dhe Timorin Lindor, OKB-ja ka krijuar administratat e plota territoriale ndërkombëtare dhe direkt janë përfshirë në administrimin e gjyqësorit, policisë, dhe shërbimet e burgjeve. Si një fushë specifike ku komuniteti ndërkombëtar ka qenë i përfshirë në proceset e drejtësisë tranzicionale që kanë një potencial pajtimi është edhe fusha e drejtësisë. OKB-ja ka ngritur tribunale ndërkombëtare të tilla si Tribunali Ndërkombëtar për ish Jugosllavin (ICTY) në Hagë dhe Tribunali Ndërkombëtar për Ruanden (ICTR) në Arusha, dhe kohët e fundit Gjykatën Speciale për Kosovën.⁹ Kjo përfshirje e aktorëve ndërkombëtarë në llogaridhënie është quajtur kulmi global i ndjekjeve penale të shkeljeve të të drejtave të njeriut duke u shfaqur si një normë e re ndërkombëtare e përgjegjësisë.¹⁰ Në Kamboxhia, Timor Lindor, Sierra Leone dhe Kosovë, OKB-ja dhe BE-ja janë përfshirë në përpjekjet për të krijuar një lloj të ri të tribunalit për ndjekjen e krimeve ndërkombëtare. Këto janë "gjykata vendore

⁷ United Nations, *Agenda for Peace, Preventative Diplomacy, Peacemaking and Peace Keeping*, UN Doc A/47/277-S/24111 at 6, 21 (1992).

⁸ Michael Barnett, et al, *Peacebuilding: What Is in a Name?*, 13 *Global Governance* 35, 45-48 (2007).

⁹ Më 3 gusht 2015 Parlamenti i Kosovës ka miratuar "Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar", një amandament kushtetues që do të themelojë një gjykatë speciale për krimet e luftës për të hetuar ish Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) për krimet e kryera gjatë dhe pas luftës në Kosovë. Shih: Ligji nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, *Gazeta Zyrtare të Republikës së Kosovës / Nr. 27 / 31 gusht 2015, Prishtinë*.

¹⁰ Kathryn Sikkink, *The Justice Cascade: How Human Rights Prosecutions Are Changing World Politics* (Norton 2011).

të ndërkombëtarizuara" apo të ashtuquajturat "gjykatat hibride", shartuar mbi strukturën gjyqësore të një shteti, ku kanë ndodhur shkeljet masive të të drejtave të njeriut dhe të drejtës humanitare.¹¹ Përveç kësaj, komuniteti ndërkombëtar ka sponsorizuar ngritjen e komisioneve të së vërtetës dhe të pajtimit, të tilla si në El Salvador, në Guatemalë dhe në Timorin Lindor dhe shumë të tjera.¹² Ndërsa të vlerësuara shumë, përpjekjet e aktorëve ndërkombëtarë në forma të ndryshme për ndërtimin e paqes pas konflikteve të dhunshme, nuk janë kursyer nga kritika shkencore. Në këtë artikull kam për qëllim të shqyrtojë disa nga kritikave për rolin e aktorëve ndërkombëtarë në lehtësimin e proceseve të drejtësisë tranzicionale në një shoqëri pas konfliktit, si dhe të vlerësojë kontributin e tyre në formimin e konceptit të pajtimit. Unë do të analizoj efektin e kritikave të tilla, dhe të diskutoj nëse kritikave ekzistuese shkencore ndryshojnë rrënjësisht konceptet dominuese të drejtësisë tranzicionale ose potencialisht kërkojnë thithjen e korpusit ekzistues të njohurive dhe kuadrit përkatës konceptual.

Ky artikull fillon me një pasqyrë të literaturës mbi drejtësinë tranzicionale dhe pajtimin, duke theksuar faktorët e përbashkët në lidhje me përdorimin dhe sqarimin e koncepteve të ndryshme legale. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet pikëpamjeve që e shohin drejtësinë tranzicionale si "projekt global", si dhe pikëpamjeve që akuzojnë hartuesit ndërkombëtarë të drejtësisë tranzicionale si ata që kërkojnë për të prodhuar modele dhe të vërteta që lidhen me demokracinë e shërbyer (një masë u përshtatet të gjithëve) dhe janë "të verbër" për të drejtat e njeriut dhe drejtësinë sociale në kontekstin lokal.

Për këtë qëllim, ky artikull analizon kritikët që e vënë në pyetje kapacitetin e aktorëve ndërkombëtarë për të hyrë në marrëdhënie ndër-personale me ish-palët në konflikt. Kjo do të mundësojë vlerësimin e angazhimit të përgjithshëm të aktorëve ndërkombëtarë dhe qasjes në drejtësinë tranzicionale, si dhe të vlerësojë kontributin e tyre në konceptimin dhe masat e drejtësisë tranzicionale dhe agjendën e pajtimit në kuadër të përpjekjeve të ndërtimit të paqes pas konfliktit.

¹¹ Derek M. Welski, Policy Report 11/2014. "Hybrid Court System in Kosovo: Has EULEX Proven to be the Device to Strengthen the Independence and Effectiveness of the Judiciary?" shtator 2014, gjendet në: <http://legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2014/11/Policy-Report-11-2014-eulex-Hybrid-Courts-ENG.pdf>.

¹² Për më shumë detaje për komisionet e të vërtetës, shih Priscilla B. Hayner (2002), *Unspeakable Truth: Facing the Challenge of Truth Commissions* (Routledge: London, 2002); Naomi Roht-Arriaza and Javier Marieacurrena (eds.), *Transitional Justice in the Twenty-First Century* (Cambridge University Press: Cambridge, 2006).

1. Drejtësia Transicionale, Pajtimi dhe Ndërtimi i Paqes

Drejtësia transicionale është një fushë e aktivitetit që fokusohet "se si shoqëritë adresojnë trashëgiminë e abuzimeve të kaluara të të drejtave të njeriut, mizorive në masë, si dhe formave të tjera të traumave të rënda sociale, duke përfshirë edhe gjenocidin apo luftën civile, për të ndërtuar një të ardhme më demokratike, të drejtë ose paqësore".¹³ Këto qasje përfshijnë një "grup të parimeve të ndërlidhura dhe proceseve të përqendruara në sundimin e imagjinuar të ligjit dhe të ligj-bërjes "në përbërjen e transicionit" drejt një vargu qëllimesh.¹⁴ Ndërsa drejtësia transicionale mund të datojë nga lindja e vetë demokracisë (në Athinën klasike), konceptimet moderne të drejtësisë transicionale shfaqen me përpjekje të përbashkëta për të mbrojtur të drejtën ndërkombëtare në qendër të marrëdhënieve ndërshtetërore në prag të Luftës së Dytë Botërore.¹⁵ Për një kohë të gjatë qasja ndërkombëtare ishte më e dukshme në përhapjen e traktateve kryesore ndërkombëtare dhe angazhimin ndërkombëtar në "agjendën pas konfliktit", kryesisht nëpërmjet OKB-së, e kohët e fundit edhe nga organizatat rajonale.¹⁶ Komuniteti ndërkombëtar ka deklaruar se i ka prioritet çështjet e drejtësisë dhe është duke financuar dhe mbështetur zbatimin e një morie nismash ligjore. Gjithnjë e më shumë përpjekje ndërkombëtare kanë shkuar në ndërtimin e gjykatave ndërkombëtare dhe hibride, në hartimin e ligjeve, në ndëshkimin e autorëve të shkeljeve të të drejtave të njeriut, në mbështetjen e OJQ-ve për të drejtat e njeriut, dhe në përgjithësi në promovimin e sundimit të ligjit jashtë vendit. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Annan, në raportin e tij për Këshillin e Sigurimit, në gusht të vitit 2004, pranoi se ka pasur një përqendrim më të madh nga ana e OKB-së për çështjet e drejtësisë, drejtësisë transicionale, si dhe sundimin e ligjit në shoqëritë në konflikt dhe pas konfliktit.¹⁷ Ai vuri në dukje se përfshirja e drejtpërdrejtë e OKB-së në shoqëritë pas konfliktit është karakterizuar nga importimi i aparatit të drejtësisë transicionale, për shembull, në Kosovë dhe Timor Lindor, ku

¹³ Louis Bickford, "Transitional Justice", në Dinah L. Shelton (ed.), *The Encyclopedia of Genocide and Crimes Against Humanity* (Farmington Hills, MI: Macmillan Reference, 2004) 1045.

¹⁴ Ruti G. Teitel, *Transitional Justice* (Oxford University Press: New York, 2000) 12.

¹⁵ Për historinë e drejtësisë transicionale shih: John Elster, *Closing the Books: Transitional Justice in Historical Perspective* (Cambridge University Press: Cambridge 2004); shih poashtu edhe Ruti G. Teitel, 'Transitional Justice Genealogy' (2003) 16 *Harvard Human Rights Journal* 69-94.

¹⁶ "An Agenda for Peace: Prevention Diplomacy, Peacemaking and Peacekeeping" (1992) *17 UN Doc. A/47/277-S/24111*.

¹⁷ UN Secretary-General, "The Rule of Law and Transitional Justice in Conflict and Post Conflict Societies" (2004) *UN Doc. S/2004/616* (23 August 2004). 4.

OKB-ja ka qenë e përfshirë direkt në administrimin e gjyqësorit, policisë dhe shërbimet e burgut.

Përkufizimet e drejtësisë transicionale ndryshojnë dhe kanë evoluar me kalimin e kohës, shumica e tyre duke u përpjekur për të kapur një dilemë ligjore, politike dhe morale për mënyrën se si të merren me historikun e të drejtave të njeriut dhunën politike në shoqëritë që kalojnë një formë të transicionit politik.¹⁸ Për OKB-në, drejtësia transicionale përfshin "gamën e plotë të proceseve dhe mekanizmave të lidhur me përpjekjet e një shoqërie për trashëgiminë e abuzimeve në shkallë të madhe të të kaluarës, për të siguruar llogaridhënie, për t'i shërbyer drejtësisë dhe për të arritur pajtimin".¹⁹ Këto mund të përfshijë mekanizma gjyqësor dhe jo-gjyqësor, me nivele të ndryshme të përfshirjes ndërkombëtare (ose kurrfarë) dhe ndjekjeve penale individuale, reparacioneve, kërkimit të së vërtetës, reformave institucionale, verifikimin dhe shkarkimet, ose një kombinim të tyre.²⁰ Thënë në përgjithësi, qëllimi i proceseve të drejtësisë transicionale është për të bërë drejtësi dhe për të siguruar një riparim në prag të dhunës së tmerrshme.²¹

Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Transicionale (ICTJ) përcakton drejtësinë transicionale si "përgjigje ndaj shkeljeve sistematike ose të përhapura të të drejtave të njeriut", e cila "kërkon njohje për viktimat dhe promovim të mundësive për paqe, pajtim dhe demokraci."²² Drejtësia transicionale është përcaktuar edhe si "koncepti i drejtësisë që ndërhyjnë në një periudhë të ndryshimeve politike, e karakterizuar nga një përgjigje juridike ndaj gabimeve të regjimit të kaluar".²³ Si e tillë, drejtësia transicionale përfshin aspekte të 'shikimit prapa dhe të të përparuar'.²⁴ Roht-Arriaza, për shembull, përcakton drejtësinë transicionale si "grup i praktikave, mekanizmave dhe shqetësimeve që lindin pas një periudhe të konfliktit, konfliktit civil ose represionit, dhe që kanë për qëllim direkt të përballen dhe të merren me shkeljet e kaluara të drejtave të njeriut dhe të së

¹⁸ Për një shqyrtim kritik të definicionit të drejtësisë transicionale, shih: Rosemary Nagy, *Transitional Justice as a Global Project: Critical Reflections*, 29 *Third World Quarterly* 275, 277-78 (2008).

¹⁹ *Ibid*, 2.

²⁰ *Ibid*.

²¹ Margaret Walker, *Moral Repair: Reconstructing Relations after Wrongdoing* (Cambridge University Press: Cambridge, 2006).

²² ICTJ Website, available at: <http://www.ictj.org/en/tj/>. Shih gjithashtu UN Secretary General, "Report of the Secretary General, The Rule of Law and Transitional Justice in Conflict and Post-Conflict Societies"

²³ Teitel, "Transitional Justice Genealogy", f 69-94.

²⁴ *Ibid*.

drejtës humanitare".²⁵ OKB-ja ka lëvizur drejt njohjes që për t'u marrë siç duhet me shkaqet rrënjësore të konfliktit, është gjithashtu e nevojshme për të adresuar shkeljet e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore.²⁶

Ka marrëveshje të përgjithshme se në çdo shtet ku mizoritë masive kanë ndodhur duhet angazhuar në procese gjyqësore (dhe jo-gjyqësore) që do të çonin në drejtësi për krimet e kaluara, paqe, një shoqërie demokratike dhe vendosje të sundimit të ligjit. Kështu, kjo afirmon se qeveritë pasardhëse duhet të ndërtojnë institucionet që do të kryejnë proceset për të kërkuar drejtësi për gabimet e kaluara, duke treguar angazhim për qeverisje të mirë dhe të respektimit të të drejtave të njeriut në të ardhmen.²⁷

Katër procese besohet se përbëjnë thelbin e drejtësisë transicionale; zakonisht, transicioni përfshin një proces të drejtësisë, për të sjellë autorët e mizorive masive para drejtësisë dhe për të ndëshkuar ata për krimet e kryera; një proces riparimi, për të rehabilituar viktimat nga krimet që kanë pësuar; një proces i kërimit të së vërtetës, për të hetuar plotësisht krimet në mënyrë që shoqëria të zbulojë çfarë ka ndodhur gjatë shtypjes/konfliktit, kush i ka kryer krimet, dhe ku janë eshtrat e viktimave; dhe një proces i reformave institucionale, për të siguruar që krimet e tilla të mos përsëriten.²⁸ Për të ndihmuar në këtë përpjekje, janë hartuar kodet transicionale, udhëzimet dhe mjetet politike të sundimit të ligjit. Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) në vitin 2006, ka lëshuar Mjetet për Sundimin e Ligjit për Shtetet e Post-Konflikt,²⁹ kurse ish Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së në Letrën Udhëzuese ofron parimet dhe kornizën udhëheqëse për një qasje të Kombeve të Bashkuara në proceset e drejtësisë transicionale dhe mekanizmat.³⁰ Në mënyrë që të zbatohen me sukses, çdo proces i drejtësisë transicionale duhet të projektohet dhe zbatohet me

²⁵ Roht-Arriaza and Mariezcurrena, "Transitional Justice in the Twenty-First Century: Beyond Truth Versus Justice", f 2.

²⁶ Office of the High Commissioner of Human Rights, *Analytical Study on Human Rights and Transitional Justice*, Document: A/HRC/12/18, United Nations: Geneva, 2009)

²⁷ Rutie Tietel, "Transitional Justice in a New Era" *Fordham International Law Journal*, Vol, 26:893,2003 . 893.

²⁸ Shih: Office of the High Commissioner of Human Rights (2009), "Analytical Study on Human Rights and Transitional Justice"

²⁹ OHCHR, *Rule of Law Tools for Post Conflict States* (United Nations: New York and Geneva, 2009 , 2006).

³⁰ GUIDANCE NOTE OF THE SECRETARY-GENERAL United Nations Approach to Transitional Justice. Gjendet në [file:///C:/Users/PC/Downloads/TJ_Guidance_Note_March_2010FINAL%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/PC/Downloads/TJ_Guidance_Note_March_2010FINAL%20(1).pdf)

vëmendje të veçantë për të drejtat e viktimave dhe familjeve të tyre, me një kujdes të veçantë për nevojat dhe perspektivat e grave dhe fëmijëve.³¹

Së bashku me drejtësinë transicionale, koncepti i pajtimit ka fituar rëndësi në mesin e atyre që angazhohen në rigjenerimin e pasluftës. Në dekadën e kaluar "pajtimi" është bërë një nga katër kategoritë kryesore të nismave që marrin mbështetje donatorësh, së bashku me zhvillimin politik, asistencën socio-ekonomike dhe sigurinë.³² Shumë hulumtues dhe praktikues e shohin pajtimin si një kërkesë të domosdoshme për paqe të qëndrueshme, duke supozuar se sapo të jetë arritur një zgjidhje politike nga lart-poshtë, një proces nga poshtë-lart duhet të ndodhë, ku çështjet e pazgjidhura të konfliktit do të trajtohen në mënyrë për të parandaluar kontestimin e zgjidhjes dhe kthimin në dhunë.³³

Pajtimi është definuar si një proces "përmes të cilit një shoqëri lëviz nga një e kaluar e ndarë në një të ardhme të përbashkët"; duke shikuar në të kaluarën në një mënyrë që lejon njerëzit të shohin atë në drejtim të "vuajtjeve të përbashkëta dhe përgjegjësisë kolektive" dhe që mund të ndihmojë për të rivendosur besimin.³⁴ Koncepti është diskutuar në kontekstin e mirënjohjes, pendimit, mëshirës dhe faljes. Disa dijetarë kanë argumentuar se proceset e pajtimit jo domosdoshmërisht do të çojnë në falje, pasi është konsideruar që të drejtën dhe autoritetin për falje e mbajnë vetëm të viktimizuarit dhe nuk mund të kërkohet nga të.³⁵

Pajtimi mund të kuptohet si "asgjë më shumë se "bashkëjetesë e thjeshtë", në kuptimin që ish-armiqtë respektojnë ligjin në vend se të vriten me njëri-

³¹ Noelen Heyzer, *Women, War and Peace: Mobilizing for Security and Justice in the 21st Century*, UNIFEM, the Dag Hammarskjöld Lecture, New York: NY, 22 shtator 2004, 1-4, në 4.

³² Dan Smith, *Towards a Strategic Framework for Peacebuilding: Getting Their Act Together. Overview Report of the Joint Utstein Study of Peacebuilding* (Ministry of Foreign Affairs: Oslo, 2004).

³³ Martina Fischer, "Transitional Justice and Reconciliation: Theory and Practice". Gjetet në: http://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Handbook/Articles/fischer_tj_and_rec_handbook.pdf.

³⁴ David Bloomfield, Teresa Barnes and Luc Huyse, *Reconciliation after Violent Conflict. A Handbook*. (International IDEA: Stockholm, 2003) 12-21.

³⁵ Martha Minow, (ed.), *Breaking the Cycles of Hatred. Memory, Law and Repair*. Princeton University Press: Princeton, NJ 2002).

tjetrin.³⁶ Konceptet e pajtimit mund të përfshijnë elemente të tilla si falja, mëshira (jo edhe aq drejtësia - edhe pse ndonjëherë edhe drejtësia), vizioni i përbashkët gjithëpërfshirës, shërimi i ndërsjellë dhe harmonia. Karen Bronéus përcakton pajtimin gjerësisht si "gjetja e një mënyre për të balancuar çështje të tilla si e vërteta dhe drejtësia në mënyrë që ndryshimi i ngadalshëm i sjelljeve, qëndrimeve dhe emocioneve mes ish armiqve të mund të ndodhë".³⁷

Pajtimi mund të ndodhë në nivele individuale, shoqërore dhe kombëtare. Pajtimi në nivelin shoqërorë dhe të shtetit jo domosdoshmërisht sjell pajtimin në nivel personal. Në nivel individual, pajtimi duhet të bëhet në mes të viktimës dhe kryerësit/dhunuesit.³⁸ Ndryshe nga keqardhjet apo kërkim faljet, të cilat mund të jenë procese të njëanshme në nivel të komunitetit dhe shtetit, pajtimi individual kërkon reciprocitet. Duhet të ketë një proces të bashkëveprimit të drejtpërdrejtë në mes viktimës dhe dhunuesit. Kryesi kërkon falje; viktimë falë. Në nivel shoqëror ose kombëtar, pajtimi mund të kuptohet si "një proces shoqëror që përfshin njohjen e ndërsjellë të vuajtjes së kaluar dhe ndryshimin e qëndrimeve dhe sjelljeve shkatërruese në marrëdhënie konstruktive drejt paqes së qëndrueshme".³⁹

Tani, në përpjekje të definimit të konceptit të ndërtimit të paqes (ose ang. peace building), shumica e dijetarëve i referohen raportit të vitit 1992 "Agjenda për paqe", i cili paraqiti konceptin e ndërtimit të paqes në OKB si "aksion për të identifikuar dhe mbështetur strukturat, të cilat do të priren për të forcuar dhe konsoliduar paqen në mënyrë për të shmangur një rikthim të konfliktit".⁴⁰

Gjatë viteve, përpjekje të ndryshme janë bërë për të elaboruar këtë përkufizim. Sipas ish-Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Kofi Anan,

³⁶ David A. Crocker, "Reckoning With Past Wrongs: A Normative Framework", në Carol A. L. Prager and Trudy Goveir (eds.) *Dilemmas of Reconciliation: Cases and Concepts* (W Wilfrid Laurier University Press: Waterloo, Ont., 2003) 54.

³⁷ Karen Bronéus, "Reconciliation and Development", punim i lexuar në: "Building a Future on Peace and Justice," Nuremberg, 25-27 qershor 2007, 3.

³⁸ Marc Forget, "Crime as Interpersonal Conflict: Reconciliation Between Victim and Offender", në Carol A. L. Prager and Trudy Goveir (eds.) *Dilemmas of Reconciliation: Cases and Concepts* WW111-35.

³⁹ Bronéus "Reconciliation and Development 5. Për pajtim shoqëror (për pajtim shoqëror me të kaluarën dhe grupet pajtuese me njëra tjetrën), shih po ashtu: "Hayner, *Unspeakable Truths*," kapitulli 10.

⁴⁰ "An Agenda for Peace: Preventive Diplomacy, Peacemaking and Peace-Keeping", gjendet: http://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/47/277

termi “ndërtimi i paqes” i referohet veprimeve të ndërmarra në fund të një konflikti për konsolidimin e paqes dhe për të parandaluar një përsëritje të konfrontimit të armatosur”.⁴¹ Raporti Brahimi nga viti 2000 ka definuar ndërtimin e paqes si “aktivitete të ndërmarra përtej konfliktit për të rivendosur themelet e paqes dhe për të siguruar mjetet për të ndërtuar në ato themele diçka që është më shumë se vetëm mungesa e luftës”.⁴² Në ushtrimin e aktiviteteve të tyre të ndërtimit të paqes, çështja kryesore me të cilën përballen misionet ndërkombëtare për ndërtimin e paqes - dhe demokracitë e dala nga konflikti - është se si duhet marrë më së miri me trashëgiminë e dhimbshme të dhunës së kaluar, dhe në të njëjtën kohë si duhet ruajtur paqen e brishtë, jo vetëm brenda territorit, por edhe në rajon, dhe në disa raste edhe si të bëhet ndërtimi institucional dhe shtetëror në një shoqëri post-konfliktuale. Ndërsa në nivelin vendorë, dilemat kryesore që ngrihen kanë të bëjnë me atë se: a duhet dhënë përparësi sjelljes së autorëve të shkeljeve të të drejtave të njeriut para drejtësisë, duke luftuar kulturën e pa ndëshkueshmërisë që ka karakterizuar shumë konflikte civile?, apo është më e rëndësishme të fillohet duke u fokusuar në pajtimin e palëve që ishin në konflikt?, ose nëse ndërmarrjen e masave të dizajnuara për të siguruar se paqja dhe stabiliteti, dhe bashkë me to edhe perspektivat për rimëkëmbjen afatgjatë të vendit, janë përforcuar?

Të dyja, praktika dhe doktrina, kanë treguar se megjithatë, kanë një seri të dobësive kronike në përpjekjet ndërkombëtare për paqe, për të kapërcyer të kaluarën përmes proceseve të drejtësisë tranzicionale, dhe për të nisur aktivitetet që do të sjellin pajtimin. Disa prej këtyre dobësive janë kompleksiteti i tranzicioneve pas konfliktit, mospërputhja në mes të pritjeve për shërim të shpejtë dhe proceseve që historikisht kanë zgjatë në mënyrë të konsiderueshme, dhe çështje parësore e marrëdhënieve shtet-shoqëri, si dhe llojet e institucioneve shtetërore të nevojshme për të mbështetur paqen, dhe (mungesa e) njohurisë së aktorëve të jashtëm, mjeteve, burimeve, ose legjitimiteti për të kontribuar.⁴³ Ndërsa sfidat e brendshme institucionale me të cilat ballafaqohen operacionet e ndërtimit të paqes janë me rëndësi të madhe, por nuk janë megjithatë fokusi i këtij artikulli. Çfarë vijon është

⁴¹ Kofi Annan, “The Causes of Conflict and the Promotion of Durable Peace and Sustainable Development in Africa”, *Report of the Secretary-General to the Security Council*, S/1998/318 (13 April, 1998), para. 63

⁴² A/55/305-S/2000/809, para. 13.

⁴³ Charles T. Call and Elizabeth M. Cousens, “Ending Wars and Building Peace: International Responses to War-Torn Societies”. *International Studies Perspectives* (2008) 9, 1–21., gjendet në: <http://peacealliance.org/cms/assets/uploads/2013/05/Ending-Wars-Building-Peace.pdf>.

rishikimi i kritikës shkencore mbi supozimet ideologjike në ndërtimin e paqes ndërkombëtare dhe ndikimin e saj në qëllimet e drejtësisë tranzicionale.

2. Kritikat paralele për ndërtimin e paqes dhe drejtësinë tranzicionale nga aktorët ndërkombëtarë

Në kontekstin e post-konfliktit, proceset e drejtësisë tranzicionale dhe iniciativat ndërkombëtare për ndërtimin e paqes shpesh ndajnë të njëjtën hapësirë kohore dhe gjeografike.⁴⁴ Operacioneve të fundit ndërkombëtare të ndërtimit të paqes u është dhënë mandat për të trajtuar drejtësinë tranzicionale si dhe aktivitetet më të përgjithshme për ndërtimin e paqes.⁴⁵ Pavarësisht nga kjo, përpjekjet ndërkombëtare për ndërtimin e paqes dhe proceset lokale të drejtësisë tranzicionale jo gjithmonë janë parë si pjesë e së njëjtës ndërmarrje. Dijetarët dhe politikë-bërësit kanë shqyrtuar tensionet mes paqes ndërkombëtare dhe iniciativat për drejtësi, manifestuar në të ashtuquajturin debat "paqe kundrejt drejtësisë".⁴⁶ Përkrahësit e paqes argumentojnë se drejtësia do të jetë e mundshme vetëm nëse ka paqe, dhe drejtësia në vetvete mund të pengojë arritjen e paqes.⁴⁷ Pavarësisht nga kjo, mund të thuhet se paqja kundrejt debatit të drejtësisë për një farë mase është pajtuar me pragmatikët për të bërë paqen me anë të standardeve normative ligjore, kryesisht përmes zbatimit të standardeve të të drejtave të njeriut si

⁴⁴ Dustin N. Sharp, "Beyond the Post-Conflict Checklist: Linking Peacebuilding and Transitional Justice through the Lens of Critique" *Chicago Journal of International Law* Vol. 14 No. 1 (2013) Gjetet në: <http://chicagounbound.uchicago.edu/cjil/vol14/iss1/6>.

⁴⁵ Për shembull, Misioni i OKB-së në Kosovë (UNMIK), dhe Autoriteti i Përkohshëm i OKB-së në Timorin Lindor (UNTAET). Për një pasqyrë të përpjekjeve të OKB-së për të vendosur sundimin e ligjit dhe të ndërtimit të paqes pas konfliktit në Kosovë dhe Timorin Lindor, shih në përgjithësi: Richard Caplan, "International Intervention and Its Aftermath: Kosovo and East Timor." Në Ulrich Schneckler and Stefan Wolff (eds.) *Managing and Settling Ethnic Conflicts: Perspectives on Successes and Failures in Europe, Africa and Asia*. (Hurst & Company: London, 2004: 206; "Hansjörg Strohmeyer, Making Multilateral Interventions Work: the United Nations and the Creation of Transitional Justice Systems in Kosovo and East Timor" 25:2 *Fletcher Forum of World Affairs* W107 (2001).

⁴⁶ Shih në përgjithësi, Chandra Lekha Sriram, "Confronting Past Human Rights Violations: Justice vs Peace in Times of Transition" 1-2 (Frank Cass 2004) që shqyrton në detaje tensionet mes iniciativave për paqe dhe drejtësi.

⁴⁷ Christine Bell, Colm Campbell and Fionnuala Ni Aolain (2004), "Justice Discourses in Transition". *Social and Legal Studies* 13, 3, fq. 305-328. Shih poashtu Sriram, Chandra Lekha and Suren Pillay (eds.), *Peace versus Justice? The Dilemma of Transitional Justice in Africa*, Scottsville, South Africa (University of KwaZulu Natal Press: South Africa, 2009)

një përgjigje automatike ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut gjatë konfliktit. Programet tradicionale ndërkombëtare të ndërtimit të paqes, megjithatë kanë qenë subjekt i fuqishëm i kritikave paralele: se ato janë shumë shpesh të shtyra nga jashtë,⁴⁸ të planifikuara dhe zbatuara në mënyrën nga lart-poshtë dhe shtet-centrike që i jep zë të pamjaftueshëm më të prekurve nga konflikti,⁴⁹ se ato janë paraqitur si zgjidhje teknokratike, neutrale dhe apolitike për çështje të kontestuara apo kontestuese;⁵⁰ dhe se ato në fund të fundit nuk pasqyrojnë nevojat lokale dhe realitetet, por një paradigmë dominuese “liberale ndërkombëtare të ndërtimit të paqes”.⁵¹ Sriram pretendon se fushat e drejtësisë transicionale dhe ndërtimit të paqes “ndajnë supozime të rëndësishme për marrëveshjet e preferuara institucionale, dhe një besim që të mirat tjera të rëndësishme - demokracia, tregjet e lira, “drejtësia” - në thelb mund të qëndrojnë dhe të krijojnë paqe”.⁵² Ky besim i ka rrënjët në doktrinën neoliberalë⁵³, e cila nxitë "hapjen e hapësirës politike, duke përfshirë përmirësimin në lidhje me kontestet, pjesëmarrjen dhe të drejtat e njeriut"⁵⁴. Teitel shton se "fenomeni kërkimit të drejtësisë është i lidhur ngushtë me formësimin e identitetit politik liberal".⁵⁵ Modeli liberal i ndërtimit të paqes propagandon promovimin e demokracisë, reformave ekonomike të bazuara në treg dhe një sërë institucionesh të tjera të lidhura me shtetet 'moderne' si një forcë shtytëse për ndërtimin e paqes së qëndrueshme.⁵⁶ Modeli i liberal i ndërtimit të paqes, si një vizion i veçantë që ndërtuesit ndërkombëtarë të paqes kanë shpallur se si shtetet duhet të

48 Wendy Lambourne, “Transitional Justice and Peacebuilding after Mass Violence”, *International Jnl of Transitional Justice* Volume 3, Issue 1, 28-48.

49 Oliver Richmond, “The Romanticisation of the Local Welfare, Culture, and Peacebuilding”. 44 *Intl Spectator: ItalJ Intl Aff* 149, 161-63. Shih po ashtu, Roger Mac Ginty, “Indigenous Peace-Making versus the Liberal Peace, Cooperation and Conflict” 43 *Jornal of the Nordic Intl Studies Assn* 139, 144 (2008).

50 Dustin N. Sharp, “Addressing Dilemmas of the Global and the Local in Transitional Justice” *Emmory International Law Review*. Gjendet në: <http://law.emory.edu/eilr/content/volume-29/issue-1/articles/dilemmas-global-local-transitional-justice.html>

51 Newman, Edward, Roland Paris and Oliver P. Richmond, “Introduction”. Në Newman, Edward, Roland Paris and Oliver P. Richmond (eds.), *New Perspectives on Liberal Peacebuilding* (United Nations University Press: Tokyo, New York, paris: 2009).

52 Chandra Lekha Sriram, “Transitional Justice and the Liberal Peace” . Në E. Newman, R. Paris & O. Richmond (eds.), *New Perspectives on Liberal Peacemaking* (UN University Press: New York, 2009)120.

53 Thania Paffenholtz, *Civil Society and Peacebuilding: A Critical Assessment*(Lynne Rienner Publishers: London, 2010) 43.

54 Anna K. Jarstad and Timothy D. Sisk (eds.) *From War to Democracy: The Dilemmas of Peacebuilding*, Cambridge: Cambridge University Press : Cambridge, 2008) 17.

55 Tietel “*Transitional Justice*” f225.

56 Newman, Edward, Roland Paris and Oliver P. Richmond “Introduction” f 3-26.

organizohen së brendshmi - bazuar në parimet e demokracisë liberale dhe tregut të orientuar të ekonomisë - kërkon për të stabilizuar vendet që kanë përjetuar kohët e fundit luftëra civile. Në kritikën e tij Paris argumenton se ndërtimi i paqes nga aktorët ndërkombëtarë i ngjan një versioni të përditësuar (dhe më të mirë) të misionit 'civilisatrice', apo besimit në epokën koloniale se fuqitë perandorake evropiane kishin për detyrë t'i "civilizonin" popullsitë dhe territoret e varura.⁵⁷ Pavarësisht nga kjo, Paris dhe autorë të tjerë pohojnë se ky lloj i globalizimit nuk është domosdoshmërisht i padëshirueshëm – në të vërtetë, ndërtuesit e paqes duhet të vazhdojnë për të promovuar parimet e demokracisë liberale të tregut në shtetet e shkatërruara nga lufta.⁵⁸ Megjithatë, në praktikë është e diskutueshme metoda e përdorur për zbatimin e parimeve të demokracisë liberale të tregut në shtetet e shkatërruara nga lufta, duke pasur parasysh ndryshimet e prioritetëve të popujve pas përvojave traumatike, humbjet e njerëzve, personat e humbur dhe shkatërrimin ekonomik, disa nga çështjet që rezultojnë nga konflikti.

Të gjitha këto çështje që mbasin në shoqëritë pas konfliktit, krijojnë tensione që mund të shpërthejnë veçmas fill pas konfliktit⁵⁹ dhe të ndërpresin përpjekjet ndërkombëtare të ndërtuesve të paqes në zbatimin e parimeve të demokracisë liberale.⁶⁰ Një kritikë tjetër është e lidhur me qëndrimin normativ të doktrinës së drejtësisë transicionale, e cila ka ndikuar shumë në zhvillimin e literaturës në këtë fushë.⁶¹ Duke u fokusuar për një kohë të gjatë në (kryesisht) mekanizmat ligjorë për t'u marrë me një të kaluar të dhunshme, drejtësia transicionale ishte e dominuar nga dijetarët ligjorë që shqyrtonin "çështje doktrinare" me referencë në të drejtën ndërkombëtare penale, të drejtat e njeriut, të drejtën humanitare dhe sfidat e brendshme për

⁵⁷ Roland Paris, "International Peacebuilding and the 'Mission Civilisatrice'", 28 *Rev Intl Studies* 637 (2002).

⁵⁸ Roland Paris, "Peacebuilding and the Limits of Liberal Internationalism", *International Security*, 22:2 (Fall 1997), 54–89.

⁵⁹ Sharp "Beyond the Post-Conflict Checklist: Linking Peacebuilding and Transitional Justice through the Lens of Critique" f 186-191.

⁶⁰ Një nga rastet më famëkeqe janë trazirat etnike në të gjithë Kosovën, ndërsa nën administrimin territorial të UNMIK-ut më 17 mars dhe 18 mars 2004, ku nëntëmbëdhjetë vetë u vranë (11 shqiptarë të Kosovës, tetë serbë të Kosovës), më shumë se 900 persona u plagosën (duke përfshirë 65 policë ndërkombëtarë dhe 58 oficerë të Shërbimit Policor të Kosovës). Për më shumë shih: Organization for Security and Co-operation in Europe, Human Rights Challenges Folloëing the March Riots, 25 maj 2004, Gjendet në: <http://www.osce.org/kosovo/32379?doenload=true>.

⁶¹ Colleen Duggan, "Editorial Note". *International Journal of Transitional Justice*, 4 (2010) 315- 328.

amnistinë".⁶² Trashëgimia e këtij bashkëpunimi ndërshtetëror dhe kriminalizimi i keqbërës shtetërore, bazuar në standardet universale të drejtave të njeriut, përbën bazën e ligjit modern të drejtave të njeriut dhe një themel juridik të normës aktuale të drejtësisë transicionale.⁶³ Normativa dominuese në optikën e të drejtave të njeriut (për të lehtësuar transicionin në demokraci) ka përcaktuar se cili lloj i masave të drejtësisë është konsideruar i duhur dhe pse disa masa ishin të njohura si iniciativat e drejtësisë legjitime gjatë kohës së ndryshimit politik.⁶⁴ Si të tilla, ndërmarrjet nga aktorët ndërkombëtarë të bazuara në të drejtat e njeriut, të manifestuara në formën e gjykatave ndërkombëtare dhe hibride, janë quajtur "projekte globale".⁶⁵ Literatura e drejtësisë transicionale, siç përcaktohet nga qasja perëndimore legaliste për drejtësinë përmes "projektit globale", ndikon në aftësinë e fushës për të llogaritur për mekanizmat vendas dhe zakonor të drejtësisë që nuk përkrahin këtë këndvështrim legalist.⁶⁶ Proceset dhe mekanizmat e drejtësisë transicionale, sikur ndërtimi i paqes liberale, mund të destabilizojnë vendet pas konfliktit pas mizorive, sepse "thirrjet për drejtësi janë të mundshme për të gjeneruar tensione dhe përkeqësuar konflikte që kanë potencial për të minuar ndërtimin e paqes."⁶⁷ Shtytja ndërkombëtare për të bërë drejtësi, ose "juridicizimi i marrëdhënieve ndërkombëtare,"⁶⁸ ka shtyrë komunitetin ndërkombëtar për t'iu përgjigjur thirrjes për përgjegjshmëri me ngritjen e institucioneve të rëndësishme ligjore ndërkombëtare, dhe, modele të tjera hibride lokale, por janë kritikuar për mos përfshirjen në një sërë aktiviteteve lokale që nuk janë direkt të lidhura me vet drejtësinë.⁶⁹

⁶² Christine Bell, "Transitional Justice, Interdisciplinarity and the State of the 'Field' or 'NonField'". *International Journal of Transitional Justice*, 3 (1) (2009) 5-27.

⁶³ Teitel, "Transitional Justice Genealogy", 69-94.

⁶⁴ Arthur Paige, "How "Transitions" Reshaped Human Rights: A Conceptual History of Transitional Justice". *Human Rights Quarterly*, 31 (2009) 321-367.

⁶⁵ Nagy, "Transitional Justice as Global Project: Critical Reflections" f. 275.

⁶⁶ Stephanie Vielle, "Transitional Justice: A Colonizing Field?" *Amsterdam Law Forum* [S.I.], v. 4, n. 3. 58-68, Sep. 2012. ISSN 1876-8156(duke argumentuar se literatura e drejtësisë transicionale është përcaktuar nga qasja perëndimore, legalise për drejtësinë, e cila ndikon në aftësinë e fushës për të llogaritur për mekanizmat vendor dhe zakonor të drejtësisë që nuk e mbështesin këtë këndvështrim legalist). Gjendet në: <<http://amsterdamlawforum.org/article/view/283>> .

⁶⁷ Chandra Lekha Sriram, Olga Martin-Ortega, and Johanna Herman, "Promoting the Rule of Law: From Liberal to Institutional Peacebuilding". Në Chandra Lekha Sriram, Olga Martin-Ortega, and Johanna Herman (eds), *Peacebuilding and the Rule of Law in Africa: Just Peace?* 1, 1-2 (Taylor & Francis: Vendi i botimit, 2010)

⁶⁸ Nagy, "Transitional Justice as Global Project: Critical Reflections" f.275.

⁶⁹ Barbara Oomen, "Donor-Driven Justice and Its Discontents: The Case of Rwanda". *Development and Change* 2005-5. 893.

Për më shumë, ndërtimi ndërkombëtar i paqes dhe ndikimi në proceset e drejtësisë transicionale janë kritikuar për një mungesë të ekuilibrit të përshtatshëm midis "vendorëve" dhe "ndërkombëtarëve" në aspektin e agjencisë, të dhënave, dhe autoritetit mbi planifikimin dhe programimin e pas konfliktit.⁷⁰ Thomson dhe Nagy deklarojnë se në fushën e drejtësisë transicionale vetëm kohët e fundit ka filluar t'i kushtohet vëmendje "mekanizmave tradicionalë, më të lokalizuar, si një korigjues për të metat e qasjeve të ndërkombëtarizuara "një masë u përshtatet të gjithëve".⁷¹ Shqetësimet për goditjen e ekuilibrit të drejtë midis aktorëve vendorë dhe ndërkombëtarë marrin një numër të formave retorike, dhe përfshijnë merakun që agjendat post-konfliktit janë "të drejtuar nga jashtë," se janë planifikuar dhe zbatuar nga "lart-poshtë", ose ndryshe dështojnë për të dhënë mjaftueshëm për aktorët lokal në lidhje me çështjet kryesore dhe zgjidhjet.⁷² Për më shumë, qasjet perëndimore lidhur me ndërmarrjet e drejtësisë transicionale janë duke i dhënë shumë pak vëmendje praktikave lokale për të promovuar paqen, drejtësinë dhe pajtimin. Argumenti se strukturat ndërkombëtare të ndërtimit të paqes në formën e misioneve paqeruajtëse janë paraqitur si zgjidhje teknokratike, neutrale dhe apolitike për çështjet politike shumë të kontestuara apo të kontestueshme.⁷³

Me fjalë të tjera, në procesin e vendosjes për modalitetet e formave më të mira të qeverisjes dhe pyetjet që lindin nga dëshira për drejtësi kanë të bëjnë me atë se: drejtësi për kë, për çka dhe për çfarë qëllimesh?, që zakonisht janë zgjedhje dhe vendime mjaftë politike që kanë pasoja të rëndësishme për shpërndarjen e pushtetit politik, ekonomik, social, dhe kulturor në transicion pas konfliktit.⁷⁴ Arthur pretendon se përmbajtja konceptuale e drejtësisë transicionale është formësuar direkt nga një grup i ndërveprimeve midis aktivistëve të të drejtave të njeriut, juristëve dhe studiuesve ligjorë,

⁷⁰ Simon Chesterman, "Ownership in Theory and in Practice: Transfer of Authority in UN State Building Operations". 1 *Journal of Intervention and Statebuilding* 3 (2007). Shih gjithashtu: Timothy Donais, "Empowerment or Imposition? Dilemmas of Local Ownership in Post-Conflict Peacebuilding Processes". 34 *Peace & Change* 3 (2009).

⁷¹ Susan Thomson & Rosemary Nagy, "Law, Power and Justice: What Legalism Fails to Address in the Functioning of Rwanda's Gacaca Courts". *The International Journal of Transitional Justice* 2011-5.

⁷² Sharp "Beyond the Post-Conflict Checklist: Linking Peacebuilding and Transitional Justice through the Lens of Critique" f,169.

⁷³ Ibid.

⁷⁴ Ole Sending, "Why Peacebuilders Fail to Secure Ownership and Be Sensitive to Context" 8 *Security in Practice, NUPI Working Paper* 2009, 755.

politikëbërësve, donatorëve dhe ekspertëve të politikës krahasuese.⁷⁵ Ata kryesisht i kuptuan transicionet nga konfliktet në aspektin e reformave politike, në vend të transformimit shoqëror, dhe kështu proceset e drejtësisë transicionale u interpretuan si zhvillime kryesisht në nivel ligjor-institucional të politikës dhe subjekt të logjikës së menaxhimit të projektit. Për shembull, në kontekstin e Irlandës së Veriut, Bell dhe të tjerët argumentojnë se reformat mund të jenë të mundshme vetëm kur ato janë "të shkruara me një gjuhë menaxheriale, me theks në "profesionalizëm", "efikasitet" dhe "modernizim".⁷⁶ Duke planifikuar, zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar, drejtësia transicionale është racionalizuar.⁷⁷ Si të tilla, proceset e drejtësisë transicionale janë artikuluar në log-korniza me aktivitete dhe rezultate të cilat supozohet se çojnë në rezultate të pritshme dhe ndikime që mund të vlerësohen. Duke krahasuar zhvillimin dhe drejtësinë transicionale, Colvin argumenton se të dyja janë të theksuara nga logjika se me planifikim të kujdesshëm dhe teknikë të duhur, qëllimet e tyre mund të realizohen në mënyrë efektive dhe efikase.⁷⁸ Duke u bazuar në manualët e praktikave më të mira që janë zhvilluar nga ekspertët, drejtësia transicionale është elaboruar dhe vendosur në projekte. Megjithatë, këto manuale përshkruajnë një vend teknokrat, mjetet dhe qasjet e të cilave për drejtësinë transicionale karakterizohen nga një përqendrim i fuqishëm në legalizëm, me pak ose aspak vëmendje në nevojat shoqërore dhe kontekstin lokal.

Pas shqyrtimit të disa prej kritikave të dijetarëve të ndërtimit ndërkombëtar të paqes dhe ndikimit të saj në proceset e transicionit, tani dua të vlerësoj ndikimin e kësaj kritike në formësimin e konceptit të pajtimit si qëllim përfundimtar i proceseve të drejtësisë transicionale.⁷⁹ Duke u nisur nga përcaktimi i gjerë i pajtimit, si një ndërmarrje për të "gjetur një mënyrë për të balancuar çështje të tilla si e vërteta dhe drejtësia, në mënyrë që ndryshimi i ngadalshëm i sjelljeve, qëndrimeve dhe emocioneve mes ish armiqve të

⁷⁵ Ibid.

⁷⁶ Bell, Campbell and Ni Aolain "Justice Discourses in Transition" f 305-328.

⁷⁷ Goetschel, Laurent and Tobias Hagmann, "Civilian Peacebuilding: Peace by Bureaucratic Means?" *Conflict, Security and Development* 9 (2009). 55-73.

⁷⁸ Colvin, Christopher J., "Purity and Planning: Shared Logics of Transitional Justice and Development" *International Journal of Transitional Justice* 2 (2008). 412-425.

⁷⁹ Skaar, Elin (2013) "Reconciliation in a Transitional Justice Perspective". *Transitional Justice Review* Vol. 1 Issue 1 (2013), Article 10. DOI: <http://dx.doi.org/10.5206/tjr.2012.1.1.4>. Gjendet në: <http://ir.lib.uwo.ca/tjreview/vol1/iss1/10>

mund të ndodhë"⁸⁰, është e vlefshme për të argumentuar se pajtimi ka nevojë për orkestrim të proceseve nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart.⁸¹ Edhe pse procesi mund të fillojë ose me udhëheqësit ose në bazë, për të qenë efektiv duhet të vazhdojë gjithmonë në dy dimensione në të njëjtën kohë.⁸² Shumica e autorëve pajtohen se pajtimi përshkruan një proces, më shumë se një gjendje të përfundimtare ose rezultat, që synon ndërtimin e marrëdhënieve midis individëve, grupeve dhe shoqërive. Pastaj është i diskutueshëm pozicioni i misioneve paqeruajtëse ndërkombëtare për të filluar procesin e pajtimit, duke pasur parasysh kritikën e mësipërme për mungesën e ndërveprimit me vendasit dhe zbatimin në stilin teknokratik dhe menaxhimin bazuar në projekte të aktiviteteve të ndërtimit të paqes. Ekziston supozimi i përhapur se projektet e drejtësisë tranzicionale nga aktorët ndërkombëtarë do të pranohen si legjitime dhe mjete neutrale, pasi që udhëhiqen bazuar në normat dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të bazuara në universalitetin e tyre. Megjithatë, kur është fjala për pajtimin është i diskutueshëm universaliteti i tij, pasi që këtu ne flasim në nivel individual dhe për më tepër praktika e ka dëshmuar se niveli kombëtar i pajtimit është vështirë që të jetë i imunizuar nga betejat për pushtet dhe instrumentalizim politik. Në veçanti kritika ndaj qasjes teknokrate, menaxhimit proceseve të drejtësisë tranzicionale në dhe pajtimit në forme të projekteve teknike, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pajtimin si qëllim përfundimtar. Sigurisht është e dëshirueshme nga perspektiva e aktorëve ndërkombëtarë që projektet e drejtësisë tranzicionale të zbatohen dhe monitorohen në logjikën e bazuar në projekt, në procesin e pajtimit elementi njerëzor është shprehur thjesht në emocionet e njeriut dhe në këtë çështje shumë të ndjeshme dhe personale individuale, nuk mund të reflektohen në një projekt (të drejtësisë tranzicionale). Ndërsa projektet e drejtësisë në formë të gjykatave ndërkombëtare dhe hibride në një farë mase mund të menaxhohen, kurse pajtimi nuk mundet. Pajtimi shpesh i referohet kompromiseve politike për të stabilizuar regjimet e reja, nuk është megjithatë një mjet me vlerë neutrale, por është më tepër një proces politik që përfshinë individët dhe shoqërinë si tërësi. Pajtimi shoqërorë mbi të gjitha bëhet për të siguruar që gjeneratat e

⁸⁰ Karen Brounéus, "Reconciliation and Development Dialogue Globalization". *Friedrich-Ebert-Stiftung, OCCASIONAL PAPERS BERLINN* 36 / nëntor 2007/. Gjetet në: <http://library.fes.de/pdf-files/iez/04999.pdf>

⁸¹ Bar-On, Dan, "Reconciliation Revisited for More Conceptual and Empirical Clarity". Janja Bec-Neumann (ed.). *Darkness at Noon. War Crimes, Genocide and Memories* (Centre for Interdisciplinary Postgraduate Studies: Sarajevo, 2007). 62-84.

⁸² Bar-Tal, Daniel, "Nature, Rationale, and Effectiveness of Education for Coexistence". *Journal of Social Issues* 60, 2 (2004). 253-271.

reja të mos bartin barrën e historisë së krimeve të dikurshme dhe të mos bartin ndjenjën e viktimizimit historik.

Sigurisht, zbatimi i qasjes "një masë për të gjithë" ka mungesë të lidhjes sociale, historike dhe kulturore të njerëzve të cilët janë të prekur kryesisht nga transicioni. Besimi i gabuar se ajo që ka funksionuar në disa vende të zhvilluara dhe të industrializuara, do të funksionojë në vende të tjera, është i diskutueshëm kur kemi të bëjmë me pajtimin. Si rezultat i kësaj, pronësia vendore e këtyre proceseve dhe angazhimi në rindërtimin e një shoqërie të drejtë nuk është gjithmonë optimal. Kjo është shqetësuese, sepse është e njohur se duke injoruar nevojat lokale dhe duke dështuar për t'u angazhuar aktorët lokalë, ka të ngjarë të dëmtohet ancorimi i një paqe të qëndrueshme.⁸³ Aktorët lokalë dhe komunitetet duhet të përfshihen në hartimin dhe zbatimin e përpjekjeve transicionale për procesin, në programe të caktuara të pajtimit. Rikrijimi i dialogut mes palëve, me anë të programeve të udhëhequra në nivel lokal, shpesh është mënyra më e mirë për të kapërcyer dallimet dhe për të rivendosur besimin.

Përfundim

Padyshim drejtësia transicionale, si një fushë e re e studimeve, është vetë në transicion.⁸⁴ Edhe pse drejtësia transicionale dhe ndërtimi i paqes pas konfliktit nëpërmjet ndihmës së aktorëve ndërkombëtarë kanë vazhduar historikisht në rrugë të veçanta, edhe pse ka pasur një ngjashmëri të shquar prapë kritikën dhe shqetësimet e doktrinave janë ngritur ndaj ndërlidhjes së konceptit të paqeruajtjes me aktivitetet e drejtësisë tranzicionale. Ajo që së pari duhet të pranohet është se çdo shoqëri në transicion është unike, edhe pse përmban ngjashmëri të shumta me shoqëritë e tjera pas konfliktit, kritika aktuale shkencore ven vëmendjen se mënyra për t'iu qasur krimeve të kaluara nga ana e aktorëve ndërkombëtarë gjatë ndërtimit të paqes duhet të dizajnohet në mënyrë specifike për secilin vend. Ka pasur një tendencë në operacionet ndërkombëtare paqeruajtëse për të barazuar konceptin 'tradicional' me 'fer', 'mirë' dhe 'paanshëm', veçanërisht në situatat kur ndërhyrësit ndërkombëtarë janë të ndjeshëm ndaj shkeljeve mbi kulturën dhe zakonet e vendit të misionit. Akuzat e imperializmit kulturor dhe zbatimi i vlerave perëndimore në misione të tilla janë përhapur për vite dhe, në disa raste, këto kritika kanë qenë të vlefshme, veçanërisht në proceset e pajtimit.

⁸³ Vieille, "Transitional Justice: A Colonizing Field?" *Amsterdam Law Forum*, f 59-68.

⁸⁴ Bell, Campbell and Ní Aoláin, 'Justice Discourses in Transition', f 305.

Prandaj, duhet të kihet kujdes në mënyrë që gjatë një përgatitjes së një operacioni të paqes, në kërkim të mbështetjes dhe mbrojtjes së normave dhe vlerave kulturore të vendit të misionit, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të mos lihen anash ose të zhduken.

Nuk duhet të ketë një qasje "një masë u përshtatet të gjithëve" për drejtësinë tranzicionale. Bashkësia ndërkombëtare, duke i siguruar qeveritë e brishta të reja me mbështetje të rëndësishme financiare, institucionale dhe normative për të marrë parasysh të kaluarën, duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje nevojave të viktimave, dhe të vendosë themelet për demokracinë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit. Roli i bashkësisë ndërkombëtare duhet të vlerësohet dhe të përcaktohet kryesisht nga njerëzit drejtpërdrejt të përfshirë në proceset e pajtimit në vendet e tyre.

Megjithatë, pajtimi nuk mund të sigurohet vetëm nga mekanizmat tranzicional, ai merr më shumë kohë dhe përpjekje se sa që mund të arrijë çdo gjykim me kohë të kufizuar, komision për të vërtetën apo proces tradicional. Mekanizmat kalimtarë shpesh të iniciuar nga aktoret ndërkombëtare janë hapa drejt pajtimit, jo arritje e saj. Megjithatë, ka disa faktorë që mund të përmirësojnë mekanizmat e drejtësisë tranzicionale dhe me këtë edhe të rriten shanset e stabilitetit, sigurisë dhe paqes së qëndrueshme.

Prof. Ass. Remzije Istrefi

Notion of the Transitional Justice and Reconciliation from a Standpoint of International Peace Building

Summary

In this paper we discussed the issue of transitional justice, its place and role in peace building of shattered and war torn societies. Some lessons from the past have been outlined, with a reservation that there is no general approach to the problem of transitional justice. It depends on several factors.

Charges of cultural imperialism have occasionally hindered the process of national reconciliation. Impartiality and objectivity are not enough to overcome the difficulties on the ground. More is needed for transitional justice to be seen as a meaningful instrument of peace and prosperity for societies that have reemerged from war and conflict.

Transitional justice and its mechanisms serve as a bridge to another phase in the peace building as they themselves are transitional and meant to be such. This means that reconciliation, mediation, truth commissions and other mechanisms of these types of justice are themselves meant to be temporary and serve the sole purpose of overcoming the dramatic situations that war and conflict usually leave behind.

Other factors, such as culture, the type of conflict and its duration also play a role in choosing proper mechanisms of transitional justice. These aspects as well have been discussed in this paper, arriving at a conclusion that there cannot be a readymade solution covering all situations emerging out of war and violence.

Prof. ass. Dr. Rrustem QEHAJA*

Rregullimi ligjor i hipotekës në Kosovë¹

1. Hyrje

Qarkullimi i mallrave dhe ofrimi i shërbimeve në mes të subjekteve të së drejtës përfshirë personat fizik dhe personat juridik nuk mund të paramendohet pa krijimin e marrëdhënieve kontraktuese në mes tyre.

Shpeshherë marrëdhëniet kontraktuese shoqërohen me rreziqe të caktuara dhe nga kontrata “kryesore” siguria juridike në mes të palëve duket të jetë e “*brishtë*”. Me qëllim të rritjes së sigurisë juridike në qarkullimin juridik palët kontraktuese krahas lidhjes së kontratës kryesore jo rrallë herë lidhin edhe kontrata “*dytësore*” të cilat i shërbejnë rritjes së sigurisë juridike të kontratave “*parësore*”.

Në këtë drejtim rol të rëndësishëm luan instituti i pengut dhe hipotekës të cilët i shërbejnë rritjes së sigurisë juridike të palëve kontraktuese që zakonisht paraqiten me emërtimet kreditor dhe debitor.

Instituti i hipotekës përveç sigurisë juridike ndikon në palët kontraktuese që ato të rrisin shkallën e vetëdijesimit dhe të përgjegjësisë juridike që buron nga marrëdhënia e caktuar kontraktuese si dhe në disiplinimin e qarkullimit juridik të mallrave dhe ofrimin e shërbimeve dhe përfundimisht në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në përgjithësi.

Aktualisht krahas institucioneve financiare bankare të cilat praktikojnë kontratën e hipotekës me qëllim të sigurimit të kërkesave të kreditorëve hipotekues ndaj debitorëve hipotekues, kohëve të fundit gjithnjë e më shumë kjo formë e sigurimit të kërkesave përmes hipotekës po vjen në shprehje

* Autori është mësimsdhënës në Fakultetin Juridik të Universiteti të Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë.

¹ Një pjesë e këtij punimi në vija të përgjithësuar është prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare : “Legjislacioni Proneor dhe reforma e tij në Kosovë” organizuar nga Instituti Gjyqësor i Kosoves (IGJK) në bashkëpunim me GTZ, në Prishtinë më 28-29 qershor 2010.

edhe në industrinë e sigurimeve përkatësisht në marrëdhëniet sigurues – i siguruar kur janë në pyetje ofrimi i shërbimeve të sigurimit të garancive produkte këto që sigruerit ofrojnë krahas licencimit të tyre nga BQK-ja të cilat në kushte më të favorshme i ofrojnë kompanitë e sigurimeve përfshirë edhe kushtet më të volitshme në krahasim me bankat komerciale të cilat veprojnë në Kosovë. Pasi që objekt i trajtimit të këtij punimi është instituti i hipotekës në vazhdim do të përqendrohemi në trajtimin e institutit të hipotekës dhe zhvillimit të saj.

2. Kuptimi i hipotekës

Lidhur me kuptimin e hipotekës nga autor të ndryshëm janë dhënë përkufizime të ndryshme. Kështu, hipoteka është e drejtë sendore dhe atë në sendin e huaj, se siguron një pretendim, se është e drejtë aksesore e kushtëzuar nga qenia ose mosqenia e pretendimit, është e papjesëtueshme dhe konsiston në sendet e paluajtshme.²

Hipoteka është e drejtë sendore në një send individualisht të përcaktuar dhe të paluajtshëm. Hipoteka është e drejtë sendore dhe mendohet se fjala hipotekë rrjedhë nga dy fjalë greke me domethënie “*nën*” dhe “*lënë*”, pra që nënkupton barrësim, ngarkim të sendit të paluajtshëm. Supozohet se kjo shprehje e marrë nga greket është futur te romakët në Shek. II e. r..

Në mbështetje të këtij përkufizimi përmbajtjesor të hipotekës ajo u zhvillua nën “*ombrellën*” e marrjes ose lënies së sendit peng pa bartjen e posedimit në pengmarrës dhe me këtë u formua koncepti se hipoteka si e drejtë, institut u bartë në të drejtën romake. Mirëpo, nga burimet historike del se vetëm në Shek XVII pengu dhe hipoteka morën kuptimin që kanë sot se “*pignusi*” konsiston vetëm në sendet e luajtshme dhe “*hipoteka*” konsiston vetëm në sendet e paluajtshme.

Lidhshmëria e ngushtë që ekziston në mes të pengut dhe hipotekës vërehet edhe në atë se hipoteka kudo si institut juridik lindi dhe u zhvillua në kuadër të pengut në të njëjtin sistem dhe vetëm në një shkallë të caktuar ndahet, zhvillohet e veçohet. Hipoteka ka rrjedhur nga pengu dhe është si institut juridik i mëvonshëm.

². Ejup Statovci “E drejta e pengut” Aspekte komparative Prishtinë, 2009, fq. 234.

Në kuptimin modern theksohet se fjala hipotekë ka prejardhje nga gjuha angleze “*mortgage*” që do të thotë “*mort*” e vdekur dhe “*gage*” pengu që ka kuptimin se pronësia e lënë në hipotekë është e vdekur.

“Hipoteka është një kontratë midis kreditorit dhe debitorit në bazë të së cilës një send i paluajtshëm lihet peng për të siguruar një pretendim të kreditorit”. Kreditori hipotekues e fiton të drejtën e hipotekës në sendin pengor. E drejta e hipotekës është e drejtë sendore mbi sendin e paluajtshëm dhe fitohet me regjistrimin në librat publik, është e drejtë absolute dhe vepron ndaj të gjithëve – *erga omnes*.

E drejta e hipotekës është e drejtë sendore e kreditorit pengmarrës e vënë në një send të paluajtshëm të debitorit pengdhënës i cili e mban posedimin, për të siguruar pretendimin e vetë me të arritur (skaduar), nga vlera e sendit, pa marrë parasysh se në dorë të kujt ndodhet ai.³

Ligji për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore i Republikës së Kosovës, në vazhdim LPDTS, institutin e hipotekës e përkufizon në këtë mënyrë: “Hipoteka do të thotë krijimi i interesit në pasurinë e paluajtshme me anë të marrëveshjes apo ligjit, që kreditorit të hipotekës (pengmbajtësit) i jep të drejtën të inicioj procedurën për heqjen e të drejtës mbi pronën e vënë në hipotekë për pasurinë e tillë të paluajtshme, me qëllim të përmbushjes së një detyrimi që është i siguruar me hipotekë dhe që duhet paguar”.⁴

3. Korniza ligjore

Vështruar institutin e hipotekës në retrospektiv të largët rezulton se edhe te ne shqiptarët instituti i hipotekës ka qenë i njohur dhe i rregulluar me norma të ndryshme qoftë ato morale apo doke, zakone e deri te ligjet më bashkëkohore.

Në dobi të këtij mendimi fletë edhe e dhëna se edhe e drejta zakonore shqiptare e vjetër të drejtën e pengut e parasheh në Kanunin e Lekë Dukagjinit, në vazhdim KLD dhe atë në këtë mënyrë: “*Për me shëndosh punën e huas e për me largue çdo dyshim pabesie për hua të dhanun mund të merret peng*”.⁵

³ E. Statovci vep. e cit. fq. 237.

⁴ LPDTS neni 172.

⁵ Kanuni i Lekë Dukagjinit, KLD paragrafi 501, Prishtinë.

Nëse bëjmë një hap prapa në shekullin e kaluar lidhur me kornizën ligjore të rregullimit të institutit të hipotekës patjetër duhet të ndalemi në vitet 80 të Shekullit të kaluar përkatësisht të përmendim Ligjin për marrëdhëniet themelore pronësore juridike bazë, në vazhdim LMTHPJB,⁶ i cili hipotekën e rregullon kështu: “Me qëllim që të sigurohen kërkesat e caktuara, sendi i paluajtshëm mund të ngarkohet me të drejtën e pengut në dobi të kreditorit (hipoteka), i cili është i autorizuar në mënyrën e parashikuar me ligj që të kërkoj arkëtimin e kërkesës së vet nga vlera e kësaj pasurie të paluajtshme para kreditorëve, të cilët mbi të nuk kanë hipotekë, si dhe para kreditorëve të cilët hipotekën mbi të e kanë fituar pas tij, pa marrë parasysh ndërrimin e pronarit të pasurisë së paluajtshme të ngarkuar.”

Fundi i shekullit të kaluar dhe fillimi i këtij shekulli në të cilin po jetojmë veçanërisht në Republikën e Kosovës në sferën e legjislacionit në përgjithësi përfshirë edhe atë të materies civile në veçanti dallon për faktin se nga data 10.06.1999, është vendosur Administrimi Ndërkombëtar Civil i njohur me emrin UNMIK i cili mision kishte të gjitha kompetencat në të tre pushtetet shtetërore përfshi edhe atë të nxjerrjes së ligjeve të njohura me emërtimin Rregulloret e UNMIK-ut në fushat e ndryshme. Shih për këtë kur është fjala për institutin e hipotekës dhe çështjeve të lidhura me të nuk u anashkalua nga UNMIK-u as kjo materie në drejtim të nxjerrjes së Rregulloreve të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi lidheshin me institutin e hipotekës. Me këtë rast vlen të përmendet Rregullorja për pengun dhe pasuritë e luajtshme.⁷ Rregullorja për shpalljen e Ligjit mbi hipotekat të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.⁸ Rregullorja për shpalljen e Ligjit mbi themelimin e një regjistri për të drejtat e pronës në paluajtshmëri.⁹

Së fundi pas shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës dritën e tij e pa edhe Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore (LPDTS) i shpallur me Dekretin nr. DL-016-2009 të datës 15.07.2009, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, i cili ka hyr në fuqi me datë 20.08.2009.

Jo rastësisht bëjmë një ri-kapitullim të kornizës ligjore në bazë të cilave rregullohen marrëdhëniet pronësore juridike në Republikën e Kosovës

⁶ Ligji mbi marrëdhëniet themelore pronësore juridike bazë, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr.6/1980.

⁷ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/5 për pengun në pasurinë e luajtshme.

⁸ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/21 për shpalljen e ligjit mbi hipotekat të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

⁹ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/5 për shpalljen e ligjit për themelimin e një regjistri për të drejtat e pronës së paluajtshme.

veçanërisht instituti i hipotekës për faktin se krahas ligjeve të cilat i nxjerr Kuvendi i Republikës së Kosovës si pushtet legjislativ, edhe më tutje prezenca e misionit ndërkombëtar përkatësisht UNMIK-ut ndonëse “*i brishtë*” bënë që Rregulloret e UNMIK-ut me fuqi të ligjit ende të janë të zbatuara. Prandaj, në rast të rregullimit ndryshe të një instituti juridik me ligj dhe me Rregullore të UNMIK-ut- dilemat nuk do të janë të vogla se cilën duhet zbatuar!

Kur është në pyetje instituti i hipotekës kjo çështje është theksuar në LPDTS në kuadër të dispozitave përfundimtare ku theksohet: “Për hipotekat, të cilat sipas Ligjit 2002/21 të datës 20.12.2002 janë të vlefshme, zbatohen edhe më tutje dispozitat e këtij Ligji, nëse nuk është parapare ndryshe me këtë ligj. Për hipotekat, të cilat para hyrjes në fuqi të këtij ligjit duhet të jenë në përputhshmëri me kushtet e aplikueshme të regjistrimit të themeluara me këtë ligj”.¹⁰

4. Krijimi i hipotekës

Në përgjithësi në teorinë juridike shumë autor janë të prirë që kur shkruajnë - trajtojnë ndarjen e hipotekës dhe atë sidomos për mënyrën e themelimit apo krijimit të saj të shqyrtojnë aspektin tredimensional përfshirë:

1. Hipotekën e kontraktuar (në bazë të punës juridike)
2. Hipotekën ligjore dhe
3. Hipotekën gjyqësore.¹¹

Bazuar në atë se objektivi ynë është i fokusuar në trajtimin e institutit të hipotekës nga këndvështrimi i LPDTS në vazhdim do të fokusohemi në këtë drejtim. Krijimi i institutit të hipotekës është i rregulluar me nenet 173-183 të LPDTS. Ashtu siç është parashikuar me nenin 173 të këtij ligji, hipoteka krijohet përmes një kontratë ndërmjet pronarit të paluajtshmërisë së ngarkuar dhe kreditorit hipotekues si dhe përmes regjistrimit në Regjistrin e të drejtave për paluajtshmëritë. Nga kjo dispozitë buron se për krijimin e hipotekës është e nevojshme nënshkrimi i kontratës në mes të pronarit të paluajtshmërisë d.m.th. debitorit hipotekues dhe kreditorit hipotekues si dhe kontrata e tillë

¹⁰ LPDTS Neni 294.1.2.

¹¹ Abdulla Aliu “E drejta sendore (pronësia)” Prishtinë 2004, fq.226-229, Francesco Galgano “E drejta private” Tiranë 1999 fq. 391.

nuk do të kishte efekte të duhura juridike nëse nuk do të regjistroj në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri.

Në praktikë jo rrallë mund të ndodhë që një pronar i një paluajtshmërie në cilësi të debitorit hipotekues të lidh dy e më shumë kontrata me kreditor hipotekues të ndryshëm në intervale të ndryshme kohore me qëllim të përfitimeve materiale dhe në rast kontesti do të merret parasysh se cili nga kreditorët hipotekues i pari ka bërë regjistrimin në Regjistrin e të drejtave të paluajtshmerive që paraqet titull më të fortë juridik në krahasim me kontratën.

Prandaj, themelimi i regjistrit të drejtave të paluajtshmerive konform nenit 173 paraqet një subjekt të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të kreditorëve. Në këtë Regjistër regjistrohen të gjitha hipotekat ekzistuese si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve në raport me ato hipoteka. Regjistri gjithashtu shërben si mjet në bazë të së cilit kreditorët e ardhshëm mund të konstatojnë nëse një pronë është e ngarkuar me hipotekë ose jo.

Në nenin 174 të LPDTS rregullohet çështja e përmbajtjes së kontratës ku theksohet se:

- duhet të jetë me shkrim,
- nënshkrimi i palëve ose personave të tretë dhe vërtetimi i tyre në gjykatë (tani te noteri) me të gjitha të dhënat themelore për palët kontraktuese ose përfaqësuesit e tyre,
- përshkrimin e saktë të paluajtshmërisë së ngarkuar sipas certifikatës për të drejtat e paluajtshmërisë përfshirë numrin e ngastrës, sipërfaqen etj.
- të dhënat tjera të sakta rreth pozitës dhe numrit kadastral,
- një fletë poseduese dhe vërtetimet rreth përdorimit të paluajtshmërisë etj.¹²

Këto janë dispozitat themelore që duhet të përmbaj një kontratë e hipotekës pa përjashtuar edhe rastet kur e njëjta mund të pasurohet edhe me dispozita të tjera të dobishme të vlerësuar paraprakisht nga palët kontraktuese. Në praktikë nuk përjashtohen edhe rastet kur një kontratë mund të konsiderohet nule dhe atë LPDTS në nenin 175 e titullon si marrëveshje nule dhe atë nëse arrihet para skadimit të afatit të përmbushjes së kërkesës së siguruar dhe kreditorit ia lejon të drejtën e shfrytëzimit të paluajtshmërisë. Nule është edhe një marrëveshje, përmes se cilës pronari i paluajtshmërisë detyrohet kundrejt kreditorit hipotekues që paluajtshmerinë mos ta shes apo të mos e

¹² Për më shumë shih Nein 174 të LPDTS.

ngarkoje më tej. Përmbajtja e kontratës së hipotekës duhet të jetë përmbajtjesore dhe e kuptueshme për palët kontraktuese me qëllim të evitimit të mosmarrëveshjeve në të ardhmen. Lidhur me këtë në të gjitha rastet është me rëndësi të definohet lënda apo objekti i kontratës përkatësisht cilat sende janë përfshirë në kontratën e hipotekës.

Hipoteka përfshinë edhe të gjitha pjesët tjera dhe frutat natyrore të paluajtshmërisë, përderisa këto nuk janë të ndara nga sendi kryesor, përfshirë sendet aksesore të cilat ndajnë fatin me sendet kryesore. Pra, hipoteka përfshin të gjitha pjesët e paluajtshmërisë, duke përfshirë ndërtesat të cilat janë të lidhura në mënyrë të pandashme me tokën.

Në praktikë jo rrallë mund të ndodhë që gjendja faktike dhe juridike e përshkruar në Certifikatën mbi të drejtën e pronësisë të jetë e ndryshme për shkak të ndërtimeve ilegale në tokat me destinim bujqësor! Nëse paluajtshmëria e hipotekuar është dhënë me qira, hipoteka gjithashtu përfshin të ardhurat e qirasë së pronarit që d.m.th. se pagesa e qirasë është pjesë e hipotekës dhe konsiderohet e ngarkuar nga kontrata e hipotekës. Kjo d.m.th. se nëse pronari nuk paguan borxhin me kohë, kreditori ka të drejtë të marrë pagesën e qirasë nga paluajtshmëria e dhënë me qira. Nëse bëhet fjalë për paluajtshmerinë në pronësi të përbashkët ku pjesët alikuote nuk janë të definuara njëri nga pronarët nuk mund të hipotekoj pjesën e tij të paluajtshmërisë pa pëlqimin e pronarëve të tjerë konform nenit 179 të LPDTS.

Në rastet kur paluajtshmëria e një debitori hipotekues nuk mjafton për sigurimin e kërkesave të kreditorit hipotekues, debitori përkatës mund të lenë në hipotekë disa paluajtshmëri të njëjtit pronar ose pronarëve të ndryshëm të ashtuquajtur hipotekë e përbashkët.

Një hipotekë është e vlefshme dhe e zbatueshme vetëm nëse kredia ose detyrimi i cili do të sigurohet nga hipoteka është i vlefshëm dhe i zbatueshëm. Kjo d.m.th. se kredia e cila pranohet nga debitori (huamarrësi) duhet të jetë e vlefshëm dhe e zbatueshme, që rrjedhimisht d.m.th. se hipoteka e llojit grabitës ose ndaj fajdexhinjve nuk janë të vlefshme.¹³ Përveç kësaj hipoteka siguron tërë shumën e detyrimit, duke përfshirë kapitalin dhe kamatën e papaguar, dënimet kontraktuese, shpenzimet e zbatimit, të mirëmbajtjes dhe shitjes së objektit të hipotekuar.

¹³ Neni 181 i LPDTS.

Në fund të kësaj për hipotekën duhet të vendoset një shumë specifike fikse. Hipoteka mund të kuptohet si siguri për një shumë të caktuar fikse (hipoteka e shumës maksimale). Hipoteka e shumës maksimale mund të sigurojë një kërkesë të veçantë apo të gjitha kërkesat nga një marrëdhënie juridike e caktuar. Kamatat dhe shpenzimet e kërkesës së siguruar ose kërkesat mund të parashtrihen vetëm brenda shumës maksimale.¹⁴

5. Efektet e hipotekës

Bazuar në dispozitat e LPDTS efektet e hipotekës mund të përmbliken në të drejtat dhe detyrimet e pronarit të paluajtshmërisë së ngarkuar dhe shuarjen e hipotekës.

Sipas nenit 183 të këtij ligji pronari i paluajtshmërisë së ngarkuar:

- Përkujdeset, mirëmban dhe ruan vlerën e paluajtshmërisë së hipotekuar (duke përfshirë ndërtesat dhe sendet aksesore).
- Me kërkesë të kreditorit, pronari siguron paluajtshmërinë e hipotekuar.
- I lejon kreditorit inspektimin e paluajtshmërisë me paralajmërim paraprak të arsyeshëm.

Duke pasur parasysh se me kalimin e kohës vlera e paluajtshmërisë mund të amortizohet kreditorit hipotekues i njihet e drejta që nga debitori hipotekues të kërkojë një siguri plotësuese ose atij t'i caktoj një afat të arsyeshëm për t'i mënjeluar të metat.

Nëse huamarrësi hipotekues dështon që të ofroj sigurinë shtesë të kërkuar, atëherë kreditorit mund të kërkojë përmbushjen e hipotekës (mund të kërkojë pagimin e menjëhershëm të kredisë së siguruar). E njëjta vlen edhe për sendet aksesore.

Në rastet kur prona është duke u zhvlerësuar-amortizuar dhe pronari është duke dështuar që të parandalojë këtë, kreditorit mund të padisë për përmbajtje nga sjelljet e këtilla dhe gjykata mund të urdhëroj vendosjen e masave për parandalimin e rrezikut të zhvlerësimit.¹⁵

Pronarit të paluajtshmërisë i takojnë të gjitha të drejtat në lidhje me kundërshtimet kundër kreditorit hipotekues, të cilat i takojnë debitorit për shkak të kërkesës së siguruar ndaj kreditorit.

¹⁴ Neni 182 i LPDTS.

¹⁵ Neni 185 i LPDTS.

Nga përmbajtja e nenit 188 të LPDTS rezulton se hipoteka e siguron kërkesën (kredinë) e siguar deri në shlyerjen e saj të plotë. Kjo d.m.th. se një pagesë e pjesëme nuk ndikon në hipotekë. Pagesa e fundit e hipotekës është elementi i cili në fakt i përmbyll detyrimet e pronarit ndaj hipotekës.

Gjithashtu, në rast të ndarjes së paluajtshmërisë, krijohet një hipoteke e përbashkët e cila i ngarkon paluajtshmëritë e hipotekuara të krijuara nga ndarja.

Efektet e hipotekës shuhen me përmbushjen e detyrimeve të ndërsjella në mes të palëve në kontratën e hipotekës përkatësisht në mes të kreditorit dhe debitorit hipotekues. Kreditori hipotekues me kalimin e afatit nëse debitori hipotekues ka përmbushur detyrimet e tij me kërkesë duhet t'i drejtohet organit përkatës që ka bërë regjistrimin e hipotekës që të njëjtën të ç' regjistroj.

Nëse pronari i paluajtshmërisë së ngarkuar nuk ka vendqëndrim në Kosovë ose pronari denoncon hipotekën është në paqartësi rreth personit, gjykata mund të caktojë një përfaqësues të cilit mund t'i dërgohet njoftimi.

Pronari i paluajtshmërisë së hipotekuar ka të drejtë që të përmbush detyrimin ndaj kreditorit, nëse afati për përmbushje të kërkesës ka arritur ose nëse debitori personalisht ka të drejtën për prestim.

Gjithashtu ligjdhënësi ka rregulluar edhe çështjen e bartjes së kërkesës e cila nuk mund të parashtrohet në dëm të kreditorit.

Ashtu siç regjistrohet hipoteka e njëjta me përmbushjen e detyrimeve të debitorit kreditues shuhet përmes shlyerjes së regjistrimit në Regjistrin për të drejtat në paluajtshmëritë.

Shuarja e hipotekës në mënyrë taksative është e rregulluar në nenin 193 të LPDTS..

6. Hipoteka në raport me personat e tretë

Në kapitullin e IV – të LPDTS trajtohet instituti i hipotekës në raport ndaj palëve të treta, përfshirë çështjen e vlefshmërisë së hipotekës, renditjes së hipotekave, bartjen e paluajtshmërisë së hipotekuar dhe bartjen e kërkesës së siguar.

Me qëllim që instituti i hipotekës të prodhoj efekte juridike nuk mjafton vetëm lidhja e kontratës, por edhe regjistrimi në Regjistrin për të drejtat në paluajtshmëritë. Procedura dhe efektet e regjistrimit janë përshkruar në

Ligjin për themelimin e regjistrimit për të drejtat e pronësisë së paluajtshme (regjistri për të drejtat e pronës së paluajtshme). Një paluajtshmeri mund të jetë e ngarkuar me disa hipoteka me ç'rast krijohen rendet duke marrë parasysh faktorin kohë të themelimit përkatësisht regjistrimit të hipotekës.

Ligdhënësi ka dhënë edhe mundësin e ndryshimit të renditjes (prioritetit) me ç'rast për një gjë të tillë është e nevojshme një marrëveshje në mes të titullarëve të drejtave të cilat preken nga ndryshimi i përparësisë dhe regjistrimi i ndryshimit në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë. Kështu, nëse një hipotekë duhet të radhitet më poshtë në renditjen e të drejtave, atëherë përveç regjistrimit, është i nevojshëm edhe pëlqimi i pronarit të paluajtshmërisë. Pëlqimi i tij është i përvokueshëm. Me fjalë të tjera kjo d.m.th. se nëse dy kreditorët hipotekues pajtohen që të ndryshojnë radhitjen (prioritetin) e të drejtave të tyre, ata duhet të marrin edhe pëlqimin e pronarit të paluajtshmërisë. Në qoftë se e drejta e radhitur më poshtë në renditjen e të drejtave është e ngarkuar me të drejtën e një personi të tretë, atëherë është i nevojshëm edhe pëlqimi i tij. Të drejtat tjera të cilat janë renditur në mes të drejtave të ndryshuara në renditjen, mbesin të pacenuara nga ndryshimi i përparësisë.

Bartja te instituti i hipotekës mund të vështrohet në dy drejtime, në drejtim të bartjes së paluajtshmërisë së ngarkuar dhe në bartjen e kërkesës së siguruar. Pas regjistrimit të hipotekës mund të ndodhë që pronari i paluajtshmërisë dëshiron të bartë atë paluajtshmeri përmes shitjes ose lënies në trashëgim. Prandaj, është rregull e përgjithshme që me rastin e bartjes së të drejtës së pronësisë e njëjta kalon te pronari i ri me ngarkesat përkatëse. Kjo d.m.th. se hipoteka është e vlefshme edhe ndaj personit i cili ka blerë ose fiton paluajtshmërinë e hipotekuar.¹⁶ E njëjta vlen edhe për bartjen e kërkesës së siguruar. Në praktikë ndodhë që kredimarrësi t'i shet kredit ndonjë kredimarrësi tjetër me çmim më të lirë me qëllim të realizimit të interesave të caktuara afariste. Kreditori i cili pranon (blen) kredinë e siguruar duhet të regjistroj atë në regjistrin e të drejtave për pronën e paluajtshme. Në fakt, bartja e hipotekës nuk është e vlefshme derisa të regjistrohet në regjistrin e të drejtave për pronën e paluajtshme. Nëse pronari i paluajtshmerisë vdes dhe paluajtshmeria e hipotekuar u bartet disa trashëgimtarëve krijohet një hipotekë e përbashkët sipas nenit 192 të LPDTS.

7. Ekzekutimi i hipotekës

¹⁶ Neni 196 i LPDTS.

Bazuar në parimin e përgjithshëm të së drejtës kontraktuese “*Pacta sunt servanda*”¹⁷ se marrëveshja është ligj për palët dhe ajo duhet respektuar, në shikim të parë fitohet bindja se nuk ka vend për dyshim në ekzekutim - përmburim të hipotekës pasi që kontrata detyron palët në përmburjen e detyrimeve të ndërsjella.

Por, pikërisht mospërmburja e kontratës në mes të palëve bënë që të vjen në shprehje ekzekutimi apo përmburimi i hipotekës për shkak se debitori nuk është në gjendje të paguaj kredinë dhe kreditori detyrohet që të propozoj përmburimin e të drejtës së tij sipas kontratës së hipotekës që përben një nga dokumentet e përmburimit.

Këto çështje janë të rregulluara në Kapitullin e V të LPDTS nga neni 198-217 përfshirë njoftimin, autorizimin e shitjes, shitjen përmes ankandit etj. Parakusht themelor që të vjen deri te ekzekutimi - përmburimi i hipotekës është shkelja e kontratës nga ana e debitorit i cili veprim apo mosveprim i hap rrugën e kërkesës së menjëhershme të kreditorit për ekzekutimin e hipotekës.

Një shkelje e kontratës nga debitori i kërkesës së siguruar ekziston nëse debitori gjendet në vonesë me pagesë me çka i hap rrugën kreditorit që përmes rrugës gjyqësore¹⁸, tani përmes përmburuesit privat të realizoj kërkesën e tij nga shitja e sendit të lënë në hipotekë. Me këtë rast kur kreditori vendos të ekzekutoj hipotekën, ai duhet t’i njoftojë për këtë fakt të gjithë personat që kanë të drejtat pronësore në paluajtshmërinë e hipotekuar.¹⁹

Krahas ekzekutimit gjyqësor tani përmes përmburuesit privat, ligdhënësi ka paraparë edhe ekzekutimin e hipotekës në mënyrë jashtëgjyqësore madje duke i dhënë përparësi kësaj të fundit kur është në pyetje hipoteka afariste. Për ekzistimin e hipotekës afariste kërkohet decidivisht plotësimi i kushteve në vijim:

- pronari i paluajtshmërisë duhet të jetë një tregtar ose një shoqëri tregtare²⁰

¹⁷ Nerxhivane Dauti “E drejta e detyrimeve (Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë) Prishtinë 2004, fq. 60.

¹⁸ Shih Kreun XIV të Ligjit për procedurën përmburimore nr. 03/L-008 dt.02.06.2008 i shpallur me dekretin nr. DL-042-2008, dt. 24.06.2008.

¹⁹ Nenet 199-200 të LPDTS

²⁰ Shih: Ligjin për Shoqëritë Tregtare nr. 02/L-123 dt.27.09.2007.

- kreditori hipotekues duhet të jetë një institut kreditor vendas dhe i regjistruar dhe
- mbi paluajtshmërinë e hipotekuar zhvillon aktivitetin një shoqëri tregtare.

Ndërprerja e aktivitetit afarist të subjektit pas hipotekimit nuk ndikon në ndryshimin e statusit të hipotekës. Me qëllim të ndërmarrjes së veprimit të shitjes së paluajtshmërisë së ngarkuar me hipotekë ligji në fjalë në nenin 202 parasheh autorizimin për shitje më të dhënat përkatëse në mënyrë që të jetë i vlefshëm. Krahas të dhënave që duhet të përmbaj autorizimi i shitjes në pajtim me dispozitat e këtij ligji palët mund të përcaktojnë kushte plotësuese ose sqarime me kusht që mos të jenë në kundërshtim me dispozitat imperative të këtij ligji. Ky autorizim përveç efekteve “*inter vivos*” prodhon efekte juridike edhe “*mortis causa*” dhe si i tillë autorizimi duhet të regjistrohet në Regjistrin për të drejtat në paluajtshmëritë.

Pas këtyre veprimeve plotësohen kushtet ligjore që autorizimi të ushtrohet duke pasur parasysh edhe:

- se është paraqitur rasti i mospërbushjes i paraparë me autorizim,
- është regjistruar njoftimi i mospërbushjes në Regjistrin përkatës
- është regjistruar një njoftim rreth shitjes së planifikuar në regjistër dhe në kadastrë.

Disa herë me radhë po përmendet shprehja “*njoftim*” e cila përben në vete një lloj kërkesë e cila duhet të përmbaj të dhënat konform nenit 206 të këtij ligji. Njoftimi i mospërbushjes regjistrohet në gjuhën e parashikuar me ligj dhe fillon me fjalët me shkrim të zmadhuara dhe të theksuara në fontin 14 si parasheh neni 206.2 i këtij ligji. Njoftimi duhet të regjistrohet në bazë të kërkesës së kreditorit hipotekues si në Regjistrin për të drejtat e paluajtshmërisë ashtu edhe në Zyrën e kadastrës kompetent për atë vend. Njoftimi në fjalë duhet dërguar disa personave përfshirë: pronarin e paluajtshmërisë, debitorin e kërkesës së siguruar, nëse ky nuk është pronar i paluajtshmërisë, agentit për shitjen e paluajtshmërisë, çdo personi tjetër i cili është i regjistruar si titullar i një të drejtë sendore në paluajtshmërinë e ngarkuar, si dhe çdo personi i cili kërkon një kopje të tillë brenda afatit 7 ditë nga dita e regjistrimit të njoftimit gjegjës.

Pronari ka 5 ditë afat për përmirësimin e përmbushjes që zakonisht rezulton me përpjekjet e debitorit për të marrë një hipotekë tjetër me qëllim të përmbushjes së hipotekës ekzistuese. Pas kalimit të këtij afati, kreditori e

njofton agjentin për fillimin e procedurës së shitjes së paluajtshmërisë. Më së voni 10 ditë pas regjistrimit të njoftimit për shitjen e paluajtshmërisë, kreditori hipotekues dhe agjenti i shitjes së paluajtshmërisë ua dërgon kopjet e njoftimit të gjithë personave konform nenit 207 të këtij ligji.

Pastaj agjenti i shitjes publikon 3 javë të njëpasnjëshme së paku një herë në javë njofton për shitjen e paluajtshmërisë në gazeta dhe revista me më shumë se 5.000 kopje të cilat publikohen në Kosovë dhe në vendet ku shtrihet paluajtshmëria që shitet. Njoftimi i parë duhet të publikohet më së voni 21 ditë para kohës së caktuar për shitje.

Më së voni 14 ditë para datës së shitjes, agjenti për shitje kumton njoftimin për shitje përmes shpalljes në tabela publike për shpallje në zyrën kompetente të vendit ku duhet të shitet paluajtshmëria. Kreditori hipotekues gjatë gjithë kohës mban kontakte të vazhdueshme me agjentin e shitjes dhe mund të jap udhëzimet e caktuara të cilat ky i fundit është i obliguar t'i respektoj sidomos ato që kanë të bëjnë me shtyrjen e shitjes. Shitja e paluajtshmërisë së hipotekuar mund të shtyhet deri në dy herë pa pasur nevojë të ri-shpallet njoftimi konform nenit 211 të LPDTS. Nëse vjen deri te shitja e paluajtshmërisë ajo duhet të shitet sipas dispozitave të këtij ligji (neni 212) dhe çdo dispozitë tjetër në kontratën e hipotekës është e pavlefshme.

Nëse arrihet deri te shitja e cila bëhet përmes ankandit publik, atëherë pas përfundimit të saj e drejta e pronësisë në pronën e paluajtshme i bartet blerësit. Kjo bartje bëhet e vlefshme me regjistrimin në Regjistrin e të drejtave për paluajtshmëritë konform këtij ligji.²¹

Hapi i fundit për realizimin e të drejtës të kreditorit është shpërndarja e të ardhurave nga shitja në pajtim me ligjin. Pas shitjes së paluajtshmërisë së hipotekuar dhe bartjes së pronësisë te blerësi, të ardhurat e realizuara nga shitja duhet të shpërndahen personave përkatës sipas renditjes të parashikuar në nenin 215 të këtij ligji.

Me qëllim që debitori hipotekues të gëzoj mbrojtje juridike ligjdhënësi ka paraparë mjetet juridike në dispozicion të pronarit të paluajtshmërisë. Para përfundimit të shpërndarjes, pronari mund të kërkojë nga gjykata ndërprerjen e shitjes së pronës së tij kërkesë kjo e cila duhet të paraqitet brenda 30 ditëve pas lidhjes së kontratës së shitjes në pajtim me nenin 213 të këtij ligji.

²¹ Neni 214 i LPDTS.

Gjykata merr vendim, nëse konstaton se mospërmbushja e pronarit të paluajtshmërisë, e cila për ligj ushtrimin e të drejtës për shitjen jashtëgjyqësore të paluajtshmërisë së ngarkuar në të vërtetë ekziston, ose agjenti për shitjen e paluajtshmërisë së ngarkuar, procedurat për ofertën e shitjes vetë i ka zhvilluar duke shkelur dispozitat e këtij ligji ose dispozitat e tjera imperative. Gjykata vendos rreth kërkesës në një procedurë të shpejtuar. Instituti kreditor i cili shkel dispozitat e kësaj pjese të ligjit për të fituar përfitime të paligjshme i nënshtrohet masave disiplinore të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) dhe masave tjera të cilat mund t'i vendos gjykata.

Krahas gjithë kësaj që u trajtua më lartë ligjdhënësi ka rregulluar edhe të drejtat dhe detyrat e agjentit të shitjes të rregulluara me nenin 217 të LPDTS.

8. Përfundim

Përprojekjet e vazhdueshme të shoqërisë sonë kosovare për kalimin nga ekonomia e centralizuar në ekonomin e tregut ka sjellë dilema të shumta financiare në vendin tonë, përfshirë edhe zbatimin e procedurave lidhur me regjistrimin e hipotekave.

Ndryshimet e ndodhura në sistemin politik dhe juridik të vendit në periudhën e pas luftës në Kosovë si pasojë e dilemave në besueshmërinë dhe sigurinë juridike të akteve përmes të cilave argumentohet e drejta e pronësisë ka sjellë një varg dilemash veçanërisht në anën e hipotekmarrësve.

Me nxjerrën e ligjeve përkatëse të kësaj fushe bankat komerciale dhe institucionet e tjera financiare kanë rritur shkallën e interesimit për sigurimin e kërkesave të tyre përkatësisht kredive.

Me qëllim të zbatimit adekuat të ligjeve përkatëse të kësaj fushe është e domosdoshme të bëhet edhe ndryshim - plotësimet përkatëse veçanërisht:

- Ndryshimin e statusit të poseduesit të drejtës së pronësisë në pronar;
- Licencimin e agjencioneve për vlerësimin e paluajtshmerive;
- Krijimin a databazës elektronike për qasje në të dhënat për titullarët e të drejtës së pronësisë;
- Licencimin e përmbauesve privat përkitazi me përmbarimin e të drejtës së dalë nga hipoteka dhe

- Ndryshim - plotësimet në rregullativën ligjore të autoritetit mbikëqyrës të institucioneve financiare përkatësisht Bankës Qendrore të Kosovës.

Në fund, jo rastësisht këtë punim po e përmbledhim në mënyrën më të vështirë të mundshme, me një fjali të vetme “*Plus cautions in re est quam in persona*”.

Prof. Ass. Dr. Rrustem QEHAJA

Legal regulation of mortgage in Kosovo

Summary

Continuous efforts of our Kosovan society towards transfer from centralized economy to market economy have been associated with lots of dilemmas in our country, including implementation of procedures in relation to mortgage registry.

The changes in political and legal system of the country that occurred in Kosovo after the conflict (war) as a consequence of doubts in credibility and legal certainty of acts through which is proven ownership right, have produced a number of interpretations, especially in relation to mortgage lenders.

With passing of relevant laws in this field, commercial banks and other financial institutions have raised awareness for securing their claims respectively their loans.

With the aim of proper implementation of the relevant laws in this field, it is our opinion that it is necessary to make the relevant changes - amendments, especially in:

- Change of status from possession of the right of ownership to owner;
- Licensing of agencies for immovable property evaluation (assessment);
- Creation of electronic database to enable notaries access to records concerning holders of ownership rights;
- Licensing of private enforcement agents in relation to enforcement of the right from mortgage;
- Changes – amendments in legal framework of supervising authority of financial institutions respectively Central Bank of Kosovo.

Finally, we are deliberately summarizing this paper in the most difficult way, with one sentence “*Plus cautions in re est quam in persona*”.

Dr. Enkelejda Turkeshi*

Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale: vështrim krahasues mbi legjislacionin penal mjedisor në Shqipëri dhe Kosovë

1. Hyrje

Mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi ka qenë objekt i iniciativave të rëndësishme legjislative në Shqipëri në fillimin e viteve '90, në kushtet kur zhvillimi ekonomik dhe shoqëror do të duhej të respektonte parimin e rëndësishëm të zhvillimit të qëndrueshëm, si një ndër parimet e njohura ndërkombëtarisht në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Vështirësitë në hartimin e një legjislacioni mjedisor sa më të plotë dhe modern nuk kanë qenë të pakta, duke patur parasysh natyrën komplekse dhe dinamike të së drejtës së mjedisit¹. Një faktor i rëndësishëm nxitës në drejtim të plotësimit dhe pasurimit të kuadrit ligjor ka qenë procesi i përafrimit të legjislacionit kombëtar me *acquis* mjedisor të Bashkimit Evropian (në vijim: BE), në të cilin mbrojtja e mjedisit është konsideruar si një ndër objektivat esenciale të Komunitetit². Në këtë kontekst, ndryshime të rëndësishme janë shfaqur edhe në fushën e mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet legjislacionit penal, si një ndër burimet e të drejtës së mjedisit. Me hartimin e Kodit Penal të ri të vitit 1995, ligjvënësi solli disa risi në këtë drejtim.

Ndërkohë, duke filluar veçanërisht nga fundi i viteve '90 janë ndërmarrë disa iniciativa të rëndësishme në nivel evropian dhe ndërkombëtar, të cilat kanë theksuar domosdoshmërinë e harmonizimit të legjislacioneve penale kombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit lidhur me disa shkelje të rënda të legjislacionit mjedisor që ishin kthyer në një kërcënim serioz për mjedisin, me synimin kryesor për të siguruar një

* *Departamenti i të Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri, E-mail: enkelejda.turkeshi@fdut.edu.al*

¹ Në mënyrë të pashmangshme, e drejta e mjedisit është po aq komplekse dhe dinamike sa edhe ekosistemi që synon të mbrojë (R.J.Lazarus, *The Making of Environmental Law*, The University of Chicago Press, 2004, f.6).

² Shih paragrafin 41 të vendimit të Gjykatës së Drejtësisë të BE-së, të datës 13 Shtator 2005, për çështjen C-176/03, *Komisioni kundër Këshillit*.

mbrojtje më efektive të mjedisit. Duke u mbështetur edhe në Konventën e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale (1998),³ BE ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim nëpërmjet miratimit të të ashtuquajturave Direktiva të Krimit Mjedor,⁴ të cilat i detyrojnë Shtetet Anëtare që të parashikojnë dënime penale⁵ në legjislacionin e tyre kombëtar për disa shkelje të rënda të dispozitave të legjislacionit komunitar mbi mbrojtjen e mjedisit, të tilla si: shkarkimi, çlirimi apo futja e kundërligjshme e materialeve ose rrezatimit të jonizuar në ajër, tokë ose ujë; menaxhimi i kundërligjshëm i mbetjeve; operimi i kundërligjshëm i një fabrike ku kryhet një veprimtari e rrezikshme ose ruhen apo përdoren substanca ose përzjerje të rrezikshme; vrasja, shkatërrimi, mbajtja ose marrja e kundërligjshme e individëve të llojeve të faunës ose florës së egër të mbrojtur, etj.

Në këtë kontekst, e drejta penale mjedorore është jo vetëm një fushë relativisht e re, por edhe një fushë në zhvillim dhe drejt përafrimit, së paku përsa i përket formave të rënda të krimit mjedor të parashikuara në direktivat përkatëse të BE-së në të cilin synojmë të anëtarësohemi.

Në këtë punim do të analizohet legjislacioni penal mjedor i Republikës së Shqipërisë në këto 21 vite nga miratimi i Kodit Penal në fuqi, shoqëruar me një vështrim krahasues me legjislacionin penal mjedor të Republikës së Kosovës, me qëllim nxjerrjen në pah të arritjeve dhe sfidave me të cilat përballen të dy shtetet në rrugën e përbashkët të harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me atë të BE-së në këtë fushë relativisht të re dhe në zhvillim.

2. Zhvillimi i të drejtës së mjedisit pas ndryshimit të sistemeve dhe legjislacioni penal si një ndër burimet e saj.

Me ndryshimin e sistemeve në fillimin e viteve 1990, legjislacioni mjedor në Shqipëri ka kaluar në një proces të rëndësishëm zhvillimi të ndarë në dy etapa kryesore që përfshijnë periudhën 1993-2000 dhe periudhën 2001 e në

³ Konventa nuk ka hyrë ende në fuqi, pasi ndonëse është nënshkruar nga katërmëdhjetë Shtete Anëtare të Këshillit të Evropës, vetëm njëri prej tyre (Estonia) e ka ratifikuar atë në vitin 2002. Shih statusin e Konventës në faqen zyrtare të Zyrës së Traktateve të KE-së <<http://www.conventions.coe.int/>>.

⁴ Direktiva 2008/99/KE e 19 Nëntorit 2008 mbi mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale, si dhe Direktiva 2009/123/KE e 21 Tetorit 2009 mbi ndotjen e shkaktuar nga anijet dhe parashikimin e dënimeve për shkeljet.

⁵ Ky detyrim parashikohet vetëm për vepra penale të kryera nga personat fizikë, ndërsa për personat juridikë, Shtetet Anëtare mbeten të lira që të vendosin nëse veprat penale të kryera prej tyre do të jenë ose jo të dënueshme me një sanksion penal.

vijim.⁶ Gjatë etapës së parë është miratuar Plani i parë Kombëtar i Veprimit për Mjedisin, si dhe ligji i parë kuadër “Për mbrojtjen e mjedisit”⁷ i vitit 1993. Një moment shumë i rëndësishëm ka qenë edhe miratimi i Kushtetutës së re të vitit 1998. Ndërkohë, etapa e dytë lidhet me miratimin nga qeveria shqiptare të Planit Kombëtar të Veprimit për Mjedisin 2001 në kuadrin e procesit të integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian,⁸ në bazë të të cilit është krijuar edhe Ministria e Mjedisit.

Në këtë kontakt, aktualisht kuadri ligjor për mbrojtjen e mjedisit në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga një shumëllojshmëri aktesh juridike, si vijon: Kushtetuta;⁹ Ligji kuadër; Ligjet sektoriale; Aktet nënligjore (VKM, urdhëra, udhëzime etj); Kodi Penal; Marrëveshjet ndërkombëtare për mjedisin, në të cilat Republika e Shqipërisë është Shtet Palë.¹⁰

Sikurse edhe në etapën e parë të fillim viteve ‘90, ligjet që janë në fuqi në fushën e mbrojtjes së mjedisit nuk janë sistemuar në një kod të veçantë,¹¹ por përfshijnë një ligj kuadër “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe disa ligje sektoriale apo të posaçme që mbulojnë fusha të caktuara, si p.sh. ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve, ligji për biodiversitetin, ligji për pyjet, etj, të plotësuar më tej me aktet nënligjore përkatëse.

Ndryshime dhe plotësime të vazhdueshme janë bërë në këtë legjislacion, me synim plotësimin dhe përshtatjen e tij me zhvillimet e reja në fushën e mbrojtjes së mjedisit, veçanërisht në kuadrin e procesit të rëndësishëm të përafrimit me legjislacionin komunitar, si një kërkesë e domosdoshme e procesit të integritimit në BE. Këto ndryshime dhe plotësime

⁶ I.Petrela, *Tipare të përgjithshme dhe tendenca të së drejtës ndërkombëtare dhe asaj shqiptare për mjedisin*, Revista “Studime Juridike”, Nr.2/2009, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, f.139.

⁷ Ligji nr.7664, datë 21.01.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

⁸ I.Petrela, *Tipare të përgjithshme dhe tendenca të së drejtës ndërkombëtare dhe asaj shqiptare për mjedisin*, vep.e cit., f.139-140.

⁹ Parime të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së mjedisit janë sanksionuar edhe në nivelin më të lartë të hierarkisë së burimeve të së drejtës. Në Kushtetutën aktuale (ligji nr.8417/1998, i ndryshuar), pjesa mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut përmban edhe dy dispozita të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me mjedisin dhe mbrojtjen e tij (neni 56 dhe neni 59/1/d,dh).

¹⁰ Shih: I.Petrela, *Tipare të përgjithshme dhe tendenca të së drejtës ndërkombëtare dhe asaj shqiptare për mjedisin*, vep.e cit., f.135-140.

¹¹ Disa shtete i kanë grupuar ligjet më kryesore në fushën e mbrojtjes së mjedisit në një kod mjedisor. Shih për shembull, eksperiencën e Francës apo të Italisë.

janë bërë jo vetëm në ligjet specifike, por, për të tretën herë gjatë 23 viteve të fundit,¹² në vitin 2011 është rindërtuar sërish edhe ligji kuadër.¹³

Një burim tjetër i rëndësishëm i të drejtës së mjedisit është legjislacioni penal. Vlen të theksohet se legjislacioni penal shqiptar në mbrojtje të mjedisit është i përqendruar në Kodin Penal (në vijim: KP) dhe veprat penale kundër mjedisit nuk janë të shpërndara në ligje të ndryshme. Madje, për herë të parë, ligjvënësi i viteve '90 është përpjekur që t'i grupojë veprat penale kundër mjedisit në një kre të veçantë të pjesës së posaçme të KP, duke e vlerësuar mjedisin si një objekt grupor të veçantë.

Gjithashtu, pas miratimit të Kushtetutës së re (1998), në pjesën e përgjithshme të KP është shtuar një dispozitë e veçantë mbi detyrat e legjislacionit penal shqiptar, në të cilën mjedisi përmendet shprehimisht si një ndër të mirat juridike të rëndësishme që legjislacioni penal ka për detyrë të mbrojë nga veprat penale. Në këtë kontekst, edhe KP luan një rol të rëndësishëm në sistemin e të drejtës së mjedisit, i cili përfshin në këtë mënyrë të gjithë aspektet e sistemit ligjor duke filluar që nga Kushtetuta, ligjet, aktet nënligjore, si dhe të drejtën penale, për aq sa këto elementë zbatohen për qëllime që lidhen me mjedisin.¹⁴ Ndërkohë, në respektim të natyrës subsidiare të mbrojtjes juridike penale,¹⁵ legjislacioni penal duhet konsideruar nga shteti si “mjete i fundit shtrëngues”¹⁶. Sipas rekomandimit të Shoqatës Ndërkombëtare për të Drejtën Penale, ndonëse roli kryesor i takon disiplinave jopenale, si e drejta administrative ose civile, legjislacioni penal duhet që, së pari, të ndërhyjë për të siguruar efikasitetin e këtyre disiplinave jopenale. Në këtë rol, legjislacioni penal, nga njëra anë ka funksion aksesor, por nga ana tjetër, në rastet e sulmeve të rënda ndaj mjedisit është e nevojshme që ai të ndërhyjë në një rol të pavarur.¹⁷ Në këtë kontekst, ai

¹² Deri në miratimin e ligjit më të ri në vitin 2011 janë miratuar dy ligje kuadër, përkatësisht i pari në vitin 1993 dhe i dyti në vitin 2002 (ligji nr. 7664, datë 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit”, si dhe ligji nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”).

¹³ Ligji nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, i cili është përafëruar plotësisht me Direktivën e BE-së “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin” të ndryshuar.

¹⁴ T.F.P. Sullivan (Editor), *Environmental Law Handbook*, Government Institutes, Twentieth Edition, 2009, f.4.

¹⁵ Shih: V.Kambovski, *E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme*, Botim i dytë, Furkan ISM, Shkup, 2007, f.11; I. Salihu, *E drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme*, Leoprint, Prishtinë, 2005, f.29.

¹⁶ Në mbështetje të këtij parimi është shprehur edhe jurisprudenca kushtetuese. Shih për shembull vendimin nr.1, datë 12.01.2011 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

¹⁷ Shih Rezolutat e miratuara në Kongresin e XII-të, Seksioni II mbi mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale, Hamburg, Shtator 1979, në *Resolutions of the Congresses of the*

përfaqëson një pjesë të rëndësishme të legjislacionit me impakt domethënës në fushën e të drejtës së mjedisit.¹⁸

3. Risitë që ka sjellë Kodi Penal i ri në fushën e mbrojtjes juridike penale të mjedisit.

KP i ri i vitit 1995 është miratuar duke u mbështetur në ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese” të vitit 1991 dhe në kontekstin e ligjit të parë kuadër “Për mbrojtjen e mjedisit” të vitit 1993. Veprat penale kundër mjedisit janë parashikuar në kreun IV të pjesës së tij të posaçme (nenet 201-207), i cili është ndërtuar si një ndarje e dallueshme nga grupimi i veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Duke u nisur nga fakti se pjesa e posaçme ndahet në krerë në bazë të objektit grupor,¹⁹ grupimi i veprave penale kundër mjedisit në një kre të veçantë, jo vetëm që i shërben një klasifikimi më të mirë të veprave penale sipas objektit të përbashkët grupor, por njëkohësisht është tregues i një ndryshimi të rëndësishëm që konsiston në konceptimin e mjedisit si një objekt grupor i veçantë dhe i përbërësve të tij (ajri, uji, toka, bimët, kafshët) si objekte të drejtpërdrejta të veprave penale, të mbrojtura posaçërisht me normat penale të këtij kreu të veçantë.

Vlen të theksohet se grupimi i veprave penale kundër mjedisit në një kre të veçantë përfaqëson një risi të KP të ri në krahasim me KP të mëparshëm të vitit 1977, duke ndjekur modelin e KP të shteteve evropiane perëndimore, të cilat në atë periudhë kishin zgjedhur të reformonin legjislacionin e tyre penal përmes përqendrimit të veprave penale kryesore kundër mjedisit në KP dhe prezantimit të një kapitulli të veçantë në pjesën e tij të posaçme.²⁰

Gjithashtu, për sa i përket larmishmërisë së figurave të veprave penale, konstatohet se kodi i ri është pasuruar me figura të reja të veprave penale kundër mjedisit, sikurse është figura e krimit të transportimit të mbeturinave toksike (neni 202) apo figurat e veçanta “ndotëse”, përkatësisht, ndotja e ajrit (neni 201) dhe ndotja e ujërave (neni 203). Tashmë, vepra

AIDP/IAPL (1926-2004), Toulouse, 2009, f.99 në faqen e internetit <<http://www.penal.org/IMG/pdf/NEP21anglais.pdf>>

¹⁸ K. L. Schroeder, *Environmental Law*, West Legal Studies, Cengage Learning, 2007, f.10.

¹⁹ I.Elezi, S.Kaçupi, M.Haxhia, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (Pjesa e Përgjithshme)*, Ribotim, Botimet KUMI, Tiranë, 2012, f.106-107.

²⁰ Për shembull, në Gjermani, veprat penale më kryesore kundër mjedisit janë përqendruar në KP me reformën e vitit 1980 (shih I.Rusu, V.Negrut, M.Pocora, G.Goga, M.Balan-Rusu, *Legal liability in environmental law*, Acta Universitatis Danubius Juridica (AUDJ), Vol.VII, Nr.3, 2011, f.51, në faqen e internetit <www.journals.univ-danubius.ro>)

penale e “ndotjes së ambjentit”, e cila në KP të mëparshëm parashikohej si një kundërvajtje penale në fushën e shëndetësisë, jo vetëm që është zhvendosur në një grup të veçantë të veprave penale që kanë për objekt të mbrojtjes së tyre pikërisht mjedisin, si një e mirë juridike më vete, por njëkohësisht është ndarë në dy vepra të reja të veçanta.

Veprat e tjera penale të parashikuara në këtë kre lidhen me disa përbërës të veçantë të mjedisit që kanë qenë në vazhdimësi objekt i mbrojtjes juridike penale, sikurse janë peshkimi i ndaluar, prerja e paligjshme e pyjeve, prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë, si dhe shkelja e karantinës së bimëve dhe të kafshëve.²¹ Megjithatë, përveç disa ngjashmërive, KP i ri ka sjellë disa risi edhe për këto figura të njohura të veprave penale, të cilat vihen re veçanërisht në përmbajtjen e dispozitave përkatëse, por edhe në copëzimin në figura të veçanta apo bashkimin, sipas rastit, të figurave të ndryshme në një figurë të vetme të veprës penale.

Nga ana tjetër, konstatohet se në KP të ri nuk janë përfshirë disa figura të tjera konkrete, të tilla si gjuetia e paligjshme apo trajtimi i pakujdesshëm i gjësë së gjallë. Po kështu, në kontekstin e ndarjes në figura të veçanta të figurës së përbashkët të “ndotjes së ambjentit” të parashikuar në KP të mëparshëm, rezulton se KP i ri fokusohet vetëm në përbërësit ajër dhe ujë, duke mos përfshirë një figurë të veçantë për ndotjen e tokës.

Një dallim shumë i rëndësishëm me KP të mëparshëm dhe një risi e KP të ri, e cila është edhe një tregues i vlerësimit të ligjvënësit mbi shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe rëndësisë së objektit të mbrojtur posaçërisht me normat penale, konsiston në zgjedhjen e ligjvënësit në lidhje me klasifikimin e veprave të ndryshme kundër mjedisit si krime apo kundërvajtje penale. Në këtë drejtim, ndonëse në gjendjen fillestare, në vitin 1995, shumica e figurave të veprave penale të parashikuara në kreun IV të pjesës së posaçme janë cilësuar si kundërvajtje penale, vihet re se në të ka edhe figura të cilësuar si krime, sikurse janë figurat e veprave penale të ndotjes, të cilat janë parashikuar kryesisht si krime, me një përjashtim të vetëm tek figura e thjeshtë e ndotjes së ajrit, e cila përbën kundërvajtje penale. Gjithashtu, këto të fundit përbëjnë vepra penale, pavarësisht nëse kanë sjellë apo jo pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e njerëzve (vdekje apo dëmtime të rënda të shëndetit të një ose më shumë personave)²², në dallim nga KP i mëparshëm, në të cilin kërkohej domosdoshmërisht ardhja e pasojave të rënda në mënyrë që shkelja e rregullave përkatëse të formonte

²¹ Me disa ndryshime, këto vepra penale parashikoheshin në tre kodet penale të mëparshme (1928, 1952, 1977).

²² I. Elezi, *E drejta penale (Pjesa e Posaçme)*, ERIK Botime, 2008, f. 336-337.

vepër penale dhe jo kundërvajtje administrative. Këto pasoja, tashmë janë parashikuar si rrethanë cilësuese për figurat përkatëse të veprave penale.

Në këtë kontekst, KP i ri ka sjellë ndryshime të rëndësishme në krahasim me KP të mëparshëm edhe për sa i përket dënimeve të parashikuara në sanksionin e normave përkatëse, të cilat pasqyrojnë ndryshimet e lartpërmendura në cilësimin e veprave penale si krime apo kundërvajtje penale, krahas ndryshimeve të tjera që i kanë ndodhur sistemit të dënimeve në tërësi në pjesën e përgjithshme të KP të ri.

Gjithashtu, duke patur parasysh faktin se në kryerjen e veprave penale kundër mjedisit shpesh mund të përfshihen edhe persona juridikë,²³ një risi tjetër veçanërisht e rëndësishme e KP të ri lidhet me subjektin e veprës penale. Për herë të parë në legjislacionin penal shqiptar, në nenin 45 të këtij kodi janë parashikuar masat penale për personat juridikë.²⁴

4. Ndryshimet relevante në Kodin Penal në vitet 2001-2013 dhe sfidat e reformimit të nevojshëm në kuadrin e zhvillimeve të reja në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Risi të tjera janë shfaqur në KP përmes shtesave dhe ndryshimeve të mëvonshme, në të cilat konstatohen disa elementë të rëndësishëm që lidhen me mbrojtjen juridike penale të mjedisit.

Së pari, në vitin 2001, në pjesën e përgjithshme të KP është shtuar një dispozitë e re mbi detyrat e legjislacionit penal shqiptar,²⁵ në të cilën mjedisi

²³ Në përgjithësi, eksperiencia e shteteve që e kanë njohur prej kohësh përgjegjësinë penale të personave juridikë, ka treguar se çështjet penale në ngarkim të tyre, të cilat lidhen kryesisht me vepra penale të natyrës ekonomiko-financiare, shpesh përfshijnë edhe vepra penale kundër mjedisit. (*Business Crimes and Compliance, Criminal Liability of Companies Survey*, Lex Mundi Ltd. 2008, f.246, në faqen e internetit <<http://www.lexmundi.com>>) Madje edhe personat juridikë publikë janë shpesh të përfshirë në kryerjen e këtyre veprave penale. Kështu p.sh., sipas një studimi të kryer në Hollandë, veprat penale kundër mjedisit zënë vendin kryesor ndër veprat penale që kryhen pothuajse rregullisht nga personat juridikë publikë. (shih Michiels Commission 1998, f.139 në: R. Widdershoven, *Encroachment of Criminal law in Administrative law in the Netherlands*, në *Electronic Journal of Comparative Law*, Vol 6.4, December 2002, në faqen e internetit <<http://www.ejcl.org/64/art64-25.html>>)

²⁴ Përgjegjësia e personave juridikë lidhet drejtpërdrejt me ushtrimin e veprimtarisë që përbënte vepër penale. Masat penale që mund të vendoseshin nga gjykata në këtë rast konsistonin në mbylljen tërësisht apo pjesërisht të veprimtarisë dhe konfiskimin e të ardhurave, mjeteve dhe çdo pasurie tjetër të siguruar nga ajo veprimtari.

²⁵ Neni 1/b, i shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.01.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”

përmendet shprehimisht si një ndër të mirat juridike të rëndësishme që legjislacioni penal ka për detyrë ta mbrojë nga veprat penale.

Së dyti, pas shfuqizimit të dispozitës së veçantë mbi masat penale për personat juridikë në vitin 2001, një hap veçanërisht pozitiv është ndërmarrë në vitin 2004 përmes rivendosjes së kësaj dispozite me një përmbajtje të ndryshuar. Megjithatë, hapi më i rëndësishëm në këtë drejtim do të ndërmerrej nga ligjvënësi në vitin 2007, kur kjo dispozitë do të bëhej e zbatueshme përmes miratimit të ligjit të posaçëm “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”,²⁶ i cili ka plotësuar dispozitën parimore të KP. Në këtë ligj të posaçëm nuk është vendosur asnjë kufizim në lidhje me llojet e veprave penale, për të cilat mund të merret në përgjegjësi penale një person juridik.

Së treti, në përmbushje të detyrave të lartpërmendura të legjislacionit penal në fushën e mbrojtjes së mjedisit, në vitin 2008 ligjvënësi ka shtuar dy vepra penale të reja në kreun IV të pjesës së posaçme të KP.²⁷ Konkretisht, janë shtuar si figura të veçanta të krimeve kundër mjedisit “shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor” (neni 206/a), si dhe “shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor” (neni 206/b). Këto shtesa në KP, të cilat janë bazuar edhe në modelet e ngjashme franceze e italiane, kanë ardhur si një reagim ndaj situatës problematike të shfaqur në praktikë nëpërmjet përhapjes së ndjeshme të zjarrvënies (me dashje ose nga pakujdesia) në pyje, kullota, pemishte, e cila kishte shkaktuar djegien e qindra mijëra hektarëve, duke dëmtuar rëndë mjedisin.²⁸

Vlen të theksohet se, me shtesat e vitit 2008, ka ndryshuar edhe raporti i krimeve me kundërvajtjet penale në kreun IV të pjesës së posaçme të KP. Tashmë, shumica e figurave të veprave penale kundër mjedisit në KP në fuqi janë të cilësuar si krime.

Me shtesat e vitit 2008, për herë të parë janë parashikuar rrethana cilësuese që lidhen me shkaktimin e dëmeve të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura. Ky vlerësim i veçantë i shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë për efektet e krimin në mjedisin në tërësi, si dhe ndaj zonave të mbrojtura në veçanti, përbën një risi në kreun IV të pjesës së posaçme të KP, pasi në asnjë prej figurave të tjera të veprave penale të këtij kreu të veçantë nuk gjenden të parashikuara rrethana të tilla cilësuese. Kjo risi, e cila ndjek në këtë mënyrë modelet e ngjashme të shteteve të tjera, i ka

²⁶ Ligji nr.9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, i cili ka hyrë në fuqi më 01.10.2007.

²⁷ Shtuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”

²⁸ Relacion për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, 2008, f.14.

përshtatur figurat e reja të krimit mjedisor me risitë e shfaqura ndërkohë në legjislacionin sektorial.

Së katërti, pas shfuqizimit të dispozitës parimore që lejonte parashikimin e dënimeve kumulative (burgim dhe gjobë),²⁹ në vitin 2013 ligjvënësi ka ashpërsuar dënimin e parashikuar në dispozitën e re të shtuar në vitin 2008 mbi krimin e shkatërrimit me zjarr të pyjeve dhe të mjedisit pyjor. Si pasojë e këtyre ndryshimeve, kjo figurë krimi e kryer në rrethana veçanërisht të cilësuar rezulton të jetë, për herë të parë, krimi më i rëndë mjedisor në Shqipëri, pasi dënohet me burgim deri në njëzet vjet, e cila është aktualisht masa maksimale më e lartë e dënimit të parashikuar për një krim mjedisor.

Megjithatë, një reformë më e plotë në lidhje me kreun IV të pjesës së posaçme të KP mbi veprat penale kundër mjedisit mbetet një domosdoshmëri, veçanërisht në kuadrin e përafrimit të legjislacionit kombëtar me *acquis* mjedisor të BE-së. Disa nga krimet e rënda të parashikuara në Direktivat e krimit mjedisor, si p.sh. ato në fushën e menaxhimit të mbetjeve, në fushën e mbrojtjes së florës dhe faunës së mbrojtur dhe habitatit të tyre, etj, mbeten ende për t'u shtuar në këtë kre të veçantë të KP, duke patur parasysh edhe faktin se legjislacioni përkatës sektorial është përafruar tashmë me legjislacionin përkatës të BE-së³⁰. Ndonëse zbatimi i pjesës më të madhe të ligjeve të reja sektoriale imponohet apo sigurohet përmes një sistemi modern të kundërvajtjeve administrative, për të cilat janë parashikuar edhe dënime të ashpra, kjo nuk mund të konsiderohet si e mjaftueshme për një mbrojtje efektive të mjedisit, nën dritën e standartit minimal të përcaktuar në Direktivën e BE-së për krimin mjedisor, sipas të cilit është e domosdoshme që, së paku, shkëljet e rënda të legjislacionit kombëtar që transpozon direktiva të caktuara të BE-së të parashikohen si vepra penale. Në këtë kontekst, reforma në KP ka një rëndësi të veçantë duke qenë se mund të shërbejë edhe në drejtim të përmirësimit të situatës së “zbatimit dhe imponimit” të legjislacionit mjedisor, për të cilën duhen bërë “përpjekje urgjente” krahas harmonizimit të legjislacionit me *acquis* mjedisor të BE-së,³¹ me synimin për të siguruar një mbrojtje më efektive të mjedisit.

²⁹ Neni 29, paragrafi i fundit të KP, i cili është shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.47/2012.

³⁰ Për shembull, ligji i ri “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i vitit 2011 është përafruar plotësisht me direktivën përkatëse të BE-së.

³¹ Në Progres Raportet për Shqipërinë, Komisioni Evropian ka theksuar në vazhdimësi domosdoshmërinë e “përpjekje[ve] urgjente për të harmonizuar, zbatuar dhe respektuar legjislacionin” (shih konkluzionet lidhur me “mjedisin dhe ndryshimet klimatike” në Progres Raportin 2012, f.61 dhe në Progres Raportin 2013, f.53). Ndërkohë, në Progres

5. Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale në Kosovë dhe modeli i ofruar në kuadrin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me direktivat e Bashkimit Evropian.

Në ngjashmëri me Republikën e Shqipërisë, kuadri ligjor në mbrojtje të mjedisit në Kosovë është i gjerë dhe i fragmentarizuar, pasi ai përbëhet nga shumë ligje administrative që mbulojnë sektorë të ndryshëm³². Krahas ligjit kuadër “Për mbrojtjen e mjedisit” janë miratuar disa ligje të posaçme për mbrojtjen e përbërësve të veçantë të mjedisit, si p.sh. ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, ligji për mbrojtjen e natyrës, ligji për ujërat, etj.³³ Po kështu, në ngjashmëri me Shqipërinë, ky legjislacion është zgjeruar dhe pasuruar në vazhdimësi me synim përshtatjen me standartet e legjislacionit të BE-së për mbrojtjen e mjedisit.³⁴

Lidhur me legjislacionin penal si një burim i rëndësishëm i të drejtës së mjedisit në Kosovë, në ngjashmëri me Shqipërinë, veprat penale kundër mjedisit janë sistemuar në një kapitull të veçantë të pjesës së posaçme të KP. Kjo strukturë, e cila ishte parashikuar në KP të parë të Kosovës (2003),³⁵ të miratuar pas çlirimit nga okupimi i Serbisë dhe Jugosllavisë në 12 qershor të vitit 1999,³⁶ është ruajtur edhe në KP të ri³⁷ të miratuar në vitin 2012.

Ndërkohë, në dallim nga KP i Shqipërisë, në këtë kapitull të veçantë janë përfshirë edhe veprat penale kundër objekteve kulturore dhe në titullin e tij janë përmendur në mënyrë të veçantë si objekte të mbrojtura posaçërisht

Raportin e vitit 2014 është arritur në konkluzionin se “[n]evojiten përpjekje të mëtejshme në të gjitha fushat për forcimin e kapaciteteve administrative dhe për të garantuar zbatim dhe imponim të ligjit, si dhe përafrimin e mëtejshëm me *acquis*.” (f.57)

<http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/albania/index_en.htm>

³² T. Fajardo del Castillo, *A case study on the EU's promotion of environmental protection through criminal law in Kosovo*. A case study compiled as part of the EFFACE project, Granada, University of Granada, f.7. Aksesuar në faqen e internetit <www.efface.eu>.

³³ Në bazë të ligjit kuadër, mbrojtja e përbërësve të mjedisit rregullohet me ligje të veçanta (neni 15 i ligjit Nr. 03/L-025, datë 26.02.2009 “Për mbrojtjen e mjedisit”). Shih në faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor <<http://mmp-hks.org/sq/Ligjet-e-Mjedisit1>>.

³⁴ T. Fajardo del Castillo, *A case study on the EU's promotion of environmental protection through criminal law in Kosovo*, vep. e cit., f.3.

³⁵ UNMIK REG 2003/05, i cili ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004, botuar në Gazetën Zyrtare të datës 6 Korrik 2003.

³⁶ I.Salihi, *E drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme*, Leoprint, Prishtinë, 2005, f. 116-7.

³⁷ Kodi Nr. 04/L-82, datë 20 prill 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013. Botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.19, datë 13 Korrik 2012 (<http://www.md-ks.org>).

nga veprat penale “mjedisi, kafshët, bimët dhe objektet kulturore”, duke lënë të kuptohet se me termin “mjedis” në kontekstin e të drejtës penale do të kuptohen tre përbërësit e tij natyrorë (ajër, tokë, ujë). Megjithatë, sikurse është theksuar në literaturën juridike, në thelb, qëllimi i ligjvënësit në këtë KP ka qenë që në ndërtimin e grupit të veprave penale të kapitullit të veçantë të pranohej koncepti bashkëkohor, sipas të cilit objekt i mbrojtjes nuk është vetëm mjedisi i njeriut, por “mjedisi i natyrës në përgjithësi”.³⁸

Në dallim nga KP i Shqipërisë, normat kryesisht blankete³⁹ të kapitullit XXVIII të KP të ri të Kosovës (nenet 347-364) përmbajnë një larmishmëri më të madhe të veprave penale, duke përfshirë edhe disa figura të reja, të cilat janë shtuar në kontekstin e përshtatjes së KP me kërkesat e Direktivës së BE-së mbi Krimin Mjedisor të vitit 2008.⁴⁰ Në shumicën e tyre, ato janë vepra të rrezikimit (konkret ose abstrakt) të mjedisit.⁴¹

Në këtë kapitull të veçantë të KP të ri janë shtuar tre vepra penale të reja, të cilat aktualisht nuk janë të parashikuara në kapitullin e veçantë të KP të Shqipërisë, përkatësisht: (1) dëmtimi i objekteve dhe pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit; (2) ushtrimi i kundërligjshëm i shërbimeve veterinerë; (3) shitja ose nxjerrja e të mirave natyrore, bimëve ose kafshëve posaçërisht të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës. Ndërkohë, krahas pasurimit me figura të reja të veprave penale, në KP të ri janë bërë edhe ndryshime të rëndësishme në disa nga veprat penale të parashikuara në KP të mëparshëm.

Po kështu, në dallim nga KP i Shqipërisë, ligjvënësi ka zgjedhur të parashikojë një vepër penale të vetme për ndotjen e mjedisit dhe nuk ka parashikuar dispozita të veçanta për ndotjen e komponentëve të veçantë të mjedisit. Në bazë të KP të ri, për veprën penale të përgjithshme të “ndotjes, degradimit ose shkatërrimit të mjedisit” nuk kërkohet si element i domosdoshëm që ndotja ose degradimi i mjedisit apo shfrytëzimi jashtë mase i burimeve natyrore të ketë shkaktuar rrezik për mjedisin dhe jetën apo shëndetin e një numri të madh të njerëzve.

Ndërkohë, lidhur me veprën penale të peshkimit të paligjshëm, e cila ka pësuar ndryshime të rëndësishme në KP të ri, konstatohet lehtësisht një

³⁸ I.Salihi, *E drejta penale (Pjesa e Posaçme)*, Fakulteti Juridik i Kolegjit Fama, Prishtinë, 2009, f.379.

³⁹ Po aty, f.380.

⁴⁰ Sipas planifikimit të përafritit të legjisllacionit mjedisor në Kosovë, kjo Direktivë, e cila është transpozuar pjesërisht përmes KP dhe ligjit për mbrojtjen e mjedisit, ishte planifikuar të implementohej plotësisht në vitin 2013. Për më shumë, shih: *Environmental approximation planning in Bosnia and Herzegovina and Kosovo under UNSCR 1244*, RENA Regional Training Workshop, Prishtinë, 2011, f.6, në faqen e internetit <www.renanetwork.org/index.php?view=wgroup&groups=w_subgroups&id_group=1&id_subgroup=1>.

⁴¹ I.Salihi, *E drejta penale (Pjesa e Posaçme)*, vep. e cit., f.380.

ngjashmëri e madhe me dispozitën korresponduese në KP të Shqipërisë, veçanërisht në sanksionin e parashikuar në secilin paragraf të normës së veçantë.⁴²

Rrethanat e cilësuara dhe ato veçanërisht të cilësuara në KP të Kosovës janë më të larmishme dhe përfshijnë si dëme në njerëz apo pasuri, ashtu edhe dëme konkrete në ajër, ujë, tokë, kafshë dhe bimë. Kështu për shembull, vepra penale e ndotjes, degradimit ose shkatërrimit të mjedisit konsiderohet e kryer në rrethana të cilësuara nëse vepra ka rezultuar me dëmtimin e shëndetit të një numri të madh të njerëzve apo me asgjësimin e plotë ose të pjesshëm të botës shtazore, bimore ose të rezervave të ujit të pijshëm ose me ndonjë dëmtim tjetër të mjedisit me pasoja të rënda, apo me shtimin e nivelit të ndotjes në shkallë kritike. Vlen të theksohet se rrethanat e parashikuara si rrethana veçanërisht të cilësuara të kësaj vepre penale janë përqendruar vetëm në dëmet në mjedis dhe konkretisht konsistojnë në “dëmtimin apo shkatërrimin e papërmirësueshëm të mjedisit ose në rrezikimin e pasurive të mbrojtura natyrore”.

Një vlerësim i veçantë është treguar për objektet e mbrojtura natyrore dhe veçanërisht llojet e mbrojtura të kafshëve dhe bimëve, në mbrojtje të të cilave janë parashikuar figura të veçanta të veprave penale, si dhe rrethana të cilësuara në disa vepra penale të tjera. Ky vlerësim i veçantë është përfunduar më tej me KP të ri, në të cilin janë shtuar rrethana të reja cilësuese që lidhen pikërisht me këto objekte të veçanta, si dhe është shtuar një figurë e re e veprës penale. Kështu, në bazë të shtesës së bërë në nenin 356, vepra penale e shkatërrimit të botës bimore me materie të dëmshme dënohet më rëndë në rast se vepra është kryer ndaj llojit veçanërisht të mbrojtur të bimëve, pemëve ose vegjetacionit tjetër. Gjithashtu, në kapitullin e veçantë të KP të ri është shtuar edhe një vepër penale e re mbi shitjen ose nxjerrjen e të mirave natyrore, bimëve ose kafshëve posaçërisht të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës.

Mbrojtjes së kafshëve dhe bimëve iu është kushtuar një numër i konsiderueshëm i dispozitave të kapitullit XXVIII të KP, duke filluar nga vepra penale e ndotjes së ushqimit dhe ujit të shtazëve, për të vijuar me veprat penale në fushën e mjekimit të kafshëve dhe luftimit të sëmundjeve në rast epidemie, gjuetinë dhe peshkimin e paligjshëm, si dhe shitjen ose nxjerrjen jashtë Republikës së Kosovës të trofeve të kafshëve të egra apo bimëve dhe kafshëve posaçërisht të mbrojtura. Sikurse është theksuar më

⁴² Shih nenin 362 të KP të Kosovës dhe nenin 204 të KP të Shqipërisë.

lart, ushtrimi i kundërligjshëm i shërbimeve veterinare është një vepër penale e re, e cila është shtuar për herë të parë në KP të ri.⁴³

Për veprën penale të gjuetisë së kundërligjshme, e cila mund të kryhet vetëm me dashje, janë parashikuar disa forma të kryerjes, sikurse janë gjuajtja, mbytja ose zënia gjallë e një kafshe të egër pa leje ose autorizim. Në nenin 359 të KP të ri janë shtuar si forma të reja edhe gjuetia e kafshëve të egra në kohë të ndaluar ose në vende të ndaluara. Vepra konsiderohet e kryer në rrethana të cilësuar në rastet kur ajo është kryer në këto rrethana: jashtë sezonit; në grup; ndaj gjahut me vlerë mbi 2.000 Euro; ndaj gjahut me rëndësi sipas rregulloreve të gjuetisë. Ndërkohë, gjuetia e kundërligjshme konsiderohet se është kryer në rrethana veçanërisht të cilësuar kur: objekt i gjuetisë janë lloje të rrezikuara ose të rralla të kafshëve, gjuetia e të cilave është e ndaluar; gjuetia është kryer ndaj llojeve të posaçme të kafshëve pa pasur lejen e veçantë për atë lloj gjahu; janë përdorur metoda të asgjësimit masiv, automjeti, ose drita e fortë.

Një veçori e rëndësishme e KP të Kosovës, e cila konstatohet që në pjesën e tij të përgjithshme,⁴⁴ konsiston në faktin se, në dallim nga KP i Shqipërisë, dispozitat e kapitullit të veçantë mbi veprat penale kundër mjedisit përmbajnë edhe përkufizime të veçanta të disa termave të caktuar, veçanërisht ato që janë përcaktues për objektin material të veprës penale përkatëse, të tilla si, përkufizimi i termit “blegtori” në kontekstin e veprës penale të moszbatimit të urdhërave për luftimin e sëmundjeve të shtazëve dhe bimëve (neni 354/6), apo përkufizimi i termit “monument ose objekt i mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror” në kontekstin e veprës penale të dëmtimit, shkatërrimit dhe nxjerrjes së paautorizuar të monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës (neni 363/5), të cilët japin kuptimin që ato do të kenë në dispozitat përkatëse të KP.

Një risi e rëndësishme e KP të ri është se në kapitullin e veçantë të pjesës së përgjithshme mbi “domethënien e shprehjeve në KP”⁴⁵ janë shtuar edhe disa përkufizime të reja që lidhen me terma që përdoren shpesh edhe në kapitullin mbi veprat penale kundër mjedisit, të tilla si “dëm i

⁴³ Në bazë të nenit 353, kjo vepër konsiderohet e kryer kur një person, pa patur përgatitjen e duhur profesionale, merret me shërimin e kafshëve ose ofron shërbime të tjera veterinare përkundërt pagesës.

⁴⁴ Pjesa e Përgjithshme e KP të Kosovës përmban një kapitull të veçantë që iu është kushtuar posaçërisht kuptimit të disa termave të caktuar në KP.

⁴⁵ Kapitulli XIII i KP të Kosovës.

konsiderueshëm”, “dëm substancial” dhe “dëm në shkallë të madhe”.⁴⁶ Në këtë kontekst, krahas rasteve të veçanta kur ligjvënësi e ka përcaktuar konkretisht vlerën minimale të dëmit në dispozitat e kapitullit XXVIII të KP,⁴⁷ përkufizimet e përcaktuara në pjesën e përgjithshme të KP mund të konsiderohen si një hap i rëndësishëm në ndihmë të një interpretimi të unifikuar të dispozitave të kapitullit të veçantë mbi veprat penale kundër mjedisit gjatë zbatimit të tyre në praktikë.

Lidhur me sanksionet e parashikuara për veprat penale kundër mjedisit, në KP të ri konstatohet një tendencë drejt ashpërsimit të dënimit për shumicën e veprave penale, duke zëvendësuar sanksionet e normave që më parë përmbanin në formë alternative dënimin me gjobë dhe atë me burgim, herë me një sanksion të ri që përmban vetëm dënimin me burgim, si alternativën e vetme, dhe herë të tjera me një sanksion që parashikon dhënien bashkërisht të dënimit me gjobë dhe atij me burgim (dënim kumulativ).

Në rastin e veprës penale të gjuetisë së kundërligjshme, si dhe veprës penale të shitjes ose nxjerrjes së kundërligjshme të trofeve⁴⁸ të kafshëve të egra jashtë Kosovës, ligjvënësi ka parashikuar edhe konfiskimin e detyrueshëm, përkatësisht, të kafshëve të egra dhe pajisjeve të gjuetisë, si dhe të trofeve të kafshëve të egra. Megjithatë, në dallim nga KP i mëparshëm, ky lloj dënimi plotësues nuk është parashikuar si një konfiskim i detyrueshëm në rastin e veprës penale të peshkimit të kundërligjshëm.⁴⁹ Krahas dënimeve kryesore dhe plotësuese, me shtesat e bëra nëpërmjet KP të ri, në dy dispozita të kapitullit të veçantë mbi veprat penale kundër mjedisit, ligjvënësi ka parashikuar, për herë të parë, mundësinë që gjykata të detyrojë autorin e veprës që të ndërmarrë “masa të caktuara për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor”. Një detyrim i tillë i veçantë, i lidhur drejtpërdrejt me mbrojtjen e mjedisit, mund të jepet me rastin e caktimit të dënimit për veprën penale të lejimit të kundërligjshëm të ndërtimit apo drejtimit të fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin, si dhe për veprën penale të dëmtimit të objekteve dhe pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit.⁵⁰

⁴⁶ Në bazë të nenit 120, pikat 29 deri 31 të KP të Kosovës, këto shkallë të dëmit korrespondojnë përkatësisht me humbje në vlera monetare sa vijon: (1) 5.000 -15.000 Euro; (2) 15.000-50.000 Euro; (3) më shumë se 50.000 Euro.

⁴⁷ Shih për shembull, nenin 349 mbi veprën penale të lejimit të kundërligjshëm të ndërtimit apo drejtimit të fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin.

⁴⁸ Sipas prof. I.Salihi, termi “trofe” i përdorur në kontekstin e kësaj vepre penale ka kuptimin e një kafshe të egër që është zënë e gjallë ose është vranë në gjueti. (I.Salihi, *E drejta penale (Pjesa e Posaçme)*, vep. e cit., f. 397.)

⁴⁹ Në KP të mëparshëm, konfiskimi i detyrueshëm parashikohej edhe në rastin e veprës penale të peshkimit të kundërligjshëm. Konkretisht, në një paragraf të veçantë të nenit 288 të tij parashikohej konfiskimi i detyrueshëm i peshqve dhe i pajisjeve të peshkimit.

⁵⁰ Shih nenet 349/5 dhe 350/7 të KP të Kosovës.

Një veçori tjetër e KP të Kosovës, e cila e dallon nga KP i Shqipërisë, konsiston në faktin se në rastet kur vepra penale është e dënueshme pavarësisht nga forma e fajit me të cilën është kryer, për secilën formë të fajit (dashje, pakujdesi) janë parashikuar paragrafë të veçantë të dispozitës përkatëse, duke bërë në këtë mënyrë edhe diferencimin apo përshkallëzimin e dënimit që mund të jepet në secilin rast. Madje, me KP të ri, ky veçim i rasteve në paragrafë më vehte në varësi të formës së fajit është bërë edhe për formën apo format më të rënda të veprës të kryer në rrethana të cilësuar ose veçanërisht të cilësuar. Kështu për shembull, për veprën penale të ndotjes, degradimit ose shkatërrimit të mjedisit, neni 347 i KP përmban paragrafë të veçantë për secilën formë të fajit, si për figurën e thjeshtë të kësaj vepre (paragrafët 1 dhe 2), ashtu edhe për veprën e kryer në rrethana të cilësuar (paragrafët 3 dhe 4), si dhe në rrethana veçanërisht të cilësuar (paragrafët 5 dhe 6).

Ndërkohë, për disa nga veprat penale kundër mjedisit të kryera me dashje, për të cilat, si rregull, faza e tentativës nuk është e dënueshme,⁵¹ ligjvënësi kosovar ka zgjedhur që të zbatojë përjashtimin nga rregulli i përgjithshëm, duke parashikuar si të dënueshme edhe këtë fazë të veprimtarisë paraprake kriminale. Kështu p.sh., faza e tentativës është parashikuar shprehimisht si e dënueshme në rastin e figurës së thjeshtë të veprës penale të vjedhjes së pyllit, e cila dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit (neni 358/3), apo në rastin e veprës penale të dëmtimit, shkatërrimit dhe nxjerrjes së paautorizuar të monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Kosovës, e cila dënohet me gjobë ose me burgim deri në një apo dy vjet, në varësi të formës me të cilën është kryer vepra (neni 363/6). Për këtë të fundit, dënueshmëria e tentativës është parashikuar për herë të parë në KP të ri, krahas shtimit të gjobës si alternativë dënimi në sanksionin e normës, e cila më parë përmbante vetëm dënimin me burgim, si alternativën e vetme për këtë vepër penale.

Në këtë kontekst, sërish vihet re tendenca e ashpërsimit apo zgjerimit të sferës së ndëshkueshmërisë për veprat penale të parashikuara në kapitullin XXVIII të KP të ri, në krahasim me KP të mëparshëm.

Në ngjashmëri me Shqipërinë, krahas përgjegjësisë së personave fizikë, legjislacioni penal i Kosovës ka pranuar përgjegjësinë e personave

⁵¹ Në bazë të nenit 28 të KP të Kosovës, tentativa, si rregull, dënohet vetëm për veprat penale për të cilat mund të caktohet një dënim me tre ose më shumë vjet burgim, ndërsa për veprat e tjera penale që dënohen më lehtë, tentativa dënohet vetëm nëse parashikohet shprehimisht në ligj.

juridikë për kryerjen e veprave penale, e cila rregullohet me një ligj të posaçëm dhe nuk është e kufizuar në vepra penale të caktuara.⁵²

6. Përfundime

Në kontekstin e hartimit të KP të ri në fillimin e viteve '90, ligjvënësi i ka kushtuar një vëmendje të veçantë çështjes komplekse dhe në zhvillim të mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet të drejtës penale, duke adoptuar një përqsasje të re dhe bashkëkohore në kontekstin e hartimit të legjislacionit të ri penal të shtetit demokratik. Risitë e KP të vitit 1995 vihen re jo vetëm në sistemimin e veçantë të veprave penale kundër mjedisit, por edhe në përmbajtjen e dispozitave përkatëse, si përsa i përket elementëve të figurave konkrete të veprave penale dhe kualifikimit të tyre si krime ose kundërvajtje penale, ashtu edhe në dënimet përkatëse. Një karakteristikë e legjislacionit penal shqiptar si një ndër burimet e të drejtës së mjedisit, shfaqet në përqendrimin e normave penale në KP, duke evituar në këtë mënyrë shpërndarjen e tyre në ligje të ndryshme sektoriale. Megjithatë, në këto 21 vite nga miratimi i këtij kodi ka patur zhvillime të ngadalta në fushën e mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet legjislacionit penal, pavarësisht zhvillimeve të reja që janë shfaqur gjatë kësaj periudhe në nivelin evropian e ndërkombëtar, si dhe në legjislacionin modern administrativ në fushën e mbrojtjes së mjedisit në Shqipëri. Me përjashtim të shtesave të vitit 2008 në fushën e mbrojtjes së pyjeve, dispozitat relevante të KP kanë mbetur me të njëjtën përmbajtje si në kohën e miratimit të tyre.

Duke iu referuar eksperiencës së Kosovës, e cila ka ndjekur një model të ngjashëm me atë të ndjekur në KP të Shqipërisë në drejtim të sistemimit të veprave penale kundër mjedisit në një kapitull të veçantë të pjesës së posaçme, vlen të theksohet se ligjvënësi ka përfshirë në të një larmishmëri më të madhe të veprave penale, me një tendencë drejt pasurimit të KP me disa figura të reja, në kontekstin e përshtatjes së KP të ri me kërkesat e Direktivës së BE-së mbi Krimin Mjedisor të vitit 2008. Gjithashtu, legjislacioni i Kosovës ofron një model të mirë edhe përsa i përket vlerësimit të veçantë mbi rrethanat e cilësuar dhe ato veçanërisht të cilësuar, të cilat janë më të larmishme dhe përfshijnë si dëme në njerëz apo pasuri, ashtu edhe dëme konkrete në ajër, ujë, tokë, kafshë dhe bimë. Në këtë kontekst, vlen të theksohet edhe zgjedhja optimale e ligjvënësit kosovar mbi objektet e mbrojtura natyrore dhe veçanërisht llojet e mbrojtura të

⁵² Neni 3/2 i ligjit Nr.04/L-030, datë 31.08.2011 "Për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale", i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

kafshëve dhe bimëve, në mbrojtje të cilave janë parashikuar edhe figura të veçanta të veprave penale, krahas rrethanave të cilësuar në disa vepra penale të tjera. Ndarja e figurave konkrete të një veprave penale në varësi të formës së fajit dhe rrethanave të cilësuar e veçanërisht të cilësuar, duke i parashikuar ato në paragrafë të veçantë të dispozitës përkatëse, është veçanërisht pozitive dhe ndihmëse në drejtim të diferencimit apo përshkallëzimit të dënimit që mund të jepet në secilin rast, si dhe në kontekstin e përshtatjes së dënimeve të parashikuara për veprat penale kundër mjedisit me kërkesën e Direktivave të BE-së për dënime “efektive, proporcionale dhe shkurajuese”. Lidhur me sanksionet e parashikuara për veprat penale kundër mjedisit konstatohet një tendencë drejt ashpërsimit të dënimit për shumicën e veprave penale. Një veçori pozitive e KP të ri në këtë drejtim është prezantimi për herë të parë i opsionit të mundshëm të detyrimit të autorit të veprës për të ndërmarrë “masa të caktuara për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor”, si një detyrim i veçantë, i lidhur drejtpërdrejt me mbrojtjen e mjedisit.

Ndërkohë, në Shqipëri, në 21-vjetorin e hyrjes në fuqi të KP të vitit 1995, ligjvënësi përballet me një domosdoshmëri për ndryshime dhe shtesa të rëndësishme në legjislacionin penal mjedisor, duke përfshirë këtu jo vetëm pasurimin e kreut të posaçëm me figura të reja të veprave penale, por edhe përshtatjen e dënimeve përkatëse me nivelin e rrezikshmërisë së veprave. Në këtë kontekst, zhvillimet e lartpërmendura në legjislacionin penal mjedisor të Kosovës mund të shërbejnë si një model në hartimin e ndryshimeve dhe shtesave të nevojshme në KP të Shqipërisë në kuadrin e përpjekjeve për përafrimin e tij me direktivat e BE-së për krimin mjedisor, me synim arritjen e objektivit kryesor për mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë.

Dr. Enkelejda Turkeshi*

The protection of environment through criminal law: a comparative analysis of the environmental criminal laws of Albania and Kosovo

Summary

The adaption of the Criminal Code (CC) in the early '90s represents an important step towards developing a comprehensive legal framework in the relatively new and evolving area of environmental law in Albania. Being one of the sources of environmental law, the CC of 1995 has brought several novelties in the field of the protection of environment through criminal law, including the introduction for the first time of a specific separate chapter on criminal offences against the environment.

Meanwhile, in the following years, especially from the late '90s, besides the new developments in the dynamic environmental law that has increasingly been approximated to the European environmental law, specific initiatives on harmonisation of the national criminal laws have been taken by international and European institutions, taking into consideration the serious threat posed to the environment by several serious infringements of provisions on environmental protection. In this context, environmental criminal law is both a relatively new field, and an evolving one with a tendency towards approximation, at least regarding the serious forms of environmental crime provided by the EU Environmental Crime Directives.

In a comparative perspective with the environmental criminal law of the Republic of Kosovo, it results that Kosovo has taken further significant positive steps in dealing with the complex issue of the protection of environment through criminal law, especially in the context of the enactment of a new CC in 2012. Besides having a separate chapter on environmental criminal offences since in the previous CC, the scope of this chapter in the new CC of Kosovo has been enhanced by the amendments to current offences and also by the addition of new criminal offences, in the effort to adapt the new legislation to the requirements of the EU Environmental Crime Directive of 2008, thus it currently provides for a wider criminal law

* *Department of Criminal Law, Faculty of Law, University of Tirana, Tirana, Albania, E-mail: enkelejda.turkeshi@fdut.edu.al*

protection of the environment. The legislator has provided for several aggravating circumstances, which are related not only to human life and health, but also to concrete harm to air, water, soil, flora and fauna. Special protection has been provided for protected natural resources, as in the new CC the legislator has also introduced a new offence, besides the aggravating circumstances in other offences of the same chapter. In addition, in the new legislation of 2012 there has been a tendency to more severe sanctions for most of the environmental criminal offences, while a specific obligation to “undertake certain measures for protection, safeguarding and improving the environment” has been introduced for the first time as an option for the court when imposing a sentence for the perpetrators of two specific offences. Meanwhile, the new legislation reinforces the differentiation of sanctions for each category of fault (intent and negligence) and for different degrees of seriousness of the criminal offences (basic offence and aggravated forms), which would also be helpful in providing “effective, proportionate and dissuasive” sanctions as it is required in the EU Environmental Crime Directives.

Therefore, Kosovo offers the perspective of its experience with the transposition of the EU directives on environmental crimes, in the context of the forthcoming criminal law reform in Albania, which has been granted the candidate status since 2014 but has not adopted yet the necessary amendments to its criminal legislation that would provide a full alignment with the minimum standards set forth in the EU Environmental Crime Directives. These legal reforms are of significant importance as they would contribute in ensuring a “proper implementation and enforcement” of the environmental legislation, which is “urgently needed” besides alignment of the national legislation to the EU environmental *acquis*⁵³ in order to achieve the aim of a more effective protection of the environment, therefore furthering the social goal of the State to “a healthy and ecologically adequate environment for the present and future generations”⁵⁴.

⁵³ The European Commission has continuously highlighted in its Progress Reports on Albania since 2012 the urgent need for “further efforts ... to ensure proper implementation and enforcement of legislation” (see conclusions in the field of “environment and climate change” in the 2012 Progress Report, p.61 and 2013 Progress Report, p.53) while in the 2014 Progress Report it has concluded that “[s]ignificant further efforts are needed in all areas to strengthen administrative capacity and to ensure proper implementation and enforcement of legislation and its further alignment with the *acquis*” (p.57).
<http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/albania/index_en.htm>

⁵⁴ Referring to the social goals of the State declared in the Albanian Constitution (Law no.8417/1998, as amended), article 59/d.

Ma. sc. Emine Abdyl

Trafikimi me njerëz në Kosovë dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit

Hyrje

Trafikimi me njerëz konsiderohet të jetë një ndër krimet më serioze i cili paraqitet si një formë bashkëkohore e skllavërisë e që atakon me shkeljen më brutale të të drejtave themelore të njeriut, të drejta këto që janë të garantuara si me të drejtën vendore ashtu edhe në atë ndërkombëtare. Trajtimi dhe shqyrtimi i trafikimit me njerëz kërkon një vëmendje të veçantë për shkak të natyrës së saj komplekse dhe njëkohësisht mbetet sfiduese si për organet kompetente të shtetit ashtu edhe për studiuesit e kësaj dukurie kriminale. Edhe përkundër përpjekjeve dhe iniciativave të shumta, që kanë bërë institucionet e Kosovës së bashku me institucionet ndërkombëtare, që veprojnë në vend për vetëdijesimin e shoqërisë, shkalla e këtij fenomeni është e lartë. Trafikimi me njerëz, si krim i organizuar, është problem me përmasa globale. Pavarësisht se në raporte të ndryshme ndërkombëtare veçohen sidomos shtetet transitore dhe me shkallë të lartë të varfërisë si dhe ekonomi të pazhvilluar, megjithatë, trafikimi si dukuri negative shfaqet në forma më të sofistikuar edhe në shtetet e zhvilluara. Gratë dhe fëmijët janë kategoritë më të prekura nga trafikimi me njerëz. Raporte të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare i konfirmojnë të dhënat se të dy kategoritë shfrytëzohen për qëllime të ndryshme, respektivisht për shfrytëzime seksuale dhe për kërkim të lëmshës.

Në këtë punim theks të veçantë do t'i kushtojmë parimeve themelore për luftimin e trafikimit me njerëz, parandalimin, ndjekjen penale të trafikuesve me njerëz sipas legjisllacionit penal të Kosovës, viktimave të trafikimit me njerëz, ndihma dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit, në mënyrë që të japim një pasqyrë si në aspektin teorik, legjisllativ dhe praktik. Gjatë shtjellimit të kësaj teme kryesisht do të mbështetemi në Kodin Penal të Kosovës, Ligjin për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e

viktimize të trafikimit, në akte të ndryshme ndërkombëtare, në të dhënat: e Entit Statistikor të Kosovës, Policisë së Kosovës, prokurorisë dhe gjykatave të Kosovës si dhe burime të tjera plotësuese që shërbejnë për hulumtimin, sa më të denjë të kësaj dukurie negative.

1. Historik i shkurtër i trafikimit me njerëz

Shikuar në aspektin historik, trafikimi me njerëz konsiderohet që fillet e tij t'i ketë qysh në kohët e mëhershme, mirëpo forma dhe mënyra e realizimit të kësaj dukurie kriminale ka evoluar me kalimin e kohës. Ky evoluim ka marrë përmasa më të theksuara në fillim të shekullit XX, mu për këtë arsye, është parë e udhës që të përpilohet një numër i madh akteve ndërkombëtare, nacionale, me qëllim të, parandalimit dhe ndëshkimit të rëndë të kryerësve të veprave penale të trafikimit me njerëz. Mirëpo, në Kanunet tona që për një kohë të gjatë kanë qenë "legjislacion" në vete nuk është paraparë trafikimi me njerëz, ngaqë familjet shqiptare kryesisht kanë bërë një jetë me rregulla konservative, brenda një rrethi të mbyllur vicioz dhe si shoqëri kryesisht nuk kanë qenë të prekur nga raste të tilla.

Vlen të theksohet se, më 25 mars 1807, Parlamenti Britanik miratoi Ligjin mbi Ndalimin e Tregtisë me Skllëvër që përmes rrugëve ligjore të eliminojë tregtinë me skllëvër në ish-Perandorinë Britaneze. Duke e parë rëndësinë e këtij ligji edhe shumë vende të tjera e ndoqën këtë shembull. Mirëpo edhe pse kaluan 206 vjet, pas kësaj ngjarje historike, fatkeqësisht edhe në këtë kohë, shoqëritë ende ballafaqohen me një tjetër formë dhe trajtë të skllavërisë – me trafikimin e njerëzve¹.

Nëse i shikojmë në mënyrë kronologjike, Konventat më të njohura ndërkombëtare, të cilat kanë për qëllim ndalimin dhe ndëshkimin e trafikimit me njerëz janë: Konventa mbi ndalimin e tregtisë me robër të bardhë të vitit 1910², Konventa për ndëshkimin e tregtisë me gra dhe fëmijë të vitit 1921,³ Konventa për ndëshkimin dhe parandalimin e tregtisë me njerëz dhe eksploatimin e tyre për qëllime prostitucioni 1949⁴, Konventa evropiane dhe

¹ OSCE/ Vlerësimi për themelimin e mekanizmave referuese për viktimat e trafikimit me genie njerëzore në Kosovë, tetor 2007, fq. 7.

² Shih: International Convention for the Suppression of the White Slave Traffic, 4 May 1910, III LNTS 278.

³ Shih: Convention for the Suppression of traffic in Women and children, 30 September 1921, 9 LNTS 415.

⁴ Shih: Convention for the Suppression of the Traffic in Persons and of the Exploitation of the Prostitution Others, in force since 25 July 1951, 96 UNTS 271.

protokollet e saj për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirisë së lëvizjes 1966⁵, më vonë një kontribut të rëndësishëm kanë dhënë edhe Deklarata e Budapestit për shëndetin publik dhe trafikimit të qenieve njerëzore 2003⁶, Konventa e Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit me qenie njerëzore 2005⁷, Direktiva e parlamentit evropian dhe e këshillit për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtja e viktimave të saj 2011⁸ etj.

Sipas legjislacionit penal të Kosovë, fillimisht vlen të theksohet se, pas luftës Rregullorja e parë, e cila ka për qëllim ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë është Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/4⁹, Kodi i përkohshëm penal i Kosovë viti 2004 neni 139¹⁰, pastaj Kodi Penal i Kosovës në fuqi (2013)¹¹, Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit¹², si dhe shumë dokumente e strategji të cilat kanë për qëllim parandalimin e trafikimit me njerëz.

1.1 Përkufizimi dhe parimet themelore për luftimin e trafikimit me njerëz

Sipas kodit në fuqi përkufizimi “trafikim me njerëz” do të thotë: “rekrutimi, transportimi, strehimi ose pranimi i personave, përfshirë në shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi këta persona, me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit”¹³. Mirëpo shprehja “shfrytëzim” “përfshin, por nuk kufizohet në, shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve, pornografisë

⁵ Shih: Council of Europe, The Europe Convention on Human Rights, 20 Janar 1966, In Strasbourg.

⁶ Shih: Budapest Declaration on Public Health & trafficking in Human Beings, 19 - 21 March 2003, in Budapest.

⁷ Shih: Konventa e Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Këshilli i Evropës, Varshavë, 16.05.2005, Seria e Traktateve Evropiane ETS, nr. 197.

⁸ Shih: Directive 2011/36/ EU of the European Parliament and of the Council, 5 April 2011.

⁹ Shih: Rregullore nr. 2001/4 Mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë, 12 Janar 2001.

¹⁰ Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, Prishtinë 2004.

¹¹ Kodi Penal i Kosovës, Prishtinë 2013

¹² Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Parandalimin me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 34/4 Shtator 2013, Prishtinë.

¹³ Neni 171, paragrafi 6.1 i Kodi Penal i Kosovës, 1 Janar 2013, Prishtinë fq. 87.

ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, lëmshës, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve apo qelizave”¹⁴.

Fillimisht për të luftuar trafikimin me njerëz duhet t’i kemi parasysh disa parime themelore, të cilat ndihmojnë luftimin e kësaj dukurie kriminale dhe janë paraparë me ligjin në fuqi. Sipas këtij Ligji parimet themelore për luftimin e trafikimit me njerëz janë:

- *“respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, në veçanti të viktimave të ndjeshme;*
- *njohja e trafikimit me njerëz si vepër penale që prek të drejtat themelore të njeriut, dinjitetin, lirinë dhe integritetin e njerëzve;*
- *pashmangshmërinë e ndëshkimit të trafikantëve me qenie njerëzore;*
- *ligjshmërisë*
- *qasja e lirë në drejtësi, qasje në këshillim ligjor dhe në përfaqësim ligjor pa pagesë, përfshirë për qëllim të parashtrimit të kërkesës për kompensim;*
- *qasje në shërbimet dhe trajtimet mjekësore pa pagesë për dëmet e shkaktuara nga abuzimi i/ose trafikimit,*
- *ndihma dhe mbështetja për viktimën nuk kushtëzohen me gatishmërinë e viktimës për të bashkëpunuar për hetimin, ndjekjen apo gjykimin penal;*
- *ofrimit të sigurisë dhe qasjes së drejtë, të paanshme për viktimat e trafikimit;*
- *përdorimi gjithëpërfshirës të masave parandaluese: ligjore, socio – ekonomike dhe ndërkombëtare;*
- *partneriteteve sociale, bashkëpunimit të autoriteteve, organizatat joqeveritare dhe përfaqësuesit tjerë të shoqërisë civile me organizatat ndërkombëtare;*
- *proporcionaliteti ndërmjet respektimit të të drejtave themelore të viktimave të trafikimit me njerëz dhe kushteve të ndjekjes penale, në mënyrë që nuk shkel të drejtat e të pandehurit;*
- *sigurohet që të gjitha aktivitetet kundër trafikimit me njerëz të kenë parasysh aspektin gjinor, promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e viktimave gra dhe vajza;*
- *trajtimin të barabartë të gjitha formave dhe llojeve të trafikimit kombëtar dhe transnacional me njerëz, pavarësisht se a është apo jo i ndërlidhur me krimin e organizuar;*
- *bashkëpunimin e autoriteteve vendore me institucionet e shteteve tjera dhe organizatat ndërkombëtare me qëllim të arritjes së objektivave të parandalimit dhe luftimit të trafikimit me njerëz;*
- *zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masave për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikuar, bëhet pa diskriminim mbi çfarëdo baze:*

¹⁴ Neni 171, paragrafi 6.2 i Kodi Penal i Kosovës, 1 Janar 2013, Prishtinë fq. 87.

*gjinisë, racës, gjuhës, fesë, mendimit politik apo ndryshe, origjinës sociale apo nacionale, shtetësisë, asocimit, përkatësisë me një pakicë etnike etj*¹⁵.

Përveç parimeve themelore të veprës penale të trafikimit me njerëz dallojmë edhe elementet e veprës penale të trafikimit me njerëz të cilat janë përcaktuar në nenin 171 të Kodit Penal e ato janë: “1. rekrutimi, 2. transportimi, 3. transferimi, 4. strehimi apo pranimi i personave, me anë të kanosjes dhe përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, 5. rrëmbimit, 6. mashtrimit, 7. lajthimit, 8. keqpërdorimit të pushtetit apo keqpërdorimit të pozitës së ndjeshme dhe 9. Dhënia apo marrja e pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, për qëllim të shfrytëzimit”¹⁶.

1.2 Parandalimi dhe luftimi i trafikimit me njerëz

Shoqëria në përgjithësi dhe institucionet shtetërore në veçanti, duke e parë rrezikun e madh të kësaj dukurie kriminale, po marrin masa të vazhdueshme për parandalimin dhe luftimin e saj. Rritja e përnjëhershme, e rasteve të trafikimit me njerëz në Kosovën e pasluftës ka bërë që edhe mas media e organizatat e ndryshme joqeveritare të japin kontributin e tyre në sensibilizim e opinionit për mënyrën e parandalimit dhe luftimin e këtij fenomeni.

Sipas ligjit në fuqi, gjegjësisht neni 6, paragrafi 1 ka përcaktuar institucionet shtetërore, respektivisht autoritetet kompetente për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz, ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave.¹⁷

Pa një kontroll të mirëfilltë të kufijve, të Ballkanit në përgjithësi dhe të Kosovës në veçanti, rruga për të parandaluar dhe luftuar këtë dukuri kriminale është më se e vështirë. Mos kontrolli adekuat i këtyre pikave kufitare të vendit e stimulon rritjen dhe zhvillimin e trafikimit.

¹⁵ Neni 4, paragrafët 1.1 – 1.15 të LPLTNjMVT

¹⁶ Neni 5, paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9 të LPLTNjMVT

¹⁷ Neni 6, paragrafi 1 i LPLTNjMVT përfshin këto institucione: Ministria e Punëve të Brendshme; Policia e Kosovës; Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Punëve të Jashtme; Ministria e Financave; Agjencia për Barazi Gjinore; Prokurori i Shtetit; Gjykatat; Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave; Komunat dhe çdo ofruer i shërbimeve në kuadër të këtyre institucioneve, i cili në bazë të këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër përkatës është i autorizuar që të merret me parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe sigurimin e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikuar.

“Duke cekur të dhënat se vetëm përmes trekëndëshit Mali i Zi – Kosovë – Serbi kanë kaluar 700 mijë femra (pa përmendur të tjerët), të destinuar për në tregun evropian të prostitucionit (Kallaba 2002)”¹⁸. Gjithashtu vlen të theksohet se kryesisht në Ballkan kemi një numër të konsiderueshëm të rasteve të trafikimit me njerëz të cilat nuk arrihen të identifikohen përmes organeve të cilat kanë për qëllim parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit.¹⁹

Neni 9 i ligjit në fuqi parasheh mënyrën e parandalimit dhe luftimit të trafikimit me njerëz ku:

- *“Parandalimi, luftimi dhe mbrojtja e viktimave të trafikuar me njerëz bëhet nga të gjitha autoritetet përfshirë edhe përfaqësuesit e ofruesve të shërbimeve vendore qeveritare duke u bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi.*
- *Autoritetet bëjnë identifikimin e viktimave të trafikimit me njerëz kur ka bazë të arsyeshme për të besuar se një person i caktuar është viktimë e trafikimit.*
- *Autoritetet duhet të marrin masat e nevojshme, si edukimi dhe trajnimi, me qëllim të reduktimit të kërkesës që favorizon të gjitha format e shfrytëzimit lidhur me trafikimin me njerëz.*
- *Autoritetet, në bashkëpunim me organizatat përkatëse dhe shoqërinë civile ndërmarrin veprimet e përshtatshme, përfshirë internetin, fushatat informuese dhe të sensibilizimit, programet shkencore dhe edukuese, me qëllim të sensibilizimit të opinionit për trafikimin me njerëz dhe reduktimit të rrezikut që personat e ndryshëm, veçanërisht fëmijët, dhe viktimat e ndjeshme të jenë viktimat të trafikimit.*
- *Autoritetet do të favorizojnë trajnimet e rregullta të zyrtarëve të cilët mund të jenë në kontakt me viktimat apo viktimat e mundshme të trafikimit, përfshirë zyrtarët e policisë, rojat kufitare, zyrtarët e imigrimit, prokurorët publikë, avokatët, anëtarët e gjyqësorit dhe zyrtarët e gjykatës, inspektorët e punës, personeli i kujdesit social, të fëmijëve dhe atij shëndetësor dhe stafi konsullor, por varësisht nga rrethanat vendore, mund të përfshijë edhe grupet tjera të zyrtarëve publikë, të cilët kanë gjasë që gjatë punës së tyre të hasin në viktimat të trafikimit, me qëllim që të mundësohet identifikimi, referimi dhe trajtimi i dinjitetshëm i viktimave të trafikimit me njerëz.*
- *Me qëllim të dekurajimit të kërkesës, dhe rritjes së efikasitetit të parandalimit dhe të luftimit të trafikimit të njerëzve, autoritetet do të ndërmarrin veprimet e nevojshme me qëllim që përdorimi i shërbimeve që*

¹⁸ Lekë Sokoli, Ilir Gëdeshi “ Trafikimi rasti i Shqipërisë” Tiranë, 2006, fq. 16.

¹⁹ Shih: IOM , Needs Assesment: Human Trafficking in the Western Balkans, fq.36,

<http://kosovo.iom.int>

*janë objekt shfrytëzimi të konsiderohen shkelje penale siç përcaktohet me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.*²⁰

1.3 Ndjekja penale e trafikuesve me njerëz sipas legjislacionit penal të Kosovës

Zbatimi i masave dhe mjeteve të ndryshme në raport me kryerësit e trafikimit të njerëzve, ndryshon prej një shteti në shtetin tjetër. Karakteri shtrëngues dhe represiv i sanksioneve penale paraqet një rëndësi në procesin e luftimit dhe parandalimit të trafikimit me njerëz. Përveç këtyre sanksioneve ekzistojnë edhe një mori masash dhe veprimesh të tjera preventive²¹.

Sipas Kodit Penal neni 171, paragrafi 1 parasheh që çfarëdo personi që merr pjesë në trafikimin e njerëzve dënohet me gjobë dhe me burgim prej 5 deri në 12 vjet, duke ju referuar këtij paragrafi, paragrafi 3 për organizatorët e trafikimit me qenie njerëzore shqipton dënime më të larta, ku dënimi me gjobë parashihet të jetë 500.000 euro, ndërsa dënimi me burgim prej 7 deri në 20 vjet. Në paragrafin 4 masa të rrepta ndëshkimi parashihen edhe për personat zyrtarë të cilët keqpërdorin pozitën e që në fakt janë të thirrur ta luftojnë këtë dukuri. Dënimet për këtë kategori janë me gjobë dhe me burgim 5 deri në 15 vjet. Mirëpo nëse kryerja e veprës penale, sipas paragrafit 1-4 rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryerësi i kësaj vepre dënohet jo më pak se 10 vjet ose me burgim të përjetshëm²². Përveç Kodit Penal të Kosovës, hetimin dhe ndjekjen penale të trafikimit me njerëz e parasheh konkretisht edhe neni 11 i Ligjit mbi trafikimi me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, ku shprehimisht thekson se kur duhet të merren masa për hetimin dhe ndjekjen penale të trafikuesve²³. Përveç këtyre dispozitave, që zbatohen në territorin e Kosovës, ekziston edhe një numër i madh dispozitash ndërkombëtare që në vete ngërthen forma dhe mënyra të ndryshme të ndjekjes penale për kryerësit e kësaj vepre të rëndë penale.

Të gjitha këto do të kenë efekt nëse shteti përmes mekanizmave të tij veprues ndërmerr dhe njëkohësisht zbaton në përpikëri të gjitha masat dhe ndëshkimet që janë paraparë me legjislacionin e Kosovës dhe vetëm në këtë mënyrë ndjekja penale arrin qëllimin e duhur.

²⁰ Neni 9, paragrafët 1 – 6 të LPLTNjMVT

²¹ Dr. Rexhep Gashi, “Trafikimi me njerëz në Kosovë në periudhën e pasluftës” E drejta nr. 3- 4, Prishtinë, fq. 29.

²² Neni 171, paragrafët 1, 3, 4 të KPK-së, 1 Janar 2013, Prishtinë fq. 86

²³ Neni 11 i LPLTNjMVT

2. Viktimat e trafikimit me njerëz

Viktimat, në të shumtën e rasteve, vijnë si pasojë e krimit të organizuar. Sa i përket viktimave të trafikimit me njerëz, kryesisht në të shumtën e rasteve, bien pre e premtimeve boshe nga personat që janë pjesë e grupeve të caktuara kriminale. Këto grupe me qëllim të caktuar inkurajojnë viktimat për një jetë më të mirë, e në fakt këto viktimat shndërrohen në skllevër të tyre. Viktimat e trafikimit me njerëz kryesisht klasifikohen në: trafikimin e femrave, trafikimin e fëmijëve dhe trafikime të tjera respektivisht trafikimi i imigrantëve, emigrantëve dhe trafikimi me organe .

2.1. Femra si viktimë e trafikimit

Trafikimit i femrave si viktimë rezulton njëra prej formave më të shpeshta dhe kyçe të trafikantëve, duke shfrytëzuar gjendjen ekonomike, psikike të saj, trupin dhe bukurinë e brishtë të saj, bën që ky lloj i trafikimit të jetë shumë fitimprurës. “Kushtet e rënda materiale dhe standardet e ulëta janë të pranishme më shumë në vendet të pazhvilluara, të cilat ndodhen në fazën e tranzicionit, ku bën pjesë edhe Kosova”²⁴. Në të shumtën e rasteve “femrat e trafikuar janë të detyruara të pranojnë çfarëdo ofertash për punë të dyshimta nga ndërmjetësuesit dhe trafikues, për shkak të kushteve të vështira materiale, kushteve të rënda të jetesës dhe standardit të ulët. Kjo gjendje i shtyn jo vetëm femrat e rritura të bëhen objekt trafikimi, por në shumë raste i shtynjë edhe prindërit t’i lejojnë, për të mos thënë me vetëdije t’i shesin fëmijët e mitur të gjinisë femërore me qëllim që të sigurojnë kushte për ekzistencë”²⁵.

Për pengimin e trafikimit me femra, si formë e krimit të organizuar, duhen të merren masa të kontrollit, masa këto që për nga natyra mund të jenë të karakterit “formal” dhe “joformal”. Masat e kontrollit të karakterit formal kanë për qëllim inkadrimin e të gjitha institucioneve dhe organeve tjera shtetërore që përmes mekanizmave të tyre të bëjnë parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz në përgjithësi²⁶. Zhvillimi i shoqërisë njerëzore, si në aspektin ekonomik, arsimor, emancipues ashtu edhe intelektual, është formë tjerët shumë efektive për të parandaluar dhe luftuar trafikimin me njerëz.

²⁴Dr. Beqir Sadikaj, “Trafikimi i femrave në Kosovë me qëllim prostitucioni, si formë e krimit të organizuar”, “E drejta” nr. 4/2002 Prishtinë, fq. 64.

²⁵ Dr. Ragip Halilaj, “Disa karakteristika kriminologjike dhe viktimologjike të trafikimit të femrave”, “E drejta” nr. 1-4/2000, Prishtinë, fq. 40.

²⁶ Po aty, fq. 40.

2.2. Fëmijët si viktimë të trafikimit

Një formë tjetër e viktimave të trafikimit janë edhe fëmijët, formë kjo sa e rëndë aq e ndjeshme dhe e rrezikshme për çdo shoqëri. Pra, të drejtat dhe liritë e fëmijëve janë të garantuara nga një mori ligjesh e aktesh ndërkombëtare dhe nacionale. Por, e rëndësishmja e kësaj është se sa respektohen këto të drejta dhe sa bëjnë për këto institucionet shtetërore përkatëse. Manipulimi me fëmijët zanafillën e ka qysh në kohët më të hershme, por kjo dukuri kohëve të fundit ka marrë dimension shumë më të gjerë në tërë botën.

Sipas nenit 1 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve thuhet: “fëmija është qenie njerëzore që nuk i ka mbushur 18 vjet, po qe se sipas ligjit të vendit në të cilin jeton nuk parashihet fitim i madhore edhe para kësaj moshë”²⁷.

Sipas shumë të dhënave e kërkimeve mbi moshën e viktimave të trafikimit të fëmijëve, nga vendet e ndryshme të botës tregojnë se mosha është e ndryshme, mirëpo në veçanti janë të prekur foshnjat, fëmijët deri në moshën 3 - 4 vjeç por edhe moshat 15 – 16 vjeç²⁸. Duke pasur parasysh gjendjen por edhe vlerën e fëmijës në raport me familjen dhe shoqërinë, të rriturit duhet të jenë të kujdesshëm në trajtimin e tyre në mënyrë që ata të konsiderohen si subjekt i të drejtave, që kanë nevojë për mbrojtje, kujdes dhe ndihmë jo vetëm nga institucionet shtetërore, por edhe nga vetë shoqëria në përgjithësi²⁹.

Sipas raportit të Departamentit të Shtetit të SHBA mbi Trafikimin me Qenie Njerëzore të vitit 2012 thuhet se “Kosova është burim, destinacion dhe ndoshta një vend transit për gratë dhe fëmijët që janë viktimë të trafikimit seksual, dhe fëmijët i nënshtrohen lypjes së detyruar.”³⁰

Sipas ligjit në fuqi, kreu, i V parasheh mënyrën e parandalimit dhe luftimit të trafikimit me fëmijë. Në neni 34 paragrafi 1 thuhet “fëmijët që janë viktimë e trafikimit përfitojnë ndihmë dhe mbrojtje. Interesat më të mira të fëmijës duhet të merren në konsideratë gjatë zbatimit të legjislacionit”³¹ pra me anë të këtij ligji fëmijët gjejnë mbështetje institucionale duke përfituar ndihmë dhe mbrojtje institucionale.

²⁷ Shih: Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve, është aprovuar në 20 nëntor 1989, nga Kuvendi Gjeneral i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

²⁸ Dr. Ragip Halili, Viktimologjia, Prishtinë 2007, fq. 103.

²⁹ Dr.Haki Demolli, “Shkeljet e të drejtës së fëmijëve për mbrojtje nga puna”, “E drejta “ nr. 4/2003, Prishtinë, fq. 61.

³⁰ Shih: Raporti i Departamentit të SHBA mbi Trafikimin me Qenie Njerëzore, 2012, www.state.gov

³¹ Neni 34, paragrafi 1 i LPLTNjMVT

2.3. Viktimat tjera të trafikimit

Përveç femrave dhe fëmijëve si viktima të trafikimit kemi edhe viktima të tjera si imigrantët, emigrantët dhe viktimat e trafikimit me organe. Fjala Imigrim, - imigroj do të thotë vij e vendosem në një vend të huaj për të jetuar e punuar përgjithmonë aty, ndërsa fjala Emigrim, - i / do të thotë mërgim.³² Imigruar dhe emigrojë shpesh përdoren si sinonime, por ka një ndryshim delikat në mes të dyjave. Emigrant është ai që e lë një vend apo rajon për të zgjidhur një tjetër. Ndërsa imigrant është personi që ka shkuar në një vend në të cilin nuk ka lindur, zakonisht për qëndrim të përhershëm. Dallimi në mes të emigrimit dhe imigrimit lidhet me pikën e këndvështrimit se cili është vendi i origjinës dhe cili është vendi i destinacionit. Ju mund të emigroni nga njëri vend, ndërsa imigroni në një vend tjetër. Këto dy kategori të trafikimit kohëve të fundit janë më prezentë, kryesisht për shkak të kushteve të rënda ekonomike. Faktori ekonomik – social ka bërë që të ndikojë në rritjen dhe viktimizimin e shumë personave pa dallim gjinie, moshe e feje. Grupe të ndryshme me qëllim, të përfitimeve materiale, u premtojnë njerëzve në nevojë për një jetë më të mirë duke organizuar bartjen e tyre në mënyrë ilegale, të cilët shoqërohen me dokumentacione false ose edhe pa dokumentacione përkatëse.³³ Kategoria më e pambrojtur nga rrjeti i

³² Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, “Fjalor i shqipes së sotme”, Tiranë 2002, fq. 301, 502

³³ www.kosovopolic.com Sipas një raporti të Policisë së Kosovës thuhet “së më datën 15.11.2013, rreth orës 06:00, Njësia e Hetimeve e Departamentit të Policisë Kufitare ka realizuar një operacion policor në rajonin e Ferizajt, me ç’rast ka arrestuar dy persona të dyshuar me dyshimin e bazuar se kanë kryer vepra penale “kontrabandim me imigrantë” dhe “falsifikim i dokumenteve”. Personat janë E.M. i lindur më 1976 dhe L.B. i lindur më 1973. Bazuar në hetimet preliminare të Policisë së Kosovës personat e dyshuar tashmë të arrestuar, në bashkëveprim dhe në vazhdimësi, me qëllim të përfitimit material, kanë siguruar dhe rregulluar dokumente të ndryshme të falsifikuara, kryesisht viza dhe letërnjoftime të shteteve të ndryshme të Evropës si dhe kanë aranzhuar dërgimin e shtetasve kosovarë në drejtim të shteteve të Bashkimit Evropian, përmes rrugëve ilegale dhe me dokumente të falsifikuara. Si pasojë e veprimeve të tyre kriminale shumë persona kanë pësuar jo vetëm materialisht por edhe fizikisht duke u maltretuar nëpër vendkalimet dhe zonat e ndryshme kufitare. Të gjitha veprimet policore lidhur me këtë rast janë kryer nën autorizimin e prokurorit përkatës dhe me autorizimin e tij të dyshuar dërgohet në mbajtje për të vazhduar me procedurat tjera hetimore.

trafikimit me njerëz rezultojnë të jenë emigrantët dhe imigrantët. Ata në të shumtën e rasteve nuk trajtohen si viktimë, ndërsa për këtë kategori të rrezikuar nuk merr përgjegjësi askush.

Përveç këtyre dy kategorive kemi edhe kategoria e trafikimit me organe, i cili në Kodin penal të Kosovës është paraparë në nenin 265. Ky nen është i përbërë prej 8 paragraf të cilat e ndalojnë transplantimin e kundërligjshëm dhe trafikimin e organeve dhe qelizave njerëzore. Gjithashtu janë përfshirë llojet e dënimeve dhe në ato raste kur kemi dënimet me burgim është e paraparë kohëzgjatja e dënimit.³⁴

3. Ndhimja dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit

Njëra prej formave më të kërkuara, sidomos nga ana e viktimës, është edhe ndihma dhe mbrojtja e tyre. Mënyra se si duhet të ofrohet ndihma dhe mbrojtja e tyre është e përcaktuar edhe me ligjin në fuqi respektivisht në kreun IV. Edhe përkundër institucioneve shtetërore, të cilat e zbatojnë këtë ligj dhe KP në përgjithësi me vullnetin e mirë të shoqërisë janë themeluar shoqata të ndryshme të cilat ofrojnë ndihma të ndryshme dhe mbrojtje viktimave të trafikimit.

Ndhimja dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit shihet si prioritet edhe për aktet ndërkombëtare të cilat kërkojnë një trajtim të duhur e sidomos kur kemi të bëjmë me viktimën në cilësinë e dëshmitarit. Sjelljet adekuate e personave zyrtar ndaj viktimave të trafikimit hap një tjetër mundësi të bashkëpunimit për të zbuluar kryerësit e kësaj vepre penale apo këtyre grupeve kriminale.³⁵

Sipas këtij raporti po shohim se viktimat bien pre e abuzimeve më çnjerëzore, keqtrajtohen dhe diskriminohen në format më mizore. Sipas shumë të dhënave të tjera shumë viktimë humbin jetën, gjatë insistimit të tyre, për të hyrë eventualisht për t'u vendosur në një vend tjetër, p.sh siç është rasti i Shqipërisë, ku me datën 9 janar 2004 humbën jetën 21 shqiptarë në ujërat e Adriatikut, të cilët ishin nisur drejt brigjeve të Italisë dhe 8 të tjerë ende konsiderohen të zhdukur. Ndërkohë për tragjedinë e 9 janarit në Shqipëri janë dënuar 5 persona me gjithsej 115 vjet burgim. Vazhdimisht hasim në dëshirën e njerëzve për një jetë më të mirë e që në fakt, në të shumtën e rasteve, kjo dëshirë ju këmbëhet me humbjen e lirisë, siç është rasti me kosovarët gjatë muajit korrik 2013, ku mijëra prej tyre e lëshuan Kosovën drejt ndonjërit vend të Evropës Perëndimore, e në fakt ata përfunduan në burgjet dhe kampet e Hungarisë e disa të tjerë më "fatlum" në tendat e Francës.

³⁴ Neni 265, paragrafët 1 - 8 të KPK-së, 1 Janar 2013, Prishtinë fq. 134.

³⁵ Shih: OSCE, A Legal Analysis of Trafficking in Persons Cases in Kosovo, October 2007, fq.16, www.humantrafficking.org

3.1. Mbrojtja e të drejtave të viktimave të trafikimit

Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit ka një qasje të drejtë dhe konkrete, lidhur me ndihmën dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimave duke përfshirë një mori institucionesh dhe organizatash të ndryshme për t'iu dalë në ndihmë kësaj kategorie. P.sh. sipas nenit 20 paragrafi 1 “viktimave të trafikimit me njerëz u jepet mbrojtje dhe ndihmë nga autoritetet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, në kuadër të kompetencave të tyre dhe në pajtim me këtë ligj dhe akte të tjera normative.”³⁶ Gjithashtu në pajtimi me Kodin e Procedurës Penale neni 20 paragrafi 2 parasheh të drejta themelore për viktimat e trafikimit. Sipas këtij neni këto janë të drejtat e parapara:

- *“të drejtën në informim mbi rrjedhën e procedurës si dhe për të gjitha të drejtat që i takojnë sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi.*
- *të drejtën për tu trajtuar si palë në procedurë;*
- *të drejtën për qasje në shërbime ligjore pa pagesë;*
- *të drejtën për shërbime të përkthimit me shkrim dhe gojor, gjatë të gjitha fazave të procedurës, në gjuhë në të cilaën ai/ajo e kupton;*
- *të drejtën në mbrojtje për viktimat dhe dëshmitarët, dhe në raste të caktuara edhe për familjet e tyre, të cilat ballafaqohen me kërcnime apo frikësime në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve;*
- *të drejtën për privatësi dhe konfidencialitet;*
- *të drejtën në parashtrimin e mjeteve juridike, përfshirë edhe ndihmën juridike nëkëtë çështje;*
- *të drejtën në strehim të përkohshëm;*
- *të drejtën në një periudhë reflektimi prej tridhjetë (30) deri në nëntëdhjetë (90) ditësh me qëllim të rimëkëmbjes;*
- *të drejtën në ndihmë mjekësore, psikologjike, dhe shërbime për mirëqenie sociale, pagesë, siç mund të jetë e nevojshme për t'i përmbushur nevojat e tyre dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi;*
- *të drejtën e pjesëmarrjes në seancat mbi caktimin e dënimit apo informimin mbi vendimet lidhur me dënimin;*
- *të drejtën ,bi informimin mbi lirimin apo arratisjen e të pandehurit nga qendra e paraburgimit”³⁷.*

Përveç institucioneve kombëtare që bëjnë përpjekje të vazhdueshme për mbrojtjen e të drejtave të këtyre personave kontribut të veçantë kanë edhe institucionet ndërkombëtare që me anë të mekanizmave të tyre mbrojnë të drejtat e viktimave të trafikimit.

³⁶ Neni 20, paragrafi 1 i LPLTNjMVT

³⁷ Neni 20, paragrafi 2 i LPLTNjMVT

3.2. Rehabilitimi dhe Riintegrimi i viktimave të trafikimit

Rehabilitimin dhe riintegrimi paraqet një tjetër formë shumë të rëndësishme për viktimat e trafikimit. Trajtimi i këtyre viktimave duhet të ketë parim kryesor risocializimin e këtyre personave me qëllim që ata t'i kthehen jetës së përditshme dhe të jetojnë të lirë e pa ngarkesa aq sa munden.

Rehabilitimin dhe riintegrimi viktimave të trafikimit e ka paraparë edhe ligji në fuqi, ku në nenin 21 thuhet “rehabilitimi i viktimave të trafikimit me njerëz bëhet me qëllim të rehabilitimit dhe rikthimit të tyre në jetën normale, duke përfshirë dhënien e ndihmës mjekësore, psikologjike, juridike dhe materiale.” Ndërsa, neni 22 parashihet “riintegrimin e viktimave të trafikimit me njerëz që bëhet pas rehabilitimit me qëllim të përfshirjes së suksesshme shoqërore të viktimave të trafikimit me njerëz, në jetë normale dhe të lirë, duke ofruar qasje adekuatë në shërbime edukuese, trajnime profesionale, mundësi për banim të përhershëm dhe të sigurt dhe pavarësi financiare përmes ofrimit të mundësive të ndryshme për (vete) punësim.”³⁸

Përveç institucioneve shtetërore për rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit meritë të veçantë kanë edhe shoqatat dhe qendrat e ndryshme. Njëra ndër to është edhe Qendra për mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore me seli në Prishtinë (MVPT), e cila deri në fund të vitit 2013 ka rehabilituar 600 viktima të trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo qendër i këshillon viktimat e trafikuar lidhur me procesin e rehabilitimit dhe riintegrimin të tyre në shoqëri, në bazë të përvojës së tyre tregojnë se viktimat në fjalë i janë nënshtruar dhunës së madhe psikologjike duke u abuzuar, shantazhuar aq shumë sa që e humbin plotësisht identitetin e tyre. Në situata të tilla duhet shumë kohë dhe punë që këta persona ta kthejnë besimin tek njerëzit në përgjithësi.³⁹ Grupet kriminale, gjegjësisht personat e këtyre grupeve gjatë kryerjes së formave të ndryshme të kriminalitetit të organizuar, përdorin forma dhe metoda të ndryshme ndaj viktimës si p.sh. kanosje, dhunë fizike e psikike me qëllim të jetësimit të veprimtarisë së tyre kriminale.⁴⁰ E gjitha kjo ndikon negativisht dhe e zgjat dukshëm rrugën drejt rehabilitimit dhe riintegrimin të viktimës.

³⁸Neni 21, 22 i LPLTNjMVT

³⁹www.16days-noviolence-ks.com

⁴⁰Mr.sc. Bajram Ukaj, “Gjendja e krimit të organizuar në Kosovë dhe legjisllacionit penal”, “E drejta” nr. 4/2002, Prishtinë, fq.73.

3.3. Kompensimi i viktimave të trafikimit

E drejta e kompensimit, respektivisht “dëmshpërblimit” për viktimat e trafikimit është e drejtë e pakontestueshme si në nivelin vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Në nivel vendor, kompensimi i viktimave të trafikimit është paraparë, edhe në kreun VI të ligjit përkatës, ku në nenin 39 paragrafi 1 thuhet: “viktimat e trafikimit, përfshirë edhe viktimat fëmijë, kurdo që është e mundur, marrin kompensimin në mënyrë që të bëhet riintegrimi dhe rimëkëmbja e plotë e tyre. Procedurat për marrjen dhe zbatimin e kompensimit duhet të jenë të qasshme për fëmijët.”⁴¹ Në kuadër të këtij ligji përfshihen të gjitha format dhe mënyrat e kompensimit për viktimat e trafikimit e për rrethana të caktuara dallojmë edhe kompensimin nga shteti.

Në nivelin ndërkombëtar sipas një raporti të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) “E drejta e personave të trafikuar për dëmshpërblim përforcohet nga Konventa e Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (KKEVTQNJ), e cila parashikon të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim nga trafikanti si për dëmin moral, ashtu edhe për atë material. Ajo gjithashtu parashikon të drejtën e përfitimit nga një skemë shtetërore dëmshpërblimi, duke iu referuar modelit të paraqitur nga Konventa Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme (KEDVKDH). Në konventë vihet më shumë theksi tek të drejtat ndihmëse, si ndihma ligjore falas, të cilat e bëjnë dëmshpërblimin një mundësi efektive dhe praktike. Megjithatë, e drejta për dëmshpërblim nga shteti është e kufizuar dhe jepet vetëm në rrethana të caktuara. KKEVTQNJ e kufizon dëmshpërblimin nga shteti vetëm për rastet e dëmit material, ku vepra penale ka qenë veprim i qëllimshëm dhune që ka rezultuar në dëmtime fizike ose mendore. Megjithatë, e drejta për dëmshpërblim nga shteti është e kufizuar dhe jepet vetëm në rrethana të caktuara. KKEVTQNJ e kufizon dëmshpërblimin nga shteti vetëm për rastet e dëmit material, ku vepra penale ka qenë veprim i qëllimshëm dhune që ka rezultuar në dëmtime fizike ose mendore.”⁴²

⁴¹ Neni 39, paragrafi 1 i LPLTNjMVT

⁴² www.osce.org, “Dëmshpërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-së “ 2008.

Sado që këto dy nivele insistojnë për një kompensim sa më të drejtë e cilësore, përjetimet dhe gjendja e tyre shpirtërore është e pakompezueshme.

4. Statistikat e personave të dënuar dhe viktimave të trafikimit me njerëz dhe veprat tjera lidhur me trafikim në Kosovë gjatë vitit 2011 – 2012

Duke u bazuar në statistikat e përgjithshme vërejmë se numri më i madh i veprave penale kryhet nga kryerësit e gjinisë mashkullore, përfshirë edhe veprën penale të trafikimit me njerëz. Kësisoj, sipas të dhënave nga Enti i Statistikave i Kosovës, për periudhën 2011 -2012, personat e dënuar për trafikim me njerëz dhe veprat tjera penale, lidhur me trafikimin e njerëzve sipas gjinisë dhe nacionalitetit kishte ecurinë si në vijim:⁴³

Tabela nr.1. Personat e dënuar sipas veprave penale, gjinisë dhe nacionalitetit në Gjykatat e Qarkut – Kosovë

Të gjitha Gjykata e Qarkut		Për vitin 2011 – 2012										
Përmbajtja e nenit dhe e kreu të LPK-së, KPK-së dhe ligjeve e rregulloreve të aplikueshme në Kosovë		Numri I të dënuarve	Gjinia e të dënuarve		Nacionaliteti i të dënuarëve							
Neni	Përmbajtja e nenit		Meshkuj	Femra	Shqiptarë	Serbë	Malazez	Boshnjakë	Turq	Romë.Egjiptas, Ashkalinive	Të huaj	Të Tjerë
KREU XIV	VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE											
138 KPK	Kontrabandimi me emigrantë	23	23	-	21	-	-	-	-	-	2	-
138, 332 KPK	Kontrabandimi me emigrantë dhe vepra penale falsifikimi i dokumenteve	1	1	-	1	-	-	-	-	-	1	-
139 KPK	Trafikimi me njerëz	30	25	5	28	1	-	-	-	-	1	-

⁴³ Shih: Statistikat e Jurisprudencës për personat madhor për periudhën 2011-2012, Enti i Statistikës së Kosovës, Prishtinë

139/2/1-20 KPK	Kryerja e v.p. në tentativë e trafikimit me njerëz nën moshën 18 vjeçare	2	1	1	2	-	-	-	-	-	-	-
139.1-23 KPK	Bashkëpjesëmarrje në trafikim me njerëz	4	3	1	4	-	-	-	-	-	-	-
139.2-23 KPK	Bashkëpjesëmarrje në trafikim me njerëz nën moshën 18 vjeçare	3	3	-	3	-	-	-	-	-	-	-
139/2/1, 193/4/1/2- 20 KPK	Trafikim me njerëz nën moshën 18 vjeçare dhe v.p. tentim i dhunimit të personit të mitur	1	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-
139/2/1,- 20-23 KPK	Bashkëkryerje e v.p. në tentativë e trafikimit me njerëz nën moshën 18 vjeçare	2	2	-	2	-	-	-	-	-	2	-
139/2/1,- 198/1/ KP	Trafikimi me njerëz nën moshën 18 vjeçare dhe v.p. keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare	2	2	-	2	-	-	-	-	-	-	-
139,229 KPK	Trafikimi me njerëz dhe v.p. Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike	2	1	1	2	-	-	-	-	-	-	-
138-23 KPK	Bashkëkryerja e v.p. Kontrabandimi me emigrantë	18	16	2	16	-	-	-	2	-	-	-
138,253-23 KPK	Bashkëkryerje e v.p. Kontrabandimi me emigrantë dhe v.p. vjedhje e	1	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-
138,328-23 KPK	Bashkëkryerje e v.p. Kontrabandimi me emigrantë dhe v.p. posedimi i armës pa leje	3	3	-	3	-	-	-	-	-	-	-
139-23	Bashkëkryerje e v.p. trafikimi me njerëz	38	35	3	38	-	-	-	-	-	-	-
139,201-23 KPK	V.p. trafikimi me njerëz nën moshën 18 vjeçare dhe bashkëkryerja e v.p. mundësimi i prostitucionit	1	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-
139,328-23 KPK	V.p. trafikimi me njerëz nën moshën 18 vjeçare dhe bashkëkryerja e v.p. posedimi I armës pa leje	1	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-
Rr.UN. 2001/04	RREGULLORE PËR NDALIMIN E TRAFIKIMIT TË PERSONAVE NË KOSOVË											
Rr.Un. 2001/04	Vepra penale e trafikimit të personave	14	14	-	13	1	-	-	-	-	-	-
Rr.un. 2001/04,23	Bashkëkryerja në kryerjen e v.p. të trafikimit të personave	7	6	1	4	2	-	-	-	-	1	-

Në bazë të të dhënave, sa i përket gjinive, shumë më i lartë rezulton të jetë numri i gjinisë mashkullore në përfshirjen e veprës penale të trafikimit me njerëz. Karshi kësaj vërejmë edhe faktin që nacionaliteti shqiptar të ketë pjesën dërmuese të rasteve, pasi që shumica e popullsisë në territorin e Kosovës i takojnë nacionalitet shqiptar.

139/2/1-20 KPK	Kryerja e v.p në tentativë e trafikimit me njerëz nën moshën 18 vjeçare	2	-	-	-	-	-	-	-	-	1	1	-	-	-	-	-	-	-	-
139.1-23 KPK	Bashkëpjesëmarrje në trafikim me njerëz	4	-	-	-	-	-	-	-	2	-	2	-	-	-	-	-	-	-	-
139.2-23 KPK	Bashkëpjesëmarrje në trafikim me njerëz nën moshën 18 vjeçare	3	-	-	-	-	-	-	-	1	-	2	-	-	-	-	-	-	-	-
139/2/1, 193/4/1/2- 20 KPK	Trafikim me njerëz nën moshën 18 vjeçare dhe v.p. tentim i dhunimit të personit të mitur	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-
139/2/1,- 20-23 KPK	Bashkëkryerja e v.p. në tentativë e trafikimit me njerëz nën moshën 18 vjeçare	2	-	-	-	-	-	-	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
139/2/1,- 198/1/ KP	Trafikimi me njerëz nën moshën 18 vjeçare dhe v.p. Keqpërdorimi seksual I personave nën moshën 16 vjeçare	2	-	-	-	-	-	-	-	-	1	1	-	-	-	-	-	-	-	-
139,229 KPK	Trafikimi me njerëz dhe v.p. Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2	-	-	-	-	-	-	-	-
138-23 KPK	Bashkëkryerja e v.p. Kontrabandimi me emigrantë	18	-	-	-	-	-	-	-	3	4	7	-	-	-	-	-	4	-	-

Sipas tabelës nr. 2 shohim numrin e personave të dënuar për veprën penale të trafikimit me njerëz dhe për veprat e tjera penale lidhur me trafikimin e njerëz, të paraparë në nenin 139 të Kodit Penal të Kosovës⁴⁴ dhe në dy raste të tjera kemi të bëjmë me rregulloren e UNMIK-ut 2001/4. Sipas kësaj tablele vërejmë se për veprën penale trafikim me njerëz dhe vepra të tjera penale të trafikimit me njerëz prej numrit të përgjithshëm 153 personave, me gjobë janë dënuar 17 persona, me 2 – 6 muaj janë dënuar 7 persona, me 6 – 12 muaj 46 persona, me 1 – 2 vjet janë dënuar 34 persona, 2 – 5 vjet 39 persona, 5 – 10 vjet 2 persona, me kusht janë dënuar 8 persona.⁴⁵

TABELA nr. 3. Numri i personave të dënuar në Gjykatat e Qarkut sipas gjinisë për veprën penale të trafikimit me njerëz në Kosovë gjatë periudhës 2011 -2012

Numri i të dënuarve	Meshkuj	%	Femra	%
153	139	90.8	14	9.2

Tabela nr.3 tregon numrin e përgjithshëm të personave të dënuar për vitin 2011 – 2012 nga të gjitha gjykatat e qarkut që funksionojnë në territorin e Republikës së Kosovë se 90.8 % i takojnë gjinisë mashkullore dhe vetëm 9.2 % i takojnë gjinisë femërore.⁴⁶

TABELA nr. 4. Numri i personave të dënuar në gjykatat e qarkut sipas përkatësisë kombëtare për veprën penale të trafikimit me njerëz në Kosovë gjatë periudhës 2011 -2012

Numri dhe përqindja e personave të dënuar sipas përkatësisë kombëtare							
Shqiptarë	Serbë	Malazezë	Boshnjakë	Turq	Romë, Egjiptianë Ashkali	Të huaj	Të tjerë
141	4	-	-	2	-	6	-
92.2	2.6 %	-	-	1.3 %	-	3.9 %	-

⁴⁴ Të gjitha këto të dhëna statistikore e kanë për bazë Kodin Penal të Kosovës i cili ka hy në fuqi me 6 prill 2004, pasi që Kodi i ri Penal i Kosovës ka hy në fuqi me 01 janar të 2013

⁴⁵ Shih: Statistikat e Jurisprudencës për personat madhorë për periudhën 2011-2012, Enti i Statistikës së Kosovës, Prishtinë

⁴⁶ Po aty.

%							
---	--	--	--	--	--	--	--

Nga të dhënat e tabelës nr. 4 shihet qartë se pjesëmarrja e nacionalitetit shqiptar në kryerjen e kësaj vepre penale është mjaft i lartë. Prej 153 rasteve të personave të dënuar, 141 persona respektivisht 92.2 % i takojnë nacionalitetit shqiptar, 4 persona apo 2.6% i takojnë nacionalitetit serb, 2 persona apo 1.3% nacionalitetit turk dhe 6 persona apo 3.9% i takojnë kategorisë së huaj. Në njëërën anë numri i madh i pjesëmarrësve të komunitetit shqiptar në kryerjen e kësaj vepre penale është i kuptueshëm pasi që pjesa dërrmuese e territorit të Kosovës është i banuar me shqiptarë e në anën tjetër ky numër është shqetësues edhe kundrejt angazhimeve të vazhdueshme për parandalimin e kësaj dukurie negative të institucioneve vendore.

Përveç të dhënave për personat e dënuar, në tabelën e mëposhtme kemi të dhënat e viktimave, respektivisht përkatësinë kombëtare të tyre. Kjo tabelë pasqyron numrin e përgjithshëm të viktimave të identifikuara në Republikën e Kosovës gjatë viteve 2011 – 2012, ku prej 93 rasteve sa janë të evidentuara, 64 viktima janë kosovare, 23 viktima janë moldave, 2 viktima janë shqiptare, 3 viktima serbe dhe 1 viktimë hyn në kategorinë e tjera.⁴⁷

TABELA nr. 5. Numri i viktimave sipas përkatësisë kombëtare për veprën penale të trafikimit me njerëz në Kosovë gjatë periudhës 2011 -2012

Vitet	Kosovare	Moldave	Shqiptare	Serbe	Tjera
2011	35	-	1	3	-
2012	29	23	1	-	1
TOTALI	64	23	2	3	1

Sipas raportit vjetor të Policisë së Kosovës, respektivisht Departamentit të Hetimeve gjatë viteve 2011-2012 vepra penale e trafikimit me njerëz dhe veprave të tjera, lidhur me të në vitin 2012 ka treguar një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2011⁴⁸.

⁴⁷ Shih: Qeveria e Kosovës, Strategjia Shtetërore për Migrim dhe Plani i Veprimit 2013-2018, Shtator 2013, Prishtinë

⁴⁸ Shih: Raporti Vjetor 2012 i Policisë së Kosovës, www.kosovopolic.com

TABELA nr. 6. Numri dhe krahasimi i veprës penale të trafikimit me njerëz dhe veprave të tjera, lidhur me trafikim sipas Departamentit të Hetimeve të Policisë së Kosovës gjatë viteve 2011 -2012

Vepra penale	2011	2012	Krahasimi
Kontrabandim me migrantë	04	09	125%
Marrje me prostitucion	17	18	124%
Trafikimi me njerëz	28	34	21%
Mundësim i prostitucioni	11	28	155

Përfundimi

Trafikimi me njerëz dita-ditës po bëhet prej krimeve më serioze në vend. Parandalimi dhe luftimi i kësaj dukurie duhet të zërë vend të rëndësishëm në të gjitha ato institucione shtetërore që kanë për qëllim sigurinë e qytetarëve në raport me krimin e organizuar. Edhe përkundër faktit që në Kodin Penal të Kosovës dhe në ligjin përkatës është përcaktuar qartë mënyra e parandalimit dhe ndëshkimi i atyre që e kryejnë këtë vepër penale, në praktikë numri i tyre është çdo ditë në rritje. Në këtë rast shtrohet pyetja se a po bëjnë sa duhet organet kompetente për parandalimin e kësaj dukurie apo ndëshkimi i tyre po bëhet në afatin kohor minimal e shpeshherë edhe me gjobë. Sa më të ashpra të jenë dënimet dhe politikat ndëshkimore aq më i vështirë do të jetë realizimi i planeve të këtyre grupeve kriminale.

Duke u nisur nga të dhënat zyrtare, respektivisht nga të dhënat e Policisë së Kosovës dhe Entit të Statistikave të Kosovës vërehet qartë se në njërën anë ndër vite kemi rritje të numrit të trafikantëve e në anën tjetër shumica e personave që bëjnë trafikim me qenie njerëzore apo edhe ndihmojnë në kryerjen e kësaj veprë penale marrin dënime relativisht të ulëta. Andaj, mendojmë se më ashpërsimin e dënimeve dhe politikave ndëshkimore mbase do të kemi rezultate më pozitive në rrugën drejt parandalimit dhe luftimit të trafikimit me njerëz.

Karshi masave ndëshkuese rëndësi të veçanta ka edhe trajtimi dhe risocializimi i viktimave të trafikimit në shoqëri. Edhe përkundër dispozitave për mbrojtjen e viktimave që janë paraparë në ligjin përkatës, shoqëria është ajo që duhet t'i largojë paragjykimet dhe ta pranojë viktimën, ashtu siç është duke i dhënë përkrahje për një jetë të re, për një riintegrim të saj. Pa përkrahjen e institucioneve në njërën anë, dhe shoqërisë në anën tjetër, vështirë se viktima do të arrijë t'i kthehet normalitetit.

Mr.sc. Emine Abdyli**

Human Trafficking and the Protection of the Victims of Trafficking

Summary

The phenomenon of human trafficking is considered to be one of the most serious crimes which appears as a modern form of slavery and violates in most brutal way basic human rights, the rights which are guaranteed both with local and international law. Human trafficking in Kosovo is a phenomenon which has started to increase especially after the war of 1999.

Analysis and treatment of this phenomenon requires a special attention because of its complex nature and remains a challenging task for government authorities and researchers of this criminal phenomenon. Regardless of numerous efforts and initiatives carried out by Kosovo institutions together with international institutions which act in this country for building awareness of the society, the level of this phenomenon remains high.

Human trafficking, as an organized crime, is an issue with global dimensions. Despite the fact that countries in transition with a high rate of poverty and underdeveloped economy are distinguished in various international reports, human trafficking as a negative phenomenon is present in more sophisticated forms even in developed countries. From the historical aspect, the phenomenon of human trafficking is considered to have its roots in ancient times but the form and method of its application has changed over time.

The treatment of this topic and prevention of this phenomenon should take an important place in all the institutions the aim of which is to offer security for citizens. Despite the fact that in the Penal Code of Kosovo and the relevant law prevention and punishment of those who commit this act is clearly specified, in practice their number is increasing every day. In this case the question arises whether relevant authorities are doing enough to prevent this phenomenon or its perpetrators are being punished in a minimal time period and most of the time with fines. The more harsh penalties and punishment policies are, the more difficult will be execution of the plans from these criminal groups. Therefore, we believe that with tougher penalties and punishment laws perhaps we will have more positive results on the road towards prevention of human trafficking.

** The author is a candidate for Dr.Sc. of criminal science at the University of Pristina, Faculty of Law and assistant in history – sociology.